

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes



Mbrojtja

Viti i 92-të i botimit
Prill-maj 2024 / Nr. 3



FARSH,
siguri kombëtare,
partneritet, aleancë,
mbrojtje e vlerave
Euro-Atlantike



DREJTOR I QKMBMMFA

ARBEN SKËNDERAJ

Shefe e Sektorit të Botimeve &**Kryeredaktore**

ANJEZA MUSOLLARI

GAZETARË:

MIMOZA GOLIKJA

GRAPHIC DESIGNER

AFËRDITA HYSAJ

REDAKTORE / KORREKTORE

SUELA HODA

BASHKËPUNËTORË

KOLONEL HYSNI GJERGJI

PROF. ASOC. DR. ZAHO GOLEMI

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

© *Ministria e Mbrojtjes*

Materialet e publikuara në këtë revistë nuk mund të riprodhohen elektronikisht apo fizikisht e të përdoren për qëllime përfitim, pa marrë autorizim nga botuesit e saj.

Botues:

*Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut
Drejtoria e Kulturës, Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes*

Adresa:

Rruga e Dibrës/ Garnizoni "Skënderbej"

Revista mund të gjendet në formatin elektronik (pdf) në adresën:

<http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikimel/revista-mbrojtja>

**Mbrojtja**

- Kryeministri Rama: Ambicia jonë brenda vitit 2030, të kemi eksporte ushtarake 'Made in Albania' dhe ushtria jonë të fillojë të pajiset me mjete ushtarake të markës 'Made in Albania' 4
- Ministri Peleshi: Rijetëzim i industrisë ushtarake 6
- 73-vjetori i Forcave Ajrore të Shqipërisë, Peleshi: Investimet e fundit, dëshmi e angazhimit për të garantuar sigurinë kombëtare 7
- Ministri Peleshi: Përkushtimi ynë ndaj vlerave euroatlantike, i pandryshuar, garant për paqen dhe stabilitetin në rajon 8
- Strategjia Ushtarake dhe Plani Afatgjatë i Zhvillimit mbledh gjeneralët aktivë dhe në rezervë 10
- Ministri Peleshi: Shqipëria, më afër se kurrë realizimit të ëndrrës historike, për të zënë vendin që i takon si anëtare e BE-së 12
- Ministri Peleshi: Shqipëria promovuese e fqinjësisë së mirë dhe pranimit të "njëri-tjetrit" 13
- 75 vite NATO 14
- Bashkë më të fortë 15
- Ministri Peleshi: Mbetemi të palëkundur si një aleat krenar, i besueshëm dhe i angazhuar ndaj agjendës politike 16
- Intervista/ Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Arben Kingji 19
- Gjeneralmajor Arben Kingji: Betimi ushtarak, një akt dhe premtim solemn për besnikëri ndaj Kushtetutës së RSH, për t'i shërbyer dhe mbrojtur deri në vetëmohim Atdheun 25
- SAR, seminar "Koordinimi ndërmjet agjencive në operacionet e kërkim-shpëtimit dhe bashkëpunimi me median" 28
- Shqipëria 15 vjet në NATO, gjeneralmajor Shehu: Krenarë që jemi pjesë e organizatës më të fuqishme politike-ushtarake të globit 30
- ZVSHSHPFA, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, pjesë e forumit ndërkombëtar "Gruaja, paqja dhe siguria", zhvilluar në Kosovë 32
- Efektivë të Forcave të Armatosura i bashkohen operacionit për gjetjen e trupave të mbytur në lumin Buna 34
- Kursi i Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen vizitoi Presidencën e Republikës së Shqipërisë 35
- Gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj priti studentët e Akademisë Ushtarake "West Point" 39
- U zhvillua në Northwood, Mbretëria e Bashkuar, Konferenca e Komandantëve Detarë të NATO-s 43
- Përfundon workshopi midis Gardës Kombëtare të New Jersey-it dhe Grup-Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë 44
- Oligarkët dhe Lufta 49
- Engjëjt shqiptar të paqes në panteonin e dëshmorëve të NATO-s 52
- Atdheu përjetë mirënjohës 53
- Rezervat materiale, në konceptin e integruar logjistik të NATO-s 54
- "Kjo Shqipëri ka lindur burra, që nuk njohin dy flamura" 58
- 111 vjet nga krijimi i Shtabit të Përgjithshëm 62
- Muzeu i FA-së, dëshmi historike dhe atraksion turistik me vlerë kombëtare 70
- Çfarë ndodh me civilët në luftë?! 74
- Inteligjenca artificiale kineze dhe ruse mund të fillojë Luftën e Tretë Botërore 76
- NATO, 75-vjet mbrojtje kolektive, Stoltenberg: Ne kemi ndërtuar Aleancën më të fuqishme dhe më të suksesshme në histori dhe gjatë 75 viteve të fundit 78
- Engjëj mbi Bunë 80
- Simbole të atdhetarizmit dhe antifashizmit shqiptar 83
- Gaqo Tanku, ushtaraku model, studiuesi i 'meritokracisë si kriter bazë në administratë' 90
- Gratë shqiptare që shkruan historinë me germa të arta 94
- Nga Dhërmiu në Gjirin e Gramës, riviera shqiptare, oazë e preferuar për europianët 98

28

SAR, seminar "Koordinimi ndërmjet agjencive në operacionet e kërkim-shpëtimit dhe bashkëpunimi me median"

04

Kryeministri Rama: Ambicia jonë brenda vitit 2030, të kemi eksporte ushtarake 'Made in Albania' dhe ushtria jonë të fillojë të pajiset me mjete ushtarake të markës 'Made in Albania'

06

Ministri Peleshi: Rijetëzim i industrisë ushtarake. Miratohet projektligji për ndihmën financiare për punonjësit dhe ish-punonjësit e Kombinatit Mekanik Poliçan

12

Ministri Peleshi: Shqipëria, më afër se kurrë realizmit të ëndrrës historike, për të zënë vendin që i takon si anëtare e BE-së

9 maji, Dita e Evropës, dita e rizbulimit të kujtesës dhe identitetit. Dita e Evropës është dita në të cilën kujtohen hapat e parë të integritit të komunitetit Evropian në vitet 1950, ndihmon për të rizbuluar objektivat themelore të "shtëpisë së përbashkët", në rend të parë paqen. Kështu historia jep edhe elemente për të kuptuar rrugën aktuale të BE-së, Pikërisht, si sot, më 9 maj të vitit 1950, u hodh hapi i parë...



FA, arsimim, modernizim, mobilizim, mbrojtje KRENARI KOMBËTARE!

Në harkun kohor të 111 viteve Ushtri Shqiptare, gjeneral Kingji është lideri i 27-të, nën drejtimin e të cilit ushtria jonë me një histori të lashtë, por me vizion të ri, po transformohet në standardet e ushtrive të vendeve aleate të NATO-s, pjesë e së cilës, prej vitit 2009, jemi dhe ne. Në këtë...


Faqe 19



Oligarkët dhe Lufta

Lufta, përveç të qenit përplasje e armatosur vullnetesh, shtetesh, grupesh, apo vazhdim i politikës me mjete të tjera; ajo është edhe biznesi më fitimprurës, i cila ka vetëm një të keqe: jetët e humbura, ndërsa gjithçka tjetër është para, është përfitim. Këtë shans përpiqen ta kapin një kategori e caktuar biznesmenësh, të cilët janë afër biznesit të luftës dhe afër politikës gjithashtu. Këta biznesmenë...

Faqe 49



Kryeministri Rama: Ambicia jonë brenda vitit 2030, të kemi eksporte ushtarake ‘Made in Albania’ dhe ushtria jonë të fillojë të pajiset me mjete ushtarake të markës ‘Made in Albania’

Qendra e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes, në Ministrinë e Mbrojtjes filloi aktivitetin e saj me një ceremoni prezantimi të rëndësishë dhe aktivitetit që ka kjo qendër për Forcat e Armatosura dhe jo vetëm. Të pranishëm në këtë aktivitet ishin kryeministri Edi Rama, i shoqëruar nga ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, ministra të kabinetit, deputetë dhe drejtues të lartë të FA-së, të cilët vizituan mjediset e kësaj qendre, ku u njohën me funksionet e secilës prej godinave.

Gjatë ceremonisë së zhvilluar me këtë rast, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, e cilësoi këtë si një hapje të një faqeje të re në Forcat e Armatosura dhe Ministrinë e Mbrojtjes.

“Është një faqe modernizimi, është një kalim në një fazë të re të zhvillimit të Shqipërisë që po i bashkohemi edhe ne. Është mishërim i vizionit të kryeministrit Rama për futjen e zhvillimeve në Shqipëri në lëvizjen për inovacion”, - u shpreh ministri Peleshi.

Sipas ministrit Peleshi: “Një vend me zhvillim si Shqipëria ka nevojë për të kapërcyer dhe për të rritur ritmin me ndihmën e teknologjive të reja, me ndihmën e fuqisë intelektuale të kombit

shqiptar. Ndaj ne sot jemi krenarë që i bashkohemi kësaj lëvizjeje dhe premtojmë që shumë shpejt do të japim produktet e para inovative, që do të jenë edhe model frymëzues besoj për të rinjtë shqiptarë që na janë bashkuar në Forcat e Armatosura, por edhe për të rinjtë e tjerë që të kuptojnë që e ardhmja mund të ndërtohet këtu”.

Ministri i Mbrojtjes tha se kjo qendër është pjesë e rrjetit të qendrave të ekselencës së NATO-s, duke qenë se Shqipëria është vend anëtar. “Qendrat e ekselencës së NATO-s, si anëtarë të Aleancës janë qendrat tona të ekselencës. Jemi pjesë e një network-u, që ndërveprojmë, rrisim kapacitetet tona të trajnimit, jemi në kontakt me të rejtat e fundit të inteligjencës artificiale, teknologjive të reja, të cilat kanë për qëllim të na ndihmojnë në rritjen e kapaciteteve tona të sigurisë dhe mbrojtjes, të ndërtojmë më shumë fuqi mbrojtëse me më pak burime”, - u shpreh ministri Peleshi.

Sipas ministrit Peleshi, në këtë qendër trajnohet modeli shqiptar i inteligjencës artificiale, duke përdorur dy satelitët “Albania 1” dhe

“Albania 2” dhe flotiljen e dronëve “Bayraktar”, imazhet e të cilëve analizohen sipas interesave të sektorëve.

Në fjalën e tij Kryeministri Edi Rama përgëzoi ministrinë e Mbrojtjes për punën e bërë dhe tha se Qendra e Inovacionit, Sigurisë dhe Mbrojtjes hap një tjetër faqe në modernizimin e ushtrisë shqiptare. Kryeministri Rama theksoi se: “Për t’iu përgjigjur sfidave të reja dhe nivelit të ri të angazhimit që kemi në bazë të vizionit tonë për Forcat e Armatosura të Shqipërisë 2030, një strategji e re ushtarake dhe një plan i ri i zhvillimit afatgjatë të Forcave të Armatosura janë tanimë gati dhe do t’i nënshtrohen procesit të ligjvënies në Kuvend. Ndërkohë që po përgatisim edhe platformën e re të zhvillimit të industrisë ushtarake. Ambicia jonë është që brenda vitit 2030 ne të kemi edhe eksporte ushtarake ‘Made in Albania’ dhe nga ana tjetër sigurisht që ushtria jonë do të fillojë të pajiset edhe me mjete ushtarake të markës Made in Albania”, - u shpreh kryeministri, duke theksuar vijimin e mbështetjes për efektivët e FA-së.

Nëpërmjet Qendrës së Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes, e cila i bashkëngjitet Njësisë Ushtarake të Sigurisë Kibernetike, synohet ndër të tjera të forcohen kapacitetet kombëtare në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes përmes zbatimit të projekteve inovative dhe integritimit të teknologjive të avancuara, si dhe të nxitet zhvillimi i një ekosistemi të inovacionit në siguri dhe mbrojtje.

“Qendrat e ekselencës së NATO-s, si anëtarë të Aleancës janë qendrat tona të ekselencës. Jemi pjesë e një network-u, që ndërveprojmë, rrisim kapacitetet tona të trajnimit, jemi në kontakt me të rejat e fundit të inteligjencës artificiale, teknologjive të reja, të cilat kanë për qëllim të na ndihmojnë në rritjen e kapaciteteve tona të sigurisë dhe mbrojtjes, të ndërtojmë më shumë fuqi mbrojtëse me më pak burime.”





MINISTRI PELESHI:

Rijetëzim i industrisë ushtarake

Miratohet projektligji për ndihmën financiare për punonjësit dhe ish-punonjësit e Kombinatit Mekanik Poliçan

Këshilli i Ministrave ka aprovuar sot, projektvendimin për propozimin e projektligjit: “Për financimin e detyrimit të prapambetur të pagesës së punonjësve dhe ish-punonjësve të Kombinatit Mekanik Poliçan”. Gjendja financiare e vështirë e ndërmarrjeve ushtarake, veçanërisht e Kombinatit Mekanik Poliçan, ka detyruar qeverinë të marrë masa për zgjidhjen e problemeve të mbartura për punonjësit dhe ish-punonjësit e këtij kombinati.

Ministri Peleshi pas mbledhjes së qeverisë theksoi se me aprovimin e këtij ligji në Kuvend, Ministria e Mbrojtjes do të sigurojë financim prej 83.800.000 Lek për Kombinatit Mekanik Poliçan për të mbuluar detyrimet e prapambetura të pagave të punonjësve: “Në total, 131 ish-punonjës dhe punonjës (127 ish-punonjës dhe 4 punonjës) do të përfitojnë nga ky fond për të mbuluar detyrimet e prapambetura në paga dhe kontribute shoqërore dhe

shëndetësore për periudhën 2017 - 2023”, - u shpreh ministri Peleshi. Projektligji që propozohet për miratim në Kuvend pas vendimit të sotshëm, përcakton kushtet dhe procedurat për realizimin e këtij financimi për Kombinatit Mekanik Poliçan. Ministri Peleshi u shpreh se ky hap i rëndësishëm shënon një ndihmë të rëndësishme për punonjësit dhe ish-punonjësit e kombinatit, duke adresuar një problematikë të vjetër dhe duke sjellë një ndryshim pozitiv në jetën e tyre.

73-vjetori i Forcave Ajrore të Shqipërisë, Peleshi: Investimet e fundit, dëshmi e angazhimit për të garantuar sigurinë kombëtare

Forcat Ajrore Shqiptare u krijuan zyrtarisht, më 24 prill 1951. Avionët e parë ishin avionë sovjetikë të prodhuar mbas Luftës së Dytë Botërore, "Yak-18" dhe fillimisht u dislokuan në Larakë në periferi të kryeqytetit të Shqipërisë, Tiranë. Përgjatë 73 viteve të rrugëtimit të saj kjo forcë ka pësuar transformime të mëdha. Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi në ceremoninë e organizuar me këtë rast shprehu mirënjohje dhe respekt për të gjithë ata që e krijuan dhe e ngritën lart këtë forcë dhe ata që vazhdojnë kontributin në ruajtjen e sovranitetit të vendit tonë.

Gjithashtu në fjalën e tij ministri theksoi se riaktivizimi i Bazës Ajrore Taktike të NATO-s në Kuçovë, ardhja e dy helikopterëve "Black Hawk", si dhe pajisja me dronët luftarakë "Bayraktar", janë investime historike për Forcat e Armatosura dhe hapa të rëndësishëm për modernizimin e Forcës Ajrore.

"Këto zhvillime, jo vetëm që rrisin aftësitë e mbrojtjes së Shqipërisë, por shërbejnë edhe si dëshmi e angazhimit të vendit tonë për të garantuar sigurinë kombëtare dhe për të përmbushur standardet më të larta të mbrojtjes", - vlerësoi ministri Peleshi. Lavdi dëshmorëve!





Ministri Peleshi: Përkushtimi ynë ndaj vlerave euroatlantike, i pandryshuar, garant për paqen dhe stabilitetin në rajon

"15 vjet më parë, në shpërblim të vullnetit absolut të popullit shqiptar, të etjes properëndimore të një vendi të çliruar nga izolimi total, Shqipëria u anëtarësua si vend me të drejta të plota në NATO, aleancën më të madhe politiko-ushtarake që këtë vit mbushi 75 vjet; një arritje kjo e jashtëzakonshme jo vetëm në kuptimin politik dhe diplomatik, por gjithashtu në kuptimin më të plotë të nocionit mbi sigurinë dhe mbrojtjen"

Me rastin e 15-vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, Komanda e Forcës Tokësore në Zall Herr zhvilloi "Ditën e Hapur", ku morën pjesë Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Sh. T. z. Bajram Begaj, njëherësh Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, i Ngarkuari me Punë i Ambasadës së SHBA-së David Wisner, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Arben Kingji, ministra, deputetë, ambasadorë, atashe ushtarakë, komandantë të forcave, etj.

Fillimisht të pranishmit ndoqën demonstrimet e kryera nga efektivët e Forcës Tokësore dhe trupat komando, ndërsa vizituan standat e Forcave të Armatosura, ku u prezantuan pajisjet dhe kapacitetet për mbrojtjen dhe sigurinë, sistemet e komunikimeve taktike, operacionale dhe strategjike.

Në fjalën përshëndetëse me këtë rast ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi u shpreh se: "15 vjet më parë, në shpërblim të vullnetit absolut të popullit shqiptar, të etjes properëndimore të një vendi të çliruar nga izolimi total, Shqipëria u anëtarësua si vend me



të drejta të plota në NATO, aleancën më të madhe politiko-ushtarake që këtë vit mbushi 75 vjet; një arritje kjo e jashtëzakonshme jo vetëm në kuptimin politik dhe diplomatik, por gjithashtu në kuptimin më të plotë të nocionit mbi sigurinë dhe mbrojtjen. U dhamë qytetarëve tanë mundësinë e mbrojtjes nga Aleanca më e madhe politiko-ushtarake e të gjitha kohërave dhe kjo nuk do të ishte e mundur pa mbështetjen e 26 vendeve aleate të NATO-s, asokohe”. Ministri Peleshi falënderoi vendet aleate për këtë vendim, ndërsa shprehu mirënjohjen për aleatin strategjik SHBA-në, që qëndroi krahu Shqipërisë në çdo hap të rrugëtimit drejt Aleancës.

Sipas ministrit të Mbrojtjes, sot kontributi i Shqipërisë respektohet e vlerësohet lart nga vendet mike dhe partnere, por vlerësim të veçantë ka për vendosmërinë që Shqipëria ka, për të qenë kudo ku Aleanca ka nevojë. “Përfaqësohemi me elitën e Forcave të Armatosura në krahun juglindor në Bullgari dhe Letoni si dhe kemi një prezencë të konsiderueshme ushtarake në KFOR, Kosovë, aktivitetet detare në detin Egje dhe misionin trajnues në Irak.

Ndërkohë djemtë dhe vajzat më të mira në uniformë, por edhe të tjerë kolegë të shërbimit civil shërbejnë me një profesionalizëm të spikatur në përfaqësinë tonë në Bruksel si dhe në shtabet dhe komandat e NATO-s në hapësirën euroatlantike”, - u shpreh ministri i Mbrojtjes Peleshi.

“Tashmë, 15 vite më pas, besoj se kemi hyrë në një fazë tjetër të rolit tonë në Aleancë. Nuk ka më asnjë dyshim në vendosmërinë tonë në kontribute, në qasje dhe në qëndrime.

Ne zgjedhim të jemi me aleatët tanë në çdo sfidë që kohët e turbullta, me të cilat po përballim njerëzimi do të na imponojnë. Ne qëndrojmë fort në krah të Ukrainës, popullit të saj, përpjekjeve të ushtrisë së saj për të përballuar agresionin e egër rus. Kemi ndihmuar dhe do të vijojmë të ndihmojmë popullin e Ukrainës në luftën e tij të drejtë për liri. Do të vazhdojmë gjithashtu të jemi garantët më luajalë të paqes dhe stabilitetit në rajonin tonë”, - theksoi ministri Peleshi.

Gjatë fjalës së tij, ministri Peleshi vuri theksin te inaugurimi i bazës ajrore taktike të NATO-s në Kuçovë, por edhe projekti për Porto Romanon, për ta vënë atë në dispozicion të Aleancës. Nga ana e tij, Presidenti Bajram Begaj theksoi se: “Angazhimi ynë ndaj NATO-s është i pakushtëzuar dhe tregon se jemi të gatshëm të marrim pjesë jo vetëm për mbrojtjen e kufijve tanë, por edhe për të ndihmuar e kontribuar në ruajtjen e paqes dhe



stabilitetin në rajon e më gjerë”.

Kreu i Shtetit e cilësoi anëtarësimin në NATO jo destinacion, por si një udhëtim të vazhdueshëm të Shqipërisë, - siç u shpreh ai, për të forcuar demokracinë, investimet në kapacitetet mbrojtëse, si dhe bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë për të ndërtuar një të ardhme më të sigurt e më të qëndrueshme për të gjithë. Presidenti Begaj përcolli një falënderim të veçantë ndaj Shteteve të Bashkuara për ndihmën e vazhdueshme dhe ndërhyrjen e NATO-s për çlirimin e Kosovës, duke u shprehur: “Kombi shqiptar nuk do ta harrojë kurrë këtë”. I ngarkuari me punë në ambasadën e SHBA-së, David Wisner, duke cituar fjalët e Presidentit George W. Bush, theksoi fuqinë e qëndrueshme të Aleancës: “Forca e qëndrueshme e aleancës së NATO-s është një testament për fuqinë e qëndrueshme të lirisë.

Kjo Aleancë do të udhëheqë rrugën drejt një bote më të sigurt dhe më shpresëdhënëse. Shpresoj që fëmijët tuaj t'i nderojnë gjithmonë betejat që keni përballuar. Qofshin historitë e Shqipërisë dritë për ata që mbeten në errësirën e tiranisë. Dhe shpresoj që shembulli juaj le t'i ndihmojë ata drejt një ditë më të ndritshme”, - u shpreh përfaqësuesi i SHBA-ve. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Arben Kingji u shpreh se: “Vlerësimet pozitive që marrin Forcat tona të Armatosura në stërvitjet, operacionet apo strukturën e komandimit të NATO-s, përforcojnë përkushtimin tonë për të realizuar me sukses detyrën dhe për të zhvilluar më tej bashkëpunimin me vendet aleate dhe partnere”. Në përfundim të aktivitetit të pranishmit përsëritën në një lidhje live efektivet që shërbejnë në misionet paqeruajtëse ndërkombëtare.

STRATEGJIA USHTARAKE

Plani Afatgjatë i Zhvillimit



Strategjia Ushtarake dhe Plani Afatgjatë i Zhvillimit mbledh gjeneralët aktivë dhe në rezervë

Pas finalizimit të Dokumentit të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, Ministria e Mbrojtjes ka hedhur për konsultim Strategjinë Ushtarake dhe Planin Afatgjatë të Zhvillimit.

Në një tryezë të zgjeruar, ku morën pjesë shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Arben Kingji, gjeneralë aktivë dhe në rezervë, drejtorë të Ministrisë së Mbrojtjes e komandantë të forcave të ndryshme, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi

theksoi rëndësinë e këtij procesi diskutimi e shkëmbimi mendimesh me grupet e interesit. Sipas ministrit Peleshi, zhvillimet globale dhe rajonale kanë diktuar edhe në rishikim të Strategjisë së Mbrojtjes dhe Sigurisë.

Z. Peleshi solli në vëmendje vijimin e konfliktit në Ukrainë, por edhe sulmin e paprecedentë të Iranit ndaj Izraelit: “Bota po përjeton momente historike shumë delikate. Shqipëria është e vendosur në atë pjesë

të globit, Ballkanin Perëndimor, ku konflikte të vjetra apo çështje të vjetra ndërmjet fqinjëve apo shteteve të ndryshme të këtij rajoni mund të rizgjojnë në kushtet e skenës dhe arkitekturës së tronditur të sigurisë dhe të paqes në botë”, - u shpreh ministri Peleshi.

Ai konfirmoi mbështetjen e Shqipërisë ndaj Ukrainës, duke evidentuar faktin se një tjetër paketë ndihmesh do të dërgohet brenda pak ditësh në Ukrainë.

“Kemi ndjekur së fundi zhvillimet në Lindjen e Mesme, sulmin e paprecedentë të Iranit ndaj Izraelit. Natyrisht ne qëndrojmë dhe jemi pranë Izraelit në këto ditë të vështira dhe duhet thënë që Irani është një agresor jo vetëm ndaj Izraelit. Ne e kemi përjetuar edhe vetë para rreth dy vitesh një sulm hibrid kibernetik ndaj sistemeve tona digjitale, i cili ka qenë jo i lehtë për t’u përballuar, por me mbështetjen e partnerëve tanë, por edhe të kapaciteteve tona mbrojtëse kemi arritur të shmangim më të keqen. Por këto sulme janë një sfidë e vazhdueshme”, - theksoi ministri i Mbrojtjes.

“Irani nuk ka qenë në strategjinë tonë të mbrojtjes kombëtare një kërcënim, por sot po flasim për sulme të përjetuara nga Shqipëria. Kemi ndërprerë marrëdhëniet diplomatike me Iranin, gjë që tregon që natyra e kërcënimeve ka ndryshuar”, - vuri në dukje ministri Peleshi.

Duke evidentuar përpjekjet që po bëhen për modernizimin e kapaciteteve mbrojtëse, ministri i Mbrojtjes renditi mes të tjerash hapjen e Bazës Taktike Ajrore të NATO-s në Kuçovë, duke shprehur edhe ambicien që përmes të njëjtit shembull të vihet në dispozicion të NATO-s edhe Porto Romano. Ministri i Mbrojtjes dëgjoi me vëmendje mendimet e shprehura nga të pranishmit në tryezën e zhvilluar, duke u zotuar se do të analizohen me vëmendje të gjitha propozimet.



Strategjia Ushtarake dhe plani Afatgjatë i Zhvillimit pritet që pas fazës së konsultimit të miratohen në Parlament. Planin Afatgjatë i Zhvillimit të Forcave të Armatosura përkthen objektivat e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, Strategjisë Ushtarake, skenarët e rishikimit strategjik të mbrojtjes 2013 si dhe Konceptin Strategjik të NATO-s, në kapacitete ushtarake, duke tentuar plane orientuese në pikëpamje të kohës dhe burimeve të disponueshme. Ky dokument përcakton drejtimit e zhvillimit të Forcave të Armatosura dhe orienton ngritjen e kapaciteteve të nevojshme për përmbushjen e misionit kushtetues dhe mbrojtjen kolektive mbi bazën e burimeve,

në harmoni me Sistemin e Planifikimit të Mbrojtjes së NATO-s. Në të përshkruhen mjetet, me të cilat FA-të do të përmbushin objektivat ushtarakë të përcaktuar në Strategjinë Ushtarake dhe që rrjedhin nga Strategjia e Sigurisë Kombëtare. Ndërsa Strategjia Ushtarake është dokumenti themelor që jep parimet dhe konceptet kryesore për zhvillimin, përdorimin dhe drejtimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si vend anëtar i NATO-s. Siguria dhe mbrojtja e Republikës së Shqipërisë janë pjesë e mbrojtjes kolektive të NATO-s, me përfitimet dhe detyrimet përkatëse, që rrjedhin prej saj.





Ministri Peleshi: Shqipëria, më afër se kurrë realizmit të ëndrrës historike, për të zënë vendin që i takon si anëtare e BE-së

9 maji, Dita e Evropës, dita e rizbulimit të kujtesës dhe identitetit. Dita e Evropës është dita në të cilën kujtohen hapat e parë të integrimit të komunitetit Evropian në vitet 1950, ndihmon për të rizbuluar objektivat themelore të “shtëpisë së përbashkët”, në rend të parë paqen. Kështu historia jep edhe elemente për të kuptuar rrugën aktuale të BE-së, Pikërisht, si sot, më 9 maj të vitit 1950, u hodh hapi i parë drejt Bashkimit Evropian.

Ministri i Jashtëm i Francës, Robert Schuman, lexoi për shtypin ndërkombëtar një deklaratë ku i bënte thirrje Francës, Gjër-

manisë dhe vendeve të tjera evropiane për të bashkuar prodhimet e tyre të qymyrit dhe çelikut, “themeli i parë konkret për një Federatë të ardhshme Evropiane”. Vendet të cilave u drejtohej thirrja kishin dalë të rrënuara materialisht dhe moralisht nga konfliktet me njëra-tjetrën.

Ajo që propozonte Schuman ishte krijimi i një institucioni evropian mbikombëtar, i cili do të administronte industrinë e prodhimit të qymyrit dhe çelikut, sektor i cili në atë kohë ishte baza e fuqisë ushtarake. Vite më vonë, në Samitin e Milanos, më 1985, krerët e BE-së vendosën që data 9 maj të

shpallej dhe të festohej si “Dita e Evropës”. Shumë pranë kësaj familjeje të madhe është dhe Shqipëria, e cila ëndrrën evropiane, vegim prej 50 vitesh është gati për ta bërë realitet. Në urimin e kësaj dite, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi do të shprehej: “Në Ditën e Europës, reflektojmë mbi rrugën tonë drejt një Shqipërie që është gjithnjë e më pranë ëndrrës evropiane. Sot, festojmë bashkëpunimin, diversitetin dhe arritjet tona, duke rikujtuar vlerat themelore që frymëzojnë idealin e një Europe të bashkuar dhe paqësore: liria, demokracia, barazia dhe të drejtat e njeriut”.



Ministri Peleshi: Shqipëria promovuese e fqinjësisë së mirë dhe pranimit të “njëri-tjetrit”

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi mori pjesë në Ministerialin e Bashkëpunimit të Mbrojtjes të Europës Qendrore dhe Ballkanit Perëndimor (Central European Defence Cooperation + Western Balkans), që u kryesua nga presidenca hungareze, në Budapest.

Në fjalën e mirëseardhjes, ministri i Mbrojtjes i Hungarisë, Kristóf Szalay-Bobrovniczky vlerësoi kontributin e iniciativës së CEDC-së, në forcimin e bashkëpunimit rajonal në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë, duke theksuar se vendet e Evropës Qendrore e kanë në fokusin e tyre Ballkanin Perëndimor dhe për këtë ky rajon ka qenë dhe mbetet një nga prioritetet kryesore të iniciativës CEDC.

Nga ana e tij, ministri Peleshi u shprehu mirënjohjen vendeve të CEDC-së, për fok-

usin dhe vëmendjen që i kushtojnë Ballkanit Perëndimor, duke vënë theksin te përfshirja e 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor e njëherësh, duke vlerësuar maksimalisht përfshirjen e Kosovës në këtë nismë. Ministri i Mbrojtjes Peleshi rikonfirmoi angazhimin e Ministrisë së Mbrojtjes në çdo bashkëpunim rajonal/ndërkombëtar që ka si qëllim përballimin e sfidave të kohës, rritjen e ndërveprimit në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes si dhe sigurimin e paqes dhe stabilitetit.

Më tej ministri Peleshi evidentoi sfidat, me të cilat po përballet rajoni ynë, që nga pasojat e luftës në Ukrainë, influencat e huaja me qëllim destabilizimin e Ballkanit Perëndimor, duke përmendur veçanërisht situatën e tensionuar në veri të Kosovës pak kohë më parë. Ministri Peleshi theksoi se: “Dialogu ndërmjet Serbisë dhe Kosovës,

aq fort i promovuar dhe kërkuar nga Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara, është e vetmja zgjidhje për mos cenimin e integritetit dhe paqes në rajon”.

Peleshi theksoi se Ministria e Mbrojtjes e Shqipërisë do të vijojë të jetë një nga kontribuueset më të mëdha të bashkëpunimit rajonal, të promovimit të fqinjësisë së mirë, të mbështetjes së parimit të pranimit të njëri - tjetrit dhe gjithëpërfshirjes, të ruajtjes së paqes dhe sigurisë në rajon dhe më gjerë. Gjatë këtij takimi u prezantuan dhe prioritetet si dhe kalendari i aktiviteteve që do të zhvillohen gjatë kryesimit hungarez të CEDC-së.

Iniciativa CEDC, por dhe formati, në kuadër të saj, dedikuar Ballkanit Perëndimor, ka forcuar bashkëpunimin dhe koordinimin midis shteteve të Evropës Qendrore dhe Ballkanit Perëndimor.

75 vite NATO

Kur dhe pse lindi NATO?

Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut, NATO, lindi më 4 prill 1949, kjo është dita në të cilën, në Uashington, u nënshkrua "Pakti Atlantik", mbrojtja themeluese e NATO-s.

Ai u nënshkrua nga përfaqësues të 12 vendeve: Belgjika, Kanadaja, Danimarka, Franca, Islanda, Italia, Luksemburgu, Norvegjia, Holanda, Portugalia, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara.

Konteksti i krijimit të NATO-s ishte ai i Luftës së Ftohtë, i dominuar nga dy blloqe të mëdha kundërshtarë, ai lindi i formuar nga Bashkimi Sovjetik dhe shtetet e tij satelitore, dhe ai përfundimor, i udhëhequr nga SHBA-të dhe që përfshinte vendet që nënshkruan marrëveshjen.

Duke filluar nga viti 1953, kërret e saj zgjodhën si stemë një trëndafil ere me katër vija, një për çdo pikë kardinal, që simbolizonte rrugët ideale drejt paqes (të gjitha në një sfond blu, një aludim për Oqeanin Atlantik, emblemë e bashkimit midis Amerikës dhe Evropës.

"Qëllimi i NATO-s është të mbajë amerikanët brenda aleancës, rusët jashtë dhe gjermanët nën kontroll", deklaroi në atë kohë Sekretari i Përgjithshëm i saj, Hastings Lionel Ismay në detyrë nga viti 1954 deri në 1957.

Në fund të Luftës së Dytë Botërore, SHBA-të donin të siguronin një prani ushtarake në arenën evropiane, në një çelës anti-rus, kontroll mbi Gjermaninë – përgjegjëse për konfliktin, e cila nga viti 1949 u nda në Gjermaninë Perëndimore dhe Lindore.

Qëllimi i NATO-s

Traktati i Atlantikut të Veriut (NATO) ishte kryesisht i fjetur derisa Lufta Koreane nisi krijimin e NATO-s për ta zbatuar atë, me anë të një strukture të integruar ushtarake, kjo përfshinte formimin e Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në Evropë (SHAPE) në 1951, i cili miratoi Strukturat dhe planet ushtarake të Western Union, duke përfshirë STANAG-të dhe SOFA-të dypalëshe. Në vitin 1952, u vendos posti i Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, si shefi civil i organizatës. Atë vit u zhvilluan gjithashtu stërvitjet e para të mëdha detare të NATO-s, Ushtrimet "Mainbrace" dhe pranimiti i Greqisë dhe Turqisë në organizatë. Pas Konferencave të Londrës dhe Parisit, Gjermanisë Perëndimore iu lejua të riarmatosej ushtarakisht, pasi ajo u bashkua me NATO-n në maj 1955, e cila ishte, nga ana tjetër, një faktor kryesor në krijimin e Traktatit të Varshavës të dominuar nga sovjetikët, duke përcaktuar dy anët kundërshtarë të Luftës së Ftohtë.

Ndërtimi i Murit të Berlinit në vitin 1961 shënoi një kulm në tensionet e Luftës së Ftohtë, kur 400 000 trupa amerikane u vendosën në Evropë. Dyshimet mbi fuqinë e marrëdhënieve midis shteteve evropiane dhe Shteteve të Bashkuara u zbehën dhe rrodhën, së bashku me dyshimet mbi besueshmërinë e mbrojtjes së NATO-s kundër një pushtimi të mundshëm sovjetik, dyshime që çuan në zhvillimin e parandalimit të pavarur bërthamor francez dhe tërheqjes të Francës nga struktura ushtarake e NATO-s në vitin 1966. Në vitin 1982, Spanja iu bashkua aleancës. Revolucionet



e vitit 1989 në Evropë çuan në një rivlerësim strategjik të qëllimit, natyrës, detyrave dhe fokusit të NATO-s në atë kontinent.

Në tetor 1990, Gjermania Lindore u bë pjesë e Republikës Federale të Gjermanisë dhe aleancës, dhe në nëntor 1990, aleanca nënshkroi Traktatin për Forcat e Armatosura Konvencionale në Evropë (CFE) në Paris me Bashkimin Sovjetik. Ai urdhëroi reduktime specifike ushtarake në të gjithë kontinentin, të cilat vazhduan pas rënies së Paktit të Varshavës në shkurt 1991 dhe shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik në atë dhjetor, i cili largoi kundërshtarët kryesorë de facto të NATO-s. Kjo filloi një tërheqje të shpenzimeve dhe pajisjeve ushtarake në Evropë. Traktati CFE lejoi nënshkruarit të hiqnin 52 000 pjesë të armatimeve konvencionale në gjashtëmbëdhjetë vitet e ardhshme, dhe lejoi që shpenzimet ushtarake nga anëtarët evropianë të NATO-s të bien me 28% nga 1990 deri në 2015.

Në vitet 1990, organizata i zgjeroi aktivitetet e saj në situata politike dhe humanitare që nuk kishin qenë më parë shqetësime të NATO-s. Gjatë shpërbërjes së Jugosllavisë, organizata kreu ndërhyrjet e para ushtarake në Bosnje nga viti 1992 deri në 1995 dhe më vonë në Jugosllavi në vitin 1999. Këto konflikte motivuan një ristrukturim të madh ushtarak të pas Luftës së Ftohtë. Struktura ushtarake e NATO-s u shkurtua dhe u riorganizua, me forca të reja, të tilla si Korpusi i Reagimit të Shpejtë të Komandës Aleate të Shtabit të Evropës. Ndryshimet e shkaktuara nga kolapsi i Bashkimit Sovjetik në ekuilibrin ushtarak në Evropë që nga traktati CFE u njohën në Traktatin e Forcave të Armatosura Konvencionale të Përshtatura në Evropë, i cili u nënshkrua në samitin e Stambollit të vitit 1999.

Politikisht, organizata kërkoi marrëdhënie më të mira me vendet e reja autonome të Evropës Qendrore dhe Lindore, dhe forume diplomatike për bashkëpunimin rajonal midis NATO-s dhe fqinjëve të saj u krijuan gjatë kësaj periudhe të pas Luftës së Ftohtë, duke përfshirë nismën e Partneritetit për Paqe dhe Dialogut Mesdhetar në 1994, Këshilli i Partneritetit Euro-Atlantik në 1997 dhe Këshilli i Përhershëm i Përbashkët NATO-Rusi në 1998. Në samitin e Uashingtonit të vitit 1999, Hungaria, Polonia dhe Republika

Çeke u bashkuan zyrtarisht në NATO dhe organizata gjithashtu nxori udhëzime të reja për anëtarësimin në "Plane Veprimi për Anëtarësim" të individualizuara. Këto plane rregulluan shtimin e anëtarëve të rinj të aleancës: Bullgaria, Estonia, Letonia, Lituania, Rumania, Sllovakia dhe Sllovenia në 2004, Shqipëria dhe Kroacia në 2009, Mali i Zi në 2017 dhe Maqedonia e Veriut në 2020. Zgjedhja e Presidentit francez Nicolas Sarkozy në 2007 çoi në një reformë të madhe të pozicionit ushtarak të Francës, duke kulmuar me kthimin në anëtarësimin e plotë më 4 prill 2009, e cila përfshinte gjithashtu ribashkimin e Francës në Strukturën e Komandës Ushtarake të NATO-s, duke ruajtur një pengesë të pavarur bërthamore.

Neni 5 i traktatit të Atlantikut të Veriut, që kërkon që shtetet anëtare t'i vijnë në ndihmë çdo shteti anëtar që i nënshtrohet një sulmi të armatosur, u thirr për herë të parë dhe të vetme pas sulmeve të 11 shtatorit, pas së cilës trupat u vendosën në Afganistan, nën ISAF të udhëhequr nga NATO. Organizata ka operuar një sërë rolesh shtesë që atëherë, duke përfshirë dërgimin e trajnerëve në Irak, ndihmën në operacionet kundër piraterisë dhe në vitin 2011, zbatimin e një zone ndalim-fluturimi mbi Libi në përputhje me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1973. Neni 4, i cili thjesht thirret në konsultim ndërmjet anëtarëve të NATO-s, është thirrur pesë herë pas incidenteve në Luftën e Irakut, Luftës Civile Siriane dhe aneksimit të Krimesë nga Rusia. Ky aneksim çoi në dënimin e fortë nga vendet e NATO-s dhe krijimin e një force të re "majë shtize" prej 5000 trupash në bazat në Estoni, Lituani, Letoni, Poloni, Rumania dhe Bullgari. Në samitin pasues të Uellsit të vitit 2014, udhëheqësit e shteteve anëtare të NATO-s u zotuan zyrtarisht për herë të parë që të shpenzonin ekuivalentin e të paktën 2% të prodhimit të tyre të brendshëm bruto për mbrojtjen deri në vitin 2024, që më parë kishte qenë vetëm një udhëzues joformal. Në vitin 2014, vetëm 3 nga 30 anëtarë të NATO-s arritën këtë objektiv (përfshirë SHBA-në); deri në vitin 2020 kjo ishte rritur në 11. Të marra së bashku, në vitin 2020, 29 shtetet jo-anëtare të SHBA-së patën gjashtë vite radhazi rritje të shpenzimeve të mbrojtjes, duke e çuar shpenzimin e tyre mesatar në 1.73% të PBB-së. Anëtarët e NATO-s i kanë rezistuar Traktatit të Ndalimit të Armëve Bërthamore të OKB-së, një marrëveshje detyruese për negociatat për eliminimin total të armëve bërthamore, e mbështetur nga më shumë se 120 vende.

15 vite, Shqipëria në NATO

Gjatë viteve '80, Shqipëria ishte vendi më i izoluar i Evropës dhe pas rënies së Murit të Berlinit, strehë e rrënojës së fundit të komunizmit e diktaturës staliniste në kontinent. Deri në vitin 1990, aleanca e fundit ushtarake, pjesë e së cilës kishte qenë vendi ynë, ishte Traktati i Varshavës, anëtarët e të cilit përbëheshin nga të gjitha vendet e bllokut komunist të Evropës Lindore (me përjashtim të Jugosllavisë) dhe që udhëhiqej nga Bashkimi Sovjetik. Shqipëria ishte anëtarësuar në këtë aleancë në vitin

1955, për t'u shkëputur më pas përfundimisht në vitin 1968, pas ndërprerjes së marrëdhënieve diplomatike me këtë të fundit. Pas përmbyesjes së regjimit komunist, Shqipëria u bashkua Këshillit të Bashkëpunimit të Atlantikut të Veriut, organizëm i krijuar nga NATO me qëllim rindërtimin e marrëdhënieve me vendet e dala nga Traktati i Varshavës.

Dy vite më vonë, më 23 shkurt 1994, Presidenti i Shqipërisë asokohe, nënshkroi Marrëveshjen e Partneritetit për Paqe mes NATO-s dhe vendeve të ish-bllokut komunist dhe paraqiti po në të njëjtën ditë, kërkesën zyrtare të Shqipërisë për t'u bashkuar Aleancës. Kështu, në 1999, Shqipërisë iu dërgua Plani i Veprimit për Anëtarësimin, vendet anëtare të NATO-s nënshkruan Protokollin e Anëtarësimit për Shqipërinë dhe Kroacinë, në Samitin e Bukureshtit të mbajtur, më 2 prill 2008, dhe Shqipëria filloi zyrtarisht negociatat e anëtarësimit, më 25 prill të po këtij viti. Reformat e gjithanshme, të zbatuara me sukses, në kuadër të ratifikimit të protokollit, bënë që më 1 prill 2009, Shqipëria të anëtarësohej në strukturat e Aleancës, duke shënuar kështu një prej arritjeve më të mëdha historike për vendin, si dhe përmbushjen e një prej objektivave madhore të politikës së jashtme dhe sigurimit e avancimit të interesave kombëtare. Statusi i Shqipërisë, si vendi i parë ish-komunist që kishte shprehur haptazi dhe qartë, nëpërmjet një kërkesë zyrtare, vullnetin për anëtarësim në NATO, i dha asaj një rol të veçantë strategjik në Evropën Lindore, si një shtet, që megjithëse i vogël, kishte arritur të vendoste një trend të ri gjeopolitik për këtë pjesë të kontinentit.

Modernizimi i forcave të armatosura Shqiptare

Avantazhet më të mëdha dhe më të frytshme të bashkëpunimit të Shqipërisë me Aleancën e Atlantikut të Veriut, janë pa dyshim ato të fuqizimit ushtarak, modernizimit të teknologjisë ushtarake, si dhe forcimit e reformimit të institucioneve të mbrojtjes. Duke iu përgjigjur detyrimeve të vendit si aleat ndaj NATO-s, Forcat e Armatosura Shqiptare janë dërguar përgjatë 15 viteve të fundit për të kontribuar në një sërë misionesh të rëndësishme paqeruajtëse në Afganistan, Detin Egje, Irak, etj. Më 4 mars të këtij viti, u përrua baza e parë taktike ajrore e NATO-s në Ballkanin Perëndimor, ajo e Kuçovës. Ky projekt nisi në janar të dy viteve më parë dhe kushtoi rreth 45,8 milionë euro. Vendimi i Aleancës për të ndërtuar këtë bazë, pikërisht në Shqipëri, forcon jo vetëm bashkëpunimin mes saj e vendit tonë, por thekson gjithashtu edhe rolin strategjik ushtarak të Shqipërisë si aleati më i rëndësishëm i Perëndimit në rajon.

Statusi i vendit anëtar të NATO-s, dhe së fundmi edhe ai i vendit kandidat në Bashkimin Europian, i japin Shqipërisë një pozicion të veçantë në kuadër të forcimit të sigurisë në Evropën Juglindore, në mbështetje të linjës politike të koordinimit të ngushtë mes Aleancës dhe Unionit, përballë kërcënimeve në rritje nga shtete me synime ekspansioniste, siç është Rusia. Sulmi në Ukrainë, i dënuar me ashpërsi nga NATO, ngriti së fundmi alarmin për sigurinë në Evropë, duke theksuar nevojën e rritjes së shpenzimeve qeveritare për mbrojtjen, për të arritur objektivin prej 2% të PBB (Prodhimit të Brendshëm Bruto), të miratur unanimisht nga të gjitha vendet aleate në vitin 2014.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg u ka bërë së fundmi thirrje 18 vendeve aleate që nuk e kanë arritur akoma këtë objektiv, për t'u kujdesur për përmbushjen e tij deri në fund të këtij viti.

Duke pasur parasysh rritjen e influencës së Rusisë në Ballkan, të dhënat e raportit duhet të jenë kampioni alarmi për Shqipërinë si aleat kryesor i NATO-s dhe Perëndimit në këtë rajon delikat.

Në këtë 15-vjetor të udhëtimit të përbashkët nga Ambasda e SHBA-së në Tiranë duke e vlerësuar si "një aleat dhe partner të besueshëm" vjen urimi "15 Vite së Bashku, Udhëtimi i Shqipërisë me NATO-n. Që nga anëtarësimi në NATO në 2009, zhvillimi i Shqipërisë në një partner dhe aleat të besueshëm ka qenë vërtet i jashtëzakonshëm".



Bashkë më të fortë

Mesazhi i Presidentit të Republikës: “1 prilli i vitit 2009 jetësoi vizionin Euroatlantik të shqiptarëve për të qenë pjesë e Aleancës politiko-ushtarake më të fuqishme të kohës sonë. Ky anëtarësim realizoi aspiratën e kahershme të popullit shqiptar, duke e kthyer atë te përkatësia e vet perëndimore, e mishëruar që në filozofinë e heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastriotit, si strateg i aleancës së parë politiko-ushtarake me Perëndimin.

Anëtarësimi i Shqipërisë në NATO është një ndër datat më të rëndësishme të historisë sonë kombëtare. Mirënjohës ndaj popullit shqiptar, SHBA-ve dhe aleatëve, të cilët mundësuan realizimin e këtij anëtarësimi.

Shqipëria në këto 15 vite në NATO ka sjellë më shumë siguri për vendin, rajonin dhe hapësirën Euroatlantike. Krenar për efektivet e Forcave tona të Armatosura, si dhe vajzat e djemtë shqiptarë në misionet paqeruajtëse dhe operacionet e NATO-s, si: Afganistan, Irak, Bosnjë, Kosovë, Bullgari, Letoni dhe Deti Egje. Shqipëria do të vijojë të jetë e palëkundur që, së bashku me aleatët, të mbrojtë lirinë e të kontribuojë për një botë në paqe.”



Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi: “15 vjet më parë Shqipëria u bë zyrtarisht anëtare me të drejta të plota e Aleancës më të fortë politiko-ushtarake të NATO-s. Në këtë përvjetor ajo qëndron e palëkundur në misionin e saj krahas SHBA-ve dhe aleatëve e partnerëve të saj, në mbrojtje të paqes dhe sigurisë në Botë.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi shpreh qëndrimin e palëkundur të qeverisë shqiptare për të vijuar rrugëtimin e përbashkët drejt një të ardhmeje të sigurt. Krenarë që jemi pjesë e kësaj historie. Përkushtimi ynë ndaj vlerave euroatlantike do të vazhdojë të mbetet i pandryshuar”, - shprehet Ministri Peleshi në mesazhin e tij me rastin e përvjetorit të 15-të të anëtarësimit në NATO. Ministri Peleshi e konsideron anëtarësimin e Shqipërisë në NATO një moment historik dhe dëshmi të dedikimit të vendit tonë për sigurinë dhe stabilitetin rajonal. “Në këto vite, vendi ynë ka treguar përkushtim të palëkundur ndaj vlerave të Aleancës dhe ka kontribuar në misionet e paqes dhe sigurisë nëpër botë. Mirënjohje të gjithë efektiveve të Forcave të Armatosura për kontributin dhe angazhimin tuaj për të bërë këtë rrugë të mundur. Vazhdojmë të punojmë për një të ardhme më të sigurt dhe të qëndrueshme për të gjithë”, - tha Peleshi. Me pjesëmarrjen e efektiveve më të mirë të Forcave të Armatosura në misionet ndërkombëtare, Shqipëria i është bashkuar përpjekjeve të Aleancës për të përballuar sfidat e sigurisë, duke u vlerësuar si një aleatë dinjitoze e NATO-s. Në përmbushje të detyrimeve ndaj Aleancës, Shqipëria ka rritur ndjeshëm mbështetjen buxhetore për mbrojtjen, duke arritur objektivin 2 % të Prodhimit të Brendshëm Bruto dhe vijon modernizimin dhe rritjen e kapaciteteve brenda Forcave të Armatosura.

Gjithashtu, më 4 mars 2024, u inaugurua baza taktike ajrore e NATO-s në Kuçovë, e cila do të jetë në funksion të misioneve të NATO-s, si pika e vetme strategjike e Aleancës në Ballkanin Perëndimor.



Kryeministri Rama: “Ky 15-vjetor i anëtarësimit të Shqipërisë në NATO nuk është vetëm një festë e arritjeve tona të së shkuarës, por edhe një riafirmim i përkushtimit tonë të palëkundur ndaj parimeve dhe vlerave që mbështesin Aleancën tonë. Gjatë 15 viteve të fundit, Shqipëria ka kontribuar me krenari në mbrojtjen kolektive dhe sigurinë e NATO-s, dhe ne mbetemi të palëkundur në përkushtimin tonë për të mbështetur paqen dhe vlerat demokratike në të gjithë rajonin tonë dhe më gjerë”.



Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Arben Kingji: “Krenar që Shqipëria është një vend aleat i besueshëm, promovues dhe mbrojtës i paqes, vlerave demokratike dhe sigurisë kolektive. Përgjatë shumë viteve jemi angazhuar dhe vijojmë të kontribuojmë në një sërë misionesh të drejtuara nga NATO, BE e OKB, krahas partnerëve dhe aleatëve strategjikë. Ky përvjetor i gjen Forcat e Armatosura në një proces transformimi dhe modernizimi që nga rishikimi i dokumenteve strategjike, implementimi i projekteve të reja me fokus rritjen e kapaciteteve operacionale, fuqisë së zjarrit, mbrojtjen kundërajrore dhe kibernetike, për t'i përmbushur më së miri detyrimet kombëtare dhe ndaj Aleancës.

Në këtë epokë të karakterizuar nga sfida komplekse të sigurisë, ku po cenohen vlerat e lirisë dhe demokracisë, NATO është më e bashkuar dhe më e fortë se kurrë!”.

Ministri Peleshi: Mbetemi të palëkundur si një aleat krenar, i besueshëm dhe i angazhuar ndaj agjendës politike

Me rastin e 15-vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë dhe Kroacisë në Aleancën e NATO-s, në Bruksel u organizua një ceremoni e veçantë, ku i pranishëm ishte edhe ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi. Gjatë fjalës së tij përshëndetëse me rastin e këtij përvjetori, Ministri Peleshi vlerësoi se kjo aleancë qëndron sot, ashtu si 75 vjet më parë, si një fener për parimet e demokracisë, lirisë individuale dhe shtetit të së drejtës.

Ministri i Mbrojtjes theksoi gjatë fjalës së tij mbështetjen e qartë të vendit tonë ndaj kësaj aleance, ndërsa vuri në dukje edhe përpjekjet që i janë dashur Shqipërisë ndër vite të renditet mes aleatëve të saj në NATO, ku sot ka një rol të vlerësuar tejet pozitivisht. “Sot, ne mbetemi të palëkundur si një aleat krenar, i besueshëm dhe i angazhuar ndaj agjendës politike, institucionale dhe ushtarake të NATO-s. Do të vazhdojmë të përmbushim që të tria detyrat thelbësore të NATO-s, ashtu siç kemi bërë kurdoherë e kudo që ka qenë e nevojshme të radhitemi krah për krah me Aleatët dhe Partnerët tanë”, - u shpreh Ministri Peleshi. Shqipëria, vijoi



gjatë fjalës së tij ministri Peleshi, nuk do të kursejë asnjë përpjekje për të vazhduar kontributin në Aleancë, teksa vendet përballen me një mjedis më të pasigurt dhe të rrezikshëm të sigurisë që nga fundi i Luftës së Ftohtë. Ministri Peleshi theksoi edhe një herë mbështetjen ndaj Ukrainës, por tha se, ky është gjithashtu momenti për të mbajtur një sy ndaj Ballkanit Perëndimor. “Nëse rajoni tani gëzon stabilitet dhe prosperitet më të madh, kjo është edhe

për shkak të rolit të NATO-s në ndalimin e masakrave dhe spastrimit etnik të viteve 1990, veçanërisht në Bosnje-Hercegovinë dhe Kosovë. Ne nuk duhet të lejojmë që fitoret që kemi bërë të zhbëhen dhe të humbasim vigjilencën tonë”, - theksoi Peleshi. Ministri i Mbrojtjes së Shqipërisë e mbylli fjalën e tij, duke theksuar punën që po bëhet në modernizimin dhe transformimin e mbrojtjes dhe sigurisë, duke evidentuar edhe rritjen e buxhetit të mbrojtjes për këtë vit.





Nënshkruhet Memorandumi i Bashkëpunimit mes Qendrës Kombëtare të Kërkim - Shpëtimit dhe Tirana International Airport

Nënshkruhet Memorandumi i Mirëkuptimit dhe Bashkëpunimit midis Qendrës Kombëtare të Kërkim - Shpëtimit (QKKSH) në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Tirana International Airport sh.p.k. (TIA): “Për bashkëpunimin në operacionet e kërkim - shpëtimit në zonën e përgjegjësisë së TIA”. Ky memorandum shënon një hap të rëndësishëm në forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit të operacioneve të kërkim-shpëtimit (Search And Rescue - SAR) në zonën e përgjegjësisë së TIA. Duke u nisur nga Marrëveshja e Koncessionit që i jep TIA të drejtën dhe autoritetin për menaxhimin dhe operimin e aeroportit, me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje konfirmohet vullneti i dy palëve për të përmirësuar sigurinë teknike dhe reagimin e shpejtë në rastet e emergjencave të SAR në këtë zonë të aeroportit. Me nënshkrimin e këtij Memorandumi, TIA dhe QKKSH zotohen për zbatimin e kushteve të për-



caktuara në të dhe për koordinim të vazhdueshëm për çdo ndryshim operacional, që mund të ndikojë në operacionet e SAR në këtë zonë të rëndësishme të aeroportit. Ky bashkëpunim reflekton përkushtimin e

të dyja palëve për sigurinë dhe mbrojtjen e qytetarëve dhe vizitorëve të aeroportit, duke u nisur nga përgjegjësia dhe detyrimi për t'u përgjigjur në mënyrë të shpejtë dhe efektive në situata emergjente të SAR.



Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Arben Kingji

FA, arsimim, modernizim, mobilizim, mbrojtje KRENARI KOMBËTARE!

Intervistoi: **ANJEZA MUSOLLARI**,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Në harkun kohor të 111 viteve Ushtri Shqiptare, gjeneral Kingji është lideri i 27-të, nën drejtimin e të cilit ushtria jonë me një histori të lashtë, por me vizion të ri, po transformohet në standardet e ushtrive të vendeve aleate të NATO-s, pjesë e së cilës, prej vitit 2009, jemi dhe ne. Në këtë linjë historike, i pari drejtues i Forcave të Armatosura të shtetit të Pavarur Shqiptar ishte Ali Shefqet Shkupi.

I nderuar gjeneral, për të rinjtë dhe të rejtat të cilët po shtojnë radhët e ushtrisë shqiptare dhe po na bëjnë krenarë kudo ku japin kontributin e tyre, si u krijua kjo strukturë dhe cili ishte qëllimi i saj?

Kjo intervistë përkon me një datë të rëndësishme në historikun e Forcave të Armatosura, në të cilën përkujtojmë 111-vjetorin e krijimit të Shtabit të Përgjithshëm, i cili në atë kohë njihej me emrin “Shtati Madhuer” dhe më tej u emërua “Shtabi Madhuer”.

Kjo strukturë u krijua nën kujdesin e veçantë të Qeverisë së Vlorës, të kryesuar nga Ismail Qemali, dhe si shef i parë i shtabit u emërua major Ali Shefqeti (Shkupi), i cili më parë kishte mbajtur detyrën e komandantit të Garnizonit të Stambollit.

Ndonëse në fillimet e tij, ai ishte një shtab fare i vogël, krijimi dhe angazhimi i këtij shtabi u konceptua si një strukturë me një rol dhe rëndësi të veçantë për organizimin, përgatitjen dhe drejtimin profesional të veprimtarisë luftarake të Forcave të Armatosura.

Në aspektin organizativ shtabi varej nga Ministria e Luftës dhe për funksionimin e tij u krijuan qarqet e Shtatit Madhuer si sekretaria, komisioni i rregulloreve dhe ushtrimeve, komisioni i trajnimit të policisë dhe xhandarmërisë, dhe komisioni i ndërtimit.

Në rrugëtimin e tij 111-vjeçar, Shtabi i Përgjithshëm ka siguruar një vend të nderuar në historinë e Forcave të Armatosura dhe shtetit shqiptar, në sajë të angazhimit në përballimin e sfidave të mëdha të ekzistencës së shtetit dhe kombit shqiptar, zhvillimit, dhe përparimit të tij në gjirin e kombeve të qytetëruar.

Ndaj, në këtë përvjetor të 111-të gjej rastin të vlerësoj dhe shpreh mirënjohjen për shefat e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura ndër vite, për rolin e tyre të pazëvendësueshëm në zhvillimin, transformimin dhe modernizimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Cili është vizioni juaj mbi transformimin dhe reformimin e Forcave të Armatosura, tashmë pjesë e ngushtë e Aleancës?

Dinamikat e mjedisit aktual të sigurisë, goditja e përsëritur nga fuqi të mëdha të sistemit ndërkombëtar të mbështetur në rregulla, zhvillimet e teknologjisë dhe koncepteve doktrinarë, shtrojnë domosdoshmërinë e të pasurit të një Force të Armatosur që zotëron cilësi dhe aftësi të veçanta.

Në këtë drejtim, fokusi im si shef i Shtabit të Përgjithshëm është që Forcat e Armatosura, të jenë të kompletuara me personel, të mirë pajisura me armatim dhe teknikë të avancuar, të mirë trajnuara, të stërvitura dhe të motivuara, të gatshme dhe të afta të kryejnë misionin e tyre kushtetues dhe të përmbushin detyrimet euroatlantike, duke vepruar në mënyrë të pavarur dhe/ose në përbërje të Aleancës,



në respekt të vlerave që e udhëheqin në realizimin e misionit, të përkushtuara, të përgjegjshme dhe të vendosura për t'i shërbyer popullit shqiptar, si dhe sigurisë dhe paqes në rajon dhe më gjerë. Më konkretisht, në vizionin tim për periudhën 2022 – 2025 drejtimet kryesore të zhvillimit fokusohen në:

- Një forcë ushtarake efektive, të kompletuar, përshtatshme, dhe të ndërveprueshme.
- Zhvillimin, menaxhimin dhe motivimin e personelit, nëpërmjet meritokracisë, transparencës, trajtimit dhe shpërblyerimit financiar, arsimit dhe kualifikimit, përkujdesjes, si dhe përmirësimit të kushteve të punës, stërvitjes e jetesës.
- Trajnimit, kualifikimit dhe arsimit të personelit, të mbështetur në programet bashkëkohore që zhvillohen në Akademinë e Forcave të Armatosura, Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë, qendrat stërvitore dhe institucionet arsimore të vendeve partnere dhe aleate jashtë vendit.
- Një forcë të gatshme dhe të aftë. Në përgjigje të sfidave të sigurisë që shtrihet koha dhe situata, FA-ja do të rishikojë dhe harmonizojë nivelet e gatishmërisë së reagimit për realizimin e detyrimeve kombëtare dhe atyre të Aleancës, në përputhje me Planet e

Mbrojtjes Kombëtare edhe ato rajonale të NATO-s. Fokusi do të jenë kapacitetet e deklaruara në NATO, duke ruajtur dhe konsoliduar nivelin e gatishmërisë për grup-batalionin e këmbësorisë së lehtë, si kontributi kryesor ndaj Aleancës, por edhe me kapacitete niche, siç janë: EOD, MADM, SOLTG etj.

- Zhvillimin e kapaciteteve, duke kushtuar vëmendje në investimet në sisteme, pajisje dhe infrastrukturë, të cilat do të përmirësojnë kapacitetet ekzistuese, krijojnë kapacitete të reja, rrisin aftësitë operacionale dhe do të ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmbushjen e nivelit të ambicies.

- Projektet e zhvillimit të infrastrukturës ushtarake me fokus përmirësimin e kushteve të punës, jetesës dhe stërvitjes së personelit, si dhe rritja e nivelit të sigurisë në ruajtjen e instalimeve dhe materialeve ushtarake.

- Përmirësimin e funksionimit të sistemit logjistik, për sigurimin e kapaciteteve të mbështetjes logjistike të domosdoshme për FA-në dhe mbështetjen e operacioneve brenda dhe jashtë vendit.

- Intensifikimin e bashkëpunimit me aleatët strategjikë dhe NATO-n, të orientuar drejt arsimit, trajnimit, stërvitjes dhe modernizimit të Forcave të Armatosura.

Si prioritet kryesor për vitet në vijim mund të përmend: Modernizimin, zhvillimin dhe rritjen e kapaciteteve dhe aftësive operacionale të FA-së. Në këtë kuadër vëmendjeje e veçantë do t'i kushtohet konsolidimit, ruajtjes dhe zhvillimit të kapaciteteve të Grup-batalionit të Këmbësorisë së Lehtë, Forcave Speciale, kapaciteteve EOD, kapaciteteve të Mbrojtjes nga Armët e Dëmtimit në Masë, dhe zhvillimin e kapaciteteve të Mbrojtjes Kibernetike; Rishikimin e dokumenteve strategjikë të Strategjisë Ushtarake dhe Planit Afatgjatë të Zhvillimit të FA-së dhe masat për zbatimin e tyre; Aktivizimin dhe organizimin e komponentit rezervist në Forcat e Armatosura; Përmirësimin e paketës ligjore ushtarake; Zhvillimin e projekteve të infrastrukturës ushtarake; Përmirësimin e sistemit të rekrutimit, përkujdesjes dhe promovimit të ushtarakëve; Konsolidimin e sistemit të arsimit ushtarak.

A ka një strategji për zhvillimin dhe menaxhimin e burimeve njerëzore të FA-së?

Burimet njerëzore janë një ndër elementët kryesorë të burimeve të mbrojtjes, ndaj zhvillimi i tyre përgjatë ciklit jetësor të personelit: rekrutimit, arsimit, emërimi në detyrë, promovimi në gradë dhe karrierë, dalja në rezervë dhe në pension është e një rëndësie të madhe për Forcat e Armatosura.

Aktualisht është në fuqi “Strategjia e menaxhimit të burimeve njerëzore 2020 – 2024”, dhe ka filluar puna për hartimin e strategjisë për pesëvjeçarën e ardhshme. Kjo strategji është e ndarë në katër kapituj dhe është e shoqëruar me Planin e Veprimit për zbatimin e strategjisë, ku specifikohen detyrat për strukturat drejtuese dhe bashkëpunuese për realizimin e objektivave të saj.

Në strategji shqyrtohet konteksti i përgjithshëm i menaxhimit të burimeve njerëzore, jepen udhëzime sektoriale për mbrojtjen, aspekte aktuale të rëndësishme të fushës, vizionin dhe objektivat që synohen të arrihen dhe përgjegjësitë e strukturave për zbatimin efektiv të saj, monitorimin, raportimin dhe llogaridhënien.

Cila është qasja mbi zhvillimin e kapaciteteve dhe modernizimin e Forcave të Armatosura?

Siç e theksova dhe më lart, si pjesë e Planit Afatgjatë të Zhvillimit të Forcave të Armatosura, modernizimi, zhvillimi dhe rritja e kapaciteteve operacionale të Forcave të Armatosura janë prioriteti kryesor i punës tonë. Investimet në sisteme, pajisje dhe infrastrukturë do të përmirësojnë kapacitetet ekzistuese, krijojnë kapacitete të reja, rrisin aftësitë operacionale dhe do të ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë

në përmbushjen e nivelit të ambicies.

Sisteme të mbështetjes me zjarr; sisteme raketash kundërtanke "Javelin", sisteme të mbrojtjes ajrore të bazuar në tokë me reze shumë të shkurtër veprimi "Stinger", pajisje të komunikimit taktik C4I (CIS statike dhe e dislokueshme); kapacitete të Forcës Ajrore dhe Forcës Detare; pajisjet e zbulimit (ISTAR/HUMINT); modernizimi i Qendrës së Simulimit; kapacitetet për realizimin e operacioneve për emergjencat civile dhe investimet në infrastrukturë do të jenë projektet kryesore.

Rol të rëndësishëm në procesin e modernizimit të Forcave të Armatosura do të luajë dhe mbështetja e konsiderueshme e partnerëve tanë strategjikë, NATO dhe BE.

Cilët janë hapat që janë ndjekur për përmirësimin e sistemit të rekrutimit, përkujdesjes dhe promovimit të ushtarakëve?

Rekrutimi i kandidatëve për ushtarë/detarë aktualisht nuk është në nivelet që duam, dhe kjo është një problematikë që haset dhe në vendet më të zhvilluara aleate dhe partnere. Qendra e Personel Rekrutimit, si struktura përgjegjëse për këtë çështje, ka ndërmarrë një sërë masash me qëllim informimin e publikut dhe promovimin e aktivitetit të Forcave të Armatosura, për t'i bërë ato një alternativë tërheqëse në sytë e brezit të ri.

Po kështu, është bërë ridislokimi i zyrave të seksioneve të rekrutimit, duke i vendosur ato në vende të përshtatshme dhe me vizibilitet të lartë, dhe janë përmirësuar aktet ligjore e nënligjore për rekrutimin në Forcat e Armatosura.

Për sa i përket përkujdesjes dhe promovimit të ushtarakëve, siç e theksova më lart, aktualisht është në funksion "Strategjia e menaxhimit të burimeve njerëzore 2020 – 2024" dhe plani i saj i veprimi, që kanë si fokus trajtimin e ushtarakëve përgjatë gjithë ciklit jetësor në Forcat e Armatosura, nga rekrutimi deri në daljen në rezervë dhe pension.

Gjithashtu, janë ndërmarrë një sërë nismash ligjore që kanë si fokus motivimin e personelit ushtarak nëpërmjet trajtimit me pagë, pagesës për kushte të veçanta pune dhe shërbimi, trajtimin me banesë sociale, qera banese, trajtimin me kredi të butë kjo për ushtarakët aktiv dhe për familjarët e tyre.

Cilat janë prioritetet e FA-së, në implementimin e sistemit e arsimit të lartë ushtarak, qasja dhe harmonizimi i edukimit dhe trajnimit në FA?

Arsimimi, trajnimi dhe kualifikimi i personelit në FARSH-së mbështetet në programet bashkëkohore që zhvillohen nga Akademia e Forcave të Armatosura (AFA), Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë (KMS), Qendrat/seksionet Stërvitore dhe institucionet arsimore të vendeve partnere dhe aleate jashtë vendit.

AFA, si i vetmi institucion ushtarak i arsimit të lartë që përgatit oficerët e ardhshëm të FARSH-së, e cila që nga viti 2020 e në vijim ka implementuar sipas ligjit të arsimit të lartë, hapjen e programeve të ciklit të parë Bachelor në: Shkenca Ushtarake, Teknologji Informacioni në fushën e mbrojtjes; Navigim Detar në fushën e mbrojtjes, këto dy të fundit në bashkëpunim me Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës.

FARSH nëpërmjet AFA-së, nga viti 2021, ka vijuar hapjen e ciklit të dytë të studimeve "Master profesional" për "Siguri kibernetike në fushën e mbrojtjes".

Gjithashtu, në vitin akademik 2023-2024, ka kaluar në riorganizimin e sistemit arsimor të oficerit sipas sistemit Bachelor (4-vjeçar), mbështetur në modelin dhe përvojën e Akademisë "West-Point" në SHBA, duke implementuar tre programe bashkëkohore: "Marrëdhënie Ndërkombëtare në fushë mbrojtjes"; "Shkenca Komunikimi në fushën e mbrojtjes"; "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi në fushën e mbrojtjes", si dhe duke i dhënë prioritet

modernizimit të infrastrukturës stërvitore dhe akademike (ndërtimi i Kampusit të ri) dhe aplikimit të standardeve të vlerësimit institucional dhe të programeve të studimit (riakreditimi institucional).

Akademia synon përgatitjen e ekselencës, por edhe të dijes për personelin ushtarak dhe civil në FARSH e më gjerë. Oficeri i ardhshëm i FA-ve do të përgatitet me një arsimim dhe formim të plotë akademik, të karakterit, formim ushtarak (leadership) dhe përgatitje speciale fizike, për të kryer me efektshmëri detyrën e liderit në çdo situatë në funksion të misionit kushtetues.

Prioritet për FA-të, përpos kalimit në një sistem 4-vjeçar Bachelor, viti 2024 shënon një hap tjetër të rëndësishëm, ku krahas programeve aktuale të studimit, AFA do të ofrojë dy programe të reja studimi në ciklin e dytë "Master i Shkencave" në "Siguri dhe Politika Ndërkombëtare" dhe "Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale".

Prioritet të veçantë do të ketë hapja e ciklit të tretë, programi i doktoratës, i cili parashikohet në vitin akademik 2026-2027, duke përmbushur dhe harmonizuar detyrimet e ligjit të arsimit të lartë për zhvillimin e të tre cikleve të studimit.

FARSH ka implementuar studime të karakterit tekniko-shkencor në fushën e mbrojtjes e të sigurisë kombëtare që i paraprin mjedisit strategjik, duke zhvilluar aktivitete shkencore dhe kërkimore në fushat e studimeve të mbrojtjes e të sigurisë, udhëheqjes strategjike, artit ushtarak, menaxhimit strategjik dhe planifikimit të mbrojtjes. FA nëpërmjet AFA-së synon të zhvillojë: Projekte kërkimore; Veprimtari mësimore; Projekte në ndihmë të institucioneve; Projekte në interes të të tretëve, në lidhje me fushën e mbrojtjes e të sigurisë kombëtare.

"Defender 21" dhe "Defender 23" u byllën me sukses, të cilat janë një bashkërendim mes kaq shumë vendesh, çfarë synojnë këto stërvitje?

Stërvitjet e serisë "DEFENDER", siç e thotë dhe vetë emri, kanë si synim angazhimin dinamik të forcave në Evropë në mbështetje të NATO-s, në kuadër të shkurajimit dhe rritjes së gatishmërisë. Ato kanë si fokus dislokimin strategjik të forcave të ushtrisë amerikane në Evropë, testimin e elementëve të mbështetjes dhe ndërveprueshmërinë me aleatët dhe partnerët në vendet e zhvillimit të këtyre stërvitjeve. Në të dy këto stërvitje u demonstrua aftësia e forcave amerikane dhe atyre aleate e partnere për t'u integruar së bashku dhe për të kryer operacione të shkallës së lartë.

Forcat e Armatosura në të dy këto stërvitje u përfaqësuan në mënyrë dinjitoze, duke treguar një nivel të lartë profesionalizmi. Në DE-21 ne u testuam me sukses për kapacitetet tona në rolin e mbështetjes së vendit pritës, ndërsa në DE-23 Forcat e Armatosura shkuan edhe më tej, duke drejtuar me sukses një nga task forcat e kësaj stërvitjeje, atë të krahut jugor, duke marrë vlerësime tejet pozitive për përmbushjen me sukses të objektivave të kësaj stërvitjeje.

Përveç këtyre stërvitjeve, Forcat e Armatosura kanë qenë të angazhuara dhe në një sërë stërvitjesh të tjera dy ose shumë palëshe, brenda dhe jashtë vendit ku janë vlerësuar për performancën dhe përkushtimin e treguar.

Vitin që shkoi, Shqipëria ishte mikpritëse e Stërvitjes "Strong Balkan", një stërvitje shumë e rëndësishme në kuadër të iniciativës rajonale të Shefave të Shtabit të Ballkanit, iniciativë që ka si fokus rritjen e bashkëpunimit ushtarak të shteteve ballkanike, duke kontribuar në sigurinë dhe stabilitetin rajonal.

Një tjetër stërvitje e rëndësishme që vlen për t'u përmendur është stërvitja tre shkallëshe "Përpjekja e përbashkët", e cila do të zhvillohet në muajin qershor të këtij viti, në të cilën do të testohen edhe elementë të planit kombëtar të mbrojtjes, në mbështetje të Planit Rajonal Juglindor të NATO-s.

Po kështu, do të merret pjesë në konferencën kryesore planëzuese të stërvitjes DEFENDER Europe 25, e cila do të zhvillohet në vendin tonë në muajin korrik, do të angazhohemi me një grup special në stërvitjen rajonale në kuadër të Iniciativës së Shefave të Shtabit të Ballkanit, që do të zhvillohet në muajin tetor në Maqedoninë e Veriut, do të vijojnë përgatitjet për stërvitjen certifikuese të Grup-batalionit të Këmbëtorisë së Lehtë që do të zhvillohet në vitin 2026, dhe shumë stërvitje të tjera, në nivele të ndryshme, brenda ose jashtë vendit.

Lidhur me angazhimin tuaj në krye të FA-së, si do ta vlerësonit ju bashkëpunimin ushtarak mes Shqipërisë dhe SHBA-së, marrë shkas dhe nga këto dy stërvitje?

Bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes ndërmjet Shqipërisë dhe SHBA-së filloi zyrtarisht me vendosjen e marrëdhënieve dypalëshe, dhe sidomos me vendosjen e atashut tonë ushtarak në vitin 1992 dhe hapjen pranë Ministrisë së Mbrojtjes, në vitin 1993, të Zyrës së Bashkëpunimit Ushtarak (ODC).

Që nga ajo kohë, mbështetja e SHBA-së ka qenë e pakursyer, duke përfshirë mbështetjen e konsiderueshme të dhënë përgjatë proceseve të transformimit, zhvillimit dhe modernizimit të Forcave të Armatosura.

Porë në këndvështrimin e arsimit dhe stërvitjes, mbështetja e SHBA-së ka luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin profesional të personelit të Forcave të Armatosura.

Trajnimi dhe arsimimi realizohet kryesisht nëpërmjet programit IMET dhe me Gardën Kombëtare të shtetit të New Jersey-it. Bashkëpunimi me Gardën Kombëtare realizohet në kuadër të Programit të Partneritetit të Shteteve (State Partnership Program).

Bashkëpunimi me palën amerikane, për kurset IMET ka filluar që nga viti 1993 e në vazhdim. Gjatë kësaj periudhe kanë ndjekur kurse institucionale dhe funksionale, personel ushtarak dhe civil, rreth 900 veta, si dhe rreth 400 veta janë trajnuar në Shqipëri nga ekipet trajnuese amerikane.

Në sajë të bashkëpunimit me SHBA-të, është mundur edhe procesi i transformimit të Akademisë së Forcave të Armatosura, sipas modelit të Akademisë "West Point".

Për stërvitjet dhe trajnimet e përbashkëta, përveç serisë së stërvitjeve DEFENDER, do të doja të përmendja stërvitjet taktike të Grup-batalionit të Këmbëtorisë së Lehtë, trajnimi integruar dhe rritja e aftësive taktike; trajnimi për EOD, zhvillimi i nënoficerëve; dhe trajnimin e studentëve ushtarakë.

Në interes të transformimit të mëtejshëm të Forcave të Armatosura, ne kemi prezent ekipe këshillues nga SHBA-të në Grup-batalionin e Këmbëtorisë së Lehtë, përveç këshilltarëve që kemi të atashuar pranë Qendrës së Personel Rekrutimit dhe në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së.

A ka investime të realizuara nga SHBA-të dhe cilat janë ato?

Ndihma e SHBA-së për Forcat tona të Armatosura është materializuar përmes Zyrës së Bashkëpunimit për Mbrojtjen (ODC) dhe Atashut Ushtarak Amerikan, nëpërmjet iniciativave të përbashkëta, aktiviteteve të ndryshme, programeve të arsimit dhe trajnimit, operacioneve të përbashkëta jashtë vendit etj.

Përveç mbështetjes në fushën e arsimit dhe stërvitjes që përmenda më lart, SHBA-të kanë dhënë një ndihmë të vazhduar në rritjen e kapaciteteve operacionale dhe modernizimin e Forcave të Armatosura.

Si shembuj konkret mund të përmend ngritjen e Qendrës Operacionale të Sigurisë Kibernetike, bashkëfinancimin për blerjen e helikopterëve "Black Hawk", që iu shtuan flotës sonë ajrore në fillim të këtij viti, mbështetjen me mjete të blinduara, armatim dhe pajisje për Grup-batalionin e Këmbëtorisë së Lehtë, etj.



Cilat janë disa nga masat që FARSH-të kanë ndërmarrë në vijim të përforcimit të konceptit të shkurajimit dhe mbrojtjes së Aleancës?

Agresioni i paprecedentë Rus kundër një shteti të pavarur e sovran, Ukrainës, ishte katalizatori i shumë ndryshimeve në Aleancë, ku më kryesorja ishte ndryshimi i përqaesjes për mbrojtjen kolektive. Për NATO-n para mbrojtjes vjen shkurajimi, koncept ky që synon frenimin e kundërshtarit apo kundërshtarëve nga ndërmarrja e veprimeve ushtarake që cenojnë territoret e vendeve të Aleancës. Në këtë drejtim, NATO kërkon që vendet, të jenë të përgatitura për luftë, pasi kjo është mënyra më e mirë e shkurajimit.

Vlen të theksohet se si e gjithë NATO-ja edhe vendi ynë jemi tërësisht të dedikuar ndaj paqes dhe nuk kërkojmë në asnjë moment luftë. Sidoqoftë, përgatitja për luftë është mënyra më e mirë për të garantuar paqen dhe vlerat e demokracisë dhe mënyra më e besueshme për të shkurajuar një agresion të mundshëm.

Në kuadër të këtyre përshtatjeve, NATO ka harmonizuar planëzimin e mbrojtjes dhe planëzimin operacional dhe nuk planifikon më mbi bazën e kapaciteteve por mbi bazën e rrezeve për të garantuar mbrojtjen kolektive.

Nëse do të shihnim se çfarë masash kemi marrë në këtë kuadër do ta nisja me pjesëmarrjen me trupa dhe kapacitete përgjatë kufirit lindor dhe jugor të NATO-s, konkretisht në Letoni dhe në Bullgari, e cila në vijim do të rritet edhe me prezencën në Rumani.

Po ashtu, masë e rëndësishme është sinkronizimi i planeve kombëtare të mbrojtjes me planet Rajonale të Aleancës, të quajtur ndryshe Familja e Planeve të NATO-s. Në këtë kuadër FARSH-të planëzojnë zhvillimin e kapaciteteve sipas kërkesave në mbështetje të planeve rajonale.

Për shkak se Planet Rajonale përfshijnë edhe lëvizjen e trupave, FARSH po zhvillon kapacitetet si vend pritës, duke vendosur në dispozicion të Aleancës infrastrukturën për mbështetjen e këtyre planeve. Këtu mund të përmend Bazën Ajrore të Kuçovës, e cila tashmë është përfshirë në listën e Bazave Ajrore Taktike të Aleancës, por edhe terminalin ushtarak të Portit të Porto Romanos.

Vlen gjithashtu të përmendend edhe investimet strategjike në korridorin 8-të, i cili shtrihet nga Durrësi në Varna (Bullgari), nga Adriatiku në Detin e Zi dhe që do të mundësonin lëvizjen e shpejtë të formacioneve të mëdha nëpërmjet territorit tonë.

Qeveria shqiptare ka deklaruar gatishmërinë e saj për të rivitalizuar industrinë ushtarake, në veçanti të prodhimit të municioneve, i cili mbetet angazhim domethënës për mbështetjen e Familjes së Planeve dhe të konceptit të shkurajimit dhe mbrojtjes së Aleancës.

Po në kuadër të mbështetjes së këtij koncepti, FARSH-të kanë

ndërmarrë një sërë projektsh modernizimi, ku më kryesoret janë: Mbrojtja ajrore e bazuar në tokë (me reze të shkurtër dhe të mesme); Helikopterë “Black Hawk”, mbështetja me zjarr (artilери deri në 155mm); Sisteme Ajrore pa pilot dhe sisteme kundër sistemeve ajrore pa pilot; Sisteme kundër tanke; Kapacitet e mbrojtjes kibernetike etj. Rëndësi për zhvillimin e kapaciteteve dhe ndërveprueshmërinë kanë edhe stërvitjet e përbashkëta, të cilat mundësojnë ushtrimin edhe përgatitjen e formacioneve, në kushte sa më realiste, për të testuar planet apo ato CPX për ushtrimin dhe testimin e komandim-kontrollit. Në këtë kuadër mund të përmend stërvitjet “Steadfast Deterrence 24” (CAX/CPX) dhe “Brilliant Jump 24” (FTX) që organizohen nga SHAPE, “Defender Europe 2025”, e cila po planifikohet të zhvillohet përsëri në Shqipëri, “Neptun Strike 24” LIVEX, drejtohet nga SHAPE dhe pjesërisht zhvillohet në Sazan etj.

Çfarë roli luajnë FARSH-të, në kuadër të bashkëpunimit rajonal? FARSH-të luajnë një rol shumë aktiv në kuadrin e bashkëpunimit ushtarak rajonal, duke arritur një bashkëpunim të fortë, të ngushtë dhe të suksesshëm ushtarak, si në planin rajonal dhe atë ndërkombëtar. Kjo pasi e shohim si mundësi për të kontribuar në ruajtjen e paqes, stabilitetit dhe sigurisë rajonale. Dëshiroj të sjell në vëmendjen tuaj se kjo përfaqëse e FARSH-së është në mbështetje të linjës kombëtare për forcimin e rolit rajonal dhe ndërkombëtar të RSH.

Aktualisht vendi ynë drejton dy iniciativat më të rëndësishme rajonale të bashkëpunimit ushtarak, Forumin e SHSHP-së të vendeve të Ballkanit (BCHOD) dhe iniciativa SHBA-Karta e Adriatikut (A-5) dhe së shpejti, më 6 qershor, do të organizojmë në vendin tonë Konferencat e SHSHP-së të BCHOD (dhe në shtator) të SHSHP-së të vendeve të A-5.

Drejtimin e këtyre dy iniciativave e shohim si mundësi, jo vetëm për të promovuar vendin dhe FARSH-të, por edhe për të përbushur politikat e qeverisë shqiptare lidhur me politikën e dyerve të hapura në të gjitha nismat rajonale dhe promovimin e paqes, stabilitetit dhe sigurisë.

Në kuadrin e integritit në NATO, BE dhe në iniciativat e tjera rajonale si A5, bashkëpunimi rajonal i kontribuon integritit të Kosovës dhe vendeve të rajonit në forumet dhe organizatat më të gjera ndërkombëtare, duke përafuar politikat, zhvilluar kapacitetet e përbashkëta dhe rritur ndërveprueshmërinë e kapaciteteve të mbrojtjes.

Rajoni i Ballkanit ka një histori tensionesh etnike, konfliktesh dhe destabiliteti, ku FARSH-të nëpërmjet bashkëpunimit ushtarak midis vendeve të rajonit shoh një mundësi për të punuar së bashku dhe ofruar kontributin për të adresuar sfidat e përbashkëta të sigurisë.

Bashkëpunimi më i thelluar është në fushat e stërvitjes, kërcënimeve asimetrike përfshi ato kibernetike, si dhe emergjencave civile. Aktualisht çdo vit zhvillohet të paktën një stërvitje e përbashkët me vendet e Ballkanit, krahas aktivitete trajnuese e stërvitore me disa aleatë dhe partnerë të ngushtë, pasi nëpërmjet stërvitjeve të përbashkëta ushtarake, programeve dhe nismave të bashkëpunimit, mund të ndërtohet besimi dhe të arrihet mirëkuptimi, duke reduktuar rrezikun e përshkallëzimit ushtarak.

Nëse ende nuk jemi në fazën ku të bashkëpunojmë për zhvillimin intensiv të kapaciteteve të përbashkëta ushtarake, ka dy struktura ushtarake rajonale, SEEBRIG, e cila për tre vite do të drejtohet nga një komandant shqiptar dhe “Balkan Medican Task Force”. Nga ana tjetër po zhvillojmë kapacitete dypalëshe dhe rajonale për emergjencat, si dhe jemi në procesin e nënshkrimit të një marrëveshjeje rajonale për lëvizjen e pandërprerë dhe të shpejtë të forcave, mjeteve dhe informacionit.

Dua të theksoj se vendi ynë, si anëtar i NATO-s, i jep rëndësi parësore bashkëpunimit nën këtë ombrellë, duke promovuar kornizat e bashkëpunimit që ofron Aleanca dhe pjesëmarrjes në misionet, operacionet dhe angazhimet e saj, ku prioritet do të jetë kontributi në misionin e NATO-s në Kosovë (KFOR).

Si vend kandidat për anëtarësim në BE, mbetemi të përkushtuar për të punuar me BE-në dhe me partnerët e aleatët evropianë, ku përputhen interesat tona, për të kundërshtuar dhe penguar influencat e huaja dhe për t’u mbrojtur kundër kërcënimeve të përbashkëta të sigurisë. Forumi i “Balkan CHOD”, A-5, DECI, SEDM, RACVIAC, “Adriatic” etj., shihen si mjete për të shtyrë para këtë axhendë.

Sa të përfshirë janë FARSH-të në misionet dhe operacionet e drejtuara nga NATO, BE dhe OKB?

Forcat e Armatosura janë angazhuar dhe marrin pjesë aktive në operacione dhe misione të ndryshme të drejtuara nga NATO, BE, OKB dhe koalicionet vullneti me partnerët tanë strategjike.

Më 9 shtator 1996, FARSH-të kanë filluar misionin e parë në Bosnjë-Hercegovinë dhe prej atëherë numri i trupave pjesëmarrëse në Misionet dhe Operacionet e drejtuara nga NATO/BE dhe OKB nuk është ndërprerë madje është rritur, siç është rritur edhe gjeografikisht numri i vendeve apo rajoneve ku ato kanë kryer operacione.

Forcat e Armatosura, aktualisht janë të angazhuara në tetë misione në kuadër të NATO-s, BE-së, dhe OKB-së. Si vend anëtar i NATO-s, ka patur dhe do të ketë prioritet kontributet në misionet, operacionet dhe angazhimet e saj, ku më i rëndësishmi do të jetë kontributi në misionin e NATO-s në Kosovë (KFOR). Përveç trupave të dislokuara, gjatë këtij viti do të dislokohej edhe një nënrepart këmbësorie në nivel



toge dhe në vitet në vazhdim po planifikohet shtimi i kontributit edhe me një tjetër nënrepart këmbësorie në nivel toge.

Sikurse e përmenda më sipër, në kuadër të familjes së planeve dhe masave të shkurajimit dhe mbrojtjes së Aleancës, FARSH-të janë prezentë me trupa dhe kapacitete në kufirin lindor dhe jugor të NATO-s, në Letoni e në Bullgari dhe në vijim do të jemi prezent edhe në Rumani.

Po ashtu, FARSH-të marrin pjesë në misionin e NATO-s në Irak, me detyra trajnimit dhe këshillimi. Forca detare nga ana tjetër merr pjesë me një anije patrulluese “Lisus”, në misionin “Aegean Sea”, në detin Egje.

Në mbështetje të axhendës integruese të vendit tonë në BE, FARSH do të rrisë prezencën në misionet e drejtuara nga BE, duke filluar me rritjen e trupave me një nënrepart këmbësorie në nivel toge, në misionin e BE-së, ALTHEA, në Bosnje-Hercegovinë dhe me një nënrepart këmbësorie në nivel kompanie, si pjesë e grup-batalionit



të Bashkimit Evropian 2024 (EUBG 24), të cilët dislokohen vetëm për stërvitje dhe në rast se aktivizohet grup-batalioni EUBG 24.

Për sa i përket misionëve në kuadër të OKB-së, vendi ynë kontribuon me personel në Sudanin e Jugut, angazhim ky që do ta vazhdojmë dhe në të ardhmen.

Në bashkëpunim me aleatët strategjikë, FARSH-të marrin pjesë me personel në "Multinational Force and Observations" (MFO), në Sinai, Republika Arabe e Egjiptit.

Vitin që shkoj FARSH implementoi strukturën e re organizative. Cili ishte qëllimi i këtyre ndryshimeve dhe ku konsistojnë ato?

Lufta në Ukrainë tregoi rrezikun konvencional, i cili është një rrezik i prekshëm dhe real për Aleancën, dhe në këto kushte FARSH duhej t'i përshtatet dhe të adoptohet me mjedisin e ri.

Mësimet e nxjerra nga Lufta në Ukrainë, midis të tjerave, nxorën në pah domosdoshmërinë e zhvillimit të kapaciteteve specifike që do të nevojiteshin si për ruajtjen e forcave, edhe për ruajtjen e infrastrukturës kritike dhe popullsisë civile.

Konkretisht struktura e re reflekton këtë nevojë, përveç të tjerave edhe me krijimin e detashmentit të UAV dhe Batalionit të Mbrojtjes Kundër Ajrore.

Struktura konsideron edhe detyrimet e vendit tonë në kuadër të NATO-s, ndryshimet e kohëve të fundit në Aleancë, ku harmonizimi i Planifikimit të Mbrojtjes me Planifikimin Operacional dhe kalimi në Modelin e ri të Forcës të NATO-së, i cili implikon edhe Forcat tona të Armatosura, kërkon më tepër kapacitete të luftimit, mbështetjes së luftimit dhe mbështetjes me shërbime të luftimit.

Kur flasim për Forcat e Armatosura, e rëndësishme ngelet gatishmëria, ndërrueshmëria dhe ulja e kohës së reagimit në rast kërcënimi dhe rreziku, e cila domosdoshmërisht kërkon edhe rritjen e kapaciteteve operacionale me të cilat siguron mbulimin e gjithë territorit të vendit. Konkretisht struktura e re, krahas Regjimentit të Operacioneve Speciale, Grup-Batalionin e Këmbësorisë së Lehtë, që kanë qenë me strukturën e mëparshme, tani ka edhe dy Regjimente këmbësorie, Regjimentin e mbështetjes me luftim, si dhe dy distrikte detare, krahas atyre që përmenda më sipër (Detashmentin UAV dhe Batalionin i Mbrojtjes Kundërajrore).

Përfshirja në strukturat e FARSH-së të konceptit të ri rezervist, duke shtuar rreth 2100 ushtarakë rezervistë në strukturat e FARSH-së është një tjetër risi e kësaj strukture.

Megjithëse vendi ynë ka pasur eksperiencë me rezervistët, bëhet fjalë për një koncept të ri, i cili nuk do të jetë i lehtë për t'u zbatuar por do të ofrojë zgjidhje për disa nga sfidat me të cilat përballen FARSH-të aktualisht.

Megjithëse mbrojtja e vendit tonë mbështetet në mbrojtjen kolektive në kuadër të Aleancës, struktura e re konsideron edhe elementin e qëndrueshmërisë duke krijuar forca dhe kapacitete të afta për

t'u përgjigjur sfidave dhe kërcënimeve me strukturat e saj, duke përbushur rolin dhe përgjegjësitë, për realizimin e një spektri të gjerë operacionesh dhe detyrash brenda dhe jashtë vendit.

Në thelb, ndryshimet konsistojnë në riorganizimin, shtimin dhe krijimin e kapaciteteve të reja për mbrojtjen ajrore, kundërtanke, kundër mjeteve fluturuese pa pilot dhe rritjen e kapaciteteve të fuqisë së zjarrit dhe kapaciteteve NICHE (EOD, CBRN).

Çfarë mund të na thoni rreth ndryshimeve ligjore që janë iniciuar në kuadër të FARSH-së?

Ndryshimet strukturore, por edhe kërkesat për rritjen e kapaciteteve të kërkuara për plotësimin me personel, kanë shtuar domosdoshmërinë për përmirësimin e kuadrit ligjor, për sa i përket menaxhimit të personelit që aktualisht shërben në Forcat e Armatosura dhe krijimin e hapësirave ligjore për rritjen e rekrutimit për qytetarët që dëshirojnë të jenë pjesë e Forcave të Armatosura.

Në fokus të ndryshimeve ligjore prioritet është mbështetja e personelit që punon në Forcat e Armatosura për një trajtim financiar të njëjtë me vendet e Aleancës (NATO-s), rregullimin e karrierës ushtarake. Këto ndryshime konsistojnë në: Rishikimin e paketës sociale të ushtarakut (statusi i ushtarakut), trajtimi me pagë, me kushte të veçanta pune dhe shërbimi, trajtimi me banesë sociale, qira banese, trajtimi me kredi të butë kjo për ushtarakët aktiv dhe për familjarët e tyre; Rishikimi i ligjit për karrierën ushtarake (i cili tashmë është fakt), ku kemi rregulluar më mirë hierarkinë e gradave dhe funksioneve, ruajmë kapacitetet nëpërmjet plotësimit të strukturave të reja me personel, rritim motivimin e personelit në forcat e armatosura si dhe i japim një dimension të ri sistemit të përparimit në gradë të ushtarakëve të Forcave të Armatosura; Rishikimi i ligjit për pushtetet dhe autoritet, ku përcakton më mirë hierarkinë dhe linjën e komandimit në Forcat e Armatosura; Hartimi i projekt-ligjit për Komponentin Rezervist, si nevojë dhe domosdoshmëri, për funksionimin e këtij komponenti.

Pas miratimit të SSK-së, a mendoni se është momenti për të rishikuar SU-në dhe PAZHFA-në?

Strategjia e Sigurisë Kombëtare (SSK), e cila u miratua pak kohë më parë, qëndron në krye të hierarkisë së dokumenteve strategjike dhe kjo e bën domosdoshmëri edhe rishikimin e Strategjisë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë dhe PAZHFA-së për të reflektuar ndryshimet dhe për ta harmonizuar me SSK-në. Sidoqoftë, SSK është vetëm një nga arsyet, pasi ndryshimet në mjedisin e sigurisë Globale dhe rajonale dhe sfidat e reja me të cilat përballemi pas agresionit rus kundër Ukrainës, Konfliktit Izrael-Hamas, ndikimi i huaj rus/kinez/iranian në Ballkanin Perëndimor, sulmet kibernetike kundër vendit tonë dhe ngjarjet në Banjskë, e kanë bërë gjithashtu të domosdoshme rishikimin e SU-së dhe PAZH-së. Ndërkohë mbajmë parasysh se SU-ja e fundit është miratuar në vitin 2015 dhe koha e ka tejkaluar atë dhe bërë të nevojshme rishikimin, jo vetëm prej ndryshimeve në mjedisin e sigurisë, por edhe zhvillimeve teknologjike, të cilat kanë qenë intensive dhe realiteti në të cilin jetojmë është i ndryshëm nga ai i 10 viteve më parë. Nga ana tjetër edhe zhvillimet e kohëve të fundit në NATO, me Konceptin e ri Strategjik 2022 dhe Strategjinë Ushtarake të NATO-s 2019, si dhe miratimit të dy koncepteve për zbatimin e SU-së (Konceptit për Shkurajimin dhe Mbrojtjen e Zonës Euro-Atlantike dhe Konceptit themelor për zhvillimin e Luftimit). Kohët e fundit Aleanca ka kaluar nëpër ndryshime rrënjësore për sa i përket planifikimit të mbrojtjes dhe planëzimit operacional me Familjen e Planeve dhe planet rajonale të Aleancës. Nga ana tjetër të gjitha vendet Aleate po rikonceptojnë mbrojtjen, rolin e FA-së dhe shoqërisë dhe domosdoshmërinë e zhvillimit të kapaciteteve kombëtare të mbrojtjes. Të gjitha këto kishin nevojë të reflektoheshin edhe në dokumentet strategjike kombëtare në fushën e mbrojtjes, duke filluar me SU-në.



Gjeneralmajor Arben Kingji: Betimi ushtarak, një akt dhe premtim solemn për besnikëri ndaj Kushtetutës së RSH, për t'i shërbyer dhe mbrojtur deri në vetëmohim Atdheun

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralmajor Arben Kingji, mori pjesë në ceremoninë e betimit të 139 ushtarëve të rinj në Regjimentin e Këmbësisë së Jugut në Poshnjë, Berat.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, ishin të pranishëm gjithashtu edhe zëvendëskomandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj, komandanti i Qendrës së Personel Rekrutimit, kolonel Fadil Ciroku, drejtues të pushtetit vendor dhe lokal, oficerë, nënoficerë, ushtarë, etj.

SHSHPFA gjeneralmajor Arben Kingji e cilësoi ceremoninë e betimit ushtarak si një ditë të veçantë në karrierën e ushtarakut, një akt dhe premtim solemn për besnikëri ndaj Kushtetutës së RSH, për t'i shërbyer dhe mbrojtur deri në vetëmohim Atdheun. "...Kjo është një ditë e shënuar edhe për Regjimentin e Këmbësisë së Jugut dhe për Forcat e Armatosura, pasi shtohen në radhët tona ushtarakë të edukuar, të motivuar, të përgjegjshëm për detyrat që u ngarkohen dhe që kultivojnë respektin për eprorët dhe shokët..."

Më tej, gjeneralmajor Kingji gjatë fjalës së tij, pasi solli në vëmendje faktin se ceremonia përkon edhe me 15-vjetorin e anëtarësimit të vendit tonë në NATO, një ngjarje e shënuar për vendin dhe Forcat e Armatosura, u shpreh ndër të tjera se: "Objektivi ynë ka qenë dhe mbetet mbajtja e kapaciteteve operacionale ushtarake të nevojshme për të garantuar sigurinë në vend, përgjegjësia në kuadër të mbrojtjes kolektive dhe në këtë drejtim në linjë me Direktivën e



Ministrit të Mbrojtjes dhe vizionit të SHSHPFA edhe gjatë këtij viti do të vijojë puna për realizimin e projekteve të modernizimit dhe implementimit të strukturës së re, duke përfshirë dhe elementin rezervist, përmirësimin e kuadrit ligjor me qëllim trajtimin më të mirë të personelit, finalizimin e strategjisë ushtarake dhe Planin Afatgjatë të Zhvillimit '24-'33, si dhe rritjen e kontributit në operacionet e drejtuara nga NATO".

Duke përfunduar, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralmajor Arben Kingji u shpreh besimplotë për dinamizmin dhe gjallërinë që ushtarët e rinj do i japin punës në strukturat ku do të shërbejnë.

Kremtohet 30 - vjetori i krijimit të Qendrës së Arsimimit Profesional të Nënoficerëve “Thomson”

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralmajor Arben Kingji mori pjesë në ceremoninë e 30-vjetorit të krijimit të Qendrës së Arsimimit Profesional të Nënoficerëve “Thomson”.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, ishin të pranishëm gjithashtu edhe zëvendës shefi i SHPFA-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, zëvendëskomandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj, komandantë forcash dhe njësisish, ish-gjeneralë si dhe ish-komandantë të kësaj qendre. Gjeneralmajor Kingji në përshëndetjen e tij, e cilësoi ditë shumë të veçantë në historikun e kësaj qendre, si një prej institucioneve më të rëndësishme të arsimit dhe stërvitjes në Forcat e Armatosura, pasi mision parësor ka kualifikimin dhe përgatitjen e nënoficerëve dhe personelin e mesëm civil të administratës. “Sot, më shumë se 2670 burra dhe gra, shërbejnë si nënoficerë dhe mbajnë grada të ndryshme, me një eksperiencë të vyer mbi shpinë gjatë pjesëmarrjes në trajnime, stërvitje dhe misione të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Është thelbësore që ju të keni një rol sa më aktiv në kërkim të informacioneve të reja, zbatimin e detyrave tuaja si udhëheqës, me krijimin e një kulture dhe mendësie të udhëhequr nga vlerat më të mira qytetare dhe ushtarake, në gjetjen e një ekuilibri midis ofrimit të njohurive taktike dhe edukimit, në mënyrë që e gjithë njësia të veprojë si një e vetme...”, - u



shpreh ndër të tjera gjeneralmajor Kingji. Më tej gjatë fjalës së tij përshëndetëse, SHSHPFA gjeneralmajor Kingji, vlerësoi mbështetjen që vendet aleate dhe ato partnere kanë dhënë për konsolidimin e sistemit të edukimit që në fillesat e para të krijimit të këtij institucioni, duke i paraprirë transformimit të mëtejshëm të përditësimit të metodologjisë, kurrikulave dhe programeve mësimore me institucionet homologe të vendeve të NATO-s.

“Nuk mund të lë pa përmendur mbështetjen e dhënë nga SHBA-të, e veçanërisht të Gardës Kombëtare të New Jersey-it, të cilët kanë ndihmuar në rritjen e aftësive dhe efektivitetin e nënoficerëve profesionistë përmes trajnimit, edukimit, standardizimit të rregulloreve, procedurave dhe zhvillimit të stërvitjeve të përbashkëta...”.

Gjeneralmajor Kingji solli në vëmendje edhe Konferencën e 17-të të Kryenënoficerëve të Forcave Tokësore Evropiane, e cila do të mbahet në muajin maj në vendin tonë dhe do të drejtohet nga Komanda Amerikane për Evropën dhe ka për synim shkëmbimin e eksperiencës dhe ekspertizës më të mirë profesionale, me qëllim krijimin e një trupe të fortë dhe inovative nënoficerësh. SHSHPFA gjeneralmajor Arben Kingji siguroi se fokusi dhe prioriteti i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm, krahas proceseve të modernizimit të mëtejshëm në ngritjen e kapaciteteve të reja, do të jetë edhe në drejtim të aftësimit të personelit, trajtimit dinjitoz dhe konsolidimit të sistemit të arsimit dhe edukimit në përputhje me nevojat e FA-së dhe standardet që kërkon NATO.





Kursantët e kursit të Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm vizitojnë njësitë e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Në zbatim të programit mësimor 2023-2024 (moduli i Historisë Ushtarake), kursantët e kursit të Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm të koordinuar nga stafi akademik, nën drejtimin e gjeneral brigade Ylli Pulaj, zhvilluan vizitë studimore në njësitë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, FSK.

Fillimisht, me anë të prezantimeve nga Deputeti z. Hysen Berisha, pjesëmarrës në betejën e Koshares, kursantët mësuam më shumë mbi të dhënat e kësaj beteje zhvilluar në prill të vitit 1999, më pas vizituan Komandën e Forcave Tokësore (KFT), ku u pritën nga shefi i Shtabit të KFT-së, kolonel Valdet Berisha, i cili i njohu pjesëmarrësit me detyrat, punën dhe angazhimet e Forcave Tokësore.

Gjeneral brigade Ylli Pulaj, u prit në një takim zyrtar nga komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Bashkim Jashari. Pas fjalës së mirëseardhjes, gjenerallejtënant Jashari e falënderoi gjeneralin Pulaj për bashkëpunimin shumë të mirë të realizuar ndërmjet Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, në edukimin dhe trajnimin e oficerëve nga grada “kapiten” deri në “kolonel”.

Me vlerësime të larta për punën e përbashkët gjenerallejtënant Jashari, vuri theksin në vijimin e pjesëmarrjes në këto kurse të personelit oficer të FSK-së, si dhe me shkëmbime lektorësh për një zhvillim sa më të lartë profesional dhe akademik të personelit ushtarak.

Gjeneral Pulaj gjatë fjalës së tij e falënderoi për pritjen e organizuar komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Jasharin dhe shprehu gatishmërinë për vijimin e bashkëpunimeve në



të ardhmen ndërmjet institucioneve, në rritjen e numrit të personelit në kurset institucionale që zhvillohen pranë Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë si dhe në shkëmbime lektorësh në kualifikime të ndryshme në fushën e edukimit dhe trajnimit. Pjesë e programit akademik për kursantët e kursit të Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm, ishte dhe ndalesa në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes të Forcës së Sigurisë së Kosovës, në Ferizaj. Gjeneral brigade Ylli Pulaj dhe grupi mësimor u pritën nga komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Jeton Dreshaj, i cili me stafin e tij bashkëbisedoi me pjesëmarrësit mbi rolin e lidërshiptit ushtarak në përballje me sfidat e sigurisë globale dhe rajonale, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë në trajnime, kurse dhe stërvitje të përbashkëta për të rritur ndërveprueshmërinë dhe operacionalitetin e personelit ushtarak.

Gjatë programit tregitor kursantët e KKSHP-së, panë nga afër ambientet e punës së Shtabit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, Komandës së Forcave Tokësore, Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, ku me anë të prezantimeve u njohën më strukturën, organizimin, detyrat dhe angazhimet aktuale të këtyre njësiteve si dhe realizuan vizita në Memorialin “Adem Jashari” në Prekaz dhe në Muzeun e “Lidhjes Shqiptare të Prizrenit”, në Prizren.





SAR, seminar “Koordinimi ndërmjet agjencive në operacionet e kërkim-shpëtimit dhe bashkëpunimi me median”

Në auditoriumin e Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, u mbajt seminari “Koordinimi ndërmjet agjencive në operacionet e kërkim-shpëtimit SAR dhe bashkëpunimi me median”, me rëndësi të veçantë për zhvillimin e kapaciteteve të operacioneve të kërkim-shpëtimit (SAR).

Seminari u organizua në bashkëpunim me agjencitë, strukturat shtetërore dhe entet private që kanë deklaruar kapacitete kërkim-shpëtimit (SAR) në Planin Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit në Republikën e Shqipërisë. Të pranishëm në këtë seminar të rëndësishëm në fushën e kërkim-shpëtimit ishin zëvendësministri i Mbrojtjes, z. Enkelejd Joti, përfaqësues të lartë të Forcave të Armatosura, përfaqësues nga prefekurat dhe pushteti vendor, nga Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore, përfaqësues nga Tirana International Airport, nga Autoriteti i Aviacionit Civil, si dhe përfaqësues nga Shërbimi i Mbrojtjes ndaj Zjarrit dhe Shpëtimit, të cilët ishin ndër pjesëmarrësit kryesorë në këtë seminar.

Qëllimi i këtij seminari ishte adresimi i sfidave dhe nevojave në koordinimin dhe bashkëpunimin ndërmjet agjencive të ndryshme në operacionet e kërkim-shpëtimit, duke përqendruar vëmendjen në bashkëpunimin ndërinstitucional dhe koordinimin ndërmjet agjencive; mbështetja mjekësore në operacionet SAR, si dhe

procedurat standarde të veprimit në operacionet SAR dhe komunikimi me mediat në operacionet SAR. Diskutimet u fokusuan në trajnimin e vazhdueshëm të personelit, koordinimin efikas të burimeve dhe përgatitjen për reagime të shpejta në situata emergjente.

Zëvendësministri i Mbrojtjes z. Joti, në fjalën e tij, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë ndërinstitucional për të garantuar





një reagim të shpejtë dhe efikas në rastet e emergjencave. Ai gjithashtu vuri në dukje rëndësinë e përgatitjes së mirëfilltë dhe koordinimit të strukturave për të siguruar mbrojtjen dhe shpëtimin e qytetarëve në gjendje fatkeqësie, duke dhënë ndihmën e duhur, pavarësisht vendndodhjes, kombësisë apo rrethanave të situatës në mënyrë të përgjegjshme.

Diskutimet në seminar u shoqëruan me prezantime nga ekspertët në fushën e kërkim-shpëtimit, duke ndarë përvojën dhe praktikat më të mira për koordinimin dhe reagimin në situata të rrezikshme. Pjesëmarrësit kishin mundësinë të ndanin përvojën e tyre dhe të identifikonin sfidat dhe mundësitë për të përshpejtuar dhe përmirësuar kapacitetet e tyre në fushën e kërkim-shpëtimit.

Rëndësi të veçantë në seminar iu kushtua punës së bërë për zbatimin e detyrimeve të Planit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit në Republikën e Shqipërisë, miratuar me VKM nr.729, datë 13.11.2019 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit në Republikën e Shqipërisë dhe Planit të Veprimit të tij”, si dhe sfidave që përballen shërbimi i kërkim-shpëtimit në Republikën e Shqipërisë në të ardhmen.

Për realizimin e detyrimeve të Planit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit në Republikën e Shqipërisë, arrijtjet janë të shumta si: Organizimi dhe vënia në efikasitet të plotë të shërbimit SAR; nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit në fushën e kërkim-shpëtimit me Qendrën e Kontrollit të Misionit COSPAS-SARSAT në Bari, Itali, anëtarësimi i vendit tonë në Komitetin Këshillues Rajonal në fushën e Kërkim-Shpëtimit Aeronautik (Regional Aeronautical Search And Rescue Advisory Committee/RASARAC); me Albcontrol SHA; me Tirana International Airport SHPK (TIA); me Kukës International Airport SHPK (KFZ) “Zayed-Flatrat e Veriut”, si dhe Autoritetin Kombëtar të Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil (AKISA); miratimi i Manualit të Kërkim-Shpëtimit në Republikën e Shqipërisë; stërvitje me strukturat SAR, si dhe monitorimi i zbatimit të planit kombëtar e raportimi si dhe detyra të tjera.

Në seminar u diskutua edhe për sfidat që ka shërbimi i kërkim-shpëtimit në RSH në të ardhmen, duke filluar nga rishikimin e ligjit nr. 10345, datë 23.06.2011, “Për shërbimin e kërkim-shpëtimit në Republikën e Shqipërisë”, rishikimin e Planit Kombëtar të kërkim-shpëtimit në RSH, hartimi dhe miratimi i Planit të operacionit të kërkim-shpëtimit në RSH, zbatimi i detyrimeve të Organizatës Ndërkombëtare e Aviacionit Civil (ICAO), miratimi i moduleve në përputhje me kërkesat e manualeve IAMSAR (ICAO/IMO), “International Aeronautical and Maritime Search and Rescue”. Në fund të seminarit, u bë një analizë e diskutimeve dhe u formuluan rekomandime për të forcuar bashkëpunimin dhe koordinimin e agjencive në të ardhmen. Mesazhi kryesor që u përcoll ishte se vetëm përmes bashkëpunimit të ngushtë dhe koordinimit të efektshëm, mund të garantohet një përgjigje e suksesshme dhe efikase në rastet e operacioneve të kërkim-shpëtimit, emergjencave dhe kërcënimeve ndaj sigurisë së qytetarëve.

Ky seminar, me pjesëmarrjen e autoriteteve të larta dhe ekspertëve në fushën e kërkim-shpëtimit, shënoi një hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të koordinimit dhe bashkëpunimit në operacionet e kërkim-shpëtimit. Ndërkohë, është e rëndësishme që rekomandimet dhe praktikat e mira të zbatohen në praktikë për të garantuar një përgjigje të përshtatshme dhe të shpejtë në incidentet SAR në të ardhmen.



Shqipëria 15 vjet në NATO, gjeneralmajor Shehu: Krenarë që jemi pjesë e organizatës më të fuqishme politike-ushtarake të globit

Komanda e Forcës së Bashkuar të NATO-s në Napoli kremtoi 75-vjetorin e krijimit të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut, “Të mbrojmë çdo centimetër të Aleancës”, me këtë rast Komanda e Forcës së Bashkuar të NATO-s në Napoli zhvilloi disa aktivitete në të cilat morën pjesë përfaqësues të nivelit të lartë ushtarak nga vendet anëtare të NATO-s, ambasadorë dhe të ftuar specialë nga vendet dhe strukturat e NATO-s. Shqipëria u përfaqësua në këtë aktivitet nga një delegacion i kryesuar nga zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu.

Komandanti i Forcës së Bashkuar të NATO-s në Napoli dhe njëkohësisht Komandant i Forcave Detare të SHBA për Evropën dhe Afrikën, Admiral Stuart B. Munsch, pasi bëri një përshkrim të shkurtër të historikut të NATO-s, theksoi rëndësinë dhe arritjet e saj gjatë periudhës 75-vjeçare në kontribut jo vetëm për sigurinë e Aleancës, por edhe për sigurinë dhe paqen në botë. “Ne sot ndihemi krenarë që NATO, si organizata më e fuqishme e sigurisë në botë, ka treguar se është e aftë jo vetëm të garantojë sigurinë e vendeve aleate, por të promovojë sigurinë dhe paqen kudo

në botë, duke u angazhuar në një sërë operacionesh kurdoherë që ka qenë e nevojshme. Ne sot jemi të aftë të mbrojmë çdo centimetër të Aleancës”. Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, Admiral Rob Bauer, duke vlerësuar kontributin e të gjithë vendeve anëtare në formësimin e NATO-s si një organizatë të qëndrueshme dhe mbartëse të vlerave perëndimore, theksoi se:

“Ne jemi që fuqishëm se e njohim dhe kemi besim tek njëri-tjetrit, në dallim nga kundërshtarët tanë. Ne jemi të fortë, sepse NATO nuk është thjesht një organizatë ushtarake, por bashkon vlerat e të gjithë popujve tanë, ku çdo shtetas ndihet krenar dhe i vetëdijshëm për kontributin e tij”.

Zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu në takimin me Komandantin e Komandës së Forcës së Bashkuar të NATO-s, pasi e falënderoi për organizimin e aktivitetit, theksoi rëndësinë e Aleancës për sigurinë e rajonit tonë. “Shqipëria sot feston gjithashtu 15-vjetorin e anëtarësimit në NATO dhe ndihemi krenarë që bëjmë pjesë në organizatën më të fuqishme politike-ushtarake të globit. Kontributi ynë besoj është një vlerë e shtuar në Aleancë dhe pjesëmarrja jonë në të gjitha angazhimet e aleancës është tregues i qartë i vendosmërisë



së lidhshimit politik dhe ushtarak ndaj rrugëtimit tonë drejt vlerave perëndimore”.

Aktiviteti vijoi me një ceremoni të zhvilluar në bordin e anijes flakmurtare të flotës VI SHBA, USS “Mount Whitney”, si dhe një koncert nga bandat e 10 shteteve anëtare të NATO-s, ku motoja e muzikës ishte: “Duke mbrojtur çdo centimetër të Aleancës”.



ZVSHSHPFA, gjeneralmajor Manushaqe Shehu: Roli i femrës ushtarake mjaft i rëndësishëm dhe gjithë-dimENSIONAL

Një grup i Komisionit për Demokraci dhe Siguri i Asamblesë Parlamentare të NATO-s, zhvilloi një vizitë në Kuvendin e Shqipërisë. Pjesë e programit të tyre ishte edhe mbajtja e një paneli ku u diskutua për zbatimin në vendin tonë të Rezolutës 1325 të Organizatës së Kombeve të Bashkuara "Gruaja, Paqja dhe Siguria". Pjesë e këtij paneli ishte edhe zëvendëseshfi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, e cila në fjalën e saj, pasi falënderoi znj. Mimi Kodheli, si Kryetare e Komisionit për Politikën e Jashtme në Kuvendin e Shqipërisë dhe drejtuese e panelit, përfaqësuesit e Komisionit për Demokraci dhe Siguri të Asamblesë Parlamentare të NATO-s, si dhe panelistet e tjera theksoi: "Jam shumë e vlerësuar që si femër ushtarake me gradë madhore, por edhe si zëvendëseshfi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së të jem pjesë e këtij paneli, ku diskutohen përpjekjet e Shqipërisë në avancimin e Barazisë Gjinore dhe zbatimin e agjendës së Grave, Paqes dhe Sigurisë e në veçanti rolin dhe kontributin e femrave shqiptare në uniformë.

Më tej gjenerale Shehu u ndal në karrierën e saj në Forcat e Armatosura, e cila përveçse një kontribut individual, është kontribut i bashkëpunimit me të gjithë ushtarakët dhe një vlerësim i lidershit ushtarak e civil.

Femra shqiptare, aq më tepër femrat ushtarake, por edhe ato civile që punojnë në Forcat e Armatosura, janë një forcë e vlerësuar në tërë jetën politike, ekonomike, arsimore, ushtarake e në shumë



nënkolonele e kolonele e deri gjeneralmajore. Ato i gjen komandante strukturash të ndryshme ushtarake, pedagoge, me grada shkencore, atashe ushtarake etj. Ajo në fjalën e saj përmendi disa shifra që tregojnë rolin e grave në Forcat e Armatosura. Kështu në total femrat ushtarake, në krahasim me numrin e përgjithshëm të personelit ushtarak, sot përbëjnë 15.2 %, nga këto oficerë 21.3 %, nënofficerë 13.5 % dhe ushtarë profesioniste 11.4 %.

Në punën që bëhet për rezolutën 1325 ajo përmendi fakti se në kuadër të Strategjisë kombëtare të Barazisë Gjinore 2021-2023, në Ministrinë e Mbrojtjes është hartuar Plani i Veprimit të Barazisë Gjinore në FA 2022-2030. Gjithashtu u bëri të njohur panelistëve hartimin në Ministrinë e Mbrojtjes të dokumentit mjaft të rëndësishëm që lidhet me mbrojtjen e femrave ushtarake ndaj dhunës dhe ngacmimeve në pozicionin e punës, dokument i cili është përgatitur tre vite më parë, me asistencën e Programit të Kombeve të Bashkuara Zhvillim në Shqipëri.

Në fund të fjalës së saj, gjenerale Shehu theksoi se rritja e rolit të femrës ushtarake në Forcat e Armatosura do të jetë një nga prioritetet e punës së Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të FA-së.



fusha të rëndësishme të jetës së vendit.

Në vijim gjenerale Shehu theksoi se roli i femrës ushtarake është rritur ndjeshëm si në arsimim, trajnim, në promovim në detyra e gradë. Femrat ushtarake sot i gjen në misionet paqeruajtëse jashtë vendit, në përfaqësitë tona në NATO, atashe ushtarake, në kryerjen e detyrave operacionale e mbështetëse brenda vendit, të barabarta me kolegët e tyre burra. Ato i gjen, jo vetëm nën-togere, togere, kapitene e majore, por edhe me grada të larta si





ZVSHSHPFA, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, pjesë e forumit ndërkombëtar “Gruaja, paqja dhe siguria”, zhvilluar në Kosovë

Me iniciativë të presidentes së Republikës së Kosovës, znj. Vjosa Osmani, në Prishtinë u organizua Edicioni i Dytë i Forumit Ndërkombëtar për Gratë, Paqen dhe Sigurinë (GPS).

Në këtë forum morën pjesë rreth një mijë pjesëmarrës nga më shumë se 40 shtete botës. Nga Shqipëria ishin të pranishëm presidenti i Shqipërisë, Sh. T. z. Bajram Begaj, kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, znj. Lindita Nikolla. Gjithashtu ishin pjesëmarrës edhe presidentja e Sllovenisë, znj. Natasha Pirc Musar, kryeministri i Maqedonisë së Veriut, z. Talat Xhaferi, si dhe shumë delegacione të tjera ndërkombëtare.

Me ftesë të presidentit të Kosovës në këtë forum mori pjesë edhe një grup oficeresh të Forcave të Armatosura, të kryesuara nga zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu.

Ky edicion i forumit u fokusua ekskluzivisht në ndërtimin e përpjekjeve të përbashkëta për të trajtuar dhunën seksuale të lidhur me konfliktin, si dhe në identifikimin e mjeteve dhe politikave për të ndihmuar gratë dhe vajzat të jenë më të sigurta në kohën e kërcënimeve gjithnjë në rritje të sigurisë klimatike.



Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, në ditën e parë të Forumit për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, në fjalën përshëndetëse, midis të tjerash u shpreh: “Atëherë, këtu më lejoni ta bëj të qartë se Kosova qëndron si kampione, si flamurtare e kësaj agjende, për shkak se përfshirja dhe përfaqësimi qëndrojnë si gur themeltar i të gjitha përpjekjeve që kemi ndërmarrë që nga dita e parë. Këtu desha të shpreh mirënjohjen time për të gjithë partnerët tanë ndërkombëtarë, për të gjitha institucionet kosovare që kanë punuar me ne për ta bërë këtë forum të suksesshëm, për organizatat e shoqërisë civile, për institucionet e sigurisë, për komunitetin akademik, mediat dhe të tjerët që janë përfshirë”.

Më tej ajo vijoi: “Përzgjedhja e dy temave kyçe për këtë edicion, nga njëra anë dhuna seksuale në lidhje me konfliktin dhe siguria klimatike në anën tjetër, nuk janë rastësi dhe në përpjekjet tona natyrisht kemi adresuar të gjitha sprovat e kohës, por na duhen edhe leksionet e të kaluarës në mënyrë që të ballafaqohemi suksesshëm me të ardhmen. Në këtë sfond të konfliktit, kufizimeve shoqërore dhe trazirave kulturore është e rëndësishme që t’i përgjigjemi nevojave të grave dhe vajzave për t’i fuqizuar, për t’i mbështetur dhe për të krijuar një mjedis të sigurt për të gjitha gratë kudo qofshin njëherë e përgjithmonë”.

Presidenti i Republikës së Shqipërisë Sh. T. z. Bajram Begaj, në fjalën përshëndetëse mbajtur në këtë forum, midis të tjerash u shpreh: “Ky forum përbën jo vetëm një akt të kujtesës kolektive të dhunës historike e aktuale ndaj grave në konflikte, por edhe aspiratën e përbashkët për një të ardhme ku paqja e siguria fuqizohen prej rolit dhe lidershit të grave”.



Në forum e morën fjalën edhe shumë personalitete të tjera të politikës, shkencës e shoqërisë civile. Më tej forumi ka vijuar me panele, ku gjenerale Shehu diskutoi për temat e trajtuara në këtë forum.

Gjenerale Shehu mbasi falënderoi presidenten e Kosovës për organizimin e shkëlqyer të këtij forumi dhe për ftesën adresuar Ministrin të Mbrojtjes ndër të tjera u shpreh: “Jam thellësisht e nderuar dhe e privilegjuar që marr pjesë për herë të dytë në këtë forum. Në emër të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, dëshiroj t’ju përgëzoj për organizimin e këtij takimi të rëndësishëm, që ndodh në një kohë kur paqja, liria dhe siguria janë nën sulm në shumë rajone të botës.



Në vijim ajo dha përvojën e Forcave të Armatosura shqiptare në zbatimin e Barazisë Gjinore, ku rreth 15.2% e personelit ushtarak janë femra. Më pas ajo u ndal në Planin Kombëtar të Barazisë Gjinore dhe në Planin e Veprimit të Ministrisë së Mbrojtjes, hartuar në mbështetje të rezolutës 1325 të OKB-së “Gruaja, Paqja dhe Siguria”. “Roli i femrës ushtarake, - theksoi ajo, - është rritur ndjeshëm si në arsimit, trajnim, në promovim në detyra e gradë. Femrat ushtarake sot i gjen në misionet paqeruajtëse jashtë vendit, në përfaqësitë tona në NATO, atashë ushtarake, në kryerjen e detyrave operacionale e mbështetëse brenda vendit, të barabarta me kolegët e tyre burra”.

Në vijim ajo i njohu pjesëmarrësit në panel edhe me hartimin e dokumentit mjaft të rëndësishëm që lidhet me mbrojtjen e femrave ushtarake ndaj dhunës dhe ngacmimeve në pozicionin e punës, dokumenti i cili është përgatitur katër vite më parë, me asistencën e “Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Shqipëri”. Në fund gjenerale Shehu theksoi se: “Detyra ime është të inkurajoj vajza dhe gra nën uniformë të mos nënshtrohen, por të qëndrojnë dinjitoze. Të punojnë me dinjitet, integritet dhe përgjegjësi për realizimin e detyrave. Gjithashtu të gjitha si gra, jo vetëm në nivel kombëtar, por në nivel rajonal dhe global duhet të ngremë fuqishëm zërin që femrat ushtarake të jenë të vlerësuara dhe të meritojnë vendin që u takon”.

Gjatë panelit, pjesëmarrësit ndanë me publikun histori suksesi dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së gruas në të gjitha aspektet e jetës. Panelistët inkurajuan pjesëmarrje të shtuar të grave në sektorin e sigurisë dhe dhanë rekomandime për të zhdukur dhe për të luftuar dhunën ndaj grave e çfarëdo lloji qoftë ajo.

Forumit Ndërkombëtar për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, organizuar në Kosovë, i mbylli punimet duke dhënë mesazhe të fuqishme për zbatimin e rezolutës “Gruaja, Paqja dhe Siguria”.

Efektivë të Forcave të Armatosura i bashkohen operacionit për gjetjen e trupave të mbytur në lumin Buna

Efektivë të Forcave të Armatosura të Shqipërisë, së bashku me mjete të tyre i janë përgjigjur menjëherë thirrjes për ndihmë dhe janë angazhuar në operacionin për gjetjen e tre trupave të raportuar të mbytur në lumin Buna, pranë fshatit Darragjat, njësi administrative Dajç, Shkodër. Ekipet e efektivëve nga Batalioni i Forcave Speciale dhe efektivëve nga Regjimenti i Këmbësorisë së Veriut, nën koordinimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile iu bashkuan palombarëve të repartit RENE, Njesisë së Sigurisë Publike Shkodër, Policisë së Shkodrës, Drejtorisë së Kufirit e banorëve të zonës, të cilët vijuan kërkimet deri në gjetjen e katër trupave. Nën drejtimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, u angazhuan 96 forca operacionale dhe 13 mjete nga strukturat vendore dhe qendrore, përfshirë Forcat e Armatosura, Forcat RENE, Njesisë e Sigurisë Publike, DVP Shkodër, dhe DRKM, si dhe banorë të njesisë administrative Dajç. Forcat e Armatosura janë në gatishmëri të plotë sa herë është e nevojshme në ndihmë të qytetarëve dhe komunitetit.



Palombarët e Forcave të Armatosura, me punën e tyre të palodhur shfaqin përkushtim të pasqorë, jo vetëm në operacionet më kritike të kërkimit nën ujë, por me krenari e përkushtim stërvitin dhe trajnojnë të gjithë zhytësit e rinj. Mirënjohje për shërbimin tuaj të jashtëzakonshëm.



Zhvilloi punimet Konferenca e 17-të e Nënoficerëve të Komandave të Forcave Tokësore Evropiane



Ka nisur në vendin tonë Konferenca e 17-të e Nënoficerëve të Komandave të Forcave Tokësore Evropiane, që mbahet nën drejtimin e Komandës Amerikane për Evropën dhe Afrikën U.S. Army Europe and Africa, dhe të Forcave të Armatosura, në të cilën po zhvillohen diskutime mbi praktikën më të mirë për zhvillimin e rolit të nënoficerit, mësimet e nxjerra nga konfliktet aktuale, të cilat përbëjnë kërcënim për sigurinë e përbashkët, shkëmbimin e eksperiencës dhe forcimin e marrëdhënieve mes vendeve pjesëmarrëse.



Kursi i Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen vizitoi Presidencën e Republikës së Shqipërisë

Në kuadër të programit akademik, Kursi i Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen KLSM-14, realizoi një vizitë në Presidencën e Republikës së Shqipërisë, ku u prit nga Presidenti i Republikës SH.T. z. Bajram Begaj. Gjatë këtij takimi ishte i pranishëm shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave tona të Armatosura, gjeneralmajor Arben Kingji dhe komandanti i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, gjeneral brigade Ylli Pulaj.

Stafi drejtues dhe pjesëmarrësit e KLSM-14 u pritën nga Kabineti i Presidentit dhe pas urimit të mirëseardhjes ata u njohën nga Këshilltarët e Kreut të Shtetit me rolin dhe funksionet e Presidentit në një Republikë Parlamentare, si edhe në politikën e jashtme dhe atë të Sigurisë dhe Mbrojtjes.

Presidenti i Republikës së Shqipërisë SH.T. z. Bajram Begaj, vlerësoi Kursin e Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen si një nga kurset më të mira në piramidën e arsimit ushtarak të Forcave të Armatosura, duke theksuar se Shqipëria beson dhe ka treguar në angazhimet e saj ndërkombëtare se multilateralizmi është mekanizmi i duhur që ofron zgjidhje të pranueshme në përbashkë me



sfidat e përbashkëta të vendeve tona në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

Kryetari i Shtetit përcolli vizionin e tij për Shqipërinë e së ardhmes në përgjigje të interesit të pjesëmarrësve të këtij kursi. Ai u shpreh se e sheh Shqipërinë të vendosur drejt realizimit të objektivave dhe ëndrrës shqiptare të kamotshme Euroatlantike. Takimi vijoi me pyetje dhe diskutime mbi situatën aktuale të sigurisë në rajon dhe më gjerë, dhe u mbyll me fotografi të përbashkët.



KLO, vizitë në Komisionin e Sigurisë Kombëtare të Kuvendit të Shqipërisë

Kursantët e kursit të Lartë të Oficerit në vijim të programit mësimor, shoqëruar nga Departamenti i Strategjisë dhe Studimeve të Avancuara zhvilluan vizitë mësimore në Komisionin e Sigurisë Kombëtare të Kuvendit të Shqipërisë.

Gjatë bashkëbisedimit me deputetet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, njëkohësisht anëtare të Komisionit të Sigurisë Kombëtare znj. Antoneta Dhima dhe



znj. Pranvera Resulaj, kursantët u njohën me organizimin dhe mënyrën e funksionimit të këtij komisioni me rëndësi në strukturën e Kuvendit të RSH.



Kursantët e KKSHP-së përfunduan stërvitjen planëzuese “Skatina-2024”

Kursantët e kursit të Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm (KKSHP) zhvilluan stërvitjen planëzuese për vendimarrje në vendkomandë, “Brigada e këmbësorisë në luftimin mbrojtës, “Skatina-2024”. Kjo stërvitje u realizua me skenar fiktiv sipas programit mësimor për periudhë dyjavore në formë teo-rike dhe praktike në terren (në rajonin Peshkopi-Kukës-Has-Tropojë-Fushë Arrëz-Pukë-Gjegjan), duke zbatuar temat doktrinar dhe skemat në përputhje me doktrinat dhe manualët e NATO-s. Kursantët gjatë stërvitjes u aftësuan për kryerjen e Procedurave të Vendimarrjes Ushtarake në rolet e oficerëve koordinues dhe specialistë në për-



bërje të shtabit të një brigade këmbësorie të mekanizuar, duke vepruar si Forcë e Bashkuar. Stërvitja u ndoq nga afër dhe nga komandanti i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, gjeneral brigade Ylli Pulaj si dhe përfaqësues nga drejtoria e Operacioneve dhe Stërvitjes në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së.

Ish-zëvendësdrejtori i AIM z. Douglas H. Wise, lektor pranë KLSM-14

Ish-zëvendësdrejtori i Agjencisë Inteligjente të Mbrojtjes z. Douglas H. Wise ishte i pranishëm si lektor në Kursin e Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes, për të sjellë gjithë eksperiencën e tij si drejtues i Agjencisë Inteligjente të Mbrojtjes, sidomos në këto kohë të vështira të tensioneve politike në rajon dhe më gjerë. Pjesëmarrësit e kursit të Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen KLSM-14, kishin mundësinë të diskutonin mbi aftësinë e lidërshipt ushtarak të NATO-s, për të ndërvepruar me personelin e shërbimit të inteligjencës gjatë operacioneve luftarake. Z. Wise, si anëtar i Shërbimit të Lartë të Inteligjencës (CIA), me gati tre dekada shërbim, bashkëbisedoi me pjesëmarrësit dhe mbi rëndësinë e ndërveprimit me shërbimet inteligjente, duke u mbështetur në koordinim dhe bashkëpunim të pandërprerë.



KLSM-14 zhvillon vizitë akademike në Romë, Itali

Në mbështetje të programit akademik stafi drejtues i kryesuar nga gjeneral brigade Ylli Pulaj dhe pjesëmarrësit e KLSM-14, vizituan institucionet ushtarake arsimore dhe të sigurisë në Romë, Itali.

Në ditën e parë, stafi drejtues dhe grupi mësimor u pritën nga Prof. Dr. Nicola Pedde, drejtor i Qendrës për Studime Globale (IGS), i cili së bashku me akademikë të tjerë diskutuan nga afër me pjesëmarrësit mbi rolin e NATO-s dhe BE-së ndaj situatës aktuale të mbrojtjes si dhe qasjen e lidërshipt aktual politik botëror në këndvështrimin e sigurisë.

Në vijim, gjatë sesionit të pasdites u zhvillua vizitë në Qendrën e Ekselencës së NATO-s (NATO SFA COE), ku u pritën nga nënkolonel Massimiliano Caramia, shef i degës së zhvillimit të koncepteve, i cili me stafin e tij, i falënderoi për vizitën dhe uroi për kursin, më pas me anë të prezantimeve i njohu pjesëmarrësit e KLSM-14, me organizimin, zhvillimet e projekteve aktuale, bashkëpunimet me institucionet civile dhe ushtarake në kuadër të NATO-s si dhe infrastrukturën e zhvillimit të kurseve në këtë qendër.

Gjatë ditës së dytë të vizitës, pjesëmarrësit e KLSM-14 zhvilluan vizitë në Kolegjin e Mbrojtjes së NATO-s (NDC), ku u pritën nga dekani Dr. Christofer Schnaubelt, i cili i njohu me historikun,



misionin, bashkëpunimet me institucionet dhe organizatat brenda dhe jashtë vendit si dhe kurset dhe trajnimet që zhvillohen me personelin ushtarak dhe civil, duke theksuar ndikimin që ka edukimi në sigurinë globale.

Gjatë sesionit të pasdites, u zhvillua vizitë në Qendrën e Mbrojtjes për Studime të Avancuara (CASD), ku anëtarët e kursit KLSM-14, u njohën me misionin, organizimin, kurset/kurrikulën si dhe bashkëpunimet kombëtare dhe ndërkombëtare që realizohen nga kjo qendër.

Gjatë kësaj vizite, gjeneral brigade Ylli Pulaj u prit në takim të veçantë nga admiral Giacinto Ottaviani, President i Qendrës së Mbrojtjes për Studime të Avancuara, ku bashkëbiseduan shkurtimisht në lidhje me bashkëpunimet në fushën e arsimit dhe sigurisë. Gjatë ditës së tretë u zhvilluan vizita kulturore në vendet më kryesore të qytetit, duke u njohur më shumë me historinë dhe kulturën e vendit si një ndër mijërvajçaret në botë.



Komandanti i KMS, gjeneral brigade Ylli Pulaj merr pjesë në aktivitetin “Rumania 20 vite në NATO”

Komandanti i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, gjeneral brigade Ylli Pulaj ishte i pranishëm në aktivitetin “Rumania 20 vite në NATO”, organizuar në Bukuresht, Rumani. Në këtë event të veçantë morën pjesë ushtarakë të nivelit të lartë të vendeve të NATO-s si dhe personalitete nga bota akademike dhe politike. Pjesë e programit ishte dhe vizita në Parlamentin e Rumanisë ku të pranishmit u njohën më historikun dhe disa nga prioritetet aktuale të institucionit. Gjatë pasdites, gjeneral brigade Pulaj u prit në takim nga Ambasadorja e Republikës së Shqipërisë për Rumaninë, znj. Enkeleda Merkuri, me të cilën diskutuan mbi ndikimin e angazhimeve aktuale diplomatike në mjedisin e sigurisë. Në ditën e dytë të vizitës, me ftesë të Kolegjit Kombëtar të Mbrojtjes në Bukuresht, gjeneral brigade Ylli Pulaj u prit në takim zyrtar nga komandanti gjeneralmajor Eugen Mavris, gjatë takimit dy titullarët u shprehën mbi mundësitë e rritjes së bashkëpunimeve mes dy institucioneve në trajnime dhe kurse kualifikimi për personelin ushtarak.



Në vijim zëvendëskomandanti i Kolegjit Kombëtar të Mbrojtjes, kolonel Tofan Marius-Silviu së bashku me zëvendës rektoren bënë një prezantim mbi strukturën, misionin, kurrikulën dhe kurset që zhvillohen si dhe treguan mjediset akademike dhe infrastrukturën mësimore të Kolegjit.

KLSM-14 priti si “Guest speaker” Ambasadorin e Republikës së Turqisë në Shqipëri

Ambasadori i Republikës së Turqisë në Shqipëri, z. Tayyar Kagan Atay vizitoi kursin e Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen (KLSM1-14). Ai u prit nga gjeneral brigade Ylli Pulaj, i cili u roi mirëseardhjen si përfaqësues i nivelit të lartë dhe e falënderoi për praninë e tij si “guest speaker” pranë grupit të KLSM-14. Më pas z. Atay bashkëbisedoi me pjesëmarrësit e kursit mbi qasjen e Turqisë në Ballkan si dhe vlerësimin e zhvillimeve aktuale në rajon, duke u ndalur dhe tek marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Turqisë.





Kursi i Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen viziton institucionet e sigurisë dhe mbrojtjes në Prishtinë, Kosovë

Kursi i Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen KLSM-14, nën koordinimin e stafit drejtues të kryesuar nga gjeneral brigade Ylli Pulaj, në vizitën akademike tre ditore në institucionet e sigurisë dhe mbrojtjes së Republikës së Kosovës, zhvilloi takime zyrtare në Komisionin Parlamentar për çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes, Ministrinë e Mbrojtjes, komandën e KFOR-it si dhe Kompleksin Memorial "Adem Jashari". Gjatë ditës së parë gjeneral brigade Ylli Pulaj, stafi akademik dhe pjesëmarrësit në KLSM-14 u pritën në Komisionin Parlamentar për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes nga z. Bekë Berisha kryetar dhe anëtarë të tjerë deputetë në Parlamentin e Kosovës. Në këtë takim u diskutua mbi prioritetet e sigurisë kombëtare, bashkëpunimet aktuale si dhe ruga drejt anëtarësimit në NATO.

Në sesionin e pasdites, pjesëmarrësit e KLSM-14, vizituan Ministrinë e Mbrojtjes, ku u pritën nga zëvendësministri i Mbrojtjes z. Shemsi Sylja, i shoqëruar nga drejtori i Drejtorisë së Inteligjencës dhe Sigurisë gjeneralmajor Gëzim Hazrolli.

Fillimisht, zëvendësministri Sylja, iu uroi mirëseardhjen dhe më pas i informoi lidhur me proceset dhe sfidat nëpër të cilat po kalon Ministria e Mbrojtjes dhe Forca e Sigurisë së Kosovës, ecurinë e zbatimit të Planit Gjithëpërfshirës së Tranzicionit të FSK-së, etj. Gjithashtu, zëvendësministri Sylja u shpreh lidhur me situatën e sigurisë në vend, rajon dhe më gjerë si dhe ndikimin e saj në aspektin global të sigurisë. Në përfundim të ligjëratës, pjesëmarrësit e KLSM-14 adresuan pyetje të ndryshme për temat e diskutuara gjatë takimit. Programi akademik vijoi me vizitë në ko-



mandën e KFOR-it, Prishtinë, ku stafi drejtues dhe grupi mësimor u pritën nga zëvendëskomandanti i KFOR-it, gjeneral brigade Federiko Bernacca, i cili iu uroi mirëseardhjen dhe i përgëzoi pjesëmarrësit për mundësinë e ndjekjes së këtij kursi të nivelit strategjik. Në vijim, me anë të prezantimeve nga përfaqësues të degës së zbulimit, operacioneve dhe planifikimit, pjesëmarrësit u njohën me organizimin, detyrat dhe sfidat aktuale të ndërveprimit të kësaj baze të NATO-s me rëndësi në Republikën e Kosovës.

Gjeneral brigade Ylli Pulaj u prit në takime të veçanta nga komandanti i KFOR-it, gjeneral major Özkan Ulutaş dhe nga zëvendëskomandanti i KFOR-it, gjeneral brigade Federiko Bernacca, ku bashkëbiseduan mbi situatën operacionale në vend, duke u ndalur në nivelin e sigurisë pas ngjarjeve të fundit në veri të Kosovës si dhe bashkëpunimet e duhura të njësive ushtarake të nivelit lartë me qëllim ruajtjen e paqes dhe sigurisë.

Gjatë ditës së tretë, pjesë e programit akademik, ishte dhe ndalesa në Kompl-

eksin Memorial "Adem Jashari", kush-tuar familjes së Heroit të Kosovës Adem Jashari në Prekaz të Poshtëm të Drenicës. Pjesëmarrësit panë nga afër shtëpitë e shndërruara në muze, varret e të rënëve në luftë të familjes Jashari, dëgjuan mbi historinë e familjes dhe sulmet e kryera ndaj shtëpisë së tij në mars të vitit 1998, si dhe me vënien në mbrojtje të kësaj zone me interes të veçantë me rëndësi ontologjike, antropologjike, historike dhe kulturore.

Kjo vizitë akademike i njohu akoma më shumë pjesëmarrësit me organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurisë dhe mbrojtjes së Republikës së Kosovës si dhe iu dha mundësi të marrin njohuri mbi veprimtarinë e tyre, rëndësinë e bashkëpunimit mes shteteve të rajonit për të zgjidhur mosmarrëveshjet, promovuar paqen dhe sigurinë në rajon si dhe angazhimin e BE-së dhe NATO-s, për të mbështetur proceset e integritetit dhe stabilizimit.



Gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj priti studentët e Akademisë Ushtarake “West Point”

Zëvendëskomandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura (AFA), Gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj priti dy studentë të Akademisë Ushtarake të “West Point-it”, të cilët iu janë atashuar studentëve të Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë për një periudhë 9 ditore, si pjesë e “Foreign Academy Exchange Program” (FAEP). Bashkëbisedimi me studentët u fokusua mbi mendimet dhe përshtypjet e tyre për programin e shkëmbimit dhe në veçanti për eksperiencën e tyre në njohjen e kulturës së vendit tonë, shoqëria me studentët shqiptar, programet mësimore, si dhe mundësitë e përmirësimit në të ardhmen. Gjeneral brigade Nuredinaj i falënderoi përzemërsisht studentët dhe vlerësoi bashkëpunimin e shkëlqyer ushtarak me SHBA-të, veçanërisht në fushën e edukimit dhe trajnimit. Në vijim, ai theksoi se: “Vizita juaj në Akademinë tonë është një shembull konkret i këtij bashkëpunimi të shkëlqyer, i cili do vijojë në të ardhmen



dhe konkretisht me vizitën e dy studentëve tanë në Akademinë Ushtarake të ‘West Point-it’”.



Në ambientet e Qendrës së Arsimimit Profesional të Nënoficerëve (QAPN) u zhvillua ceremonia e përfundimit të kursit të 57-të të Avancuar të Nënoficerit.



Akademia e Forcave të Armatosura dhe Universiteti “FAN S. NOLI” Korçë, nënshkruan një marrëveshje me qëllim vendosjen e një kuadri institucional bashkëpunimi në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor. Aktiviteti i nënshkrimit të marrëveshjes u zhvillua në ambientet e Akademisë së Forcave të Armatosura. Marrëveshja u nënshkrua nga gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj, zëvendëskomandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura dhe Rektori i Universitetit të Korçës Prof. Dr. Dhimitri Bello. Gjatë bisedimeve, ndër të tjera theksuan përfitimet reciproke të dy institucioneve të Arsimit të Lartë, që rrjedhin nga vendosja dhe zhvillimi i marrëdhënieve dhe bashkëpunimit reciprok. Kjo marrëveshje parashikon shkëmbim të personelit akademik për mësimdhënie në lëndët e modulet me interes të përbashkët, programe studimi të përbashkëta, kualifikim të personelit akademik, nëpërmjet organizimit të seminareve, workshop-eve, konferencave shkencore, udhëheqjeve shkencore, organizimin dhe hartimin e programeve të përbashkëta,



transferimin e studimeve dhe programeve sipas nevojave dhe interesit të përbashkët, bashkëpunimin për botime të përbashkëta akademike dhe periodike, shfrytëzimin e bibliotekave nga personeli akademik dhe studentët e dy institucioneve, etj.

AFA dhe Universiteti “FAN S. NOLI” Korçë, nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor



Komandanti i FAj-së, gjeneral brigade Ferdinand Dimo mori pjesë në Simpoziumin e Shefave Ajrorë të NATO-s në Ramstein, Gjermani

Gjatë Simpoziunit I të Shefave Ajrorë të NATO-s (NATO Air Chiefs' Symposium - NACS) në 2024, udhëheqja e lartë nga forcat ajrore aleate, NATO dhe organizatat ndërkombëtare, u mbledhën për të diskutuar se si të përmirësohen operacionet e integruara në fuqinë ajrore dhe hapësinore të NATO-s dhe gjithashtu përkujtuan 75-vjetorin e Aleancës.

Në vijim, u diskutuan çështje që lidhen me luftimin ajror në operacionet e përbashkët, praktikat e reagimit të menjëhershëm, ndryshimi i strukturës së komandimit dhe kontrollit ajror, zëvendësimi i konceptit të patrullimit ajror me shtimin e kapaciteteve të mbrojtjes ajrore nga toka (SMAMD), si dhe shtimi i kapaciteteve të ndarjes dhe shkëmbimit të informacionit. Me rëndësi ishte edhe bisedimi i rritjes së kapaciteteve hapësinore si pasojë e ndryshimeve gjeostrategjike.

Komanda ajrore aleate ka pritur për disa vite simpoziume gjashtëmujore të shefave ajrorë të NATO-s. Ato janë një vend për shkëmbimin e pikëpamjeve për përfaqësuesit e lartë të forcave ajrore të shteteve anëtare të NATO-s dhe ofrojnë një mundësi për të vlerësuar situatën dhe për të diskutuar bashkëpunimin, koordinimin dhe zhvillimin e fuqisë ajrore dhe hapësinore të NATO-s.




Dy studentë të Akademisë së Forcave të Armatosura morën pjesë në aktivitetin “Java ndërkombëtare e Kadetëve”, që u zhvillua në Kosovë. Në këtë aktivitet, përveç studentëve nga Shqipëria, morën pjesë edhe studentë nga Kosova, Maqedonia e Veriut, Turqia, Kanadaja dhe SHBA-të. Pjesëmarrësit në këtë aktivitet shkëmbyen eksperiencat me njëri-tjetrin.



Ekipi i kërkim-shpëtimit së bashku me helikopterin e Emergjencave Civile në Ministrinë e Mbrojtjes u angazhuan menjëherë sapo kanë marrë njoftimin, krah policisë së Tropojës, në ndihmë të një grupi alpinistësh, që mendohet të jenë shtetas kroatë, të cilët janë ngjitur nga territori i Malit të Zi, për të mbërritur në vendin e quajtur “Maja e Jezercës”. Fatkeqësisht njëra nga anëtarët e grupit, shtetasja Z.L, 43 vjeç kishte rënë nga një terren i thepisur malor dhe me borë dhe si pasojë ka humbur jetën.

Ekipi i kërkim-shpëtimit ka bërë të mundur nxjerrjen e trupit të pajetë dhe transportimin me helikopter drejt morgut.

Ndërsa operacioni i shpëtimit ka vijuar duke bërë të mundur nxjerrjen e turistëve të tjerë, nga vendi ku ishin bllokuar.



Atasheu i BE-së, vizitë në komandën e Forcës Detare/Rojës Bregdetare

Në Komandën e Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra priti në një vizitë zyrtare atasheun ushtarak të Bashkimit Europian për Shqipërinë, kolonel Pietro Mostardi. Në takim u diskutua mbi planet e modernizimit, angazhimin e Forcës Detare në shërbim të Aleancës dhe Bashkimit Europian në mbrojtje të sigurisë rajonale konventave ndërkombëtare. Gjithashtu atasheu i BE-së u njoh me misionin dhe detyrat që kryhen në cilësinë e Rojës Bregdetare nga struktura jonë, si dhe bashkëpunimin me strukturat e tjera kombëtare, si dhe homologët e saj ndërkombëtarë.

Gjatë vizitës së tij, atasheu ushtarak i BE-së u njoh nga afër dhe me kapacitet, mjetet që disponon Roja Bregdetare, për kryerjen e detyrave dhe misionit të saj



Anija "Lissus", një tjetër sukses në mbrojtje të jetës

Gjatë orëve të para të mëngjesit, anija "Lissus", e cila ndodhet në mision në Detin Egje, asistoi në finalizimin me sukses të operacionit të kërkim - shpëtimit. Operacioni u zhvillua për t'i dhënë ndihmë emigrantëve të paligjshëm, të cilët lundronin në kushte të vështira dhe rrezikonin të mbyteshin.

Mjeti i tipit gomone me emigrantë ishin nisur nga Turqia me destinacion Greqinë. Pas koordinimit të anijes "Lissus" me Rojet Bregdetare të Greqisë dhe Turqisë, u bë i mundur shpëtimi i 36 emigrantëve mes tyre edhe fëmijë me kombësi nga Sudani, Libia dhe Jemeni. Emigrantët, 18 meshkuj, 14 femra dhe 4 fëmijë në gjendje të mirë shëndetësore, u morën nga Roja Bregdetare turke për vazhdimin e procedurave të mëtejshme. Forca Detare/Roja Bregdetare vazhdon misionin e saj fisnik në shpëtimin e jetëve njerëzore, në kuadër të Aleancës.



Neptun Strike 24-1" zbarkon në brigjet e Adriatikut

Në rajonin perëndimor të ishullit të Sazanit dhe Gadishullit të Karaburunit, u zhvillua stërvitja "Neptune Strike 24-1" me pjesëmarrjen e anijeve të Forcës Detare, Forcave Speciale shqiptare, regatave Spanjolle, anijes shumërolëshe Turke, Forcave Speciale të Maqedonisë së Veriut dhe forcave ajrore Franceze. Stërvitja u drejtua nga Komanda e Forcave Detare të NATO-s, (MARCOM) në koordinim me vendet pjesëmarrëse.

Në këtë stërvitje u testuan aftësitë e grupit të anijeve të mbështetura nga ajri për të reaguar në shumëllojshmëri situatash detare si: njohja e situatës detare, zhvillimi i embargos detare, operacione amfibe, bor-



dim, zbatim i ligjshmërisë në det, mbrojtja e Task Forcës nga sulme asimetrike, formacione të thjeshta dhe të avancuara detare, furnizim në det dhe sigurim i rajonit të zbarkimit.

Nga anija shumërolëshe turke "Anadolu" dhe fregatat spanjolle u kryen manovra zbarkimi me anije, gomone dhe me helikopter nga ajri, ndërkohë që avionët luftarakë spanjollë A-80 dhe ata francezë "Rafael" siguronin hapësirën ajrore.

Pjesë e skenarëve të stërvitjes ishin dhe operacionet amfibe, ku forcat Shqiptare, (Regjimenti i Operacioneve Speciale të FARSH) Spanjolle, Turke dhe të Maqedonisë së Veriut, kryen operacione të përbashkëta zbarkimi.

Në ditët e fundit të stërvitjes, u simulua një sulm terrorist nga një mjet i shpejtë ndaj anijes komandë, ku Task Forca vepronte me anije dhe helikopterë për neutralizimin e rrezikut.

Kjo stërvitje i shërbeu më së miri rritjes së ndërveprueshmërisë, kohezionit ndërmjet vendeve aleate, si dhe testimi të kapaciteteve për mbrojtjen e hapësirës detare, si një nga prioritet kryesorë të Aleancës.



Baza Detare e Sarandës, 50 vite histori suksesi

Komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra mori pjesë në ceremoninë e 50 - vjetorit të krijimit të Bazës Detare të Sarandës.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast ishin të pranishëm personalitete të pushtetit vendor e lokal, kryetari i Bashkisë Sarandë, z. Oltion Çaçi, kryetari i Shoqatës Detaria Shqiptare, ish - komandantë të Forcës Detare/Rojës Bregdetare, ish - efektivë dhe punonjës civilë që kanë shërbyer në Bazën Ushtarake Detare Shëngjin, Qendra e Personel Rekrutimit me personelin e saj, gjatë së cilës dhanë informacion më shumë ndaj të rinjve për t'u bashkuar në radhët e Forcave të Armatosura të RSH si një mundësi për të ardhmen. Ceremonia vijoi me dhënie të certifikatave të mirënjohjes për kontributin e dhënë në Forcën Detare/Rojën Bregdetare



nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FASë, gjeneralmajor Arben Kingji, komandanti i Forcës Detare/Rojës Bregdetare kundëradmiral Adnand Agastra, si dhe me ekspozitën fotografike në Galerinë Art Saranda, ku u shfaq një dokumentar historik, duke përmbyllur këtë ditë të veçantë me kujtime dhe respekt për traditën detare të këtij qyteti.

Aktiviteti u zbulua nga nxënësit e shkollës 9-vjeçare "9 Tetori", që kishin përgatitur një program të shkurtër artistik në këtë ditë të veçantë në përkujtim të detarëve të qytetit të Sarandës.

Në shëtitoren e qytetit të Sarandës u vendos pllaka me emrin "Marinari" në përkujtim dhe nderim të të gjithë personelit që kanë shërbyer në Bazën Ushtarake Detare Sarandë.



U zhvillua në Northwood, Mbretëria e Bashkuar, Konferenca e Komandantëve Detarë të NATO-s

Në Komandën Detare të NATO-s (MARCOM), u zhvillua Konferenca e Komandantëve Operacionalë Detarë të Aleancës (MOCC), në të cilën Forca Detare u përfaqësua me komandantin e Forcës Detare/Rojës Bregdetare kundëradmiral Adnand Agastra.

MOCC është një angazhim vjetor i MARCOM me komandantët e flotave aleate dhe partnere që ofron një mundësi për të diskutuar gjendjen e NATO-s, detare në epokën e DDA (Deterrence and Defence of the Euro-Atlantic Area) dhe këtë vit u diskutua lidhur me "Rritjen e Kapaciteteve dhe Gatishmërisë Detare në një mjedis me shumë kërcënime në domene të ndryshme". Gjatë ditëve të konferencës kundëradmiral Agastra pati një takim të veçantë me komandantin e MARCOM vice-admiral Mike Utley dhe komandantin e Joint Suport and Enabling Command (JSEC) gjenerallejtënant Aleksander Sollfrank, me të cilët zhvilloi diskutime në lidhje me çështjet e modernizimit të Forcës Detare, si dhe mori vlerësimet më të larta për angazhimin e FD/RB në misionet e NATO-s.

Komandanti MARCOM, vice-admiral Mike Utley, në fjalën e tij gjatë konferencës theksoi se: "Situata e sigurisë sot ka arritur në një pikë kritike, ku të gjitha vendet duhet të rrisin kapacitetet për mbrojtjen kolektive të Aleancës, pasi çdo aleat i sjell NATO-s aftësi kritike luftarake dhe ekspertizë unike".



Anija shqiptare "Lissus" në misionin "Sea Guardian" në detin Egje vijon kontributin në parandalimin e emigracionit të paligjshëm në ujërat e Aleancës. Ekuipazhi shqiptar, gjatë lundrimit në rajonin e patrullimit, konstatoi një gomone me 24 persona në bord, të cilën pas koordinimit me rojën bregdetare turke e greke, ia dorëzoi autoriteteve lokale për procedurat e mëtejshme.



Forca Detare/Roja Bregdetare përcjell Kontingjentin IV në misionin në detin Egje

Në Komandën e Forcës Detare/Rojës Bregdetare, u zhvillua ceremonia për përcjelljen e Kontingjentit IV për në operacionin e NATO-s në detin Egje. Në ceremoni, krahas personelit të Forcës Detare/Rojës Bregdetare, morën pjesë drejtori i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral brigade Aleksandër Pando dhe zëvendëskomandanti i Policisë Ushtarake, nënkolonel Artur Loka. Në fjalën e tij komandanti i Forcës Detare/Rojës Bregdetare, kundëradmiral Adnan Agastra u shpreh ndër të tjera: “Angazhimet e Forcës Detare/Rojës Bregdetare jo vetëm në Detin Egje por edhe në operacionin FOCOPS janë një kontribut i rëndësishëm dhe i prekshtëm për Aleancën dhe shpreh



bindjen se ky kontribut do të vijojë me sukses edhe në të ardhmen, duke shtuar peshën e kontributit të përgjithshëm që vendi ynë jep për aleancën”. Efektivët e Kontingjentit IV me marrjen e detyrës do të kalojnë nën Komandën e Grupit II të Gatshëm Detar të NATO-s dhe do të kryejë detyrat e patrullimit në zonën e saj të përgjegjësisë në Izmir, Turqi me qëllim parandalimin e fluksit të emigrantëve të paligjshëm dhe, ajo që është më kryesorja, vijimi i suksesit për shpëtimin e njerëzve, të cilët mund të jenë në rrezik për jetën e tyre në ujërat e detit Egje. Ceremonia u mbyll me dorëzimin e Flamurit Kombëtar nga komandanti i Forcës Detare/Rojës Bregdetare, kundëradmiral Adnan Agastra, komandantit të kontingjentit kapiten lejtënant Jetnor Balla, i cili do të drejtojë kontingjentin për tre muajt në vazhdim.

Përfundon workshopi midis Gardës Kombëtare të New Jersey-it dhe Grup-Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë

Në mjediset e Grup-Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë (GBKL) në Forcën Tokësore, u zhvillua një workshop midis përfaqësuesve të Gardës Kombëtare të New Jersey-it (GKNJ) dhe GBKL. Takimi “LIBG FY 25 Planning Workshop” u zhvillua në mbështetje të programit të bashkëpunimit midis GKNJ dhe Forcave tona të Armatosura. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte zhvillimi i bisedimeve me përfaqësues të Gardës Kombëtare të New Jersey-it për të identifikuar dhe planëzuar aktivitetet kryesore të bashkëpunimit për vitin 2025, si dhe draft-aktivitetet për vitet 2026-2027, me qëllim arritjen e objektivit kryesor të certifikimit të GBKL, për të qenë të gatshëm që prej vitit 2027 (FOC) të dislokohehet në operacione ushtarake në kuadër të NATO-s. Gjatë takimit palët folën për trajnimet në rritjen e aftësive profesionale të efektivave të GBKL, në përdorimin e mjeteve të fluturimit pa pilot, armëve anti-tank, mitralozave të rëndë, mbështetjen shëndetësore etj. Ditën e djeshme komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Ilir Xhebexhia priti në një takim ekipin e përfaqësuesve amerikanë të Gardës Kombëtare të New Jersey-it të kryesuar nga nënkolonel Kevin Murphy. Në



këtë takim palët shprehën konsideratat më të larta për bashkëpunimin e deritanishëm, ku theksi u vu në rritjen e mëtejshme të këtij bashkëpunimi në drejtim të kurseve, trajnimeve dhe modernizimit të FA-së. Gjeneralmajor Xhebexhia në fjalën e tij u fokusua në zhvillimin e trajnimeve dhe asistencës së specialistëve të Gardës Kombëtare të New Jersey-it.

Trupat Komando të Forcës Tokësore përfunduan me sukses stërvitjen “Strong Eagle 7”

Efektivë të Batalionit Komando dhe Regjimentit 3 “Ranger” të Forcave të Armatosura angleze, zhvilluan në vendin tonë stërvitjen “Strong Eagle 7”, e cila është një ndër aktivitetet e përbashkëta dypalëshe për shkëmbim eksperience, trajnimin dhe stërvitjen e këtyre strukturave.

Stërvitja u zhvillua në rajonin e Zall-Herrit si dhe në Poligonin Kombëtar të Bizës. Kjo stërvitje vjen në vazhden e bashkëpunimit të shkëlqyer me MB, duke pasur stërvitjen “Strong Eagle 6”, e cila u zhvillua në nëntor 2023 në Mbretërinë e Bashkuar.

Qëllimi i kësaj stërvitjeje është trajnimi dhe aftësimi i efektivit Komando në vlerësimin e situatave të ndryshme në fushën e luftimit, teknikat e luftimit dhe komunikimit në rritjen e ndërveprueshmërisë midis trupave aleate. Efektivit shqiptar u trajnuan në planëzimin e veprimeve luftarake,

trajnimin dhe kryerja e qitjeve me armë të precizionit të lartë, mënyra e komunikimit me radio sipas standardeve që përdorin vendet anëtare të NATO-s, dhënien e ndihmës së parë në fushën e luftimit, transportimin e të plagosurit etj. Me rastin e përfundimit të kësaj stërvitjeje, në Regjimentin e Operacioneve Speciale (ROS) u zhvillua një ceremoni, ku morën pjesë shefi i Shtabit të Forcës Tokësore, kolonel Beqir Tafili, zëvendës atashu ushtarak i Mbretërisë së Bashkuar në Shqipëri, major Imran Ahsan etj. Ceremoninë e hapi komandanti i ROS-së, kolonel Ajet Jata, i cili pasi falënderoi efektivët për përkushtimin dhe korrektësinë në stërvitje, theksoi se zhvillimi i këtyre stërvitjeve janë një vlerë e shtuar për aftësimin e komandove shqiptare.

Nga ana e tij, zëvendës atashu ushtarak i Mbretërisë së Bashkuar në Shqipëri major



Imran Ahsan, përshëndeti trupat për përfundimin me sukses të kësaj stërvitjeje, duke theksuar se këto stërvitje janë një tregues i qartë i bashkëpunimit të ngushtë midis dy ushtrive tona.

Shefi i Shtabit të FT-së, kolonel Beqir Tafili në fjalën e tij përmbyllëse vlerësoi maksimalisht këtë stërvitje, në të cilën u realizuan me sukses objektivat e stërvitjes nga ana e strukturave që u angazhuan, si dhe falënderoi zëvendës atashu britanik për bashkëpunim, donacionin e pajisjeve të zbulimit dhe të bashkëpunimit të vazhdueshëm si dhe komandën e ROS-së, për profesionalizmin dhe dedikimin në realizimin me sukses të kësaj stërvitjeje.

Gjithashtu ai u ndal në vlerësimin që i bën komanda e FT-së kësaj stërvitjeje dhe nënvizoi rritjen e vazhdueshme të bashkëpunimit, veçanërisht në fushën e trajnimit dhe stërvitjeve të përbashkëta, duke kërkuar që të stërvitemi me skenar sa më real bazuar në situatën e sigurisë.

Në fund të ceremonisë, për të pranishmit, nga ana e zëvendës atashu ushtarak britanik, u prezantuan pajisjet e zbulimit që Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar i dhuroi Regjimentit të Forcave Speciale.

Përfundon Kursi Bazë i Oficerit në specialitetin Këmbësori

Në mjediset e Qendrës Stërvitore në Komandën e Forcës Tokësore Zall-Herr, u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit Bazë të Oficerit në specialitetin Këmbësori. Në këtë kurs u trajnuan 33 ushtarakë. Në këtë ceremoni mori pjesë Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Ilir Xhebexhia, shefi i Shtabit të FT-së, kolonel Beqir Tafili, komandanti i Qendrës Stërvitore, kolonel Ekland Dauti etj. Në fjalën e tij përshëndetëse, komandanti i Forcës Tokësore gjeneralmajor Ilir Xhebexhia, pasi falënderoi oficerët e rinj për përkushtimin dhe profesionalizmin e treguar u ndal në kujdesin që ata duhet t'i kushtojnë përgatitjes profesionale, si kusht bazë për përparimin në karrierën e oficerit si dhe kujdesin e shtuar që po tregon Ministria e Mbrojtjes dhe lidhshpimi i Forcave të Armatosura për trajtimin sa më të mirë të personelit ushtarak dhe në veçanti për oficerët e rinj të FA-së. Ky kurs u zhvillua në një periudhë 4 mujore, ku kursantët morën njohuri të plota mbi togën, rolin dhe detyrat që kryen ajo në lloje të ndryshme luftimi: në procesin e drejtimit të trupave, dhënien e njohurive të domosdoshme për dre-



jtimit operacional të togës në operacionet luftarake, jo luftarake e paqeruajtëse; marrjen e njohurive bazë në specialitet ushtarakë përkatëse, marrjen e njohurive bazë për armët dhe shërbimet në FA si dhe në dhënien e njohurive për menaxhimin dhe analizën pas stërvitjes.

Në Qendrën Stërvitore të Forcës Tokësore nga muaji janar i këtij viti deri më sot janë zhvilluar një sërë kurseesh, si KBO specialiteti Zbulim dhe Këmbësori, KBNOF, Kursi Komando, kursi “Junior Command and Leadership Course” si dhe tre grupe mësimore të gjuhës angleze, në total 120 kursantë. Gjithashtu vijojnë KAO, KANOF, KBOF.



Stërvitje e përbashkët “eVA 24/01” me trupat ushtarake të Regjimentit të KëmbëSORISË së Jugut dhe ato të Malit të Zi

Në rajonet stërvitore të Zall-Herrit dhe Bizës, trupat e Regjimentit të KëmbëSORISË së Jugut (RKJ) të Forcës Tokësore u stërviten së bashku me efektivë të Forcave të Armatosura të Malit të Zi.

Kjo stërvitje e përbashkët u zhvillua në kuadër të stërvitjes paradisllokuese e koduar “eVA 24/01”(enhanced Vigilance Activity), që konsiston në rritjen e aftësive profesionale të efektivave në fushën e luftimit si dhe koordinimin sa më të mirë të veprimeve luftarake në kryerjen e detyrave në përbërje të Grup-Batalionit të NATO-s, në kufirin lindor të saj. Pas përfundimit të stërvitjes kompaktësuese “Luftim në qendër të banuar”, efektivat



realizuan qitje me armët e këmbëSORISË në situata të vështira moti e terreni.

Kjo stërvitje paradisllokuese e trupave që përgatiten për mision në kuadër të NATO-s, bën të mundur aftësimin e efektivave të dy forcave të armatosura në realizimin e detyrave luftarake të përbashkëta në situata dhe terren të përafërt me vendin ku do të kryejnë misionin.



Trupat speciale, pjesë e stërvitjes shumëkombëshe “Neptune Strike 24”

Operatorët e Forcave Speciale të Regjimentit të Operacioneve Speciale së bashku me kolegët e tyre të Maqedonisë së Veriut, të mbështetur nga një anije e klasit “Iliria” dhe dy avionë nga Spanja e Franca, zhvilluan skenarë të ndryshëm stërvitor në bazën detare të Pashalimanit dhe ishullin e Sazanit.

Në këtë stërvitje komplekse të quajtur “Neptun Strike 2024” u ndërthurën kapacitetet tokë, ajër, det, aftësitë reaguese dhe asetet e aleatëve, me qëllim rritjen e gatishmërisë në mbrojtje të Aleancës.

Forcat speciale të ROS së bashku me kolegët e tyre të Maqedonisë së Veriut dhe Turqisë kryen operacione zbarkimi nga deti në tokë, goditje objektive, zbulim, luftim në zona të banuara me qëllim testimin e aftësive integruese me forca detare aleate në përgjigje të krizave dhe operacioneve të ndryshme.

Këto stërvitje i shërbejnë zhvillimit të aftësive bashkëvepruese ndërmjet vendeve aleate, si dhe testimit të kapaciteteve për mbrojtjen e hapësirës detare.



Efektivi i Regjimentit të Mbështetjes me Luftim zhvilloi marshim dhe qitje luftarake

Në zbatim të plan-kalendarit të aktiviteteve kryesore, planit të marshimeve dhe qitjeve luftarake, efektivi i Regjimentit të Mbështetjes me Luftim në Forcën Tokësore kreu një marshim taktik 7 km në rrugëkalimin Çakallë - Qafëlopë - Poligoni i Qitjes. Ky marshim u zhvillua në tre faza ajo e planëzimit, e zhvillimit të marshimit dhe realizimit të qitjes. Qëllimi i këtij marshimi ishte rritja e kompaktësimit dhe qëndrueshmërisë së trupave në lëviz-



je për në rajonin e përqendrimit, marrjen e detyrës luftarake dhe realizimit të qitjes me armët individuale.

Gjatë lëvizjes u improvizuan situata të ndryshme sipas listë-detyrave themelore të reparteve, si: situatë të mbrojtjes nga MADM, kontrollin e shtigjeve të kalimit, masat e ruajtjes dhe veprimet në rast goditje nga artileria etj. Pas përfundimit me sukses të dy fazave u realizua qitje luftarake me armët individuale.



Përfundoi operacioni për pastrimin nga municionet e paplasura në territorin e kishës së “Shën Gjergjit” në Mbreshtan, Berat

Efektivët e Kompanisë EOD, për më shumë se dy javë, janë angazhuar në operacionin për pastrimin e territorit të kishës së “Shën Gjergjit” në fshatin Mbreshtan, bashkia Berat.

Në këtë operacion u kontrollua me aparat ferro-magnetik sipërfaqja 450 m² jashtë godinës së kishës dhe sipërfaqja 270 m² brenda objektit.

Specialistët e Kompanisë EOD identifikuan municione të ndryshme si: granata dore, kapsolla detonatorë, fishekë dhe armë pistoletë. Municionet e gjetura u vlerësuan të lëvizshme dhe u magazinuan në Batalionin e Xhenios. Mjediset brenda dhe jashtë kishës së “Shën Gjergjit” u pastruan dhe nga inertet, bimësia, duke i dhënë një pamje të re dhe duke e bërë më të arritshme për banorët e zonës. Kompania EOD me profesionalizmin dhe angazhimin e saj i shërbeu jo vetëm komunitetit ortodoks, duke qenë se kisha përfaqëson një monument kulture të kategorisë së parë, por i shërbeu dhe banorëve, të cilët tani mund të kryejnë ritet dhe zakonet në varrezat e fshatit Mbreshtan.



Kompania EOD realizoi me sukses misionin e saj për eliminimin e rrezikut nga municionet e paplasura

Në bashkinë Poliçan dhe Elbasan janë identifikuar municione të paplasura. Ndërhyrja e specialistëve të Kompanisë EOD, Batalionit të Xhenios, bëri të mundur pastrimin e zonës dhe kthimin në një mjedis të sigurt.

Gjatë rikonicionit të kryer nga ekipi i ekspertëve janë konstatuar disa lloje të municioneve të paplasura si: predha mortaje, predha topi dhe granata të kalibrave të ndryshëm. Këto municione u vlerësuan të preکشme dhe të lëvizshme.

Nën masa të forta sigurie u bë transportimi dhe magazinimi në mjediset e Batalionit të Xhenios.

Përfundon Kursi EOD Niveli III, në Qendrën Stërvitore në Komandën Mbështetëse

U zhvillua në mjediset e Qendrës Stërvitore, ceremonia për përfundimin e Kursit EOD (Explosive Ordnance Disposal) Niveli III, nën drejtimin e instruktorëve amerikanë. Në këtë ceremoni morën pjesë komandanti i Qendrës Stërvitore, kolonel Ylli Zyla, si dhe përfaqësues të palës amerikane.

Në fjalën përshëndetëse komandanti i Qendrës Stërvitore, kolonel Ylli Zyla falënderoi kursantët për seriozitetin e treguar dhe vendosmërinë për të marrë dijet e duhura dhe për t'u aftësuar profesionalisht në detyrën e tyre.

Ky kurs, i cili zgjati shtatë javë, kishte për qëllim aftësimin e kursantëve për zbatimin e procedurave për vendosjen në siguresë dhe asgjësimin logjistik të municioneve deri në 50 kg. Ceremonia u përmbyll me një foto të përbashkët.



Përfundoi ndërtimi i urës “Bailey” në fshatin Arrës, bashkia Devoll

Ekipi xhenerier i kompanisë së urave në Batalionin e Xhenios të Komandës Mbështetëse ka punuar me intensitet për më se dy javë, duke i dhuruar banorëve të fshatit Arrës, bashkia Devoll, urën tip “Bailey”, me gjatësi 9 metra dhe seksion 1/1.

Kjo urë me një vlerë të jashtëzakonshme në komunitet, do iu shërbejë rreth 600 banorëve të fshatit Arrës, për lidhjen dhe komunikimin me fshatrat e tjerë si dhe zhvillimin e mëtejshëm të kësaj zone.

Komanda Mbështetëse me kapacitetet dhe asetet e saj xheneriere, do të jetë gjithmonë në mbështetje të vazhdueshme për të dhënë kontributin e nevojshëm në ndihmë të popullsisë civile.



Baza e Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile mirëpriti në ambientet e saj nxënësit e shkollës së mesme “Aleks Buda”, Tiranë

Në kuadër të aktiviteteve promovuese të fushatës së rekrutimit të të rinjve në Forcat e Armatosura, nxënës të shkollës së mesme “Aleks Buda”, Tiranë zhvilluan një vizitë njohëse në mjediset e BMEC. Nxënësit u pritën nga komandanti i BMEC, kolonel Hajdar Gurra, i cili në fjalën e tij përshëndetëse u uroi mirëseardhjen dhe u foli të rinjve për misionin fisnik të BMEC, duke ndarë me ta jo vetëm kontributin e këtij reparti, operacionet brenda vendit por dhe ato jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë.

Në këtë aktivitet morën pjesë zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse, kolonel Shkëlqim Çela, komandantë të reparteve vartëse të Komandës Mbështetëse dhe përfaqësues nga Qendra e Personel Rekrutimit. Nxënësit e shkollës së mesme “Aleks Buda”, u njohën me ambientet, teknikën, pajisjet speciale dhe materiale të ndryshme, të cilat janë në përdorim nga BMEC. Gjithashtu nëpërmjet standave të ekspozuara nxënësit morën informacion në lidhje me aktivitetin e realizuar ndër vite nga nën-repartet e Komandës Mbështetëse. Aktiviteti vijoi me një demonstrim



ushtrimi nga efektivet e kompanisë së parë dhe të dytë operacionale, demonstrimin e një situatë të fikjes së zjarrit në ambiente të mbyllura dhe të hapura si dhe një ushtrimi kompleks kërkim-shpëtimi malor (hedhje nga lartësia dhe zbritja e të plagosurit nga lartësitë). Në

këto demonstrime u përdorën pajisje dhe teknika moderne. Përfaqësuesit e Qendrës së Personel Rekrutimit shpërndanë broshura me materiale informuese për t'u bërë pjesë e Forcave të Armatosura. Në përfundim të aktivitetit u realizua një foto e përbashkët midis ushtarakëve dhe nxënësve të pranishëm.



Një tjetër urë “Bailey” e përfunduar nga specialistët xhenierë, në fshatin Grabovë, bashkia Gramsh

Specialistët xhenierë të Kompanisë së Urave në Batalionin e Xhenios, Komanda Mbështetëse, janë angazhuar për ndërtimin e urës me gjatësi 18 metra,

me seksion 2/1 dhe me peshëmbajtje deri në 40 ton, në përroin e Çumës, njësi administrative Lenie, bashkia Gramsh.

Duke qenë një zonë me histori dhe kulturë të lashtë si dhe atraksione të shumta turistike, kjo urë do t'i shërbejë jo vetëm 350 banorëve të fshatit Grabovë, por njëkohësisht do të shërbejë për tërheqjen e shumë turistëve vendas dhe të huaj.

Mirënjohje për specialistët xhenierë të cilët, pavarësisht kushteve të vështira atmosferike dhe reshjeve të borës, nuk e ndalën kontributin e tyre në ndihmë të komunitetit.



Specialistët EOD përfundojnë me sukses operacionin në Poshnje, Dimal

Specialistët të kompanisë EOD, të Batalionit të Xhenios në Komandën Mbështetëse realizuan një operacion për njohjen, largimin dhe magazinimin e municioneve të paplasura në afërsi të repartit ushtarak nr.1030, Poshnje, Dimal. Gjatë këtij operacioni, i cili u realizua duke zbatuar rregullat e sigurimit teknik të parashikuara në manualin EOD, u gjetën gjashtë predha të kalibrave të ndryshëm. Pasi u verifikua që predhat e gjetura janë të lëvizshme, ato u transportuan dhe u magazinuan në mjediset e Batalionit të Xhenios.



15 efektivë të Bazës së Mbështetjes së Emergjencave Civile përfundojnë Kursin I të Kërkim - Shpëtimit Malor

Në mjediset e Qendrës Stërvitore të Komandës Mbështetëse, u zhvillua ceremonia e certifikimit të 15 kursanteve efektivë të Bazës së Mbështetjes së Emergjencave Civile, të cilët përfunduan me sukses Kursin I të Kërkim - Shpëtimit Malor.

Ky kurs u zhvillua për një periudhë tre javore dhe kishte si qëllim përvetësimin e njohurive dhe aftësimin e kursantëve në veprime praktike për përdorimin e pajisjeve individuale dhe kolektive të ndërhyrjes në operacione të kërkim - shpëtimit malor.

Në këtë ceremoni morën pjesë shefi i Shtabit i Komandës Mbështetëse, kolonel Idriz Kuca, dhe komandanti i Qendrës Stërvitore, kolonel Ylli Zyla.

Kolonel Zyla në fjalën e tij të rastit, nënvizoi faktin se në një të ardhme të afërt kursantët që ndjekin kurse të tilla do të pajisen me dëshmi aftësie, gjë

e cila do të shërbejë edhe në jetën civile. Kursi i sapo përfunduar do të pasohet me kurse të tjera në të cilët do të merren njohuri më të avancuara për perfeksionimin e teknikave për t'u aftësuar për pjesëmarrje në operacione. Kolonel Kuca, në fjalën përmbyllëse, falënderoi kursantët dhe in-



strukturët për përkushtimin e treguar gjatë zhvillimit të kursit, ku ndër të tjera theksoi mbështetjen e vazhdueshme për vijimin e trajnimeve dhe stërvitjeve të mëtejshme, për përgatitjen e personelit të Forcave të Armatosura dhe jo vetëm. Në përfundim të ceremonisë, të gjithë kursantët u pajisën me certifikatë për përfundimin me sukses të trajnimit dhe certifikatë mirënjohjeje morën edhe instruktorët për kontributin e tyre.

Ekspertët e kompanisë EOD, realizuan me sukses operacionet në bashkinë Himarë dhe bashkinë Vlorë

Një ekip ekspertësh të kompanisë EOD, të batalionit të xhenios në Komandën Mbështetëse, i erdhën në ndihmë banorëve të lagjes Stefanel, bashkia Himarë, duke realizuar një operacion për verifikimin, largimin, transportimin dhe magazinimin e municioneve. Nga kontrolli i kryer në mënyrë vizuale dhe me aparate të posaçme, ekspertët e kompanisë EOD identifikuan dy predha të paplasura të luftës së dytë botërore. Duke zbatuar të gjitha masat e sigurisë dhe ruajtjes, grupi i specialistëve të kompanisë EOD, bëri të mundur dhe pastrimin nga municionet e paplasura, të gjetura në zonën bregdetare të Zvërnecit, bashkia Vlorë.

Edhe në këtë operacion u gjetën predha topi të luftës së dytë botërore. Municionet e gjetura u vlerësuan të lëvizshme dhe u transportuan për t'u magazinuar në ambientet e batalionit të xhenios. Komanda Mbështetëse, nëpërmjet operacioneve të tilla, përbush misionin e saj, duke e bërë mjedisin dhe jetën e popullsisë civile më të sigurt.



Përfundon operacioni për shkatërrimin e masivit shkëmbor në fshatin Neviçisht, Bashkia Korçë

Specialistët e Kompanisë së Punimeve Xheniere, në Batalionin e Xhenios, për një periudhë më shumë se dy javore, kanë punuar për shkatërrimin e masivit shkëmbor në fshatin Neviçisht, njësi administrative Bulgarec, bashkia Korçë. Katër shkëmbinj të madhësive të konsiderueshme, për një kohë të gjatë kanë rrezikuar jetën e banorëve. Specialistët xhenierë eliminuan rrezikun, duke bërë shkatërrimin e kontrolluar të shkëmbinjve. Për realizimin e detyrës u përdorën lëndë plasëse si dhe thyerje mekanike me krah.





Oligarkët dhe Lufta



KOLONEL HYSNI GJERGJI

“Oligarkët politikë” shkojnë në anën tjetër, ata e kthejnë pushtetin politik në para. Në Europën juglindore ata nuk janë pak dhe sanksionimi i SHBA-ve e tregon qartë këtë fenomen në përhapje. Kategoria e oligarkëve mediatikë është shumë e përhapur në epokën tonë, atë digjitale, mund të formojnë, deformojnë, drejtojnë opinionin, grupet e mendimit dhe universitetet (metoda e preferuar e Charles Koch) përmes platformave të tilla si “Facebook”, “X”, “Tik-tok” etj.

L

ufta, përveç të qenit përplasje e armatosur vullnetesh, shtetesh, grupesh, apo vazhdim i politikës me mjete të tjera; ajo është edhe biznesi më fitimprurës, i cila ka vetëm një të keqe: jetët e humbura, ndërsa gjithçka tjetër është para, është përfitim. Këtë shans përpiqen ta kapin një kategori e caktuar

biznesmenësh, të cilët janë afër biznesit të luftës dhe afër politikës gjithashtu. Këta biznesmenë janë thirrur për herë të parë oligarkë, nga Aristoteli, gati 2400 vjet më parë: “Kudo që njerëzit sundojnë për shkak të pasurisë së tyre, kjo është një oligarki”.

Oligarkët janë një lloj i përjetshëm biznesmenësh që tani po përhapen në mbarë botën, në perëndim dhe në lindje. Shumë prej tyre drejtojnë edhe shtete. Sipas Max Weber, kapitalizmi politik karakterizohet nga shfrytëzimi i posteve politike për të grumbulluar pasuri private. Kapitalistët politikë nuk janë unik për vendet post-sovjetike, por ata janë në gjendje të lulëzojnë pikërisht në ato zona ku shteti ka luajtur historikisht rolin dominues në ekonomi dhe ka grumbulluar kapital të pamasë, tashmë të hapur për shfrytëzim privat. Këtë ata e dinë mirë dhe e presin ta kapin si shans, pikësëpari ata që financojnë luftën, e blejnë, e shesin e negociojnë, e shkatërrojnë dhe e ndërtojnë përsëri. Qofshin këta shtete, banka apo edhe individë, të gjithë njihen me emrin oligarkë. Megjithatë, oligarkët dhe fuqia e tyre për fatin e shteteve dhe luftërave janë çuditërisht të nënvlerësuar, thotë David Lingelbach, i cili bashkë

me Valentina Rodríguez Guerra ka shkruar një libër të ri, “Sundimi i Oligarkëve”, i cili ripunon përkufizimin e Aristotelit. “Një oligark, është dikush që e siguron dhe riprodhon pasurinë ose pushtetin, më pas e transformon njëherë në tjetër”. Së pari, oligarkët nuk janë thjeshtë manjatë, ata janë biznesmenë të pasur që mund të mos kenë asnjë pushtet politik. Ka dy lloje kryesorë oligarkësh: oligarkët e biznesit dhe oligarkët politikë.

Elon Musk për shembull u shndërrua nga manjat në oligark vetëm kur bleu “Twitter”, “X” në vitin 2022. Kompania e tij, “X”, formon, krijon, shpërndan opinionin mbi ngjarjet sot nga Ukraina deri në Izrael. Aktualisht Musk është një nga pesë ose 10 oligarkët më të rëndësishëm në botën tonë. “Oligarkët e biznesit” si Musk e kthejnë pasurinë në pushtet politik, pasi opinionet që krijohen dhe shpërndahen nga kompania e tij, ndryshojnë pushtetet politike duke mbështetur njëherë palë, apo duke dëmtuar imazhin e palës tjetër. Oligark arrogant u quajt Musk, më 24 prill 2024, nga kryeministri australian Albanese, pasi ai nuk kishte pranuar kërkesën e qeverisë australiane për të hequr nga “X” pamjet e rënda të goditjes me thikë në një kishë.

Ndërsa “oligarkët politikë” shkojnë në anën tjetër, ata e kthejnë pushtetin politik në para. Në Europën juglindore ata nuk janë pak dhe sanksionimi i SHBA-ve e tregon qartë këtë fenomen në përhapje. Kategoria e oligarkëve mediatikë është shumë e përhapur në epokën tonë, atë digjitale, mund të formojnë, deformojnë, drejtojnë opinionin, grupet e mendimit dhe universitetet (metoda e preferuar e Charles Koch) përmes platformave të tilla si “Facebook”, “X”, “TikTok” etj. Musk konkretisht, përmes platformës së tij “X” u bëri thirrje ndjekësve të votojnë republikanët në zgjedhjet afatmesme të vitit të kaluar në SHBA. Nga një oligark mediatik ai kthehet në politik pasi ndikon drejtpërdrejt në një rezultat zgjedhor. Tani ai është një zë i krahut të djathtë, me sa duket do të mbështesë Trump për president në zgjedhjet e 2024. Trump vetë si person, për dekada ishte një trashëgimtar lokal oligark i qytetit të Nju Jorkut, i cili në vitin 2015 bëri kërcimin nga oligark biznesi në oligark politik.

Kur kandidoi për president, ai shpenzoi 66 milionë dollarë nga paratë e tij personale për presidenciale. Kandidatët e tjerë nuk e kanë këtë mundësi, prandaj këtu gara që duhet të bëhet në pozita të barabarta, që e garanton demokracia, prishet.

Një shembull klasik i oligarkut politik, thotë libri, është Vladimir Putin, “ai është një miliardar që ka në pronësi armë bërthamore”. Influencuesit oligarkë si Rupert Murdoch, Charles Koch etj., vendosin axhenda, ndërsa pronarët e platformave “X”, si Musk, Mark Zuckerberg i “Facebook” dhe Larry Page i “Google”, drejtojnë, manipulojnë dhe përzgjedhin rrjedhën e informacionit që influencin trurin tonë. Intensiteti dhe kostoja në ritje e “luftës totale” në shekullin e njëzetë e një dhe zhvillimi i ekonomive të luftës, në të cilat transaksionet monetare janë të përhapura në të gjithë industrinë e luftës, i kanë dhënë fuqisë monetare rëndësi të madhe për fuqinë ushtarake. Lufta proxy në Ukrainë nuk mund të vazhdojë asnjë ditë nëse nuk financohen të dy palët, si nëpërmjet shteteve ashtu dhe individëve. Me paranë si armë në duart e oligarkëve politikë ose individëve, lufta mund të blihet, të krijohet, të ndalohet dhe të shtet, si mall gjeopolitik.

Në Rusinë e viteve 1990, rrua drejt pasurisë së menjëhershme ishte vetëm përmes përdorimit të zyrtarëve të qeverisë, për të patur akses tek privatizimi i pronave publike. Për shkak të kësaj origjine, oligarkët rusë nuk i zotëruan kurrë plotësisht pasuritë e tyre, pasi oligarkët politikë i kërcënonin në çdo kohë. Shtatë oligarkë siguruan në vitin 1990, kontrollin mbi gjysmën e ekonomisë ruse. Pikërisht atëherë fjala “oligark” hyri në përdorimin e zakonshëm të rusishtes. Ata kujdeseshin vetë për paratë, deri në momentin kur padronët e tyre në

qeveri i lejonin. Shumë oligarkë post-sovjetikë ndërtuan një jetë midis Moskës dhe perëndimit, duke shfrytëzuar tensionin midis Rusisë dhe kundërshtarëve të saj perëndimorë. Me pak fjalë, autokracitë bëjnë një punë “më të mirë” se demokracitë në frenimin e oligarkëve. Udhëheqësi autokratik shpesh bëhet krye oligarku i vendit. Çdo oligark në shtetet autokratike është gjithmonë në rrezik dhe duke u mbrojtur nga kërcënimi për paratë (ose jetën) e tij.

Ka dallime midis oligarkëve post-sovjetikë dhe pasardhësve të tyre tani gjatë konfliktit në Ukrainë, në veçanti. Për oligarkët e luftës historia shkruhet në “dhomën e pasme” dhe ata janë “miq me interes”, që do të thotë se ata i përdorin dhe më pas i hedhin poshtë partnerët e përkohshëm, siç bëri Putin dhe Roman Abramovich, me shokun e tyre oligark Boris Berezovsky, i cili u gjet i varur në shtëpinë e tij në Ascot, Angli. Mbretërimi i një oligarku ka qenë shpesh i shkurtër, dhe pse ai (sepse pothuajse të gjithë janë burra) përgjithësisht jeton i rrethuar nga truproja. Oligarkët që pasurohen në luftë zakonisht zhvendosen në vende më të sigurta, veçanërisht në Londër dhe Dubai.

Oligarkët perëndimorë jetojnë me një tjetër lloj frike nga ai i autokracive lindore. Ata kanë frikë vetëm nëse Uashingtoni apo Brukseli do t'i thyejnë monopolet e tyre në treg. Oligarkët perëndimorë, ndryshe nga ato të autokracive, kërkojnë thjesht që qeveritë t'i lënë ata të qetë. Në një demokraci, oligarkët shpesh zgjedhin dhe mbështesin kandidatët politikë përmes donacioneve. Rreth 200 vjet më parë babai themelues amerikan John Adams shkruante: “Frika më e madhe për të ardhmen e SHBA-së nuk është një mbret tiran, por një oligark”. Zgjedhja, për shembull e Berlusconi si kryeministër i Italisë në vitin 1994, tregoi papritur admirim popullor për oligarkët, e cila ishte e pa parashikuar. Seksionet e politikës dhe biznesit në redaksitë e lajmeve filluan të bashkohen me Berlusconi tashmë, si manjat i mediave dhe politikan njëkohësisht. Oligarkët rusë rizgjodhën Boris Yeltsin në vitin 1996 dhe thujse me të njëjtat mjete Peter Thiel mbështeti Donald Trump në zgjedhjen e tij në 2016.

Lufta në Ukrainë po krijon, zëvendëson dhe përditëson rolin e oligarkëve në këtë luftë të mbuluar mediatikisht më shumë se çdo luftë e mëparshme. Dy nga aktorët kryesorë të luftës së Ukrainës, Prigozhin dhe Musk, ishin ose janë oligarkë me besnikëri jo të besueshme, siç janë zakonisht oligarkët. Prigozhin ishte ai lloj oligarku, komandant i një ushtrie private, i silit romak. Musk, megjithëse nuk është një komandant lufte në fushëbetejë, ai kontrollon në një formë të re kapacitetin ushtarak, që është media, informimi dhe komunikimi në përgjithësi. Satelitët dhe platformat e tij “Starlink”, ofrojnë avantazh dhe bëjnë diferencën e palëve ndërluftuese në fushën e betejës, më shumë se çdo armë tjetër e përdorur deri tani.

Në fillim të konfliktit këto platforma u ofruan nga Musk për popullin ukrainas, për të rikuperuar komunikimin e shkatërruar nga raketat ruse. Më vonë gjatë luftës platformat ofronin internet falas dhe u bënë vdekjeprurëse për ushtrinë ruse, pasi çdo person që kishte një smartphone mund t'i dërgonte komandës së dronëve ukrainas koordinatat dhe fotot e rusëve në kohë reale. Në 2023, Musk ndërhyri dhe ndikoi në ecurinë e luftës, duke refuzuar ta zgjerojë mbulimin e “Starlink”, me qëllim që të lejonte Ukrainën të bënte një sulm të befasishtëm ndaj flotës ruse. Sipas revistës “The New Yorker”, Musk u tha zyrtarëve të Pentagonit se kishte diskutuar për luftën me Putinin. Pavarësisht nëse ata folën apo jo, marrëveshjet private midis oligarkëve tani mund të ndryshojnë luftën dhe për rrjedhim botën.

Lufta po i rrëzon dhe shkatërron shumë oligarkë të mëparshëm, pasi tani miliardarët e rinj rusë grumbullojnë pasurinë e tyre falë lidhjeve personale me Vladimir Putin. Putini nuk i toleron më oligarkët autonomë, të pavarur nga ai, siç u bë e qartë me Prigozhin, i cili pasi marshoi drejt Moskës në qershor 2023, vdiq në një aksident



ajror “jo misterioz”. Sipas një hetimi, grupi i minierave Evraz i Roman Abramovich, furnizonte me lëndë të para fabrikat e tankeve dhe kimikate për eksplozivë dhe raketa. Në fillim të luftës, Abramovich e shmangu takimin në të cilin kreu i Kremlinit kishte ftuar të gjithë biznesmenët kryesorë rusë, duke preferuar të paraqitej si një “ndërmjetës” midis Kievit dhe Moskës për të gjetur një “zgjidhje paqësore”. Roman Abramovich, kishte marrëdhënie personale me Putinin për shumë vite, por u helmua i akuzuar si pjesëmarrjes në bisedimet e paqes ruso-ukrainase, në mars 2022.

Kur janë pyetur nga mediat: “A keni frikë për jetën tuaj?”, oligarkët rusë kanë thënë “Jo”. Por, me siguri ata kanë shumë frikë, pasi mbrohen, rrethohen nga roje dhe iu fshihen oligarkëve politikë.

Tani oligarkët rusë po zëvendësohen nga një grup i “miliarderëve të emëruar” të Putinit që janë miqtë e tij si: Igor Sechin, Boris Rotenberg dhe Vladimir Potanin. Në kohën kur minigarku rus Oleg Tinkov kritikoi luftën e Rusisë, ishte Vladimir Potanin ai që bleu aksionet në bankën e Tinkov të zhvlerësuar. Potanin bleu gjithashtu Rosbank nga “Société Générale”, pasi banka franceze u largua nga Rusia si rezultat i fillimit të luftës.

Ka ende mjaft pasuri ruse për të rishpërndarë, por jo pushtet politik, pasi më 17 mars 2024, Putin fitoi një tjetër mandat deri në 2030.

Oligarkët ukrainas, nga ana tjetër në këtë periudhë lufte, po ngrihen dhe njëkohësisht shkatërrohen gjatë luftës. Shumë pasuri ukrainase janë të zhdukura në rrënojat e luftës, kur shteti ukrainas u mobilizua për luftë. Në vitin 2021, Kievi miratoi një ligj de-oligarkizimi, duke i detyruar ata të deklarojnë pasuritë e tyre dhe të ndalojnë financimin e partive politike, për t’iu vënë në shërbim të luftës. Igor Kolomoisky, oligarku, kanali televiziv i të cilit shfaqti komedinë televizive anti-oligarke të Volodymyr Zelenskyy në politikë, i cili më pas financoi fushatën presidenciale të Zelenskit, u arrestua për mashtrim dhe pastrim parash.

Zelenskyy është kthyer kundër oligarkut krijues të tij, siç bëri

Putin kundër Berezovskit. Zelenskit i duhej ta bënte këtë, pasi Perëndimi do të financojë rindërtimin e Ukrainës dhe do ta pranojë Ukrainën në BE, vetëm nëse beson se oligarkët nuk do t’i vjedhin paratë e dhuruara. Politikëbërësit ukrainas që përballen me oligarkët sigurisht që i dinë rreziqet. Ish-shefja e bankës qendrore Valeria Gontareva, e cila mbikëqyri shtetëzimin e “PrivatBank” të Kolomoisky, pati një “aksident” me një makinë misterioze në Knightsbridge në 2019, që e çoi Valerian në karrocën e invalidit. Javë më vonë, një shpërthim molotov dogji shtëpinë e saj jashtë Kievit. Libri “Sundimi i Oligarkëve” thotë se “në vitet 1940, oligarku kinez Soong besojë të ishte personi më i pasur në botë me një vlerë neto prej 600 milionë dollarësh në dollarët e sotëm”. Në Kinë aktualisht numri i oligarkëve kinezë është rritur frikshëm, të cilët janë plotësisht nën kontrollin qeveritar, duke financuar madje edhe ushtri private.

Pasuria neto e Musk në 2024 është rreth 207 miliardë dollarë. Në vitin 2021, drejtori i Programit Botëror të Ushqimit të OKB-së tha se vetëm 2 për qind e pasurisë së tij do të “shpëtonte 42 milionë njerëz në prag të urisë”. “Nga ferri i të varfërve lind parajsja e të pasurve”, shkruante Viktor Hygo në shekullin XIX. Në një vit si 2024, të mbushur me luftëra dhe zgjedhje politike në gjysmën e globit, oligarkët munden dhe do të gjejnë gjithmonë strehë dhe përfitime, siç thonë Lingelbach dhe Rodríguez Guerra, oligarkët lulëzojnë dhe ndikojnë në kohë tranzicioni politik, lufte dhe pasigurie si kjo e sotmja. Shumë oligarkë të tjerë ndërsa në përgatitje të shkrimit, mundet edhe nga Shqipëria, janë sot duke lobuar, duke u afruar me politikën, për ta korruptuar atë, që të gjejnë hapësirë për “paratë e gjakut”, që do t’i jepen Ukrainës për rindërtim. Oligarkët në përgjithësi nuk njohin integritet në marrëdhënie me njërin apo tjetrin palë politike, madje “paguajnë për t’u shitur”. Dhe përsëri në rastin e përfitimeve nga luftërat e fundit, në Ukrainë apo Gaza, Viktor Hygo do të thoshte “Luftën e bëjnë heronjtë, qeverisin maskarenjtë dhe përfitojnë horrat”.

Engjëjt shqiptar të paqes në panteonin e dëshmorëve të NATO-s

Çdo 6 maj, Forcat e Armatosura përkujtojnë me nderime dy prej ushtarakëve, që dhanë jetën e tyre në misionin “Asgjësimi i Municioneve me Eksplozivë”, në Riga, Letoni. N/tetare Zarife Hasanaj dhe major Klodian Tanushi tashmë janë yjet e paharruar në panteonin e dëshmorëve të atdheut. Nderim dhe mirënjohje për ushtarakët tanë, veprën e tyre sublime, për të cilën betohen para flamurit.

N/tetare Zarife Hasanaj ishte mobilizuar në FA si ushtare profesionist i parë dhe në datë 01.10.2013, titullohet n/officer me gradën ‘n/tetar’. Më 20 dhjetor 2018, pas mbarimit të kursit EOD, niveli I “Asgjësimi i Municioneve me Eksplozivë”, u dërgua me mision në operacionin ushtarak të NATO-s në Riga, Letoni, në përbërje të Grup-Batalionit Kanadez, me afat qëndrim 6 mujor, me detyrë Operator EOD.

Zarife Hasanaj, humbi jetën në Letoni, teksa një minë shpërtheu. Ushtarja 32 vjeçare nga Tropoja, ishte në misionin e saj të parë



jashtë vendit. Prej vitesh familja Hasanaj ishte zhvendosur në Tiranë. Zarifeja lindi në Bajram Curri dhe ishte fëmija i katërt i familjes Hasanaj.

Vetëm pak duhej që të përmbyllnin misionin dhe të ktheheshin në atdhe. Por kolegët e kontingjentit EOD u kthyen me trupin e pajetë të mikes së tyre.


Me peshën e dhimbjes të ndarjes nga jeta të Zarife Hasanajt, çdo 6 maj, vajzës me uniformën e shenjtë të ushtarakut shqiptar, i përkulemi me mirënjohje për sakrificën deri në vetëmohim.

Major Klodian Tanushi lindi në Dibër, më 31.10.1980, fëmija i parë i familjes Tanushi. I martuar dhe me tre fëmijë (dy djem dhe një vajzë) përkatësisht 14 vjeç, 11 vjeç dhe më e vogla 1 vjeç e gjysmë. Nga viti 2000 deri në vitin 2003 ndoqi studimet në ‘Akademinë Ushtarake “Skënderbej”.

Gjatë karrierës së tij ushtarake kreu detyra si Komandant Toge, Komandant Kompanie, Shef Seksioni, Specialist Operacionesh. Me detyrën Komandant i Togës së parë të EOD, më 20.12.2018 u dërgua me mision në Operacionin Ushtarak të NATO-s në Riga, Letoni, në përbërje të Grup-batalionit kanadez me detyrë Komandant i Kontingjentit shqiptar dhe përfaqësues i lartë ushtarak, me afat qëndrimi 6-mujor. Gjatë karrierës së tij është vlerësuar me Medaljen e “Karrierës” nga Komandanti i Forcës, Medaljen e “Shërbimit” nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, Medalje shërbimi në Mision jashtë vendi si dhe Medaljen “Për pjesëmarrje në shërbime ndërkombëtare” nga Ministri i Mbrojtjes.

“Bashkohemi me dhimbjen e familjes së n/tetare Zarife Hasanaj dhe major Klodian Tanushi, por edhe me dhimbjen e të gjithë Forcave tona të Armatosura për humbjen e ushtarakëve tanë, të cilët me aktin e tyre heroik të rënies në krye të detyrës, nën flamurin shqiptar, në përbërje të forcave të NATO-s, u bënë engjëjt shqiptar të paqes dhe dëshmorët e kombit shqiptar në panteonin e dëshmorëve të NATO-s, duke na dëshmuar të gjithëve se edhe mbrojtja e paqes kalon përmes sakrificash sublime!”, - u shpreh në mesazhin e tij të ngushëllimit ministri i mbrojtjes Niko Peleshi Ndërsa Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Arben Kingji në këtë ditë përkujtimore do shprehej: “Shqipëria e të gjithë ne, bashkë me dhimbjen, ndjejmë krenarinë që i japin flamurit tonë kombëtar dhe emrit të Shqipërisë bijat e bijtë e rritur me dashurinë për atdhe e për flamur! Ju qoftë falë dheu i tokës mëmë!





Atdheu përjetë mirënjohës

“Dëshmorët e Atdheut”, kapiten Florian Delia dhe toger Donald Hoxha ranë në krye të detyrës tetë vite më parë, si pasojë e rrëzimit të helikopterit EC -145 në Malësinë e Madhe, gjatë një fluturimi stërvitor.

Prilli i para 8 viteve u ndal në gjysmë, pranverën e re nuk do e shijonin më dy djemtë e rinj, “shqiponjat e qiellit”, Floriani dhe Donaldi.

Kapiten Floran Delia lindi më 01.10.1973 në Dibër. Kreu studimet në akademinë ushtarake “Skënderbej” nga ku u diplomua në vitin 1996 në specialitetin “Oficer Aviacioni”. Nga viti 2004 e në vazhdim ka kryer detyra të ndryshme në Repartin e Farkës, si pilot ekuipazhi i parë në BO105 dhe komandant ekuipazhi SAR. Kapiten Delia ka kryer kurse kualifikimi brenda dhe jashtë vendit. Kapiten Delia ishte i martuar me 3 fëmijë.

Toger Donald Hoxha u lind më 17.06.1988 në Berat. Kreu Akademinë e Aviacionit të Pozzuolit në Napoli, Itali, ku e përfundoi me sukses në vitin 2011 dhe u certifikua si pilot. Pas shkollimit, u emërua si pilot në Forcën Ajrore dhe më pas në Bazën Ajrore të Farkës, ku dhe

shërbeu nga viti 2012 me profesionalizëm e devotshmëri. Detyra e fundit e toger Hoxhës ishte “pilot (SAR)” në Grupin e Helikopterëve në Bazën Ajrore të Farkës.

Kreu kurse të ndryshme kualifikimi, brenda dhe jashtë vendit, për pilotimin e helikopterëve të tipit EC145 (SAR).

Sot dhe përgjithmonë ne do kujtojmë dëshmorët tanë, inspirimin e brezave në vite.

Dëshmorët janë ndërgjegjja më sublimë dhe vetëdija e ngritur lart, deri në piedestalin e vetëflijimit. Breza të tërë pas nesh do i kujtojnë ata!

Dëshmorëve u këndohen këngë trimërie, si këto fjalë zemre që në vijë melodike vijnë për dëshmorët tanë:

Nga Trupi po prapë

Shfaqet një ylber

Flamuri kuq e zi valëvitet në erë

Është komandant Hoxha

Mbi helikopter

Legjendë e vendit

Do mbetesh përherë

Aty në ballkon ka mbetur nëna

Me buzët që dridhen për djalin e saja.

Me mision u nise për të fundit herë

Bashkë me Florianin ju mbetët në qiell

Ata që të njohin të kujtojnë me mall

Dëshmorët e atdheut, përjetë jeni gjallë

Një shembull i ndritur

Për brezat që vijnë

Atdheut që deshët ia rritët lavdinë

Kujtimet e vetme që kemi për dëshmorët janë përmendoret, lapidarët dhe kujtesa historike që na bën të jemi krenarë.

I përjetshëm kujtimi i bijve tanë!



REZERVAT MATERIALE, NË KONCEPTIN E INTEGRUAR LOGJISTIK TË NATO-S



KOLONEL ARBEN DHULI

Është e rëndësishme të pranohet se funksionet e ndryshme logjistike bashkohen për të formuar tërësinë e mbështetjes logjistike. Planifikimi logjistik e ka origjinën në udhëzimet e politikave kombëtare, të NATO-s, dhe duhet të koordinohet me të gjitha degët e stafit në fjalë, qofshin ato operacionale, administrative apo logjistike, ushtarake apo civile. Një ekzaminim i shkurtër i funksioneve kryesore të logjistikës e tregon qartë këtë. Logjistika e prodhimit ose e blerjes mbulon materialin, nga faza e parë e ciklit jetësor deri në asgjësimin përfundimtar nga inventari. Pjesa e parë e ciklit, nga specifikimi, projektimi dhe prodhimi është qartësisht një funksion i logjistikës së prodhimit. Marrja në shërbim e pajisjeve, shpërndarja dhe ruajtja e saj, riparimi, mirëmbajtja dhe asgjësimi janë padyshim një detyrë logjistike e konsumatorit. Megjithatë, dizajni fillestar i pajisjeve që është pjesë e logjistikës së prodhimit duhet të marrë parasysh aspektet e konsumatorit të riparimit dhe mirëmbajtjes, dhe për këtë arsye përfshin të dyja disiplinat. Furnizimi mbulon të gjithë materialin dhe artikujt e përdorur në pajisjet, mbështetjen dhe mirëmbajtjen e forcave ushtarake sipas klasave të furnizimit. Funksioni i furnizimit përfshin përcaktimin e niveleve të stokut, sigurimin, shpërndarjen dhe rimbushjen.

Logjistika e integruar krijon një sistem koheziv. Çdo aktivitet i zinxhirit të furnizimit është i ndërvarur, ku përfshihen: prokurimi i materialeve, prodhimi, magazinimi, shpërndarja, transporti, furnizimi, marketingu. Me fjalë të tjera, burimet, teknologjia dhe proceset organizative janë të ndërlidhura. Ky koncept u shfaq si një strategji për të kapërcyer sfidat logjistike në shitje me pakicë të gjithë kanaleve. Duke rregulluar dhe thjeshtuar të gjitha proceset, organizatat mund të mbajnë ritmin me kërkesën e klientëve për përbushje të shpejtë të porosive dhe dërgesa brenda 24 orëve. Me logjistikën e integruar, organizatat mund të

zhvillojnë fleksibilitet dhe shkathtësi për të përballuar ndërprerjet e zinxhirit të furnizimit dhe për të zbutur rreziqet. Kur kompanitë zbatojnë këtë model, proceset logjistike si përpunimi i porosive, shpërndarja, zhdoganimi, përcjellja, logjistika e kundërt, etj., nuk funksionojnë më në kabanone.

Aspekti gjithëpërfshirës i logjistikës së integruar ka modifikuar mënyrën se si organizatat përgatiten për efikasitet të shtuar dhe avantazh konkurrues. Në fund të fundit, logjistika e integruar bashkon logjistikën hyrëse dhe dalëse për të formuar një tërësi gjithëpërfshirëse dhe të lehtë për t'u kontrolluar.

Fazat e prodhimit ose të prokurimit përfshijnë trajtimin e materialit, planifikimin e blerjeve, komunikimin me furnitorët dhe transportin e inventarit në magazina ose qendrat e përbushjes. Zgjidhjet e integruara logjistike drejtojnë planin e prodhimit, inventarin dhe operacionet e magazinimit. Funksioni i logjistikës së integruar është optimizimi i planifikimit dhe menaxhimit të inventarit në kohë reale me teknologji dhe flukse pune të automatizuara. Kjo lejon parashikime të avancuara, rimbushje në kohë të stoqeve, planifikimin e kohës së prodhimit dhe parandalimin e rezervave dhe humbjeve.

Plotësimi dhe dërgimi. Logjistika e integruar u mundëson organizatave të tregtisë elektronike të mikromenaxhojnë përpunimin, zgjedhjen, paketimin, shpërndarjen dhe dërgimin e porosive. Firmat mund të shpërndajnë në mënyrë strategjike produkte te partnerët e shitjes me pakicë dhe qendrat e shpërndarjes me dukshmëri të zgjeruar dhe parashikimin e kërkesës. Me të gjithë palët e interesuara në komunikim, firmat mund të menaxhojnë ruajtjen, të automatizojnë përbushjen dhe të përdorin teknologji si IT dhe AI për saktësinë e porosive dhe dërgimin e shpejtë. Së bashku me menaxhimin e magazinës, logjistika e integruar në të njëjtën kohë thjeshton transportin. Kur të gjitha sistemet janë në linjë, bëhet më e lehtë për të fituar shikueshmëri të plotë në statusin dhe përbushjen e porosive. Shpërndarja. Logjistika e integruar koordinon transportin, ndarjen (sipas llojit) dhe shpërndarjen e produkteve. Me përparimet në sistemet e menaxhimit të transportit, magazinimin strategjik dhe menaxhimin e inventarit, shpërndarja në kohë është shtuar. Logjistika e integruar ndikon që çdo element në departamentin e logjistikës të funksionojë në kohezion, duke reduktuar ndryshimet në kohën e tranzitit dhe të përpunimit. Për më tepër, mund të jetë e dobishme nëse firmat lëvizin drejt një modeli biznesi prodhimi në kohë. Marketingu. Funksioni i marketingut përfshin koordinimin e paketimit të nevojshëm për të forcuar proceset logjistike. Për më tepër, logjistika e integruar koordinon departamentet e



marketingut me pjesën tjetër të organizatave. Kjo lejon krijimin e fushatave efektive të marketingut që ndikojnë në inventarin dhe dizajnin e produktit. Funkzioni i marketingut përfshin gjithashtu publikimin e informacionit të saktë mbi shërbimet dhe zgjerimin e prezencës së biznesit ndërmjet klientëve dhe partnerëve.

Teknologjia. Logjistika e integruar bashkon proceset, teknologjinë, furnitorët, shitësit dhe transportuesit për të ruajtur të dhëna të sakta dhe dukshmëri të plotë të zinxhirit të furnizimit. Përfundimisht, ajo vendos skenën për përbushjen e shumë kanaleve, logjistikën shumë kanalëshe.

Logjistika e integruar përmbledh përmirësime teknologjike, praktika të rrjedhshme të biznesit dhe avancime të prokurimit në të gjitha fazat e një sistemi produkti. Prandaj, ajo shkurton ciklin e jetës së një produkti në të gjitha pikat, siç shpjegohet më poshtë:

- Prokurimi dhe menaxhimi i materialeve përfshijnë planifikimin e prodhimit, burimin, trajtimin dhe optimizimin. Ajo gjithashtu përfshin zgjedhjen e furnitorëve, monitorimin e kontratave të furnitorëve dhe planifikimin e blerjeve. Logjistika e integruar punon drejt adoptimit të strategjive për zvogëlimin e kohës së ofrimit në tregtinë elektronike me sisteme të përmirësuara të rimbushjes, ruajtjes dhe transportit. Duke nxitur procese automatike dhe duke vendosur lidhje me furnitorët, rrit efikasitetin në dhënie dhe burimeve, qoftë për dropshipping (ku produktet dërgohen direkt nga furnizuesi te klienti dhe paguhet vetëm për atë që shitet) pra nuk ka kosto fillestare të inventarit apo për shitje me pakicë të gjithanshme.

- Logjistika e integruar ka dy nëngrupe kritike: inventarin dhe magazinat. Logjistika e integruar funksionon duke koordinuar të dhënat e inventarit, duke rishikuar buxhetet e ruajtjes dhe logjistikës dhe duke analizuar historinë e shitjeve për kërkesën. Kështu, inventari mund të vendoset në mënyrë strategjike në magazina më afër pikave të nxehta të kërkesës dhe të ndahet në përputhje me rrethanat midis transportuesve me kosto të ulëta.

Në mënyrë të ngjashme, duke përdorur sisteme dhe mjete inteligjente të menaxhimit të depove, si skanerët e inventarit. Këto përfshijnë përpunimin e porosive, metodat e marrjes, ngarkimin dhe shkarkimin dhe rimbushjen e stoqeve. Logjistika

e integruar bashkon pikat e forta të personelit të magazinës, operacionet e shitjes dhe përpunimin e porosive. Me të dhënat mbi parashikimin e kërkesës dhe menaxhimin e transportit, firmat mund të shpërndajnë më shpejt në zonat me kërkesë të lartë. Me menaxhimin efikas të porosive, logjistika e integruar mund të parashikojë kërkesat dhe nevojat e klientëve.

Logjistika e integruar optimizon transportin dhe shpërndarjen me shpejtësi dhe saktësi. Kjo bëhet nëpërmjet dixhitalizimit të fuqisë punëtore, planifikimit të rrugëve dhe bashkëpunimeve në kohë reale në të gjithë rrjetin e zinxhirit të furnizimit. Ajo menaxhon pika të shumta përfundimtare si trajtimi i produktit, pagesat, planifikimi i dërgesave, zhdoganimi. Logjistika e integruar gjithashtu bën të mundur zbatimin e transportit intermodal (që përfshin transportin nga më shumë se një formë transportuesi gjatë një udhëtimi të vetëm) dhe multimodal (që ka ose përfshin disa mënyra, modalitete ose maksimum shpërndarje) të mallrave. Me drejtimin dinamik, integrimin me shumë transportues dhe një ekip të centralizuar transporti, logjistika e integruar e çon përpara dërgimin dhe shpërndarjen. Logjistika e integruar promovon planifikimin sistematik me fazat e kontrollit dhe menaxhimit që punojnë së bashku. Me integrimet e proceseve dhe koordinimin e sigurt, gjurmimi i gabimeve bëhet më i lehtë.

Kur kompanitë e tregtisë elektronike përfshijnë menaxhimin e integruar të logjistikës, ato ndërtojnë sisteme për të parashikuar parashikimet e gabimeve dhe për të zbuluar rrezikun. Ata mund ta bëjnë këtë në tre mënyra:

- Së pari, identifikon të metat ekzistuese të aplikacionit për korrigjim të menjëhershëm;
- Së dyti, parashikimi i rreziqeve;
- Së treti, vizualizimi i situatave të paparashikuara në financat, blerjen e materialeve, produktivitetin dhe kënaqësinë e klientit.

Sistemi operacional i firmës mund t'i nënshtrohet kontrolleve të përsëritura pasi përmirësimi është një proces i vazhdueshëm. Kjo mund të jetë mirëmbajtje rutinë ose kurse trajnimi për të rregulluar mirë procedurat dhe për të maksimizuar funksionalitetin. Pas testimit, raportet e analizës mund të gjenerohen për të përshkruar përmirësimet dhe rekomandimet për sistemet e prirur ndaj gabimeve.

Kjo është një detyrë qendrore në menaxhimin e proceseve të tepërta dhe pakënaqësisë së klientit. Një nga faktorët kryesorë të kostos që ndikon në të gjitha bizneset e tregtisë elektronike është logjistika. Me një qasje të efektshme ndaj logjistikës, firmat mund të ulin kostot në pika të shumta problematike, nga prokurimi të transporti, magazinimi deri te dorëzimi. Kur të gjitha proceset funksionojnë së bashku dhe informacioni shpërndahet nëpër departamente, bëhet më e lehtë të mbash gjurmët e shpenzimeve dhe humbjeve aktuale. Me ciklet e ndërlydhura të produkteve, zgjidhjet e integruara logjistike përfshijnë një

numër më të vogël palësh që lejojnë kompanitë të përdorin çmime konkurruese. Firmat gjithashtu mund të dallojnë jo-efikasitetet dhe të krijojnë më shumë fusha për kursime. Rezultati neto përkthehet në një marzh më të madh fitimi dhe kosto të reduktuara operacionale.

Mbështetja Logjistike e Integruar (ILS)

Një qasje e disiplinuar e unifikuar dhe përsëritëse ndaj menaxhimit dhe aktiviteteve teknike të nevojshme për të (1) integruar konsideratat mbështetëse në projektimin e sistemit dhe pajisjeve; (2) zhvillojnë kërkesa mbështetëse që lidhen vazhdimisht me objektivat e gatishmërisë, për të hartuar, dhe ndaj njëri tjetrit; (3) merr mbështetjen e nevojshme; (4) të sigurojë mbështetjen e nevojshme gjatë fazës operative me kosto minimale.

Duke bashkuar prodhimin, menaxhimin, teknologjinë dhe marketingun, logjistika e integruar optimizon aspekte të shumta. Këto përfshijnë dizajnin e produktit, veçoritë, kriteret e cilësisë dhe paketimin për t'iu përmbajtur pritshmërive të klientit.

Fleksibiliteti dhe elasticiteti janë bërë parime thelbësore sot, pasi ne jemi dëshmitarë të llogarive të shumta të ndërprerjeve të zinxhirit të furnizimit. Një nga përfitimet më të mira të logjistikës së integruar është shkathtësia e zinxhirit të furnizimit me dukshmëri nga fundi në fund dhe bashkëpunime midis ekipeve të ndryshme. Meqenëse zgjidhjet e integruara të logjistikës përpilojnë të gjitha proceset për t'u përgatitur së bashku, ato mund t'i përgjigjen ndryshimeve të papritura, vonesave dhe rënies së shpejtësisë. Për më tepër, firmat mund të krijojnë struktura elastike me zgjidhje logjistike të integruara si automatizimi, ndërfaqja e dizajnit, shkëmbimet IT.

Çelësi për menaxhimin pa probleme të zinxhirit të furnizimit janë të dhënat që rritin efikasitetin dhe ndikojnë shumë në vendimmarrjen e informuar. Lidhja së bashku e të gjitha të dhënave dhe sistemeve logjistike përmirëson integritetin, qëndrueshmërinë dhe saktësinë e të dhënave. Kjo, nga ana tjetër, ndikon pozitivisht në shërbimin ndaj klientit, rrit operacionet e brendshme dhe përmirëson teknikat e marketingut. Më e rëndësishmja, përmirëson ndjeshëm dukshmërinë në mënyrë që porositë të arrijnë në destinacionin e tyre në kohë dhe të paprekura.

Aspekti i parë i logjistikës së integruar është planifikimi. Fillon me vendosjen e qëllimeve për krijimin e një grafiku rrjedhash për të



kuptuar të gjitha funksionet, proceset dhe personelin e përfshirë. Është gjithashtu thelbësore t'i jepet përparësi identifikimit të mangësive të komunikimit dhe përmirësimit të tyre brenda dhe ndërmjet departamenteve të ndryshme. Një zinxhir furnizimi elastik dhe i shkathët ka të gjitha burimet, personelin, teknologjinë, partneritetet dhe proceset në të njëjtën faqe. Hapi i dytë është përmirësimi i sistemit logjistik, duke identifikuar mundësitë e bashkëpunimit dhe duke konsoliduar aktivitetet logjistike. Për shembull, drejtuesit e menaxhimit dhe shitjeve mund të analizojnë së bashku konkurrencën për të ndërtuar politika për të rritur avantazhin e tyre konkurrues. Mënyra e tretë është të trajnohet dhe zbatohet një model "biznesi i orientuar nga njerëzit", ku kompetencat individuale zhvillohen për të lulëzuar në situata me kërkesa të larta. Këtu, departamenti i burimeve njerëzore luan një rol qendror në përputhjen e individëve me përshtatjen e duhur të punës. Trajnimi i teknikëve, operatorëve dhe personelit për t'i pajisur ata me aftësi praktike të përshtatura me nevojat organizative janë jetike për fillimin e tyre drejt logjistikës së integruar. Mënyra e katërt është përforsimi i vazhdueshëm i efektivitetit operacional me mirëmbajtje rutinore për një sistem operacional optimal. Kompanitë zgjedhin zgjidhje të Logjistikës së Integruar për dy arsye kryesore: kosto dhe efikasitet. Ata mund të menaxhojnë faza të shumta në lëvizjen e mallrave nga një burim i vetëm. Logjistika e integruar lejon kompanitë të ofrojnë produkte tek konsumatorët fundorë me kosto dhe efikasitet. Kjo ndihmon në përmirësimin e përvojës së klientit, ndërkohë që i bën operacionet e biznesit më të shkathët. Ai u lejon kompanive të rrisin produktivitetin e tyre përmes konsolidimit të informacionit dhe thjeshtimit në ekzekutim. Burimet materiale, rezervat strategjike, nivelet dhe planëzimi i rezervave materiale

Qeveria e Republikës së Shqipërisë siguron burime materiale të mjaftueshme për zhvillimin dhe transformimin e Forcave të Armatosura, duke u fokusuar në sigurimin e atyre burimeve që shkojnë për krijimin e kapaciteteve operacionale, që i bëjnë Forcat e Armatosura të afta për kryerjen e misionit të tyre kushtetues dhe të ndërveprueshme me forcat ushtarake të NATO-s.

Gjithë burimet materiale që vihen në dispozicion të FA-së, si nëpërmjet prokurimeve nga buxheti i mbrojtjes, ashtu edhe nga ndihmat e aleatëve dhe të partnerëve, synohet të jenë në përputhje me standardet e NATO-s. Sigurimi i sasisë së mjaftueshme të

burimeve të mbrojtjes dhe standardizimi i tyre përfshin të gjitha fushat e mbështetjes logjistike të FA-së, armatimin, ushqimin, veshmbathjen, karburantin, shërbimet e trupës, transporti dhe mirëmbajtja janë fusha të rëndësishme që mbështeten në mënyrë harmonike me burime materiale. Një ndërthurje efektive e sektorit shtetëror me atë privat siguron burime materiale cilësore dhe në kohën e duhur për mbështetjen e objektivave të mbrojtjes.

1. Rëndësia e krijimit të rezervave strategjike
2. Furnizimi dhe funksioni i shërbimit.

Procesi i Furnizimit me Materiale: (Burimi-Porosi-Marrje-Magazinim-Shpërndarje-Kthim)

1. Njësitë - Organizata Taktike, ku kërkohet gatishmëria.
2. Kërkesa - Nevoja për materiale dhe shërbime.
3. Gjendja - Gjendja e autorizuar e stokut në magazinat e Bat Mb të K K.
4. Depot / Magazinat - Depot kryesore të mirëmbajtjes dhe furnizimit.
5. Logjistika e Kthimit - Kanalet e kthimit për riparim në nivelin e kapanoneve.
6. Blerjet - Prokurimi i materialeve dhe furnizimeve të nevojshme. Në kuptimin më të plotë, logjistika mbulon të gjitha ato aspekte të operacioneve ushtarake që merren me përcaktimin, marrjen në dorëzim, magazinimin, transportimin, shpërndarjen, mirëmbajtjen, shpërnguljen dhe sistemimin e resurseve materiale të FA-së.

Rezervat materiale krijohen në funksion të misionit kushtetues të FA-së. Krijimi i tyre mbështetet në kapacitetet e disponueshme të komandave, në buxhetin e mbrojtjes dhe në burimet kombëtare. Ato përdoren gjithashtu për mbështetjen e Forcave të Armatosura dhe popullsisë civile në përballimin e situatave të jashtëzakonshme që shkaktohen nga forca madhore si tërmete, përmbytje, epidemi, ndotje të mjedisit etj., në kohë paqeje krize dhe lufte.

Forcat e Armatosura evidentojnë burimet kombëtare (publike apo private) në interes të misioneve të tyre dhe në përputhje me legjislacionin përkatës, planëzojnë masa konkrete, për përdorimin e tyre në rast nevojë. Rezervat materiale përshkallëzohen sipas kriterëve doktrinore dhe misioneve specifike të njëjësive. Struktura dhe niveli i rezervave materiale si dhe shkalla e gatishmërisë së tyre propozohen nga Këshilli i Ministrave të RSH. Planifikimi i rezervave për furnizim të FA-së, do të jetë sipas kërkesave, ndërsa gjendja e materialeve, transferimi, identifikimi i nevojave dhe ndjekja e ciklit jetësor do të jetë një proces i vazhdueshëm; Hartimi i konceptit të rezervës materiale për situata të jashtëzakonshme si dhe planifikimi i rezervave për furnizim të FA-së, do të jetë sipas kërkesave, ndërsa gjendja e materialeve, transferimi, identifikimi i nevojave dhe ndjekja e ciklit jetësor do të jetë një proces i vazhdueshëm;

Menaxhimi i burimeve materiale do të vijojë të jetë pjesa më e rëndësishme e misionit të strukturave logjistike të FA-së, të cilat kanë si qëllim sigurimin e kapaciteteve logjistike të domosdoshme për mbështetjen e FARSH brenda dhe jashtë vendit, si dhe minimizimin e rrezikut të krijimit të stoqeve. Ky risk luftohet, duke bërë një planëzim të saktë dhe të llogaritur mirë mbi bazën e normave të miratuara.

Burimet materiale në përdorim të FARSH-së do të përdoren me synim përmirësimin e kushteve të jetesës, punës dhe stër-

vitjes së personelit, në sigurimin e mbështetjes logjistike të domosdoshme për operacionet e FA-së brenda vendit, mbështetjen e trupave që angazhohen në misione/operacione jashtë vendit në kuadër të NATO-s, transportin strategjik (ajror, detar, tokësor dhe i kombinuar) për dislokimin dhe ridislokimin e trupave të FARSH-së, etj.

Mbështetja në operacione do të sigurohet edhe me marrëveshje me shtetet e tjera pjesëmarrëse në operacionet e përbashkëta, me agjencitë e mbështetjes të NATO-s, si dhe me kontraktorë vendas.

Furnizimi do të organizohet dhe funksionojë si vijon:

Koncepti bazë i furnizimit bazohet në ditët e furnizimit (DF) për të gjitha klasat. Ai do të realizohet nga lart poshtë deri në nivel force (Komandë Mbështetëse - Komandë Force, ose deri në reparte që janë në vartësi të drejtpërdrejtë nga SHP/MM). Synimi kryesor do të jetë krijimi i kapaciteteve për të përballuar angazhimin e qëndrueshëm (me sigurim të rotacionit të nevojshëm) në kuadër të misioneve ushtarake të NATO-s, me një batalion këmbësorie të përforcuar me elementë mbështetës.

Në nivel Taktik (batalion) do të jetë i kompletuar si vijon:

- 3 DOS (Ditë Furnizimi) në kompani;
- 2 DOS (Ditë Furnizimi) në batalion;
- 2 DOS (Ditë Furnizimi) në Grup-batalion;
- 23 (Ditë Furnizimi) DOS në Elementët e Mbështetjes Kombëtare (NSE), e cila ngrihet si strukturë nga KM, rast pas rasti sipas misioneve.

Mbështetja në operacione jashtë vendit me kohëzgjatje mbi 30 ditë, do të sigurohet më anë të marrëveshjeve me shtetet pjesëmarrëse në operacionet e përbashkëta, me vendet që janë udhëheqëse (Lead Nation) për mbështetjen logjistike, si dhe duke përdorur marrëveshjet e lidhura nga agjencitë e mbështetjes së NATO-s në operacione.

Forcat e Armatosura mbajnë tre lloj rezervash materiale:

Niveli strategjik. Mbështet operacionet ushtarake të Forcave të Armatosura në nivelin strategjik, që kushtëzohen nga objektiva dhe nisma të përcaktuara në strategjinë ushtarake, të cilat kanë për qëllim arritjen e objektivave strategjike politiko-ushtarake. Logjistika në nivelin strategjik merret me mobilizimin, marrjen në dorëzim, mbrojtjen, lëvizshmërinë strategjike dhe përqendrimin strategjik të aseteve logjistike.

Niveli operacional. Përqendrohet në krijimin dhe ruajtjen e linjave të komunikacionit, si dhe mbështetjen e forcës në operacion, sipas prioriteteve të komandantit. Gjithashtu krijon kushtet për shndërrimin e udhëzuesit të nivelit strategjik në sukses të nivelit taktik, duke siguruar lidhje ndërmjet këtyre niveleve. Ajo përfshin lëvizjen në rajonet e detyrave të reparteve dhe personelit, zhvillimin e infrastrukturës, shpërndarjen dhe menaxhimin e rezervave, kontraktimet, shërbimet dhe kontrollin e lëvizjes.

Niveli taktik. Mbështet komandantët e nivelit taktik për realizimin e misionit nëpërmjet sigurimit të mbështetjes me forcat e mjetet organike. Në këtë nivel, funksionet kryesore janë furnizimi, transporti, mirëmbajtja, mbështetja mjekësore, administrimi dhe shërbimet jetësore në mbështetje direkte të trupës për t'i krijuar mundësi asaj të realizojë misionin e ngarkuar. Një logjistikë e suksesshme taktike duhet të sigurojë mbështetjen në kohën dhe vendin e duhur të reparteve që i janë caktuar asaj.

“Kjo Shqipni ka lindur burra, që nuk njohin dy flamura”

Dita e Dëshmorëve ose 5 maji është dita që përkujtohen të rënët e Shqipërisë. Kjo datë është shumë e rëndësishme për shqiptarët, pasi në këtë datë kujtohen dhe nderohen trimat që luftuan për Shqipërinë e lirë. Bota e qytetëruar, shoqëritë e rritura përmes vlerave, ku janë kultivuar parime themelore në ecurinë e brezave, mes të tjerash, e kanë mësuar kombin të kthejë rregullisht kokën mbrapa e të shohë rrugën e përshkuar, të dijë nga vjen, të kujtojë e respektojë historinë e të parëve dhe të mësojë prej asaj kohe se ku do shkojë. Është kjo arsyeja që pothuaj gjithë shtetet e kombet kanë një ditë në vit që përkujtojnë heronjtë, dëshmorët, të rënët në beteja për atdheun, për kombin. Disa e quajnë “Dita e Heronjve”, disa të tjerë “Dita e Heronjve Kombëtarë” ose “Dita e Martirëve”. Ne e quajmë “Dita e Dëshmorëve të Atdheut” dhe pasi Republika e Kosovës e përshtati këtë ditë përkujtimore, 5 Majin, edhe për bijtë e bijat e saj të rënë për lirinë, u mësua ta quajmë “Dita e Dëshmorëve të Kombit”. Për arsyet e caktimit të ditës, nga vende të ndryshme vijën kultura të ndryshme. Shpesh mbahen në ditëlindjen e një heroi apo heroine kombëtare, ose zgjidhet momenti i veprave të tyre të mëdha, që i bëri ata heronj. Në shumë raste kremtimi i “Ditës së Heronjve” lidhet me një betejë përcaktuese, ku të rënët që luftuan kundër armiqve të vendit, kanë qenë ndikim i madh ose përcaktues për fatet e kombit. Në raste të tjera lidhet me një ditëlindje të heroit, burrë ose grua, aktet e guximshme të të cilëve i kanë mundësuar vendit të rriten si komb. Po kësaj dite i janë kushtuar memoriale monumentale, ku populli, por posaçërisht elita kombëtare, bën në këtë ditë nderet dhe ceremonitë protokollare. Shqipëria, si dhe disa vende të tjera, kanë caktuar si të tillë ditën e rënies së një heroi. Vrasja, më 5 maj 1942, e Qemal Stafës, ish-sekretari politik i të rinjve komunistë, në nderim të veprës së tij, është caktuar të jetë Dita e Dëshmorëve.

Në Ditën e Dëshmorëve të Kombit janë të shumtë emrat e të gjitha kohërave që kujtohen me mirënjohje, jo vetëm për vlerat e përjetshme dhe kontributin që dhanë për çlirimin e vendit për një të ardhme më të mirë, por edhe të gjithë ata që sakrifkuan jetën e tyre për liri, demokraci, të drejtat e njeriut dhe dinjitetin e çdo shqiptari.

“Atdheu lëngon, na thërret të luftojmë me armë”. Partizanët, kudo ku shkonin, nga mali në mal, nga beteja në betejë e merrnin atdheun me vete, e kishin në zemër. Ideali atdhetar i shtynte që me pushkë në dorë të luftonin për Shqipërinë. Kishin ardhur ato ditë, për të cilat ëndërronte Asdreni: “Lart, përmbi shkëmbinj/ atje tek shqiponjat rrinë/ Tomorr, atje mblidhi të rinjtë/ të përpiqen për lirinë”. Dhe partizanët bënë atë që thotë kënga e tyre: “N’ato maja, rripa-riipa, se ç’gjëmojnë/ Ndizet lufta për liri dhe derdhet

gjak/ Janë trimat partizanë që luftojnë”. Ose kënga tjetër: “Se ç’u mbushën malet plot me partizanë”. Dhe në luftë binin dëshmorë bijtë e shqipes. Vaskë Dushku, që më vonë do të jepte jetën, bënte thirrje: “Atdheu lëngon nën thundrën fashiste. Ai na thërret të luftojmë me armë në dorë. Nuk ka pse të rrimë”. Dhe vetë luftoi e ra dëshmor. Sa shembuj të lartë atdhetarie ka në radhët e partizanëve! Kristaq Tutulani në ditarin e tij do të shkruante. “O Shqipëri, o nënë e dhimbshur! Hiqe zinë sot: ja, pleq e të rinj, bijtë e tu, gjaku më i kulluar, është gati të derdhet... Që tani e tutje s’ka më pushim, por luftë gjer në vdekje...”. Birçe Sinemati bënte apel: “Shtrëngata ka nisur. Në këmbë të gjithë! Kjo është detyra jonë”. Midat Dautaj i drejtohej nënës: “Dëgjo, nënë, unë do shkoj partizan. Ti ke edhe tre djem të tjerë. Në qoftë se unë nuk kthehem, të qëndrosh trime”. Mustafa Radovicka shprehej me vargje: “Atdheun tonë kaq të dashur/ Shqipërinë e gjorë/ shumë e kanë shkelur/ dy okupatorë/ kaq të fëlliqur e kaq barbarë/ kurrë ndonjë herë, bota s’ka parë”. Partizani luftonte “me kokë në torbë” dhe nuk pyeste për jetën e tij. Fjalët e Tafil Rexhepit, që bëri fli jetën e tij, ishin: “Njeriu është i lumtur kur jeton për atdheun”. Sadik Stalavec i thoshte: “Gjëja më e madhe është t’i japësh jetën atdheut, por njëkohësisht duhet të dish si t’ia falësh”. Dhe vetë ra si hero në kodrën e kuqe, bashkë me Vojo Kushin e Xhorxhi Martinin, duke luftuar 6 orë kundër qindra fashistëve. Novruz Xhaja fliste me zjarr: “Ty, të falem, o Atdhe, e dashur Shqipëri! Kush në luftë bie për atdhe, ai s’ka vdek, por ka le”. Dhe këtë shembull e dha vetë, duke luftuar trup me trup me armiqtë. Edhe në detyrën e agjitorit të luftës e të mësuesit, tema më e preferuar e bisedave të partizanëve ishte atdhe. Ferit Bisha hynte dhe dilte shtëpi më shtëpi dhe theksin e vinte në dy-tri fjalë: “Atdheu duhet çliruar”. Fasli Çami ishte mësues. Kur ra dëshmor një ish-nxënës i tij, në fjalën e lamtumirës i tha: “Fjalët vendlindje, atdhe, Shqipëri, popull, që ne i dëgjonim gjithnjë prej teje, me kalimin e kohës morën kuptimin e vërtetë. Dhe ne filluam të kuptonim se ç’është atdhe, pse duhet ta duam, pse duhet t’i urrejmë armiqtë dhe tradhtarët”.

Ata ishin modeli i atdhedashurisë. Ende pa dalë partizanë me armë në dorë, këta luftëtarë betoheshin duke shkruar për atdheun dhe prisnin rastin të shkonin drejt maleve, atje ku ishte “Foleja e partizanëve”! Fliste edhe pena e tyre. Fliste gatishmëria e tyre. Gjaku që vlonte për tokën mëmë, për çlirimin e vendit nga pushtuesit e huaj. Dhe binin dëshmorë me dy armë: me pushkë dhe penë! Në një nga poezitë e tij Ali Demi, shprehet: “Më jep fuqi që të qëndroj, Më jep guxim që të luftoj. Më çon në sulm me vrap të shkoj, Me nder të vdes, me nder të rroj”. Dëshmori Sabri Caka nga Dibra, qysh kur ishte nxënës shkollë, në një nga hartimet e tij



Gjithë shtetet e kombet kanë një ditë në vit që përkujtojnë heronjtë, dëshmorët, të rënë në beteja për atdheun, për kombin. Disa e quajnë “Dita e Heronjve”, disa të tjerë “Dita e Heronjve Kombëtarë” ose “Dita e Martirëve”. Ne e quajtmë “Dita e Dëshmorëve të Atdheut” dhe pasi Republika e Kosovës e përshtati këtë ditë përkujtimore, 5 Majin, edhe për bijtë e bijat e saj të rënë për lirinë, u mësua ta quajmë “Dita e Dëshmorëve të Kombit”.



shënonte: “Njeriun, vetë natyra e ka pajisur me cilësitë e çmueshme të dashurisë ndaj atdheut dhe familjes, që janë sendet më të shenjta e të madhërishtme të jetës së tij”. Dëshmorit Jani Dode nga Berati, mësues, me dyzet vargje i këndon atdheut, lirisë, flamurit. Ja disa prej tyre: “O këngë e mbetur/ Në dukje e vdekur/ Dil e këndo/ E mos vajto/ Se me vajtim/ Nuk ke shpëtim”. Në prozë: “Për Shqipërinë s’ka vend dhe vatër, po qe se s’ka flamur. Se i rrëfen botës tërë me sa gjak është lyer dhe se vetëm gjaku është ai që e mban gjallë atë, që përfaqëson trimërinë, krenarinë dhe lirinë e një kombi. E vranë armiqtë pabesisht. Dëshmorët kishin ëndrra të bukura dhe fluturonin gjeth më gjeth si flutura”. Në fletoren e dëshmorit Shahin Toçi nga Mati u gjet shënimi: “Kjo Shqipni ka lindur burra, që nuk njohin dy flamura”. Dëshmorit Syrja Çakshiri nga Devolli, shokët i gjetën në xhep një letër, në kapakun e së cilës shkruhej: “Plane dhe projekte për reformën agrare në Shqipëri”. Vangjel Pando, iu gjend në xhep shënimi: “Të shkojmë në fshatra, të demaskojmë para fshatarëve gënjeshtret e armiqtë, t’u themi të mos paguajnë xhelepet, të tretën dhe të dhjetën, agallarët të mos i qasin në fshatrat e tyre”. Dhe këto ëndrra e plane të skuqura me

gjak, dëshmorët nuk arritën t’i shihnin në realitet. Dhanë jetën, por të qeshurit nuk u ngriu në buzë, optimizmi i tyre ishte real, me besimin në fitore.

Ka luftëtarë, që para se të bien dëshmorë, patën shkruar në ditarët e tyre. Kristo Isaku nga Dardha e Korçës shënon në ditar: “O Shqipëri, o nënë e dhembshëruar, hiqe zinë sot, ja, pleq e të rinj, bijtë e tu, gjaku më i kulluar është gati të derdhet. Që tani e tutje s’ka më pushim, luftë gjer në vdekje, luftë ditën, luftë natën, luftë në male, luftë në fusha, luftë për Shqipëri, luftë për të drejtën, luftë për liri”.

Myrteza Pengilli shkruan: “Ja, malet e Shqipërisë gjëmojnë përsëri si në kohën e Skënderbeut dhe i trumbetojnë botës vendimin e burrave: Ja vdekje, ja liri! Populli përgjithësisht zgjohet. Dhe zgjimi është i furishëm, zgjim trimi, zgjim luani”. Alush Grepcka: “29 korrik 1943... Duçja “i madh” i fashizmit të ndyrë, që ishte gjer pardje e që thoshte se do mbante qiellin me bajoneta, u rrëzua”. Seit Lesko: “Me gjakun e shokëve tanë më të mirë, po gatuhet betoni, me të cilin hidhen themelet e pushtetit tonë popullor”.

‘Lavdi Dëshmorëve të Atdheut, bijve dhe bijave më të mirë të kësaj toke, larë me gjak!’

Traktati i Fshehtë i Londrës, 'loja' në kurriz të shqiptarëve

Biblioteka e Kongresit Amerikan, ka publikuar hartën e Traktatit të fshehtë të Londrës (26 prill 1915), ku është planifikuar zhdukja e shtetit shqiptar nga harta e Europës. Sipas këtij traktati famëkeq të arritur midis Fuqive të Antantës (Francës, Anglisë, Rusisë dhe Italisë), pjesa veriore e Shqipërisë që përfshin Malësinë në veri, në lindje Dibrën, deri në qytetin e Lezhës në perëndim dhe në jug deri të qyteti i Krujës, është skicuar t'ia japin Serbisë dhe Malit të Zi. Për më tepër, Serbisë i lejohet të projektojë dhe ndërtojë linjën hekurudhore Danub-Adriatik! Greqisë është planifikuar t'ia japin pjesën jugore të Shqipërisë, ndërsa Italia të marrë territorin jug-perëndimor, që përfshin Vlorën dhe ishullin e Sazanit. Në fund traktati parashihet themelimin e një Shteti Islamik Shqiptar (në Shqipërinë e mesme), me një territor shumë të vogël që do të mbikëqyrej nga Italia.

Teksti integral i marrëveshjes së fshehtë të Londrës – më 26 prill 1915

"Me urdhër të qeverisë së tij, markezi Imperiali, ambasadori i madhërisë së tij mbretit të Italisë, ka nderin t'njohet shumë të nderuarit sër Eduard Grein, sekretar shteti kryesor i madhërisë së tij britanike për punët e jashtëme, dhe shkëlqesave të tyre zotri Pol Kambon, ambasador i Republikës Franceze dhe zotri kont Bekendorf, ambasador i madhërisë së tij perandorit të të gjitha Rusive, ta pranojnë këtë:

Memorandum

Neni 1

Një konventë ushtarake do të përfundojë menjëherë midis shtabeve të përgjithshme të Francës, të Britanisë së Madhe, të Italisë dhe të Rusisë. Kjo Konventë do të caktojë minimumin e forcave ushtarake që Rusia duhet t'i përdorë kundër Austro-Hungarisë, me qëllim që të mos lërë këtë Fuqi të përqendrojë të gjitha përpjekjet e saj kundër Italisë, në rast se Rusia do të vendosë



të drejtojë përpjekjen e saj kryesore kundër Gjermanisë. Konventa ushtarake do të zgjidhë çështjen e armëpushimeve, që varet kryesisht nga komanda e përgjithshme e ushtrive.

Neni 2

Nga ana e vet, Italia merr përsipër të përdorë të gjitha burimet e veta për të vazhduar luftën së bashku me Francën, me Britaninë e Madhe dhe me Rusinë kundër gjithë armiqtë të tyre.

Neni 3

Flotat e Francës dhe të Britanisë së Madhe do t'u japin Italisë ndihmën e tyre aktive dhe të vazhdueshme gjer në shkatërrimin e Flotës Austro-Hungareze ose gjer në përfundimin e luftës. Një konventë detare do të përfundojë menjëherë për këtë qëllim midis Francës, Britanisë së Madhe dhe Italisë.

Neni 4

Në Traktatin e Paqes, Italia do të marrë Trentinon, Tirolin, Çizaplin dhe kufirin e tij gjeografik dhe natyror (kufirin e Brenarit) si dhe Triesten, rrethet e Goricës dhe të Gradiskës, gjithë Istrinë gjer në Kvarner, duke përfshirë edhe Voloskën dhe ishujt Istrinë të Kersos, Lusionos, si dhe ishujt e vegjël

Plavnik, Unie, Kanidol, Palacoul, San-Pietro di Nemb, Azinelo, Gruica dhe ishujt e vegjël aty afër.

Shënim me rëndësi

Kufiri i nevojshëm për të siguruar zbatimin e nenit 4 do të caktohet si në vijim:

Nga Piz Umbraili gjer në veri të Stellovës, ai do të ndjekë kreshtën e Alpeve Rretiane gjer në burimet e Adixhes dhe të Esiakut, duke kaluar atëherë në malet e Rreshenit dhe Brenarit dhe në lartësinë e Oexkist dhe Cilerit. Pastaj kufiri do të shkojë drejt jugut, do të kalojë nëpër malin Toblah dhe do të arrijë te kufiri i sotëm i Alpeve Kernike. Ai do të ndjekë këtë kufi gjer në malin Travis, dhe pas malit Travis vijën ujëndarëse të Alpeve Juliane nëpër qafën Predil, malin Mangarat, Trigllav dhe vijën ujëndarëse të qafave Pobergo, Podlaniskam dhe Idria. Duke filluar nga kjo pikë, kufiri do të ndjekë drejtimin juglindje drejt Shenebergut, duke lënë jashtë territorin italian gjithë pellgun e Savës dhe të degëve të saj; nga Shenebergu kufiri do të zbresë drejt bregdetit në mënyrë që të përfshijë Kastuan, Matulien dhe Volosken në territorin italian.

Neni 5

Italia do të marrë gjithsej provincën e Dalmacisë brenda kufijve të saj të sotëm administrativë, duke përfshirë në veri Lisarikën dhe Tribaninë dhe në jug gjer në një vijë që nisët nga kepi Planka në bregdet dhe që ndjek drejt lindjes majat e lartësive që formojnë vijën ujëndarëse në mënyrë që të lihen brenda territorit italian të gjitha luginat dhe lumenjtë që zbresin drejt Shibenikut si fjala vjen Qikallën, Kërkun, Butisnicën dhe degët e tyre. Ajo do të t'i marrë të gjithë ishujt që ndodhen në veri dhe në perëndim të Dalmacisë nga Premuda, Selve, Olbo, Maun, Pag dhe Vis në veri gjer në Mlet në jug, duke përfshirë aty Sant Andrian, Bishevën, Visin, Hvarin, Torkolën, Korçullën, Kasiollënn dhe Lastoven, si dhe shkëmbinjtë dhe ishujt



përreth me Pelagruzhen me përjashtim vetëm të ishujve Cirona e Madhe dhe e vogël, Bua, Solta dhe Braç.

Do të jenë të neutralizuar:

1. I gjithë bregdeti nga kepi Planka në veri gjer në rrëzën jugore të Gadishullit Peleshac në jug, në mënyrë që të përfshihet ky gadishull i tërë.

2. Pjesa e bregdetit që fillon në veri në një pikë të ndodhur 10 kilometra në jug të kepit Cavtatit dhe që zbrit në jug gjer te lumi Vjosa, në mënyrë që të përfshijë gjirin dhe portet e Kotorit, Tivarit, Ulqinit, Shëngjinit, Durrësit pa u prekur të drejtat e Malit të Zi që rrjedhin nga deklaratat e këmbëzera midis Fuqive në prill dhe në maj 1909; prandaj këto të drejta kanë të bëjnë vetëm me territorin e sotëm malazez dhe nuk mund të shtrihen në territoret dhe në portet që mund t'i jepen Malit të Zi. Si rrjedhim asnjëra pjesë e bregdetit që i përket sot Malit të Zi nuk mund të neutralizohet. Do të mbeten në fuqi kufizimet që kanë të bëjnë me portin e Tivarit, të cilat vetë Mali i Zi i ka pranuar më 1909.

3. Më në fund ishujt që nuk i jepen Italisë.

Shënim

Katër Fuqitë e përmendura ua ndajnë territoret e numëruara Kroacisë, Serbisë dhe Malit të Zi. Në Adriatikon e sipërm gjithë bregdeti prej Volloskës në kufi me Istrën deri te bregdeti verior i Dalmacisë, që përfshin bregdetin e sotëm hungarez dhe gjithë bregdetin e Kroacisë me portin e Riekës dhe skelet e vogla si Novi dhe Karlobag gjithashtu ujdhesat Krk, Prviç, Grgur, Goli dhe Rab. Ndërsa në Adriatikon jugor në regjionet për të cilat aspiron Serbia dhe Mali i Zi, tërë bregdeti nga kepi Planka gjer në lumin Drin me portet e rëndësishme: Split, Dubrovnik, Kotor, Tivar, Ulqin, Shëngjin, me ujdhesat Drevniku i Madh, Drevniku i Vogël, Qeovë, Shollta, Braç, Jakllina, Kolloçep. Porti i Durrësit do t'i mbetet shtetit të pavarur MUSLIMAN (!) të Shqipërisë.

Neni 6

Italia do ta ketë sovranitetin e plotë mbi Vlorën, mbi ishullin e Sazanit dhe një territor mjaft të gjerë për të siguruar mbrojtjen e këtyre pikave – nga Vjosa në veri deri në lindje ku piqet në kufirin verior të rrethit të Himarës në jug.

Neni 7

Në qoftë se Italia merr Trientin dhe Istrën në përputhje me përmbajtjen e nenit 4, Dalmacinë dhe ishujt e Adriatikut brenda kufijve të shënuar në nenin 5 dhe gjirin e Vlorës (nenin 6), dhe në qoftë se pjesa qendrore e Shqipërisë REZERVUET për të formuar një SHTET të vogël autonom të neutralizuar, ajo nuk do të ketë kundërshtim që pjesët veriore dhe jugore të Shqipërisë të ndahen, po qe se këtë e dëshirojnë Franca, Britania e Madhe dhe Rusia, midis Malit të Zi, Serbisë dhe Greqisë. Bregdeti, duke filluar nga kufiri jugor i zotërimin italian të Vlorës (neni 6) gjer në kepin Stillo, do të neutralizohet. Italia do të ngarkohet që ta përfaqësojë shtetin e Shqipërisë në marrëdhëniet e saj me botën e Jashtme. Italia pranon, nga ana tjetër, ta lërë, në çdo rast, në lindje të Shqipërisë një territor të mjaftueshëm për të siguruar qenien e një kufiri të përbashkët midis Greqisë dhe Serbisë në perëndim të Liqenit të Ohrit, duke mos i prishë interesat e të dy palëve aspiruese në tërë liqenin.

Neni 8

Italia do të marrë sovranitetin e plotë mbi ishujt e Dodekanezitetit, të cilët ajo i okupon tani e tutje (sot për sot).

Neni 9

Përgjithësisht, Franca, Britania e Madhe dhe Rusia pranojnë se Italia është e interesuar për ruajtjen e ekuilibrit në Mesdhe dhe se, në rast copëtimi të plotë ose të pjesshëm të Turqisë Aziatike, ajo duhet të marrë një pjesë të përshtatshme në zonën e Mesdheut ngjitur me krahinën e Adalias, ku Italia ka fituar tanimë të drejta dhe interesa që përbëjnë thelbin e konventës italo-britanike. (Është fjala për marrëveshjen për ndërtimin e një hekurudhe në vijën Izmir-Ajdin në Anadoll, e lidhur në mes Italisë dhe Britanisë më 19 V 1914, – firma private, vërejtje nga profesor Arben Puto, Tiranë 1987. f. 639). Zona që do t'i jepej eventualisht Italisë do të kufizohet, kur të vijë koha, duke pasur parasysh interesat reale të Francës dhe të Britanisë së Madhe. Interesat e Italisë do të merren parasysh edhe në rastin kur tërësia territoriale e Perandorisë Osmane do të ruhej dhe kur do t'u

bëheshin ndryshime zonave të interesave të Fuqive të Mëdha. Në qoftë se Franca, Britania e Madhe dhe Rusia do të zënë territore nga viset e Turqisë Aziatike (Anadoll) gjatë luftës, zona mesdhetare ngjitur me krahinën e Adalias brenda caqeve të shënuara këtu sipër, do t'i lihen në sundim Italisë, e cila do të ketë të drejtë për t'i pushtuar përgjithmonë.

Neni 10

Italia do të marrë në Libi të drejtat dhe privilegjet që i përkasin tani sulltanit (Turqisë), sipas traktatit të Lozanës (1913, po edhe më 1923, vërejtje – HB).

Neni 11

Italia do të marrë pjesën që do t'u përgjigjet përpjekjeve dhe sakrificave të saj në dëmshpërblimet eventuale të luftës, kundër Boshtit: Vjenë-Berlin.

Neni 12

Italia deklaron se bashkohet me deklaratën e bërë nga Franca, Britania e Madhe dhe Rusia, me qëllim që ARABIA dhe vendet e shenjta myslimane në Arabi të lihen nën autoritetin e një pushteti mysliman të pavarur, për aq kohë sa të ketë nevojë për ndryshime në favor të nënshkruesve të këtij Pakti katërpalësh.

Neni 13

Në rast se Franca dhe Britania e Madhe do t'i zgjerojnë pushtetet e tyre koloniale në Afrikë në dëm të Gjermanisë, këto Fuqi pranojnë në parim se Italia ka mundësi të kërkojë kompensime si e drejtë e saj, sidomos në zgjidhjen në favor të çështjeve që kanë të bëjnë me KUFIJTË e KOLONIVE italiane siç është – Eritrea, Somalia, Libia dhe kolonive fqinje të Francës dhe Britanisë së Madhe. (Lexoni lexues të nderuar se sa me lehtësi këto Fuqi e kanë nxirë jetën e popujve në robëri për interesa të tyre kriminale shfrytëzuese dhe skllavëruese. Kjo frymë dominon në çdo nen të kësaj Marrëveshjeje – HB).

Neni 14

Britania e Madhe merr përsipër të lehtësojë marrjen e menjëhershme në kushte të drejta, të një huaje prej të paktën 50 milion sterlinash, që do të emetohej në tregun e Londrës.

Neni 15

Franca, Britania e Madhe dhe Rusia do të përkrahin kundërshtimin që do të paraqesë Italia kundër çdo propozimi që do të synojë të pranohet një përfaqësues i Selisë së Shenjtë në të gjitha bisedimet për paqe, dhe për zgjidhjen e çështjeve që do të ngrihen nga kjo luftë kundër Bllokut Berlin-Vjenë.

Neni 16

Kjo marrëveshje do të mbahet në msheftësi. Vetëm aderimi i Italisë në deklaratën e datës 5 shtator 1914, do të bëhet menjëherë i ditur botërisht pas shpalljes së luftës nga ana e Italisë, ose e shpallin Berlini dhe Vjena kundër saj. Pasi morën shënim për memorandumin e sipërm, përfaqësuesit e Francës, Britanisë së Madhe, Ruisë, të autorizuarit rregullisht për këtë qëllim, përfunduan me përfaqësuesin e Italisë, gjithashtu i autorizuar nga qeveria e tij, këtë Marrëveshje:

Franca, Britania e Madhe dhe Rusia japin pëlqimin e tyre të plotë për memorandumin e paraqitur nga qeveria italiane.

Në lidhje me nenet: 1, 2, 3 të memorandumit, që parashikojnë bashkëpunim ushtarak tokësor dhe detar të të katër Fuqive, Italia deklaron se do të hyjë në LUFTE sa më parë dhe brenda një muaji të shumtën nga dita e nënshkrimit të këtyre dokumenteve që na obligojnë të gjithëve të luftojmë nën një front kundër një fronti armik, Berlin-Vjenë.

I bërë në Londër, më 26 prill 1915

Nënshkruajnë: Benkendorf (në emër të Ruisë); Pol Kambon (në emër të Francës); Eduard Grei (në emër të Britanisë së Madhe) dhe Imperiali (në emër të Italisë).

Pas këtij traktati, në të njëjtën ditë të përfaqësuarit në Konferencën sekrete të Londrës, më 26 prill 1915, e lëshojnë një Deklaratë ku thuhet se pasi që Italia t'i shpallë luftë bllokut kundërshtar (Berlinit dhe Vjenës), palët do të lëshojnë një informatë dhe do ta bëjnë të njohur marrëveshjen, por kuptohet jo përmbajtjen e saj të fshehtë. Gjithashtu të katër Fuqitë, më 26 prill 1915, obligohen me një deklaratë se nuk do të bëjnë marrëveshje paqësore në shkallë të veçantë për luftën që po zhvillohej në të gjitha frontet, e paparë në histori.

111 vjet nga krijimi i Shtabit të Përgjithshëm

Ushtria Kombëtare e shtetit shqiptar është ngritur 110 vjet më parë, krahas Ministrisë të Luftës/Mbrojtjes. UKSH-ja ka pasur në drejtim shtatmadhorët dhe Shtatmadhorinë e saj. Tradita luftarake shqiptare ka ekzistuar që nga ushtritë ilire, në ushtrinë e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut, në atë të Pashallëqeve të Bushatllinjve dhe Ali Pashë Tepelenës, tek Lidhja Shqiptare e Prizrenit, që janë faqe të ndritura të historisë dhe traditës ushtarake shqiptare. Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të një shteti të pavarur, në Shqipëri, u formua më datën 4 maj 1913 në Vlorë. Formimi i Shtabit Madhuer u bë me miratimin e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës. Ai mban fillimisht emërtimin Shtati Madhuer dhe më tej u emërua "Shtabi Madhuer" kryetar i të cilit ishte major Ali Shefqet Shkupi. Shtabi Madhuer e kishte qendrën në Vlorë, pranë Ministrisë së Luftës të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës që kryesohej nga Ismail Qemal Bej Vlora. Në verën e vitit 1913 ky shtab ishte fare i vogël, ai përfaqësohej nga një zyrë që emërohej Zyra e Shtatit Madhuer të Ushtrisë, pranë Ministrisë së Luftës dhe ishte në përbërje e në varësi të kësaj ministrie. Në pikëpamje organizative Shtabi Madhor përbëhej nga "pjesët e nënzëshme" që emërtohej në terminologjinë e fillim-shekullit të kaluar si: "Qarqet e Shtatit Madhuer, Sekretaria e Shtatit Madhuer, Komisioni i rregulloreve e i ushtrimeve, Komisioni i trajnimit të policisë e të xhandarmërisë, Komisioni i ndërtimit". Shtabi Madhor ishte konceptuar, ndërtuar, por edhe veprimi teorikisht e praktikisht si një organ bazë i Ministrisë së Luftës. Shtabi ishte përgjegjësi kryesor për organizimin, përgatitjen dhe drejtimin profesional të veprimtarisë luftarake të FA-së Shqiptare. Nga Shtabi kalonin të gjitha projektet e raportet për Ministrinë e Luftës, që i dërgoheshin asaj nga ana e zyrave apo edhe nga vetë qarqet e tjera ushtarake. Shtabi në këtë periudhë u mor drejtpërdrejtë edhe me çështje dhe probleme që kishin lidhje me organizimin dhe kryerjen e luftimeve në mbrojtje, në pjesën jugore e juglindore të Shqipërisë kundër shovinistëve grekë, dhe në pjesën verilindore. Shtabi Madhor ishte përgjegjës për furnizimin me armatime, municione e barna mjekësore të forcave ushtarake shqiptare në zonat e veprimeve. Shtabi merrej me organizimin e forcave dhe strukturave të Ushtrisë, me hartimin e rregulloreve dhe udhëzimeve mbi organizimin, jetesën, stërvitjen dhe veprimtarinë e Ushtrisë dhe të Xhandarmërisë Shqiptare. Pas 24 majit 1944, me unifikimin e Komandës në Komandë të Përgjithshme, me një Komandant të Përgjithshëm në Krye, Shef i Shtatmadhorisë u emërua gjeneralmajor Spiro Moisiu. Shtabi i Përgjithshëm vijoi të mbetej si një organ i specializuar ushtarak, që kryente detyra të ngjashme si dhe më parë. Me çlirimin e vendit, në vitin 1944, ashtu si gjithë UNÇSH-ja, edhe Shtabi i Përgjithshëm iu nënshtrua shndërrimeve të domosdoshme për një ushtri të rregullt të kohës



së paqes. Shtabi i Përgjithshëm dhe Ministria e Mbrojtjes, në vitet 1945-1990, është riorganizuar në varësi të drejtpërdrejtë të ecurisë së FA-së, duke iu përgjigjur gjendjes, detyrave e strukturave të tyre. Riorganizimet, shërbimet e zhvillimet e Ushtrisë Shqiptare u mbështetën edhe në efektshmërinë e udhëheqjes operative-strategjike. Në këtë periudhë u përsos organi i drejtim, Shtabi i Përgjithshëm. Për organizimin dhe drejtimin e Forcave të Armatosura, më 1 korrik 1945, u krijua Ministria e Luftës dhe e Mbrojtjes Kombëtare, ku në përbërje të saj vepronte Komanda e Përgjithshme e Ushtrisë Kombëtare. Shtabi i Përgjithshëm ishte në varësi të Komandantit Suprem, i cili ishte edhe i ngarkuari me punët e Luftës dhe të Mbrojtjes Kombëtare. Në varësi të Shtabit të Përgjithshëm ishin, Drejtoria e Mbrojtjes Kombëtare dhe Drejtoria e Ndërlidhjes dhe tetë seksione dhe më konkretisht Seksioni Operativ, i Informacionit, i Topografisë, i Shifrës, i Stërvitjes Luftarake, i Ekspeditës, i Aeronautikës, i Brendshëm. Komandat dhe drejtoritë e tjera vareshin drejtpërdrejtë nga Komanda e Lartë Supreme.

Nënkolonel Ali Shefqet Shkupi, personalitet në Ushtrinë osmane, ish-komandanti i garnizonit të Stambollit me gradën "binbash". Nënkolonel Ali Shefqet Shkupi ka qenë shef i Shtatmadhorisë së parë Shqiptare me funksionet e komandantit suprem të ushtrisë shqiptare, në qeverinë e Ismail Qemal Vlorës. Braktisi ushtrinë osmane kur ishte komandant i garnizonit të Stambollit.



Gjeneral Ali Riza Kolonja, përveç detyrës si Ministër Luftë në Ushtrinë Kombëtare Shqiptare në vitet '20, pas Kongresit të Lushnjës me Kryeministër Sulejman Delvinën, ka kryer edhe detyrën e Kryetarit të Shtabit Madhor si dhe njëherësh edhe detyrën e Komandantit të vetëm të Divizionit që kishte në atë kohë Shqipëria.



Major Xhavid Leskoviku ka lindur më 2 maj 1882, në Leskovik. Ndoqi studimet në Akademinë e Luftës në Stamboll për degën e këmbësorisë (Pyade). Është titulluar oficer, më 1 gusht 1907, duke shërbyer për gjashtë vjet me radhë në ushtrinë osmane në disa detyra. Por më 1 janar 1913, hyn në shërbim të Ushtrisë Kombëtare shqiptare. Ai shërbeu në qeverinë e Ismail Qemal Bej Vlorës si dhe në ushtrinë e Vilhelm Vidit.



Major Bajram Fevziu ka qenë i njohur si një nga drejtuesit e Shtabit Madhor, por njëherësh edhe si personalitet politik i botës shqiptare së cilës i përket. U shqua, për besnikëri, atdhetarizëm, vendosmëri dhe aftësi ushtarake. Me gradën 'major' zëvendësoi Xhavid Leskovikun në postin e kryetarit të Shtabit Madhor të Ushtrisë Shqiptare. Këtë post ai e mbajti edhe me ardhjen e Qeverisë së Fan Nolit. Në krye të Shtabit Madhor, major Fevziu qëndroi deri më 24 dhjetor 1924.



Gjeneral Gustav Von Myrdac, me origjinë austriak, ishte në postin e kryetarit të Shtabit madhor, i cili kryente njëherësh edhe detyrën e organizatorit të Ushtrisë Shqiptare, që e mbante qysh prej vitit 1922. Ai kishte lindur më 7 dhjetor 1876, në Vjenë, kryeqytet i Austro-Hungarisë. Më 18 janar 1925, me riorganizimin e UKSH-së, Myrdac emërohet Kryetar i Shtatmadhorisë dhe organizatori kryesor i UKSH-së. Në vitin 1933 i jepet grada 'gjeneral', gradë me të cilën punoi për UKSH-në deri në pushtimin e Shqipërisë, në vitin 1939. Ai rishfaqet përsëri në kohën e pushtimit në tendencat për ngritjen e ushtrisë së pavarur shqiptare nën drejtimin e Komandës së Mbrojtjes Kombëtare, që me pushtimin gjerman u emërtua: "Komanda Shqiptare e Mbrojtjes".



Gjeneral Spiro Moisiu lindi në vitin 1900, në qytetin e Kavajës. Moisiu mori pjesë në përbërje të forcave qeveritare që u caktuan

në mbrojtje të Kongresit të Lushnjës dhe po atë vit ai u caktua me detyrën e shefit të shtabit të grupit, në luftimet që u zhvilluan në Kaptinë të Martaneshit kundra forcave serbe. Në Kryengritjen e Qershorit të vitit 1924, Spiro Moisiu u rreshtua përkrah ushtarakëve të komanduar nga kolonelët Rexhep Shala dhe Kasëm Qafzezi, të cilët u bashkuan me forcat fanoliste. Po kështu, në dhjetorin e vitit 1924, Moisiu mori pjesë me forcat qeveritare që dolën në Shkallën e Tujanit për të penguar kthimin e Zogut në Shqipëri.



Duke pasur parasysh të kaluarën e tij të papërlyer dhe aftësitë e rralla si ushtarak i karrierës, në korrikun e vitit 1943 kërret e Partisë Komuniste e thërritën atë në Labinot të Elbasanit, ku dhe i propozuan detyrën e Komandantit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Ai kishte famën e madhe që kishte krijuar Spiro Moisiu si Komandant i Përgjithshëm, në Kongresin e Përmetit, por të gjitha funksionet u përqendruan në funksionit politik si Komandant edhe Komisar i Përgjithshëm i Ushtrisë NÇ; ndërsa Spiro Moisiu mbajti vetëm detyrën e Komandantit të Shtabit të Përgjithshëm.

Gjeneralkolonel Mehmet Shehu lindi më 10 janar 1913, në fshatin Çorrush të Mallakastrës. Gjatë Luftës Nacional-Çlirimtare ka qenë komandant i Çetës Plakë të Mallakastrës, në shkurt 1943; komandant i Br1S në gusht 1943; Komandant i D1S, në maj 1944 me gradën 'kolonel', ndërsa në tetor 1944 gradohet 'gjeneralmajor'. Mbas çlirimit të Shqipërisë dërgohet për studime në Bashkimin Sovjetik. Më pas emërohet Shef i Shtabit të Përgjithshëm. Kryen njëkohësisht detyrën e zëvendëskryeministrit dhe atë të ministrit të punëve të brendshme. Kryeministër; ndërsa nga 1974 deri në 1981 ka qenë Ministër i Mbrojtjes. Njohës i pesë gjuhëve të huaja: anglisht, frëngjisht, italisht, spanjisht dhe rusisht.



Gjenerallejtënant Beqir Balluku lindi më 14 shkurt 1917, në Tiranë. U përfshi në lëvizjen komuniste qysh gjatë kohës që kryente shërbimin ushtarak 1940 deri 1942. Më 20 maj 1943, u caktua komandant i batalionit partizan "Krujë-Ishëm", më 18 shtator 1943, komisar i brigadës së tretë dhe më pas komandant i Br2S. Më 28 janar 1948, ishte emëruar



kryetar i Shtatmadhorisë së Ushtrisë. Kreu në Moskë Akademinë Ushtarake “Voroshilov”. Në kongresin e parë të Partisë u zgjodh anëtar i Byrosë Politike dhe në vitin 1953 Ministër i Mbrojtjes Popullore. Një vit më pas mori gradën më të lartë në Shqipëri, atë të ‘gjenerallejtënantit’. Balluku ishte gjithmonë deputet i Kuvendit Popullor. Në korrik të vitit 1974, ai u akuzua si organizues i veprimtarisë puçiste ushtarake nga diktatura dhe u dënua me vdekje dhe u pushkatua, më 5 nëntor 1975, për tradhti të lartë ndaj atdheut.

Gjenerallejtënant Arif Hasko

Mema lindi në Tërbaç të Vlorës, i njohur gjatë LLIB me pseudonimin “Patrioti”, gjatë luftës për çlirimin e vendit. Në dhjetor të 1943-it, inkadrohet në BrLS, duke kryer detyra të ndryshme, deri komisar politik i kësaj brigade. Mbas çlirimit kryen Akademinë e Lartë të Shtabit të Përgjithshëm në Bashkimin Sovjetik. Më vonë kryen detyra të larta si Komisar Divizioni, Korpusi, Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë dhe zëvendësministër i Mbrojtjes Popullore. Ai tërë jetën e tij, qëndroi besnik i idealeve të LANÇ-it. Ai kreu detyrën e zëvendëskryetarit të Parë të Komitetit Kombëtar të Organizatës së Veteranëve të LANÇ-it. Për kontributet e tij është nderuar me shumë urdhra e medalje të akredituara nga ish-Prësidiumi i Kuvendit Popullor.



Gjenerallejtënant Petrit Dume

lindi më 20 maj të vitit 1920. Deputet, i arsimuar me dy akademitë sovjetike ushtarake, shef i shtatmadhorisë së Forcave të Armatosura të Shqipërisë si shefi më jetëgjatë në Shtabin e Përgjithshëm. Ai ka qenë deputet në të gjitha legjislaturat.



Sami Meçollari

ishte shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, për një periudhë të shkurtër në vitin 1974; ka qenë drejtues i spikatur i Formacioneve të mëdha ushtarake. Lindi në Marjan të Oparit në Korçë, më 10 mars 1937. Në periudhën 1970-1972 u caktua shef i htabit të Korpusit të Gjirokastrës. Në vitin 1973 mori detyrën e komandantit të këtij korpusi deri në vitin 1974, kur u emërua shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Shqiptare.



Veli Llakaj

ka lindur më 18 shkurt 1935, në Kras të Tepelenës. Në vitet 1967-1968, oficer drejtimi pranë SHP; Në vitet 1968-1971 ka mbajtur pozicionin e komandantit të BrLK, Tiranë. Në vitet 1971-1972, në Akademinë e SHP dhe Komandant i Korpusit të Burrelit. Në vitet 1972-



1974, komandant i Korpusit të Parë të Mbrojtjes Bregdetare Fier. Në vitin 1974 emërohet zëvendësministër i Parë dhe shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, detyrë të cilën e kryen deri në vitin 1982.

Kiço Mustaqi ishte një ushtarak karriere që kishte lindur më 22 mars 1938, në një fshat pranë Delvinës, Sarandë. Në detyrën e Ministrit të Mbrojtjes vjen pasi kishte kryer detyrën e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Shqiptare për nëntë vjet rresht. Në shkurt të vitit 1991 ngarkohet me detyrën e Ministrit të Mbrojtjes të Shqipërisë në përbërje të qeverisë së Kryeministrit Fatos Nano dhe që u largua nga detyra me dorëheqjen e qeverisë në qershor të po atij viti.



Kolonel Halim Abazi ka lindur në dhjetor të vitit 1944 në Tërbaç të Vlorës. Ka kryer detyra të nivelit më të lartë në ushtrinë shqiptare, përfshi edhe ato në nivelet e shkollave ushtarake. Në shkurt-qershor 1991, u përzgjedh për detyrën e lartë të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë shqiptare. Ka dalë oficer në rezervë në vitin 1993.



Gjeneralmajor Kostaq Karoli

ka lindur në dhjetor të vitit 1945, në Korçë. Ka qenë ushtarak i talentuar, ka kryer të gjithë llojet e arsimit ushtarak shqiptar, të cilat i ka përfunduar me rezultate të shkëlqyera. Në qershor 1991 deri në gusht 1992 ka kryer detyrën madhore të Shefit të SHP.



Gjeneral Ilia Vasho

ka lindur më 10 korrik 1944, në Leskovik. Mbante gradën shkencore “Doktor Shkencash”. Në 1992-1994 u përzgjedh për detyrën e lartë të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë shqiptare. Dalë oficer në rezervë në vitin 1997, nga funksioni që ka në NATO, funksion që e kreu nga 1994 deri në 1997.



Gjeneral me katër yje Sheme Kosova

Në periudhën 1994-1997 ka kryer detyrën madhore Shef i Shtabit të Përgjithshëm.



Sheme Kosova ishte lindur në 24 mars 1949. Ka kryer detyra të nivelit më të lartë në ushtrinë shqiptare deri në Shef i SHPFASH.

Gjeneralmajor Adem Çopani ka lindur në korrik të vitit 1944, në Tiranë. Ka kryer detyra të nivelit më të lartë në ushtrinë shqiptare, përfshi edhe ato në nivelet e shkollave ushtarake. Në vitet 1991 deri në mars 1997 ka kryer detyrën e Këshilltarit ushtarak të Presidentit të Republikës. Në një nga periudhat më të vështira e të errëta të ushtrisë shqiptare në mars të vitit 1997 zgjidhet në postin madhor të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, detyrë që e mbajti deri në gusht të vitit 1997.



Gjeneral brigade Aleks Andoni ka lindur më 8 qershor 1956, në fshatin Vuno të Vlorës. Ka kryer detyra të nivelit më të lartë në ushtrinë shqiptare, përfshi edhe ato në nivelet e shkollave ushtarake.



Gjenerallejtënant Pëllumb Qazimi ka lindur në vitin 21.10.1957, në Skrapar. Ka kryer detyrat: komandant toge, instruktor stërvitje; Zëvendës drejtor në drejtorinë e zbulimit në Shtabin e Përgjithshëm, grada 'nënkolonel'; Zëvendës drejtor i Shërbimit Informativ Ushtarak dhe shef i Zbulimit Ushtarak, Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.



Gjeneralmajor Luan Hoxha ka lindur më 28 mars 1960, në Shkodër dhe ka qenë Shef i Shtabit të Përgjithshëm i Forcave të Armatosura nga viti 2006-2008.



Gjeneralmajor Maksim Malaj ka lindur në 13.12.1958. Gjatë periudhës që Maksim Malaj ka qenë në krye të FASH ka pasur një progres të dukshëm, ku Shqipëria është pranuar anëtare me të drejta të plota në strukturën e sigurisë së kombeve, NATO.



Gjeneralmajor Xhemal Gjunkshi ka lindur në Peshkopi, më 30 janar 1963. Me dekret të Presidentit të Shqipërisë nr.7079, datë 8 gusht 2011, u emërua shef i Shtabit të Përgjithshëm.



Gjeneralmajor Jeronim Bazo ka lindur më 1960, Drejtoi Shtabin e Përgjithshëm nga 3 nëntori 2013 - janar 2017.



Gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku është lindur në Pëllumbas të Beratit më 1967. Ka kontribuar për ngritjen në një shkallë më të lartë të stërvitjes e modernizimit të FA-së, për forcimin e kapaciteteve dhe përbushjen e objektivave strategjike në kuadrin e direktivave të NATO-s.



Forcat e Armatosura nën drejtimin e tij u angazhuan për ngritjen e niveleve cilësore ushtarake nëpërmjet shndërrimit në një forcë profesioniste, të mirë stërvitur, të pajisur me sisteme të teknikes dhe të armatimit bashkëkohor si një proces i modernizimit të FA-së në vijimësi.

Gjeneralmajor Bajram Begaj është lindur më 20 mars 1967, në qytetin e Rrogozhinës. Në vitin 2020, një muaj pas gradimit si 'gjeneralmajor', shërbeu si Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.



Ka përfunduar studimet dokto-rale dhe është autor i disa publikimeve shkencore.

Nga viti 2016, mban gradën shkencore "Prof. i Asoc". Aktualisht është Presidenti i 8-të i Republikës së Shqipërisë, që prej 24.7.2022.



Gjeneralmajor Arben Kingji, është lindur më 22 dhjetor 1970, në Kukës. Pas diplomimit ka shërbyer si Komandant toge, Instruktor taktik, Drejtues i Grupit Special në Batalionin Komando, Zëvendëskomandant i Batalionit të Forcave Speciale, Komandant i Batalionit të Policisë Ushtarake, si dhe Komandant i Forcës Tokësore. Ka shërbyer në katër misione jashtë vendit, si Komandant i kontingjentit Shqiptar në Afganistan dhe Komandant i kontingjentit Shqiptar në Irak.



Gjurmë në kaltërsi, 73 vite histori

Përpjekjet e para për t'i futur aeroplanët e parë në shërbim të ushtrisë nisin aty nga fillimi i viteve 1920. Por, me gjithë dëshirat dhe përpjekjet e disa prej drejtuesve të lartë ushtarakë të asaj kohe, mundësitë ishin të pakta për "pamundësi financiare dhe buxhetore".

Vetëm pas çlirimit të vendit, më 24 prill 1951, u krijuan Forcat Ajrore të ushtrisë shqiptare, që ne sot i njohim si pasojë e faktorëve historikë dhe politikë, që mundësuan krijimin e Aviacionit Ushtarak.

Pozita e favorshme gjeostrategjike e Shqipërisë në krahun juglindor të Evropës favorizonte synimet e Bllokut Lindor e sidomos të ish-Bashkimit Sovjetik, për daljen e tij në ujërat e Adriatikut dhe Mesdheut Qendror, për krijimin e bazave aero-detare. Për këtë, sovjetikët morën përsipër të gjitha angazhimet për ta futur Shqipërinë në Traktatin e Varshavës. Ana morale-politike konsis-

tonte në instalimin e vlerave komuniste pro lindore në Shqipëri dhe inkuadrimin e saj në të ashtuquajturën bashkësi të shteteve të demokracive popullore të Evropës Lindore.

Po kaq të rëndësishme ishin roli dhe aftësia e udhëheqjes politike e ushtarake të shtetit shqiptar, i cili i shfrytëzoi këto konjunktura politike e ushtarake për forcimin e mbrojtjes së Shqipërisë. Pas kësaj u krijuan kushtet që ushtria jonë të riarmatosej me shpejtësi, duke u pajisur me teknikën luftarake moderne të kohës dhe formimin e Aviacionit e të Ushtrisë Shqiptare.

Aviacioni ynë u formua në rrethana tepër të veçanta, pothuajse në një vend të zbrazët, pa një infrastrukturë të përgatitur, pa tradita dhe pa eksperiencën e nevojshme në këtë fushë. Ne kishim një varg mungesash në fushën e shfrytëzimit të teknikës, sidomos për pjesë këmbimi e materiale konsumi, mungonte baza e nevojshme e riparimit fushor të teknikës, ndërsa prapavija e aviacionit mun-

gonte pothuajse krejtësisht.

Në vitet 1945-1955 Shqipëria ishte shndërruar në një arenë të mbikalimeve të shumta e të pakontrollueshme të aeroplanëve të huaj ushtarakë dhe civilë, ndaj kërkoheshin masa urgjente dhe efektive për mbrojtjen e dimensionit të tretë, atij të hapësirës ajrore, e cila paraqitej më e dobët e tepër delikate, krahas mbrojtjes së kufijve tokësorë e detarë.

Në këtë kohë u shtrua për zgjidhje një problem me karakter strategjik, krijimi i forcave ushtarake kundërajrore, që do të përfshinin: Aviacionin Luftarak, Artilerinë e Mbrojtjes Kundërajrore dhe mjetet e zbulimit të hapësirës ajrore, të drejtuara nga një staf drejtues. Komanda e MKA-së së Shtetit, si lloji i veçantë i forcave të armatosura për mbrojtjen e sovranitetit të shtetit shqiptar.

Gjeneratës së parë të aviatorëve shqiptarë, në vitet 1954-1955, i takoi rasti historik që të hapin erën e aeroplanëve reaktivë në Shqipëri. Pas këtyre viteve filloi funksionimi normal i aviacionit sipas standardeve bashkëkohore dhe ingranimi i tij në hallkat e sistemit të mbrojtjes ajrore. Filloi një epokë e re e zhvillimit, nga më intensivët e përgatitjes luftarake, fillimisht për përvetësimin e aeroplanëve reaktivë, kompaktësimi brenda vetes dhe me trupat e MKA-së dhe më pas në kuadrin e Forcave të Armatosura në tërësi, me detyrën për mbulimin dhe sigurimin e veprimeve luftarake të Forcave Tokësore dhe Flotës Luftarake Detare, në drejtimet kryesore operative dhe për barazimin e vlerave tona me FUA-të e vendeve të Bllokut Lindor.

Në sajë të një përgatitjeje ajrore intensive dhe të organizuar mirë, pilotët tanë kishin nivele të krahasueshme me aviatorët e vendeve të tjera. Këtë e dëshmojnë sukseset në drejtim të mbrojtjes së hapësirës ajrore të vendit. Mjaft pilotë trima dhe figura të spikatura lanë emër në historinë e aviacionit: Kosta Dede nga Vunoi i Himarës, Anastas Ngjela, nga Sheperi i Zagorisë, Mahmut Hysa nga Maminasi i Durrësit, Më pas, pilotët Koco Biku dhe Gëzdar Veipi treguan një përgatitje luftarake të lartë, guxim e trimëri, pjekuri e gjakftohtësi, si dhe korrektësi në zbatimin e instruksioneve për rastet e shkeljeve të hapësirës ajrore nga dhunuesit e huaj.

Aviacioni ynë tregoi edhe përpara opinionit ndërkombëtar se Shqipëria ka zot shtëpie dhe askujt nuk i lejohet ta shkelë sovranitetin ajror të saj. Për veprimet e tyre të vendosura e të guximshme ata u dekoruan me 'Urdrin e Lartë Luftarak të Trimërisë', ose merituan vlerësimin më të lartë të Komandës së Përgjithshme.

Në vitin 1959 aviacioni ynë u pajis me aeroplanë reaktive superpersonikë interceptues, për kryerjen e detyrave luftarake në të gjitha kushtet meteorologjike dhe u armatos me raketa ajër-ajër. Kështu, u çel në Shqipëri era e aeroplanëve superzanorë. Aviatorët e gjeneratës së dytë treguan aftësi të lavdërueshme profesionale si në përvetësimin e këtyre aeroplanëve, ashtu edhe në qitjet luftarake me raketa ajër-ajër, duke zënë vendin

e dytë ndërmjet vendeve të Aleancës Lindore. Ata u bënë mjeshtër të përvetësimit të teknikës supersonike, zotëruan dhe aeroplanët më modernë MIG-21, duke u bërë komandantë të zotë dhe instruktorë në përvetësimin e kësaj teknike edhe për kuadrot pasardhës të aviacionit.

Një respekt i veçantë i takon efektivit të Regjimentit të Helikopterëve dhe Skuadriljes së Transportit. Ata meritojnë vlerësimin më të lartë për shërbimet që i kanë sjellë ushtrisë dhe popullatës civile. Në këto reparte janë përgatitur me qindra parashutistë të njësive tona operative. Por ato dhanë një kontribut të madh edhe në elektrifikimin e plotë të vendit, spërkatjen e mijëra hektarëve tokë bujqësore, apo kryen akte të guximshme në raste përmbytjesh e fatkeqësish natyrore. Jetëshkrimi i aviacionit tonë luftarak është historia e çdo ushtaraku, piloti, tekniku e specialisti. Mirënjohje për përpjekjet e panumërta dhe përkushtimin e tyre maksimal, si dhe për sakrificat më sublime që kanë dhënë ata për mbijetesën e aviacionit.

Mbështetur mbi këtë efektiv të pas viteve 1961, Komanda e Përgjithshme e Ushtrisë u dha rrugëzgjidhje shumë problemeve të mprehta që lindën e pasuan pas prishjes së marrëdhënieve të vendit dhe të ushtrisë sonë me Traktatin e Varshavës. Aviacionit tonë iu ndërpre në të gjitha furnizimet me karburant,



për pjesë këmbimi e materiale konsumi, municione, remontin teknik etj. U ndërpre edhe përgatitja dhe shkollimi i kuadrove fluturuese dhe inxhiniero-teknik, si edhe një sërë projektesh të filluara. Ndryshimi i kahut të politikës shqiptare dhe orientimi i saj drejt Republikës Popullore të Kinës ishte zgjidhja e kohës. Sot ne kemi të drejtën legjitime që të krenohemi me këtë institucion të rëndësishëm të aviacionit luftarak, nga dyert e të cilit, për dekada kanë dalë kuadro të kualifikuar, që mbajtën mbi supet e tyre gatishmërinë luftarake. Në periudhën 1961-1978, në mënyrë graduale, u krijuan tre regjimente të aviacionit gjuajtës dhe gjuajtës-bombardues të strehuar në tunele, një regjiment helikopterësh MI-4, një skuadrilje autonome e transportit ushtarak AN-2, u kompletua shkolla e aviacionit me aeroplanë luftarako-mësimorë dhe me të gjitha mjetet e nevojshme mësimore didaktike dhe detashmenti i avionëve qeveritare IL-14.

U ndërtua uzina e riparimit kapital të aeroplanëve dhe helikopterëve, filloi prodhimi i pjesëve të këmbimit dhe më pas edhe riparimi kapital i motorëve të aviacionit. Në Republikën Popullore të Kinës u specializuan rreth 150 pilotë luftarake për drejtimin e aeroplanëve supersonikë MIG-19 dhe MIG-21. Dhjetëra pilotë të rënë në lulen e rinisë mbetën të përrjetshëm si martirë të ajrit, si bij të paharruar të atdheut. Dhjetëra dhimbje njerëzore mbetën të pashlyera në zemrat tona. Të gjitha këto u bënë në emër të mbrojtjes së atdheut.

Veteranët e aviacionit, punuan, luftuan dhe sakrifkuan në rrethanat e një konfrontimi politik-ushtarak të dy blloqeve kundërshtarë, në kushtet e një gare të shfrenuar të armatimeve, mes një ankthi të madh të luftës së ftohtë, nën një tension nervor të skajshëm dhe plot mobilizim të forcave materiale e shpirtërore të popullit, sidomos të efektivave të forcave të armatosura.

Pohojmë pa mëdyshje se 60 vitet e ekzistencës së aviacionit tonë janë një periudhë e lavdishme në historinë e zhvillimit të Forcave të Armatosura. Sot ne jetojmë në kushte e rrethana krejtësisht të ndryshme e të pakrahasueshme me të kaluarën. Shqipëria ka hequr dorë nga vetë-izolimi. Tani jemi inkuadruar në NATO dhe organizma të tjera evropiane. Ndërtimi i ushtrisë moderne e të pajisur me teknikë bashkëkohore, sidomos për një vend të vogël si Shqipëria, është pa dyshim një barrë e rëndë për ekonominë, por ajo është njëherazi domosdoshmëri për interesat e mbrojtjes së vendit.

Ndaj, për t'u afirmuar në kuadrin e NATO-s, duhet të bëhemi të barabartë me partnerët e tjerë të aleancës Euro-Atlantike, në përgatitjen teknike e luftarake, të thithim idetë më të mira të kolegëve perëndimorë, ta ngremë në ideal traditën tonë të aviacionit, duke bërë shndërrimin rrënjësor të Forcës Ajrore Shqiptare dhe të krijojmë elitën e re të aviacionit tonë në të gjitha fushat e kësaj arme, sa delikate aq edhe të rëndësishme për atdheun, e cila do t'i plotësonte fondet me shumën prej 10.000 frangash ari, aq sa kushtonte avioni.

Në një artikull të datës 10 mars 1921, në gazetën "Shqiptari", që botohej në Rumani, në faqen 3 thuhet: "Në një letër që na vjen nga Parisi, na lajmëron se atje po presin këto ditë të vijnë nga Shqipëria tre shqiptarë për të mësuar në shkollë për aviatorë. Shprehim se të tjerë do të vijnë pas tyre për të mësuar në Paris".

Në prizmin organizativ shtetëror, që në nëntor të vitit 1929, në Shqipëri u dekretua "Ligji mbi organizimin e Fuqive Armate", ku ushtria emërtohej "Ushtria Kombëtare Shqiptare" dhe organi më i lartë drejtues i saj ishte Komanda e Mbrojtjes Kombëtare. Sipas këtij ligji, ushtria ndahej në tri lloje forcash: Tokësore, Detare dhe Ajrore. Megjithatë, Forcat Ajrore nuk arritën të jenë funksionale asnjëherë para Luftës së Dytë Botërore, ndonëse ato ekzistonin në tri dekrete, që u miratuan dhe u vunë në zbatim edhe në vitet 1931, 1934 dhe 1937 nga mbreti Ahmet Zogu, kryesisht për pamundësinë financiare, për këto arsye, në atë kohë u gjykua që Forcat Ajrore ose "Fuqitë Aerore", siç i quante dekretligji, të lireshin dhe të formoheshin në varësi të "disponibilitetit të buxhetit" me një ligj të veçantë.

Por forma më e organizuar e përgatitjes së efektivave të aviacionit ka filluar pas Luftës së Dytë Botërore, kohë në të cilën Shteti Shqiptar dërgoi në ish- Jugosllavi kontingjentin e parë dhe, pothuajse njëkohësisht, edhe në ish-Bashkimin Sovjetik. Në prill të vitit 1945, pranë Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Kombëtare, u krijua Seksioni i Aeronautikës, me qëllim që të kryhej sigurimi i

aerodromeve dhe vënia në funksionim e aeroportit të Tiranës për pritjen e avionëve në këtë aerodrom. Në këtë grup bënin pjesë ish-partizanë, si zëvendëskomandanti i Brigadës së Tretë, Kapiten Ernest Jakova, shefi kësaj dege, si dhe togerët Mahmut Agolli e Hysen Brovina.

Fillimet e tij, Aviacioni Luftarak Shqiptar i ka pas ardhjes së avionëve JAK-9P (Jakovljevi), në muajin mars të vitit 1951, kur në Laprakë u formua reparti i parë. Struktura e këtij reparti ishte e para formë e organizuar e Aviacionit Shqiptar. Gjithçka ishte shqiptare, pilotët, grupi inxhinier-teknik, mbështetja logjistike, ndërlidhja.

Regjimenti i Helikopterëve u formua në dhjetor 1967. Ai kishte në organikën e tij tri skuadrilje me 36 helikopterë MI-4. Baza Ajrore e Gjadrit është formuar e fundit në repartet e aviacionit. Ajo u krijua në shkurt të vitit 1974 dhe ishte një bazë tërësisht e tunelizuar, e cila kishte dy skuadrilje MIG-19 dhe një skuadrilje MIG-21.

Aviacioni Luftarak Shqiptar në atë kohë numëronte mbi 200 avionë e helikopterë, të cilët që të gjithë ishin të prodhimit lindor. Aviacioni Luftarak Shqiptar kishte për detyrë "Mbrojtjen e pa-prekshmërisë së kufijve shtetërorë të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë".

Që nga krijimi i repartit të parë e deri në vitin 1974, aviacioni ishte një strukturë brenda Mbrojtjes Kundër Ajrore të shtetit. Komandanti i aviacionit është emëruar për herë të parë në vitin 1955, në krye të aviacionit u caktua Edip Ohri, i cili njëkohësisht ishte edhe zëvendëskomandant i MKA-së. Në vitin 1974 aviacioni u sanksionua si komandë më vete dhe si e tillë ka qëndruar deri në vitin 1995.

Në vitin 1995 repartet e aviacionit u bënë pjesë e Forcave të Mbrojtjes Ajrore, një strukturë që përmblihte MKA-në, aviacionin, Regjimentin Radio/Teknik. Në krye të Forcave të Mbrojtjes Ajrore drejtuan Gjeneral Perlat Sula dhe gjeneral Agim Baruti.

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, u përcaktua se: "Forcat e Armatosura përbëhen nga Forcat Tokësore, Detare dhe Ajrore". Me urdhër të Komandantit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, datë 08.04.2000, "Për fillimin e ristrukturimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", doli urdhri i ministrit të Mbrojtjes, "Për kalimin në strukturën e re organizative të Forcave Ajrore". Më 18 gusht të vitit 2000, me dekret të Presidentit të Republikës, nr. 2733, datë 11.08.2000, komandant i Forcave Ajrore të Republikës së Shqipërisë u emërua kolonel Astrit Jaupi (gjeneral brigade në vitin 2001).

Aviacioni Shqiptar ka të ardhme të madhe

Sipas mitologjisë, Ikari, njeriu i parë që "sulmoi" qiellin me disa flatra të ngjitura në shpinë, u nis në aventurën më të çmendur për të realizuar të pamundurën, sfidën e njeriut ndaj perëndive, fluturimin, por, në lartësitë e mëdha, dielli e shkriu dyllin, me të cilin Ikari kishte ngjitur krahët. Ndodhi kështu "katastrofa" e parë ajrore, e cila nxori në pah faktin se "teknologjia" do të kishte historikisht rolin e vet në fatin e ëndrrave e projekteve të mëdha të njerëzimit në sulmin ndaj qiellit.

Ikari vdiq, por nuk vdiq ëndrra e njerëzimit për të fluturuar, legjenda mbeti e gjallë mes brezave të shoqërisë njerëzore, sfida ndaj qiellit mbeti e hapur deri në realizimin e saj pas mijëra vjetësh.

Prej rreth 100 vjetësh, që nga shpikja magjike e vëllezërve Rajt në Amerikë, kur u shpikën avionët, makinat fluturuese më të renda se ajri e deri më sot, kur nga Kep Kenedi nisen mjetet më moderne që

“sulmojnë” kozmosin, “dylli i krahëve të lkarit” shpesh ka pësuar “shkrirje”, teknologjitë kanë treguar kështu dobësitë e veta. Me gjithë evolucionin e jashtëzakonshëm shkencor, teknologjia e zbatimit të projekteve dhe ëndrrat e mëdha nuk kanë mundur të ecin krah për krah. Hekura, tela, termometra, aparatura e matës nga më të ndryshmit, me tekat e shpërfilljen e tyre pa ndjenja, e kanë sfiduar ëndrrën e njerëzimit për fluturim, kanë tentuar ta shkruajonjë guximin e atyre që sfidojnë epokat dhe periudhat tranzitive, ecjen përpara në këtë fushë.

Mijëra heronj të ëndrrës fluturose të njerëzimit kanë hedhur gurin e tyre në “kështjellën” e dijeve njerëzore, për t’i dhënë shansin brezave pasardhës të kuptojnë e ndreqin gabimet, për t’u dhënë atyre shansin e ecjes përpara dhe të kuptojnë se ku janë afatet. Aviacioni Luftarak ka lënë kujtimin e dëshmorëve, të cilët janë krenaria dhe nderi i kësaj arme, simboli i mënyrës se si i duhet shërbyer shtetit, me një përkushtim që nuk merr parasysht as sakrificat sublime, gjë që përbën një shembull edhe për brezat e sotëm në devotshmërinë karshi vendit.

Në aviacion kanë rënë në krye të detyrës shumë “Dëshmorë të Atdeut”, mosha mesatare e të cilëve është 31 vjeç. Si në çdo luftë, ku marrin pjesë heronj të vërtetë, ata që bien janë dëshmorët, siç



janë pa asnjë diskutim edhe dëshmorët e aviacionit. Të shtrirë mbi shtratin e topit, të mbështjellë me flamurin kombëtar, në ritmet e përzishme të marsheve funebre, ata u nisën drejt përjetësisë, për në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit, aty ku vargjet e himnit tonë, “po vdes, po vdes, si një dëshmor”, marrin një kuptim real e krejt të veçantë. Aktualisht, repartet e Aviacionit janë pjesë shumë e rëndësishme e Forcave Ajrore të Shqipërisë. Misioni i kësaj force, teknika e ardhur dhe ajo që pritet të vijë nga ushtritë mike e aleate si dhe kualifikimi bashkëkohor i personelit të tij bën që planet e zhvillimit të parashikojnë modernizimin e mëtejshëm, në mënyrë të tillë që nivelet operacionale të saj të rriten vazhdimisht.

Në përpjekjet e vazhdueshme që bëhen në Forcat Ajrore të Shqipërisë për kualifikimin e tyre të mëtejshëm, krahas arsimimit dhe kualifikimeve në shkollat aktuale ushtarake të vendin tonë e po kështu edhe të atyre perëndimore, bëhen përpjekje të lavdërueshme për të përvetësuar edhe nga përvoja e trashëguar nga profesionistët dhe historia e reparteve të dikurshme të Aviacionit Luftarak Shqiptar.

Aviacioni është një armë krenare, moderne e bashkëkohore, por e vështirë dhe e rrezikshme. Kjo armë kërkon që njerëzit që punojnë aty jenë të emancipuar e të përgatitur shumë mirë profesionalisht,

të kenë pasion e përkushtim të veçantë dhe këta njerëz Shqipëria i ka; aviacionit i duhen njerëz me eksperiencë shumë të vyer të personelit, pilotë, teknikë dhe reparte mbështetëse, dhe Shqipëria i ka; aviacioni është një armë që kushton shtrenjtë, dhe aviacioni ka mbështetjen e Qeverisë Shqiptare, të Ministrisë së Mbrojtjes, të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, por edhe të ushtrive partnere e aleate të NATO-s.

Historia e aviacionit në mbarë botën është një histori e guximtarëve, e pionierëve të ecjes përpara, e ëndrrave të njeriut për sfidat e mëdha të zhvillimeve e transformimeve epokale. Edhe aviacionit tonë nuk i kanë munguar as heronjtë që i përcillnin këto ndryshime. Aviacioni i vendit tonë është arma e vështirë dhe e lavdishme, është simboli i gatishmërisë më të lartë për t’i shërbyer vendit, emblema e përkushtimit për detyrën e profesionin.

Aviatorët, ashtu si njerëzit e profesioneve me rrezik të lartë në përgjithësi, janë pionierët e zbulimeve njerëzore e të ndryshimeve teknologjike, janë përfaqësuesit e thjeshtë që realizojnë të pamundurën, atë që mbase duam të bëjmë të gjithë, e që nuk e bëjmë dot për njëmijë arsye, janë pjesë e asaj shtrese të shoqërisë që simbolizon kurajën dhe luftën për ëndrra të mëdha.

Brezat paraardhës të Aviacionit Luftarak, me ndjenjën më të lartë të përgjegjësisë në zbatimin e detyrave, me eksperiencën e madhe e të çmuar që kanë lënë pas për brezat e ardhshëm, me krenarinë që i kanë dhënë aviacionit e Forcave të Armatosura, janë pa diskutim një vlerë e madhe kombëtare.

Aviacioni ynë Luftarak ishte një armë, një shërbim, një institucion i organizuar më së miri, teknika që ai pati në përdorim në ato vite ishte nga më prestigjiozet për kohën, e mirë dhe e krahasueshme si e mjaft shteteve rreth e rrotull vendit tonë. Njerëzit që e drejtuan e menaxhuan atë, u treguan të aftë për ta administruar, për ta vënë në përdorim në mënyrë shkencore, megjithëse ishte një teknikë e shkence bashkëkohore, gjë që edhe sot i bën ata të ndihen krenarë për detyrat e realizuara. Pilotët e teknikët që i shfrytëzuan në vite avionët e helikopterët e Shtetit Shqiptar, me eksperiencën e madhe e të çmuar që kanë lënë pas, mbeten një vlerë kombëtare për ndjenjën e lartë të përgjegjësisë në zbatimin e detyrave të caktuara.

Forcat Ajrore të Aviacionit janë simbol i bashkëpunimit me ushtritë aleate, prej të cilit ka arritur rezultate konkrete transformuese. Ky bashkëpunim, i bazuar në Strategjinë e Sigurimit Kombëtar, i jep përparësi marrëdhënies me partnerët strategjikë, të cilët kanë kryer investime të rëndësishme, kanë trajnuar ushtarakët tanë, kanë kryer investime serioze, apo kanë ndihmuar në realizimin e stërvitjet e përbashkëta, ku ky bashkëpunim ka pasur efekte reale.

Stema e Forcave Ajrore paraqet në mënyrë skematike mburojën mbrojtëse të luftëtarit, në fushën blu brenda së cilës, në një rrip të bardhë janë paraqitur tre avionë luftarakë supersonikë. Fusha blu e stemës sonë simbolizon qiellin, rruga e bardhë ku janë vendosur avionët simbolizon paqen, ndërsa vendosja në këtë fushë e tre avionëve luftarakë supersonikë, zhvillimet në të ardhmen e Forcave Ajrore.

Në historinë e njerëzimit ka ndodhur ajo që, atje ku ka ngulur flamurin ushtria, aty një komb ka pasur syrin e shpirtin, atje një shtet ka pasur kufirin dhe kjo, me sa duket, nga fakti se ushtria dhe ushtarakët janë një pjesë përfaqësuese dhe emblematiske e tyre, ndërsa flamuri simbolika e të gjitha politikave e interesave. Aviacioni është ai që e ngre në qiell flamurin e Shqipërisë.



Muzeu i FA-së, dëshmi historike dhe atraksion

turistik me vlerë kombëtare

Muzeu i Forcave të Armatosura (MFA) është muze tipologjik dhe pasqyron ngjarjet më të rëndësishme ushtarake dhe vlerat më të mira të trashëguara nga kombi ynë gjatë historisë së tij në shekuj. Në esencë ai shpreh identitetin, kujtesën dhe progres-zhvillimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Misioni i Muzeut të FA është: “Evidentimi, grumbullimi, seleksionimi dhe vënia në përdorim, për grupet e interesuara, të vlerave edukative të trashëgimisë ushtarake të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Objektet që janë ekspozuar në pavijonet e muzeut janë kryesisht: armatime, teknikë e pajisje, dokumente, simbole e objekte të tjera. Ky muze është një dëshmi e historisë së ushtrisë shqiptare dhe ndahet në 5 pavijone të veçanta në një hapësirë prej 100 mijë metër katrorë.

Në hapësirën e tij të gjerë, ai prezanton mbi 1 100 objekte të ndryshme, duke përfshirë mjete ushtarake, armë, uniforma dhe artefakte të tjera të përdorura nga Forcat e Armatosura Shqiptare





nëpër periudha të ndryshme historike.

Pjesa më e spikatur e muzeut është pjesa e jashtme, ku janë ekspozuar artileria e rëndë, mjetet e blinduara, flota ajrore dhe detare, të cilat tani janë relikte historike. Këto objekte tregojnë historinë e forcave ushtarake të Shqipërisë, duke përfshirë periudhën e komunizmit, kur Shqipëria ishte nën influencën e Bashkimit Sovjetik dhe më pas të Kinës.

Në muzeun e Bërzhitës, vizitorët mund të shohin objekte të ndryshme të përdorura gjatë periudhës së diktaturës komuniste, duke përfshirë tanket T-34, avionët "MiG" dhe helikopterët e ndryshëm. Gjithashtu, ekspozita përfshin edhe armë dhe mjete të përdorura gjatë Luftës së Dytë Botërore, duke treguar rolin e Shqipërisë në këtë konflikt global.

Një pavijon i veçantë i është kushtuar armatimeve antike dhe periudhës së rilindjes kombëtare, duke përfshirë kohën e Skënderbeut dhe periudhën e mbretërisë së Ahmet Zogut. Këtu janë ekspozuar objekte të tilla si topuzë, kobure dhe pushkë të përdorura gjatë luftërave të ndryshme në historinë e Shqipërisë.

Gjithashtu, muzeu përmban një pavijon të veçantë për forcën e armatosur të Shqipërisë si anëtare e NATO-s, duke prezantuar uniformat dhe pajisjet e përdorura nga ushtria në kohën e sotme. Ndërtimi i Muzeut të Forcave të Armatosura nisi në vitin 2019 dhe u përfundua në dhjetor 2023. Vendosja e tij në një ambient të bukur natyror në Bërzhitë e bën atë tërheqës për vizitorët që



dëshirojnë të njihen më mirë me historinë dhe evoluimin e forcave ushtarake në Shqipëri. Ky muze është një dëshmi e përkushtimit të vendit ndaj ruajtjes dhe prezantimit të trashëgimisë së tij historike në fushën e ushtrisë.

Tashmë i kthyer në një atraksion turistik për të huaj dhe vendas, muzeu numëron një numër të madh vizitorësh.

Ditët e fundit të muajit prill ai u vizitua edhe nga Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë, të cilët ishin të interesuar mbi gjithçka, për t'i dhënë sytë e shpirtit historisë së Forcave të Armatosura.

Pjesë e vizitorëve 'të veçantë' ishin dhe Ambasadori i Austrisë Dr. Christian Steiner, i shoqëruar nga zoti Stefan Krause, drejtor në "Kunst Historische Museum Wien", si dhe sekretari i parë i Ambasadës së Austrisë, zoti Martin Schaller, zhvilluan një vizitë në Muzeun e Ri Forcave të Armatosura.

111 vite histori suksesi, përkushtimi deri në vetëmohim të Forcave të Armatosura, vijnë në këtë muze për të gjithë ata që duan të njohin historinë e kombit shqiptar të vërtetë dhe pa ngjyrimë, të vlerë dhe të denjë si vetë trojet e tij.

Muzeu qëndron çdo ditë i hapur nga e hëna në të diel, për të gjithë admiruesit e rrugëtimit historik të Forcave të Armatosura.





Dje dhe sot, 80 vjet tinguj që frymëzuan shpirtin luftarak të kombit shqiptar

Në Priskë të Tiranës, më 18 tetor 1944, krijohet Banda Frymore e Ushtrisë Nacionalçlirimtare, tingujt që frymëzuan dhe mbajtën gjallë shpirtin luftarak të Kombit.

Orkestra Frymore e Forcave të Armatosura, formacioni muzikor i vlerësuar me titullin e lartë “Kalorës i Urdhrit të Flamurit” në vitin 2020, është trupë artistike profesioniste e “radhëve të blerta” të FA-ve shqiptare, e përbërë nga kontingjente të përzgjedhura muzikantësh, konform standardeve të kërkuara. Ky formacion muzikor, u krijua me urdhër të Shtabit të Korparmatës së Parë të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, në të cilën u grumbulluan një grup i madh muzikantësh partizanë, të cilët formuan orkestrën frymore të këtij formacioni të madh partizan. Pas Çlirimit, kjo orkestrë u plotësua me të gjithë elementet e nevojshme të një bande muzikore moderne dhe e tillë vazhdon të jetë edhe sot.

Në fillim ajo u quajt Orkestra Frymore e Ushtrisë Kombëtare dhe më vonë Orkestra frymore e Ushtrisë Popullore. Sot, quhet “Orkestra Simfonike e Forcave të Armatosura” (OSFA). Që nga krijimi i saj e deri më sot, ajo ka një histori shumë të pasur aktivitetesh të rëndësishme që përbëjnë edhe pjesën

më të qenësishme të krenarisë së saj legjitime. Aktivitetet artistike të realizuara prej saj janë shtuar, veçanërisht pas anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, pjesë e së cilës janë edhe Forcat e Armatosura Shqiptare, pas vitit 2008.

Zanafilla e këtij formacioni kompleks muzikor, në fakt qëndron në vetë shpirtin luftarak të Kombit shqiptar, në historinë e tij të luftërave shekullore kundër pushtuesit të huaj. Ritualet e kahershme kur binin trimat në luftë, apo kur ata varroseshin me të gjitha nderet që iu takonin, më pas shoqëroheshin nga këngët e trimërisë, që brenda tyre kishin tinguj që të bëjnë të ndjehesh krenar. Dhe kjo krenari pastaj përcillej nga brezi në brez.

Kështu, një moment i rëndësishëm që evidenton qëllimin dhe misionin e madh që ka pasur Orkestra Frymore e Forcave të Armatosura në historinë pararendëse të saj, ka qenë viti 1920, dhe pikërisht Lufta e Vlorës. Referuar Historisë së Shqipërisë, nuk ke se si të mos ndjehesh krenar, kur nëpër rreshta lexon se si 120 vullnetarë shqiptaro-amerikanë, të mbledhur dhe të përgatitur nga federata “Vatra” në SHBA, erdhën në Shqipëri për të dhënë ndihmën e tyre për çështjen kombëtare shqiptare, duke lënë Amerikën për të ndihmuar Atdheun edhe përmes muzikës e koncerteve të saj, që u shtrinë nga Shkodra në Gjirokastrë, nga



Elbasani në Korçë, për të dalë në Drashovicë, ku ishte nderur Lufta e Vlorës.

Me këngët e saj, Banda Muzikore “Vatra” mbajti lart moralin e forcave që luftonin furishëm në Tepelenë, Drashovicë dhe kudo përreth qytetit të Vlorës. Kjo luftë e pashembullt, ku luftonte një popull i vogël dhe i paarmatosur me një fuqi të madhe, kishte marrë përmasat e një beteje epike. Dhe po epike u bë edhe kënga “Vlora-Vlora”, simboli i kësaj lufte: “Vlora, Vlora, Vlora, Vlora,/



Rroki armët, bëja fora!/ Vlora, Vlora, Vlora, Vlora,/ Bjeri më të lumtë dora!”. Dhe siç dihet, kjo këngë simbol, e kënduar nga Banda “Vatra” shoqëroi Komitetin “Mbrojtja Kombëtare” dhe luftëtarët popullorë, më 3 shtator 1920, në manifestimet e fitores së Luftës së Vlorës.

Edhe sot, pas shumë vitesh, shqiptarët nderojnë Bandën Kombëtare “Vatra”, si dhe Orkestrën Frymore të Forcave të Armatosura, të cilat mbartin simbolikën e shtetit shqiptar dhe të institucioneve të lidhura ngushtësisht me të.

Këto dy banda janë e djeshmja dhe e sotmja e një tradite të bukur muzikore shqiptaro-amerikane. Kjo traditë e ka zanafillën në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me krijimin e Bandës Kombëtare “Vatra” nga Thoma Nasi, trashëgimia e të cilës vijon sot, pas 100 vitesh, me Orkestrën Frymore të Forcave të Armatosura.

Sot në vitin 2024, pas më shumë se një shekull aktivitet i pandërprerë, por tani me djem dhe vajza nën uniformën e gjelbër, marshet partizane, dhe jo vetëm, të performuara nga OSFA, po ngrenë në këmbë publikun brenda dhe jashtë Shqipërisë. Së fundmi me rastin e 75-vjetorit të krijimit të NATO-s, 15-vjetorit të futjes së shtetit Shqiptar në këtë aleancë shumëkombëshe, OSFA performoi me dinjitet në mbrëmjet gala të organizuara në Tiranë, Bruksel dhe Poloni.



Çfarë ndodh me civilët në luftë?!

Eksperiencia njerëzore e luftës ka qenë gjithmonë më e thellë se ajo e përjetuar nga personat që luftojnë me forcat e armatosura. Lufta sot, është një katastrofë sociale, ekonomike dhe kulturore e qindra e miliona njerëzve, të cilët nuk kanë dëgjuar apo parë një betejë. Por njerëzit janë të shquar edhe në luftë. Ata kryesisht bëjnë atë që bëjnë gjithmonë qeniet njerëzore duke mbijetuar, vepruar dhe përshtatur, pasi energjia dhe liria e njerëzve ridrejtohen për të përballuar, për t'u kujdesur dhe për t'i rezistuar çnjerëzimit të luftës. Ne përballemi me dy nën-fusha të përvojës së civilëve në luftë:



Vuajtja civile

Sa dimë realisht për vuajtjet e civilëve në luftërat e deritanishme të këtij shekulli? Përgjigja është e përzier, sepse vështirësitë e të dhënave ende nënkuptojnë mungesën e informacionit të qëndrueshëm në të gjithë botën dhe publiciteti humanitar ndonjëherë keqinterpreton vuajtjet e civilëve, duke u fokusuar në grupe të veçanta dhe duke dhënë përshtypjen se lufta po mbulon të gjitha zonat e një vendi, kur në fakt nuk është ashtu.

Vdekjet e civilëve

Një gjë që ne dimë është se numri i civilëve që vriten dhunshëm në "vdekje në betejë" është jashtëzakonisht i ulët në krahasim me shekullin e kaluar.

E njëjta gjë është e vërtetë për vdekjet e civilëve nga uria, sëmundjet, varfërimi ose trajtimi çnjerëzor, të cilat statisticienët i quajnë "vdekje indirekte" nga lufta. Lloji i luftërave të vogla ushtarakisht, që janë zhvilluar deri më tani dhe investimet e reja të mëdha në përgjigjen humanitare janë dy arsye për këtë.

"Vdekje luftarake" të dhunshme

Përpjekjet për të numëruar me saktësi vdekjet e dhunshme

civile në luftë është një shkencë e re dhe në zhvillim, e njohur si numërimi i viktimave, e cila është duke u nisur nga organizata si "Every Casualty Counts" dhe ACLED.

Numërimi i viktimave po prodhon të dhëna të rëndësishme për të gjitha format e konfliktit të dhunshëm. Projekti "Cost of War" i Universitetit "Brown" ka bërë një studim të veçantë të viktimave luftarake dhe civile në luftërat në SHBA që nga fillimi i viteve 2000 dhe ka të dhëna për Afganistanin, Irakun, Sirinë dhe Jemenin.

Shifrat e Universitetit "Brown" tregojnë dy tendenca të rëndësishme. Së pari, se në të gjitha luftërat, përveç Irakut, vdekjet e betejave luftarake janë shumë më të larta se vdekjet e betejave civile. Së dyti, vdekjet e civilëve në luftërat e shekullit të 21-të janë të ulëta në krahasim me viktimat e shekullit të 20-të.

Këto nuk janë tregime që zakonisht dëgjojmë nga agjencitë humanitare, organizatat e të drejtave të njeriut apo mediat kur diskutojmë për këto luftëra. Në vend të kësaj, ata priren të theksojnë vdekjet e betejave civile dhe të japin një përshtypje të tyre si shumë të larta.

Vdekjet indirekte

Uria dhe sëmundjet kanë qenë historikisht shkaku kryesor i vdekjeve indirekte të civilëve në luftë.

Në shekullin e 20-të, uria dhe epidemitë shkatërruese të kohës së luftës ishin tragjikisht të zakonshme. Në të kundërt, në shekullin tonë deri më tani, ka pasur një uri të madhe të kohës së luftës vetëm në Somali në vitin 2011. Kjo zi e tmerrshme ndoshta vrau 244,000 njerëz.

Duke shqyrtuar të dhënat nga disa luftëra të fundit, profesori Paul



Wise vlerëson se vdekjet indirekte janë zakonisht dyfishi i vdekjeve të dhunshme të drejtpërdrejta për shkak të “shkatërrimit të gjërave thelbësore”, si mjetet e jetesës, kujdesi shëndetësor, ushqimi dhe strehimi i shkaktuar nga lufta. Kjo ilustron gjithashtu nga një studim i udhëhequr nga profesori Francesco Checchi në Sudanin e Jugut, një nga luftërat më të këqija të gjata të këtij shekulli, i cili vlerëson se midis dhjetorit 2013 dhe prillit 2018 rreth 383 000 njerëz vdiqën për shkak të luftës, duke përfshirë 190 000 njerëz që u vranë dhunshëm.

Raporti Vdekje-Zhvendosje

Lufta për shumicën e civilëve sot përjetohet si një fatkeqësi socio-ekonomike. Tipari më themelor i përvojës civile në luftërat e shekullit të 21-të është zhvendosja dhe varfërimi.

Fakti që zhvendosja dhe jo vdekja e dhunshme është përvoja kryesore e shumicës së njerëzve të prekur nga lufta sot, mund të shihet në raportin vdekje-zhvendosje.

Kjo krahason numrin e vdekjeve të dhunshme në një konflikt me numrin e zhvendosjeve të shkaktuara nga konflikti, kur njerëzit ikin për të shmangur vdekjen e dhunshme ose për të braktisur zonat e bëra të pajetueshme nga rreziku dhe “shkatërrimi i gjërave thelbësore”.

Në konfliktin midis forcave qeveritare dhe Boko Haram në Nigerinë verilindore, për shembull, ky raport qëndron në 1:160. Në Jemen është 1:333 dhe në Mozambik është 1:265.

Përvoja Civile dhe Gjinore

Gratë dhe burrat, djemtë dhe vajzat e përjetojnë ndikimin e luftës në mënyra sa të ndryshme aq edhe të njëjta. Ata janë të gjithë të cenueshëm ndaj bombardimeve dhe bastisjeve, ndaj zhvendosjeve të detyruara, varfërimit, të pastrehëve, urisë dhe sëmundjeve. Por ata gjithashtu durojnë dhimbje, dhunë, ngarkesa dhe përgjegjësi të ndryshme në luftë për shkak të rolit që luan gjinia e tyre në shoqërinë e kohës së luftës rreth tyre.

Në mënyrë tipike, për shembull, gratë përballen me rreziqe më të mëdha të dhunës seksuale, përgjegjësi të prindërimit të vetëm, martesës së detyruar dhe vdekjes gjatë lindjes nga sistemet e dobësuar shëndetësore, ndërsa burrat përballen me rreziqe më të mëdha të rekrutimit të detyruar ushtarak, ndalimit, ekzekutimit të përmbledhur dhe migrimit.

Një pjesë më e madhe e vëmendjes humanitare dhe të të drejtave të njeriut në luftërat e fundit është përqendruar te “gratë dhe vajzat” përvoja e të cilave nga lufta vlerësohet të jetë më e keqe se ajo e burrave.

Megjithatë, disa studiues feministë të luftës, si Charli Carpenter, po e ngjyrosin këtë përqendrim më të madh në vuajtjet e grave dhe vajzave për dy arsye: Kjo pikëpamje tenton të anashkalojë përvojën e burrave, duke i bërë ata civilë të harruar, që shpesh mbeten të padukshëm për agjencitë humanitare dhe të marginalizuar në programet e ndihmës.

Një përqendrim humanitar dhe diplomatik mbi vuajtjet e grave luan një stereotip të dëmshëm të grave si viktimat të dobëta, kur, në fakt, ato shpesh janë agjente të fuqishme të mbijetesës së tyre dhe lojtarë kyç në rimëkëmbjen e komuniteteve të tyre.

Civilët si të mbijetuar

Narrativat ndërkombëtare humanitare dhe të të drejtave të njeriut, me theksin e tyre në viktimizimin dhe mbledhjen e fondeve, ende priren të vlerësojnë agjencinë e organizatave të ndihmës dhe vetëm pjesërisht aludojnë në agjencinë e vetë civilëve si aktorët

kryesorë në mbrojtjen, mbijetesën dhe rimëkëmbjen e tyre.

Në realitet, agjencitë e ndihmës ndihmojnë vetëm disa nga njerëzit, disa herë në disa mënyra. Pjesa më e madhe e zgjuarsisë, energjisë, punës dhe kapitalit social në mbijetesën e njerëzve vjen nga vetë civilët. Civilët ndërmarrin veprime të jashtëzakonshme dhe të përditshme për të mbijetuar në luftë.

Veprimi i jashtëzakonshëm përfshin veprimin që ndryshon jetën për të ikur, rezistuar ose ndërtuar diçka të re. Veprimet e përditshme janë më pak ekstreme, por po aq thelbësore për mbijetesën. Ato përfshijnë veprime të vogla por strategjike që përsëriten pafundësisht përmes një lufte, si: aktet e mirësisë; shmangia e njerëzve dhe vendeve kërcënuese; përmbysja e sistemeve të padrejta; duke pretenduar besnikëri dhe respekt; akomodimi dhe negociimi me pushtetin, dhe radhitja fizike ose dixhitale për të qenë në listat e shpërndarjes së ndihmës.

Qëndrimet civile ndaj luftës

Civilët jo thjesht vuajnë, mbijetojnë dhe rezistojnë në dhunën e luftës. Qëndrimet e tyre gjatë luftës informojnë dhe formësojnë



luftën rreth tyre. Civilët nuk janë të gjithë aktivistë të zjarrtë të paqes ose politikisht neutralë. Popullatat civile zakonisht paraqesin një sërë qëndrimesh të ndryshme për luftën rreth tyre dhe për atë që ata e konsiderojnë përdorimin e drejtë të forcës në kryerjen e armiqësive. Hulumtimi nga profesor Benjamin Valentino tregon se sa më shumë civilët të ndihen të kërcënuar, aq më shumë pikëpamjet e tyre zakonisht ndryshojnë për t'u bërë më pranues të niveleve ekstreme të forcës kundër forcave armike dhe civilëve armiq. Nuk është e qartë se qëndrimet aktuale ndaj kufizimit ushtarak do të qëndrojnë nëse aksionet politike dhe ekzistenciale rriten në mbarë botën.

Qëndrimet civile shpesh e bëjnë popullsinë civile audiencë të rëndësishme dhe me ndikim për politikanët, forcat e armatosura dhe grupet e armatosura, komunikimet e të cilëve synojnë në mënyrë specifike qëndrimet civile në mënyra të ndryshme, ose për t'i fituar ata ose për t'i terrorizuar ata në një luftë të vazhdueshme mbi opinionin dhe moralin civil.

Instituti i Oksfordit për Etikën, Ligjin dhe Konfliktet e Armatosura

Inteligjenca artificiale kineze dhe ruse mund të fillojë Luftën e Tretë Botërore

Rusia dhe Kina duhet të sigurojnë që vetëm njerëzve, dhe asnjëherë inteligjencës artificiale, t'u jepet kontrolli i armëve bërthamore për të shmangur një skenar të mundshëm të fundit të botës, ka deklaruar një zyrtar i lartë amerikan. Uashingtoni, Londra dhe Parisi të gjithë kanë rënë dakord të mbajnë kontrollin e plotë njerëzor mbi armët bërthamore, tha zyrtari i kontrollit të armëve të Departamentit të Shtetit, Paul Dean, si një dështim për të parandaluar çdo defekt teknologjik nga zhytja e njerëzimit në një konflikt shkatërrues.

Ajo vjen pasi rregullatorët paralajmëruan se AI-ja po përballet me "momentin e saj të Openheimer" dhe po u bëjnë thirrje qeverive të zhvillojnë legjislacionin që kufizon zbatimin e tij në teknologjinë ushtarake përpara se të jetë tepër vonë. Deklarata alarmante, duke iu referuar J. Robert Oppenheimer, i cili ndihmoi në shpikjen e bombës atomike në 1945, përpara se të avokonte për kontrollin mbi përhapjen e armëve bërthamore, u bë në një konferencë në Vjenë, ku zyrtarë civilë, ushtarakë dhe teknologjikë nga më shumë se



Raketa balistike ndërkontinentale "Hwasong-18" është lëshuar nga një vend i pazbuluar në Korenë e Veriut



Uashingtoni, Londra dhe Parisi kanë rënë dakord të mbajnë kontrollin e plotë njerëzor mbi armët bërthamore, tha zyrtari i kontrollit të armëve të Departamentit të Shtetit, Paul Dean, duke i kërkuar Rusisë dhe Kinës që të ndjekin shembullin. (Lançimi i raketës balistike ndërkontinentale "Sarmat" në foto)

100 vende, u takuan për të diskutuar perspektivën e sistemeve të militarizuara të AI-së.

Megjithëse integrimi i AI-së në pajisjet ushtarake po rritet me shpejtësi, teknologjia është ende në fazat e saj fillestare. Por ende, nuk ka asnjë traktat ndërkombëtar që ekziston për të ndaluar ose kufizuar zhvillimin e sistemeve vdekjeprurëse të armëve autonome (LAWS).

"Ky është momenti Oppenheimer i brezit tonë", - tha ministri i Jashtëm austriak Alexander Schallenberg. "Tani është koha për të rënë dakord për rregullat dhe normat ndërkombëtare".

Gjatë fjalëve të tij hyrëse në Konferencën e Vjenës mbi Sistemet Autonome të Armëve, Schallenberg e përshkroi AI-në si përparimin më domethënës në luftë që nga shpikja e barutit mbi një mijëvjeçarë më parë. Dallimi i vetëm ishte se AI-ja është edhe më e rrezikshme, vazhdoi ai.

"Të paktën le të sigurohemi që vendimi më i thellë dhe më i gjerë

– kush jeton dhe kush vdes – të mbetet në duart e njerëzve dhe jo të makinerive”, - tha Schallenberg.

Ministri austriak argumentoi se bota duhet të “sigurojë kontrollin njerëzor”, me tendencën shqetësuese të softuerit ushtarak të AI-së që zëvendëson qeniet njerëzore në procesin e vendimmarrjes.

“Bota po i afrohet një pike kthese për të vepruar mbi shqetësimet mbi sistemet autonome të armëve dhe mbështetja për negociatat po arrin nivele të paprecedentë”, - tha Steve Goose, drejtor i fushatave të armëve në Human Rights Watch.

“Miratimi i një traktati të fortë ndërkombëtar mbi sistemet autonome të armëve nuk mund të ishte më i nevojshëm apo urgjent”. Tashmë ka shembuj të AI-së, që përdoret në një kontekst ushtarak me efekt vdekjeprurës.

Në fillim të këtij viti, një raport nga revista “+972” citoi gjashtë oficerë të inteligjencës izraelite, të cilët pranuan se përdornin një sistem AI-je të quajtur “Lavender” për të klasifikuar deri në 37 000 palestinezë si militantë të dyshuar, duke i shënuar këta njerëz dhe shtëpitë e tyre si objektiva të pranueshëm për sulmet ajrore.

Sipas raportit, “Lavender” u trajnuar mbi të dhënat nga vëzhgimi dhjetëvjeçar i inteligjencës izraelite të popullatave palestineze, duke përdorur gjurmët dixhitale të militantëve të njohur si një model për atë se çfarë sinjali duhet kërkuar në zhurmë.

Ndërkohë, Ukraina po zhvillon dronë me aftësi të inteligjencës artificiale që mund të kyçen në objektivat ruse nga më larg dhe të jenë më elastike ndaj kundërmasave elektronike në përpjekjet për të rritur aftësitë e saj ushtarake ndërsa lufta vazhdon.

Zëvendësministrja e Mbrojtjes Kateryna Chernohorenko tha se Kiev po zhvillon një sistem të ri që mund të dallojë, gjuajë dhe godasë në mënyrë autonome objektivat e tij nga larg.

Kjo do ta bënte më të vështirë rrëzimin ose bllokimin e dronëve dhe do të reduktonte kërcënimin e sulmeve hakmarrëse ndaj pilotëve të dronëve.

“Dronët tanë duhet të jenë më efektivë dhe duhet të drejtohen drejt objektivit pa asnjë operator. Duhet të bazohen në navigimin vizual. Ne gjithashtu e quajmë atë ‘shënjestrim i miljes së fundit’, duke hyrë në shtëpi sipas imazhit”, - tha ajo për “The Telegraph”.

Konferenca mbi LIGJET në Vjenë erdhi ndërsa administrata Biden përpiqet të thellojë diskutimet e ndara me Kinën mbi politikën e armëve bërthamore dhe rritjen e inteligjencës artificiale.

Përhapja e teknologjisë së AI-së u shfaq gjatë bisedimeve gjithëpërfshirëse midis Sekretarit të Shtetit të SHBA-ve, Antony Blinken dhe ministrit të Jashtëm të Kinës, Wang Yi në Pekin në fund prilli.

Të dy palët ranë dakord të zhvillojnë bisedimet e tyre të para dypalëshe mbi inteligjencën artificiale në javët e ardhshme, tha Blinken, duke shtuar se ata do të ndajnë pikëpamjet se si të menaxhohen më mirë rreziqet dhe siguria që rrethojnë teknologjinë. Si pjesë e normalizimit të komunikimeve ushtarake, zyrtarët amerikanë dhe kinezë rifilluan diskutimet për armët bërthamore në janar, por negociatat formale për kontrollin e armëve nuk priten së shpejti.

Kina, e cila po zgjeron aftësitë e saj të armëve bërthamore, kërkoi në shkurt që fuqitë më të mëdha bërthamore duhet, së pari të negociojnë një traktat pa përdorim të parë midis njëra-tjetrës.

“

Washingtoni, Londra dhe Parisi të gjithë kanë rënë dakord të mbajnë kontrollin e plotë njerëzor mbi armët bërthamore, tha zyrtari i kontrollit të armëve të Departamentit të Shtetit, Paul Dean, si një dështim për të parandaluar çdo defekt teknologjik nga zhytja e njerëzimit në një konflikt shkatërrues.



Deri më tani, nuk ka asnjë traktat ndërkombëtar që ekziston për të ndaluar ose kufizuar zhvillimin e sistemeve vdekjeprurëse të armëve autonome (LAWS).

NATO, 75 vjet mbrojtje kolektive, Stoltenberg: Ne kemi ndërtuar Aleancën më të fuqishme dhe më të suksesshme në histori dhe gjatë 75 viteve të fundit

PËRSHTATI: MIMOZA GOLIKJA

Që nga krijimi i saj, më 4 prill 1949, Aleanca transatlantike është rritur nga 12 anëtarë themelues në 32 vende anëtarë sot, të gjithë duke punuar së bashku për të mbajtur popullin e tyre të sigurt. Një komunitet aleatësh i lidhur së bashku nga vlerat e përbashkëta të demokracisë, lirisë individuale, të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit, NATO festoi përvjetorin, më 4 prill, në selinë e saj në Bruksel dhe më tej do të vazhdojë në samitin e ardhshëm më 9-11 korrik në Uashington, D.C., ku u nënshkrua traktati themelues i saj.

Në Bruksel, ministrat e Jashtëm u takuan më 3 dhe 4 prill 2024 për të shënuar 75-vjetorin e NATO-s, për diskutimin e çështjeve aktuale dhe për t'u përgatitur për Samitin në Uashington që do të mbahet në korrik të këtij viti.

NATO u themelua mbi një premtim të vetëm, solemn: Një sulm ndaj një aleati është një sulm ndaj të gjithëve. “Nga ai themel, ne kemi ndërtuar Aleancën më të fuqishme dhe më të suksesshme në histori dhe gjatë 75 viteve të fundit, Dera e Hapur e NATO-s ka ndihmuar në përhapjen e demokracisë dhe prosperitetit në të gjithë Evropën”, - tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg përpara takimeve të ministerialit të Jashtëm të NATO-s në Bruksel.

Sekretari i Përgjithshëm përshëndeti përpjekjet e vazhdueshme të aleatëve për të ofruar dërgesa të mëdha të armëve, municioneve dhe pajisjeve në Ukrainë, duke paralajmëruar se çdo vonesë në mbështetje ka pasoja në fushën e betejës. Ai u bëri thirrje aleatëve që të sigurojnë ndihmë për Ukrainën për një kohë të gjatë. “Ndërsa festojmë arritjet e NATO-s, Evropa sot përballet me luftë të një shkalle që ne menduam se i ishte dorëzuar historisë. Ditët e fundit, Kremli ka nisur sulme të reja të mëdha, duke goditur civilët dhe infrastrukturën ukrainase dhe Rusia vazhdon të bëjë presion përgjatë vijës së frontit. Pra, ne duhet të qëndrojmë të vendosur në mbështetjen tonë për Ukrainën”, - tha Stoltenberg. “E mirëpres që aleatët vazhdojnë të bëjnë dërgesa të mëdha të armëve, municioneve dhe pajisjeve, por Ukraina ka nevoja urgjente”, - tha ai, “Çdo vonesë në ofrimin e mbështetjes ka pasoja në fushën e betejës ndërsa flasim. Pra, ne duhet të zhvendosim dinamikën e mbështetjes sonë. Ne duhet të sigurojmë ndihmë të besueshme dhe të parashikueshme të sigurisë për Ukrainën për një kohë të gjatë. Kështu që ne të mbështetemi më pak në kontributet vullnetare dhe më shumë në



angazhimet e NATO-s. Më pak për ofertat afatshkurtra dhe më shumë për zotimet shumëvjeçare”, - theksoi ai.

Ministrat diskutuan se si NATO mund të marrë më shumë përgjegjësi për koordinimin e pajisjeve ushtarake dhe trajnimit për Ukrainën, duke e ankoruar këtë brenda një kuadri të fortë të NATO-s. Ata diskutuan gjithashtu një angazhim financiar shumëvjeçar për të mbështetur mbështetjen aleate dhe ky ministerial krijoi terrenin për arritjen e konsensusit mbi këto çështje ndërsa NATO përgatitet për Samitin e Uashingtonit. Aleatët e NATO-s ofrojnë 99 për qind të të gjithë mbështetjes ushtarake për Ukrainën. Pra, bërja e më shumë nën NATO-n do t'i bënte përpjekjet e Aleancës më efikase dhe më efektive. Moska duhet të kuptojë se ajo nuk mund t'i arrijë qëllimet e saj në fushën e betejës. Ministrat diskutuan gjithashtu sfidat e sigurisë në rajonin jugor të Aleancës, duke përfshirë kërcënimin e qëndrueshëm të terrorizmit.

Në ditën e dytë, më 4 prill, u mbajt një takim i Këshillit NATO-Ukrainë. Ku me ministrin Kuleba, aleatët trajtuan situatën aktuale dhe nevojat e Ukrainës si tani ashtu edhe për të ardhmen. Aleanca po e transformon paketën gjithëpërfshirëse të ndihmës së NATO-s në një program shumëvjeçar ndihme dhe po ndihmon Ukrainën t'i afrohet NATO-s, standardeve të NATO-s për gjithçka, nga prokurimi tek logjistika. NATO po mbështet përpjekjet reformuese të Ukrainës për ta sjellë Ukrainën gjithnjë e më afër Aleancës. “Ukraina do të bëhet anëtare e NATO-s. Është çështje kur, jo nëse”.

Gjithashtu në ditën e dytë, ministrat e NATO-s u takuan me partnerët e tyre në Indo-Paqësor dhe Bashkimin Evropian, ku diskutuan mbi rritjen e bashkëpunimit praktik, si dhe implikimet globale të luftës së Rusisë kundër Ukrainës.

Këshilli NATO-Ukrainë, Aleatët bien dakord të rrisin mbështetjen

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg kryesoi një takim virtual të Këshillit NATO-Ukrainë në nivelin e ministrave të mbrojtjes, për të adresuar nevojën urgjente të Ukrainës për mbrojtje ajrore dhe ndihmë të tjera ushtarake. Presidenti ukrainas Volodymyr Zelenskyy informoi aleatët për situatën në fushën e betejës dhe nevojat urgjente të Ukrainës.

Pas takimit, Stoltenberg tha se aleatët kishin rënë dakord të ofrojnë mbështetje të mëtejshme ushtarake, duke përfshirë më shumë mbrojtje ajrore: “NATO ka përcaktuar aftësitë ekzistuese në të gjithë Aleancën dhe ka sisteme që mund të vihen në dispozicion të Ukrainës”, - tha ai, duke shtuar se ai pret njoftime të reja mbi aftësitë e mbrojtjes ajrore për Ukrainën së shpejti. Ministrat trajtuan gjithashtu nevojën e Ukrainës për më shumë predha artilerie, aftësi të thella sulmi me precizion dhe dronë.

Z. Stoltenberg përshëndeti mbështetjen e fundit shtesë nga aleatët për Ukrainën, duke përfshirë vendimin e Gjermanisë për të dorëzuar një Patriot shtesë në Ukrainë; 4 miliardë euro shtesë në mbështetje ushtarake nga Holanda; Iniciativa e Çekisë për municione; dhe premtime të reja nga Danimarka dhe Norvegjia. Sekretari i Përgjithshëm përshëndeti gjithashtu planet e Dhomës së Përfaqësuesve të SHBA-së, për të caktuar një votim mbi një paketë kritike ndihme për Ukrainën. “Unë besoj që projektligji të kalojë pa vonesa të mëtejshme”, - tha ai. Ai nënvizoi se të



gjithë aleatët duhet “të gërmojnë thellë në inventarët e tyre dhe të përshpejtojnë shpërndarjen e raketave, artilerisë dhe municioneve”.

Stoltenberg nënvizoi se “Ukraina po përdor armët që ne ofrojmë për të shkatërruar aftësitë luftarake ruse. Kjo na bën të gjithëve më të sigurt. Pra, mbështetja për Ukrainën nuk është bamirësi. Është një investim në sigurinë tonë”.

Sekretari i Përgjithshëm merr pjesë në takimin e G7, thekson mbështetjen e NATO-s për Ukrainën

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, nënvizoi rëndësinë e forcimit të mbështetjes për Ukrainën

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, nënvizoi rëndësinë e forcimit të mbështetjes për Ukrainën në takimin e Ministrave të Jashtëm të G7 në Capri, Itali.

“Tani kemi shenja inkurajuese nga Kongresi Amerikan se ata do të votojnë një paketë për Ukrainën në ditët në vijim”, - tha Stoltenberg, duke përshëndetur angazhimin dhe vendosmërinë e aleatëve të NATO-s në mbrojtje të Ukrainës. Në javët e fundit, aleatët kanë rritur mbështetjen, duke përfshirë iniciativën e municionit të udhëhequr nga Çekia; rritja e mbështetjes ushtarake nga Holanda; një paketë e re ndihme nga Danimarka dhe vendimi i Gjermanisë për të dërguar një sistem shtesë Patriot në Ukrainë. “Nëntëdhjetë e nëntë për qind e mbështetjes ushtarake për Ukrainën vjen nga aleatët e NATO-s dhe është me rëndësi jetike që aleatët e NATO-s të mbështesin dhe të rrisin mbështetjen e tyre”, - tha Sekretari i Përgjithshëm. Stoltenberg tha se NATO planifikon të punojë drejt një roli më të madh në koordinimin e ndihmës dhe trajnimin të sigurisë për Ukrainën dhe theksoi rëndësinë e ofrimit të mbështetjes financiare të qëndrueshme dhe të parashikueshme.



Engjëj mbi Bunë



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Nuk më ka munguar kurrë dëshira për të shkruar mbi çdo fenomen që cenon moralin, integritetin, dinjitetin, jetën, por kurrë mbi një tragjedi si ajo që përpiu lumi Bunë.

Thellësisht e tronditur dhe pafundësisht e trishtuar për humbjen e katër jetëve të pafajshme në ujërat e Bunës. Tre engjëj dhe nëna e tyre kanë humbur jetën në mënyrë makabre.

Dyshimet janë se dhuna e bashkëshortit dhe babait të familjes i ka çuar drejt vdekjes.

Fenomeni i tmerrshëm i dhunës ndaj grave që plagos shoqërinë dhe shtetin tonë, duhet të ndalet me çdo kusht dhe me çdo çmim. Lufta ndaj kësaj dhune që merr dhe sakaton jetë grash dhe fëmijësh, duhet të ngrihet në nivelin e emergjencës kombëtare. Duhet të zgjohemi të gjithë si njerëz, si shoqëri e si shtet.

Të çohemi të gjithë kundër këtij fenomeni primitiv, sepse secila jetë është e çmuar dhe nuk mund t'i dorëzohet dhunës së verbër.

Organet ligj zbatuese dhe sistemi i drejtësisë duhet të jenë vigjilentë dhe të pamëshirshëm ndaj çdo sinjali, informacioni, denoncimi apo gjykimi për raste të tilla.

Drita e diellit nuk duhet të jetë privilegj për ata që dritën e jetës ua heqin çdo ditë viktimave të tyre.

Sistemi ynë arsimor, media, politika, të gjithë duhet të bëjnë më shumë për të ruajtur dhe lartësuar dinjitetin e grave, për të mbrojtur fëmijët, jetën, shpresën e së ardhmes.

Asaj nënë, me sa duket nuk i mjaftoi asgjë që dha për fëmijët e saj, iu kërkua shumë më shumë, për të cilën ajo nuk hezitoi. Iu kërkua të ikte, por pa mundur dot ta bënte këtë rrugë e vetme. Fëmijët iu vunë nga pas, pa e ditur nëse rruga e nënës së tyre ishte apo jo rruga e duhur.

Edhe pse nuk mund, dhe nuk duhet, të iknin kaq shpejt dhe

në këtë mënyrë, nuk jemi ne ata që vendosim për një nënë dhe fëmijët e saj, se çfarë mbetet të bësh, kur i ke humbur të gjitha, edhe arsyen, forcën dhe besim për t'u ndeshur dhe për t'ia dalë.

Qëndrimi ende në një të sotme që zgjedh të jetë gjithnjë në anën e kundërt, me gjasë ishte bërë e padurueshme për këtë nënë, e cila pa asnjë shpresë zgjedh të bëjë hapat e fundit me fëmijët e saj, hapa që e çuan në rrugën pa kthim.

Të kapur dorë-përdore u fashitën në natën që po hidhte mantelin e zi mbi qytet, duke humbur sysh. E ashtu në heshtje u hodhën mbi lumë, si mbi të vetmen prehje që ishte gati t'i priste në paqe. Kanë qëndruar disa çaste ashtu të ngjitur, ndoshta, por pa mundur të shkonin rrjedhës së ujit ashtu së bashku të katërt.

I përpiu nata dhe uji i ftohtë i Bunës, për t'i zhytur thellë në heshtjen e një zhurme që bërtet kujshëm dhe... drithëron çdo kraharor nënë, për lot çdo sy përjetimi, thyen çdo zemër e plagos çdo shpirt, që trishtueshëm u përfshi në këtë akt fundi fatal.

Asnjë tragjedi si kjo nuk u ngjit në skenë pa zbritur më parë mbi të sublimiteti i dhimbjes dhe zbritur thellë e ngjeshur fort në ndjenjat tona të gatshme për t'u dhënë.

Ata iu vunë nënës nga pas, sepse për ta kishte vetëm një dashuri, të cilës i besuan, dashuri e cila i lindi, i mëkoi dhe po i rriste, por pa mundur t'i mbante në jetë, në një fat që nuk zgjodhën ata, por ishin ata që e paguan me një çmim të shtrenjtë.

Këta fëmijë, me ikjen, na mësuam se nuk është kufiri i jetës dhe vdekjes, ai që ndan të gjallët në një të tashme, por i urrejtjes dhe dhunës, i mosdashurisë dhe mospranimit. Duke u bërë të huaj, të ftohtë, indiferent, na mësuam se jeta ka gjithnjë e më pak mundësi për të cilat ia vlen të luftosh, por më shumë të zgjedhësh, siç kjo nënë mbeti të pranonte si zgjidhje.

Ndoshta të gjithë vumë dorë në paqen e tyre tokësore, dhe për këtë nuk është vetëm një baba që akuzohet, por vetë jeta që njuh dhe promovon dhunën dhe poshtërsinë, si mënyrën për të komunikuar me botën dhe të dëgjohesh prej saj.

Ndoshta fati i keq i të lindurit në kohë të gabuar, ishte për këtë nënë dhe tre engjëjt e saj, po kaq mizor sa vdekja që pretendon të tregojë kaq mizorisht, se këtë të sotme nuk e ndryshon dot dhe as nuk e shpëton asgjë tjetër, veç dashuria, një dashuri që ata zgjodhën ta pranojnë ndoshta në një botë që është më e përzemërt edhe pse më mizore.

Sot kur pas ka mbetur një re e zezë trishtimi që zymton jetën e çdo ndjeshmërie sociale, ajo që dëgjohej në këtë pësjtjellim



dhimbje dhe faji, është një zë i shurdhër i arsyes që rreket të ngrihet mbi këtë atmosferë trishtimi, për të menduar dhe folur zëshëm, për të reaguar dhe vepruar që të tjerë të mos kenë këtë fund.

Një nënë që merr me vete në varr jo vetëm të vërtetën dhe fëmijët e saj, por duke lënë pas fajin e një nëne mizore, të një 'Medea' tragjike, ishte, është dhe mbetet nënë, e cila si shumë nëna dhe gra të tjera, në pamundësi për t'u ndeshur, për të luftuar ndoshta edhe të vetme, zgjedhin më mirë të ikin.

Kjo nënë që u hodh në krahët e vdekjes me tre fëmijët e saj, mbeti e vetme dhe e pamundur t'i japë jetës një drejtim tjetër dhe fëmijëve të saj një të nesërme ndryshe, ku të kishin ëndrra dhe dashuri që t'u plotësonte dëshirat e tyre.

Ndoshta atyre nuk u kishte mbetur asnjë zgjidhje tjetër veç kësaj që na trishtoi, siç edhe na bën fajtor.

Kur themi që kjo është një ngjarje shumë e rëndë, ndodh dhe një tjetër që të kuptojmë se e keqja nuk ka fund.

Një nënë që vetëvritet, duke marrë me vete edhe tre fëmijët e

saj.... Nuk gjej dot fjalë ta përshkruaj makabritetin dhe nuk gjej dot forcë ta akuzoj nënën, që në vendimin fatal për t'i ikur jetës së saj, mori me vete edhe fëmijët e mitur.

Pas kësaj ngjarjeje do të ziejnë edhe programet televizive. Do të dalin nëpër studio "ekspertë" që do të tregojnë me detaje se si u hodhën gruaja dhe fëmijët nga ura, si u gjet fëmija nga peshkatari, në ç' pozicion ishte fëmija i pajetë etj.. Gazetarët do të intervistojnë xhajat, dajat, hallat, fqinjët, kushërinjtë, ku janë dhe ku s'janë, dhe pas tre ditësh dalldia do të shuhet.

Studiot do të kthehen sërish në arenat e politikës, dhe ne do të mblidhemi sërish në mortin e radhës...

Gra, mos u bëni 'fjalë', por forca dhe kryefjala e çdo dite për jetën dhe fëmijët tuaj!

Mos heshtni, por reagoni ndaj gjithçkaje që prek lumturinë tuaj! Fëmijët i sjellim në jetë dhe për ta duhet të luftojmë, përballë gjithçkaje, por nuk kemi të drejtë, për asnjë arsye, t'i 'dënojmë', duke u prerë rrugëtimin e bukur të jetës.

U prehshi në paqe engjëj të pafajshëm!

“Kufijtë që ndajnë shtetet janë të dëmshëm për shoqëritë njerëzore, janë shkaktarë të luftërave kriminale. Bota pa kufij, është bota e re e një njerëzimi të mendshëm dhe jo barbar”

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Ka gjithmonë një arsye pse lind një konflikt për luftë

Në epoka të ndryshme, luftërat edhe pse jo në formatin e sotëm, “inteligjente”, në vetvete imazhin dhe pasojat i kanë të njëjta, në fund ajo shkak/pasoja, ‘pirgje kufomash’ dhe shkatërrim i gjithçkaje të ndërtuar me mund. Janë bërë luftëra të përgjakshme, të cilat kanë sjell pasoja mjaft të rënda, pasoja psikologjike dhe fizike të cilat nuk kanë qenë të pakta. Njerëzit shpesh mundohen të gjejnë pretekste (akuza ose fakte jo të vërteta) për të nisur një luftë. Njëra prej tyre ishte vrasja e Franc Ferdinandit, e cila u bë shkak për nisjen e parë të luftës botërore. Nga kjo luftë pati shumë vdekje dhe humbje.

Por, përse niset një luftë?

Shpesh ndodh për të përfituar më shumë pasuri ose për të marrë diçka më shumë, sepse njeriu asnjëherë nuk mjaftohet me atë që ka, por kërkon gjithnjë e më shumë, pavarësisht pasojave që mund të ketë kjo.

Lufta... një nga paradokset më të mëdha të shoqërisë njerëzore... Një sëmundje më e tmerrshme se murtaja, që ka lindur me njeriun. Në shërbim të saj, një organizëm gjigant njerëzor e pajisjes për të prodhuar vdekjen... Armatime, fortifikime pa fund, për të vrarë njëri-tjetrin e për t'u mbrojtur nga njëri-tjetri. Një marrëzi e marrë seriozisht që gjithë popujt e botës e kanë kaluar dhe do ta kalojnë atë, sa të jetë jeta.

Më gjeni një shtet në botë, gjatë historisë, por edhe sot, që nuk i është nënshtruar këtij absurd!

Lufta nuk është në gjenet tona. Ajo që është e pashmangshme është zemërimi dhe dhuna njerëzore. Ne të gjithë e përfetojmë në bashkëjetesën tonë sociale se brenda nesh ka zemërim, dhunë, pikëllim dhe trishtim, por edhe gëzim, afrim, dëshirë dhe instinkt për të luajtur. Ndonjëherë është e vështirë për ne ta shohim të dukshmen. Tek njerëzit, rregull moral esencial është të mos bëjmë keq, dhe ne jemi qenie humane që arrijmë të jetojmë në zona urbane të dendura të populluara, ku ka një shoqërueshmëri të respektueshme, ku ndërveprojmë në një mënyrë besimi me të huajt, me kufij shumë të gjerë tolerance dhe bashkëpunimi.

Si është e mundur të ndodhë lufta?

Konfrontimi i armatosur është ajo që e kemi parë me shekuj, e ushqyer nga “instinktivismi”, një ide e fshehtë për ta pranuar luftën. Ka emocione njerëzore dhe më pas kultura është përgjegjëse për stimulimin ose shtypjen e njerës apo tjetrës.

Lufta është shtylla kurrizore e mësimave të historisë, pikturave, romaneve, filmave, serialeve dhe video-lojërave. Është një simbol shumëplanësh i perceptuar si fat, detyrë, zakon, thirrje biologjike, aventurë, absurditet dhe së fundmi si krimi më i keq.

Lufta lind në mendje, prandaj, duke vepruar sikur lufta të mos ishte e pashmangshme, ne mund ta parandalojmë atë.

Të pretendosh se lufta është e pashmangshme do të thotë të mos mbash askënd përgjegjës për shkatërrimin e paqes.

A është lufta fataliteti i jetës njerëzore?

Lufta është një nga fatalitetet e jetës njerëzore, por nuk është shkaktari i vërtetë i saj. Është e vërtetë që lufta lë shumë plagë. Lufta nuk është shkaktari i vërtetë i fatalitetit të jetës së njeriut.



Lufta nis nga lakmia. E keqja e çdo njeriu është lakmia për pasurinë e tjetrit. Lufta nis nga lakmia dhe xhelozia. Por prap natyra e njeriut krijohet nga edukimi i tij. Nëse një fëmijë edukohet keq ose dhunohet në të ardhmen, ky fëmijë do të dhunojë fëmijët e tij siç kanë bërë dhe prindërit e tij me të. Lufta sjell humbje të cilat sjellin urrejtje, hakmarrje, lakmi dhe gjithçka fillon nga e para, duke krijuar kështu luftëra të tjera. Ndoshta në të vërtetë shkaktari i vetëm i fatalitetit të jetës së njeriut është vetë natyra njerëzore.

“Lufta është një akt dhune për të detyruar armikun t’i nënshtrohet vullnetit tonë. Lufta gjithmonë fillon nga një situatë politike dhe shkaktohet vetëm nga një motiv politik. Pra është një akt krejtësisht politik. Lufta është thjesht një vazhdim i politikës me mjete të tjera”, (Carl von Clausewitz).

Në kohët e lashta mësuam si Perandoria Romake, gjermanët në shpërnguljen e popujve dhe fuqitë feudale mesjetare ishin krejt të ndryshme, por gjithmonë luftuan njeriun kundër njeriut. Sistemi i parandalimit me armë bërthamore midis dy blloqeve ushtarake, NATO-s dhe Paktit të Varshavës, të udhëhequr nga dy fuqitë botërore, SHBA dhe Bashkimi Sovjetik, bazohet në “balancën e terrorit”. Rreziku i një lufte ishte bërë i pallogaritshëm për shkak të “armëve totale” (bombave bërthamore dhe hidrogjenit, raketave balistike) dhe shkatërrimit të sigurt. Lufta u zhvendos në gara të kushtueshme dhe kërcënuese ekzistenciale të armëve dhe kërcënime dhe kundërkërcënime të shëndosha strategjiksht.

Pas vitit 1990, u numëruan një numër i madh i luftërave “të reja”, të cilat krijuan probleme etnike dhe sociale, duke përfshirë shkatërrimin e shteteve dhe shoqërive.

Karakteristikat e luftës moderne janë nacionalizimi, masat, mekani-zimi, shpërbërja e kufijve, dominimi i luftës, duke mos lënë anash edhe iniciatorin dhe dirigjuesin e luftës.

Aktualisht ballafaqohemi me luftën mes Ruisë dhe Ukrainës. Arsyja e luftës posedon qëllime të ndryshme me veçanti dirixhuese, të cilat populli nuk mund t’i kuptojë asnjëherë. Propaganda mbizotëruese dhe ajo e zhvillimit të luftës është shumë e komplikuar dhe psikologjikisht perfekt e përgatitur. Duhet të jemi të sigurt se qëllimin e luftës, iniciatorët e saj, atë të mirin dhe atë të keqin, nuk do ta kuptoni asnjëherë. Edhe pse ekzistojnë marrëveshje për paqe dhe rend politik në Evropë dhe botë, luftërat zhvillohen pandërprerë, duke demaskuar çdo marrëveshje paqësore. Këto luftëra zhvillohen në forma të ndryshme dhe me interesa të ndryshme.

Që nga lindja e shteteve dhe shoqërive të ndryshme në botë, është diskutuar për luftën si mjet për arritjen e qëllimeve politike.



Hasan Stafa



Qemal Stafa

Simbole të atdhetarizmit dhe antifashizmit shqiptar



Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

Hasan Stafa, atdhetar dhe ushtarak karriere

Historia e jetës dhe aktiviteti ushtarak e atdhetar i Hasan Stafës e i familjes së tij, të djemve të tij antifashistë, Veliut e Qemalit që falin jetën për lirinë e atdheut, janë simbole monumentale dhe kombëtare. Qemal Stafa u lind në Elbasan, më 10 mars 1920, në një familje patriotike të njohur atdhetare. Hasan Stafa, babai i Qemalit, u shqua si ushtarak trim e atdhetar. Familja e tij vinte nga Zabzuni i Gollobordës. Hasan Ahmet Stafa u lind në vitin 1878, në Elbasan, ku familja kishte vendbanimin e ri. Aty ai mbeti jetim fare i ri, por falë shkollimit të mesëm me rezultate të dukshme dhe me talent të rrallë, me mbështetjen e miqve siguroi një bursë në Akademinë e Stambollit. Në akademi spikati talenti, dhe duke qenë ndër më të

mirët krijoi marrëdhënie të shkëlqyera me shokë e eprorë, që më pas do të bënte karrierë ushtarake, duke zënë miqësi deri me Qemal Ataturkun, si bashkë-student dhe shok i ngushtë me të. Në shenjë respekti ndaj shokut të ngushtë Qemal Ataturkut, ai e pagëzoi djalin e tretë me emrin Qemal. Pas mbarimit të akademisë titullohet oficer dhe merr gradën e 'toherit', ku qeveria turke e dërgon më shërbim në Manastir, Serez, Selanik etj. Veprimtari të gjerë zhvilloi kur shërbente në Manastir, sidomos pas ekspeditës famëkeqe të Durgut Pashës në Shqipëri, duke ndihmuar të gjithë bashkatdhetarët e persekutuar nga pushtuesit turq. Hasan Stafa përkrahu e mori pjesë në lëvizjen e turqve të rinj dhe shumë shpejt do të zhgënjehej, pasi filloi Lufta Ballkanike, ku u gjend në frontin turko-serb me gradën Kapiten. Në një nga betejat ai zihet rob nga serbët dhe qëndron i internuar për gjashtë muaj në Beograd.

Pas shpalljes së pavarësisë nga Ismail Qemali, kthehet në atdhe dhe u vu në shërbim të Qeverisë së Vlorës. Pas dorëheqjes së Ismail Qemalit, ngeli i papunë si ushtarak dhe kthehet në Elbasan, ku çeli një librari. Me përfundimin e Luftës së Parë Botërore, Hasani rikthehet në detyrë ushtarak, në shërbim të shtetit të ri me gradën ushtarake 'major'. Ishte ndër oficerët e parë që u vu në shërbim të qeverisë së zgjedhur nga Kongresi i Lushnjës. Kreu detyra të ndryshme si në Krujë, Tiranë e Elbasan. Revolucionin e Qershorit i vitit 1924, që solli në krye Fan Nolin, e emëruan në detyrën e drejtorit

të Zyrës së Rekrutimit në Shkodër, ku ishte vendosur familjarisht me banim. Në punë Hasanin e çmonin si njeri të ditur e të shkolluar për kohën. Ai u dallua si ushtarak i zgjuar dhe i matur në veprime e gjykime. I zhgënjyer nga rrjedhat politike të kohës, i larguar në moshë të re nga Forcat e Armatosura, regjimi i monarkisë, e la ushtarakun e njohur të karrierës që t'i kalonte vitet e jetës në pension para kohe. Hasan Stafa ishte njeri i ushqyer me idetë e Rilindjes, veçanërisht me veprat e Sami Frashërit, duke i ruajtur me kujdes në bibliotekën e shtëpisë. Ai njihnte mirë iluministët frëng e në radhë të parë Rusoin. Lexonte rrjedhshëm në turqisht e frëngjisht. Ishte njeri me kulturë dhe i shëtitor, për kohën e tij, çmohej si burrë me logjikë. Nga natyra ishte gjakftohtë e vinte i butë, megjithëse, kur e donte rasti dinte të tregojë i guximshëm. Ai ishte i thjeshtë, i sjellshëm e i afruar me njerëzit, dinte të bisedonte shtruar me cilindo. Të preferuarit e tij ishin zanatçinjtë dhe nëpunësit e vegjël, shembull që më pas do ta ndiqte më vonë dhe i biri, Qemali. Në korrik të vitit 1935 ndahet nga jeta, duke u lënë fëmijëve të tij, nder dhe emër të mirë. Rrugën e tij luftarake e vazhduan djemtë dhe familja e tij.

Qemali në rrugën atdhetare të babait

Në gjurmë të babait, Qemali, e nisi aktivitetin e tij revolucionar që kur ishte fare i ri, në bankat e shkollës, në gjimnazet në Shkodër e në Tiranë. Nxënës në gjimnazin e shtetit të Shkodrës, Qemali ishte një revolucionar kundër regjimit të Monarkisë. Qemali u lidh me masën e varfër të punëtorëve, me zanatçinjtë e të rinjtë si Vasil Shanto, Jordan Misja, Vojo Kushi etj. U aktivizua i ri në një nga celulatat e qytetit, mori pjesë në lëvizjen revolucionare të rinisë, u bë një nga drejtuesit e shoqërisë jashtë shkollore, "Besa Shqiptare", e cila u bë qendër e edukimit të të rinjve të gjimnazit me idetë revolucionare të kohës. Në numrin e parë të revistës së kësaj shoqërie, Qemali shkroi kryeartikullin me titull "Qëllimi ynë", që ishte një thirrje për luftë kundër regjimit shtypës. Kjo thirrje nuk doli në dritë, sepse nuk u lejua të botohej revista. Në gjimnaz në vitin 1935, në moshën 15 vjeçare, ai bëri hartimin me titull "E vjetra shembet, kohët po ndryshojnë, një jetë e re po lulëzon gërmadhash", ku për herë të parë hedh në letër mendimin e tij mbi nevojën e shembjes së rendit borgjez dhe të vendosjes së një rendi të ri.

Në vitin 1936, familja e Qemalit vendoset në Tiranë, ku ndoqi mësimet në gjimnazin shtetëror të Tiranës, si dhe vazhdoi veprimtarinë revolucionare, u lidh me të rinjtë e varfër, nxënës të gjimnazit dhe forcoi lidhjet me të rinj punëtorë, si topografë, marangozë, furrtarë, etj. Ai luftoi për të demokratizuar shoqërinë "Fryma e re" dhe organin e saj me të njëjtin emër, që grumbullonte nxënësit e gjimnazit. Në këtë kohë bashkëpunon me rrethet përparimtare të intelektualëve e punëtorëve e zhvillon një aktivitet të ndjeshëm në fushën letrare, duke botuar në revista e në të përkohshme të atëhershme shkrime, të cilat ishin një akuzë e rëndë për regjimin e Zogut. Shkrime si "Qortimet e vjeshtës" të botuar në revistën përparimtare "Bota e re" e Korçës, paraqisnin mjerimin dhe varfërinë e shtresave të ulëta të popullit dhe dëshirën e flaktë të tij për çlirimin dhe shpëtimin e tyre. Për aktivitetin e tij revolucionar Qemali, u ndoq nga regjimi i Zogut. Gjatë vitit 1937 u arrestua dy herë. Në Tiranë u lidh me Vasil Shanton, u organizua në grupin komunist të Shkodrës në vitin 1937. Së bashku me Vasil Shanton zhvilloi veprimtari revolucionare, ku u lidh me punëtorët, si dhe organizon aksione të rinisë shkollore. Në vitin 1938 shkoi në Paris, Francë së bashku me vëllanë Velinë, për mjekim, i cili ishte i sëmurë. Në Itali, më pas regjistrohet në fakultetin e drejtësisë në Universitetin e Firences.

Kthehet në atdhe dhe në janar të vitit 1939, ku u arrestua e u dënua me burgim nga gjyqi që regjimi i Zogut zhvilloi kundër intelektualëve të rinj. Në gjyq nga i akuzuar u kthye në akuzues i regjimit e rendit feudalo-borgjez. Në prag të pushtimit fashist të Shqipërisë aratiset nga burgu dhe bashkë me Vasil Shanton organizon qëndresën antifashiste, punon pa u lodhur për tërheqjen e rinisë në luftë kundër

pushtuesit të huaj. Vijoi përkohësisht studimet në Itali, por në kushtet e reja që u krijuan Qemali u hodh me të gjitha forcat në luftë kundër fashizmit. Më 27 dhjetor 1940, për aktivitetin e tij antifashist, u arrestua në Itali nga kuestura dhe u burgos në burgun e Firences. Më 15 qershor 1941, për mungesë faktesh, u lirua nga burgu dhe u kthye në atdhe. Pas kthimit në atdhe u hodh në ilegalitet.

Veprimtaria revolucionare e Qemalit...

Qemal Stafa ishte një figurë e shquar për rininë antifashiste shqiptare. Qemal Stafa ishte dhe letrar i talentuar. Krijimtaria e tij u takon kryesisht viteve të rinisë. Shkroi tregime, skica e vjersha, një pjesë e të cilave u botuan me pseudonimin "Brutus" në shtypin përparimtar të kohës. Radhitet ndër letrarët e rinj realistë të viteve '30 të shek. XX, në Shqipëri. Në shkrimet e tij u ngrit kundër realitetit shoqëror të kohës, vuri në qendër njerëzit e thjeshtë që vuanin nga padrejtësitë shoqërore, dha portrete të luftëtarëve e të njerëzve me karakter të fortë që nuk mposhten nga vështirësitë, që luftojnë për një botë të re. Në një varg shkrimesh me karakter publicistik Qemal Stafa paraqiti haptazi idetë e tij revolucionare me pjekuri e bindje. Trashëgimi i tij letrar është përmbledhur në vëllimin "Qortimet e vjeshtës" (1961).

Në këtë kohë Qemal Stafa u takua me mjaft atdhetarë dhe komunistë që po punonin për formimin e një organizate politike, që të ngrinte popullin në luftë kundër pushtuesit fashist. Kështu me mjaft revolucionarë të tjerë, si me Vasil Shanton, Enver Hoxhën, etj., punuan për shkrirjen e grupeve komuniste dhe formimin e Partisë Komuniste Shqiptare. Qemal Stafa mori pjesë aktive në punët e partisë, u zgjodh anëtar i Komitetit Qendror të përkohshëm dhe sekretar politik i Komitetit Qendror të Rinisë Komuniste. Kreu me sukses shumë detyra të rëndësishme për organizimin e forcimin, për luftën e armatosur kundër pushtuesve fashistë e tradhtarëve të vendit, për demaskimin e shpartallimin e elementëve përçarës etj. Kështu Qemal Stafa u bë një figurë e shquar e rinisë antifashiste shqiptare.

Më 5 maj 1942, në Tiranë, duke luftuar me armë në dorë kundër milicisë fashiste dhe tradhtarëve të atdheut, ra në fushën e betejës, militant komunist Qemal Stafa. Dita e rënies së tij u bë simbol i qëndresës së partizanëve në luftë për çlirimin e atdheut.

Vlerësim i figurës së Qemal Stafës

Pas çlirimit të atdheut, që në vitin 1945, iu dha titulli i lartë "Hero i Popullit". Për nder të emrit dhe të veprës së tij heroike, si dhe të shembullit të frymëzimit për rininë në luftë dhe në kujtim të dëshmorëve të atdheut, dita e rënies së tij, në vitin 1946, u shpall si "Dita e Dëshmorëve të Atdheut", ditë që vazhdon të përkujtohet edhe sot, duke u kthyer kështu në një traditë. Por kjo ditë nuk përkujton vetëm një dëshmor, por të gjithë ata qindra e mijëra njerëz, që me dashurinë e tyre për lirinë dhanë jetën për atdheun. Emrin e Qemal Stafës e mbajnë rrugë e sheshe, shkolla e institucione, dhe në monizëm qendra pune e reparte ushtarake. Në kryeqytet, në sheshin që mban emrin e tij, është ngritur busti i heroit.

Për figurën e Qemal Stafës është shkruar monografi nga shkrimtari Nasho Jorgaqi, është realizuar filmi "Qortimet e vjeshtës", si dhe janë bërë mjaft piktura e portrete për figurën e tij, janë shkruar tregime e poezi, si dhe janë ngritur shtëpi muze në Shkodër dhe në Elbasan. Për figurën e ushtarakut Hasan Stafa është shkruar në librin "Ushtarakët e Gollobordës" nga Kujtim Boriçi dhe Eduard Abazi.

Më 5 Maj, e gjithë Shqipëria përulet para kujtimit të Heroit të Popullit Qemal Stafa, heronjve, dëshmorëve dhe martirëve të Shqipërisë, emrat e të cilëve janë të pavdekshëm. Historia me shkronja të arta ka shkruar dhe do të shkruajë heroizmin dhe sakrificat e tyre në shekuj. Në çdo 5 Maj, mbarë populli shqiptar përulet me respekt para kujtimit dhe veprës së tyre të lavdishme. Figura e Qemal Stafës është bërë simbol i kombit shqiptar, ai nderohet dhe vlerësohet për veprën e tij. Atdheu përulet me respekt dhe mirënjohje për para varrit të tij, të vendosur në varrezat e Dëshmorëve të Kombit në Tiranë.

BESA E SHTËPËZIT, BESË E SHPRESË PËR SHQIPËRINË



Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

(Me rastin e 110-vjetorit të Kuvendit lab të Shtëpëzit, në nderim të kapedanëve të këtij Kuvendi, Selam Musa Salaria, Halil Huto Sullo, Sulo Beqiri (Sulo Beqir Bedaj), Mersin Gjoça, Sali Murat Vranishti, Çerçiz Ago Topulli, Bajram Ligu (Prongjia), Hasan Xhiku, etj. Pjesëmarrjes në këtë kuvend të kapitenit holandez De Val (De Waal), lejtnanti Juljus Sonne, ekipit mjekësor holandez të përbërë nga mjekët ushtarakë Tido Reddinguis dhe Van Vliet si dhe civilli De Groot. Në mirënjohje edhe për atdhetarin Manxhar Taka që ka shkruar para një dekade librin “Drithërimat e Katërmbëdhjetës”, që hedh dritë mbi egërsinë e qeveritarëve dhe ushtrisë greke që ishin vërsulur 110 vite më parë kryesisht kundër popullsisë myslimane shqiptare të Labërisë, ku vullnetarët patriotë e atdhetarë të Labërisë e më gjerë jo vetëm që kundërshtuan burrërisht pushtimin dhe makinacionet asimiluese, por u thanë “ndal” barbarive greke në Shqipërinë jugore. Nderim burrave që shkruan histori me trimëri, mençuri dhe vendosmëri si dhe nderim në përjetësi gjakut të të rënëve!).

Shtëpëzi është një copëz e historisë kombëtare shqiptare. 110 vjet më parë, më 10 prill 1914, malet e Labërisë kishin hequr qeleshen e bardhë të dëborës. Në këmbët e tyre jeta rridhte “e qetë”, por e shqetësuar që në zhargonin popullor është quajtur “drithërimat e katërmbëdhjetës”. Gjithë fshatrave të jugut dhe mbarë Labërisë i kanosej një prej gjëmave më të tmerrshme të shekujve. Qeveria e Ismail Qemal Vlorës ia kishte besuar kontrollin e vendit Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit (KNK). Vilhelm Vidi kishte disa ditë që kishte zbaritur në Durrës dhe “sundonte” në një zonë të papërfillshme në Durrës. Vendi ishte rrethuar me dhelperi nga “ujqër” të të gjitha ngjyrave. Gjarpërinjtë e kombit shqiptar ishin ngritur për të copëtuar trupin e një Shqipërie londineze ende pa unitetin e duhur. Jugut dhe veriut të vendit i ishin veshur ushtritë mercenare të lakmive të megalidhesë dhe të naçertanjes të planifikuara në skutat më të errëta të barbarisë ballkanike. Në Gjirokastër “shqiptari” famëkeq Zografos kishte ngritur një



qeveri që trembej vetëm nga kapedanët e Labërisë. Dhe këta kapedanë follenë e kishin në zonat më luftarake, ku në magje bashkë me bukën gatuhej liria, liria që rrugën e niste në odat dhe në kuvendet e Labërisë, atje ku lidhej besa dhe niste veprimi luftarak i kryengritjes së përgjithshme popullore. Në këto kushte ogurzeza për Shqipërinë e shqiptarët, për t'i thënë “ndal” dorës kriminale pushtuese nga Jugu në Shtëpëzin historik, kemi një eveniment memorial për Labërinë, për Shqipërinë dhe për mbarë kombin shqiptar, që në gjuhën historiografike është i njohur si Kuvendi i besëlidhjes popullore të Shtëpëzit. Është kjo arsyeja që ndryshe këtij kuvendi i thonë: “Besa e Labërisë në Shtëpëz”, që ishte besë e shpresë për Shqipërinë.

Kapedanët e Labërisë në Shtëpëzin historik

Fshatrat, njerëzit dhe kapedanët e Labërisë ishin të gjithë gjerdan në kuvende. Kjo u vërtetua edhe në njoftimin gojë më gojë në gjithë Labërinë e më gjerë: “Kapedanët në takim në Shtëpëz, për t’i bërë ballë hasmit që ka ardhur tek dera. Thirrjesiu i përgjigjen të gjithë prijësit e çetave. Të gjithë shkuan në Shtëpëz në kuvendin historik të prillit 1914. Kapedanët lidhën besën për luftë ndaj andartëve. Kanë kaluar 110 vjet dhe Shtëpëzi është po ai, mes gjelbërimit me kokën “pështetur” në faqe të malit dhe që ngjason me bedenat e një kalaje të stërlashtë. Edhe pse ka humbur gjallërinë ende ka vellon jeshile të hijeshisë e të qetësisë. Shtëpëzi të fton si në një ballkon ku lugina e Drinos duket në pëllëmbë të dorës, nga Lekëli deri në Kakavijë. Përballë tij qëndron hijerëndë manastiri i Cepos, vendi i Zotave, karakoll mijërvjeçar i mbushur me ngjarje heroike, kuvende, ku “shkruhej” e ardhmja e gjithë trevës. Në të djathtë lugina e lumit të Kardhiqit që kullon bardhësi dhe që përfundon me qafën e Skërficës dhe atë të Shtufit. Mali i Gjerë, mali i Lucës dhe mali i Pusit mbyllnin horizontin me rryma ajri të freskëta mëngjesore, për t’ia lënë vendin ditës së ndritshme gjithë diell.

Si fishekë gjerdani për kombin arbëror

Është fakt se, sa herë binte briri i luftës labët, gjirokastritët, lunxhiotët, tepelenasit e përmetarët ishin bashkë, sikurse thotë polifonia, lidhur “si fishekë gjerdani”. Kështu ishin mbledhur edhe në fillim të prillit 1914 paria e kuvendi të kapedanëve dhe prijësve. Nga Fushëbardha Halil Sullo, legjenda e pushkës, burrërisë dhe mendjemprehtësisë së bashku me katër djem fushëbardhas: Dalip Kondi, Surja Tefa, Rizal Muho e Sejdi Baho. Nga Golëmi ishte koordinatori i katër çetave Sulo Beqiri, luftëtar trim dhe i mençur, që me krismën e katër çetave që drejtonte shkroi epope lavdie. Po kështu nga Zhulati Mersin Gjoça kapedan e prijës, figurë shumë e njohur popullore krahinore, por dhe trimi Hazhi Zeman Muxhai. Gjithashtu merrnin pjesë luftëtarë kombëtar Çerçiz Topulli, që vinte nga fronti i përjetshëm i luftërave për liri. Çerçizi kishte shkruar me gjak historinë kur çeta e tij me Hito Labin (Lekdushin) dhe Bajram Ligun (Prongjia) shtrinë përtokë bimbashin osman, tronditën themelet osmane me betejën në Mashkullorë dhe kishin mbjellë farën e lirisë në çdo fshat. Në Kuvend kishte ardhur dhe trimi e luftëtar i paepur Hasan Xhiku, legjenda e të gjithë luftërave me osmanët, grekun e italianin e 20-tës. Nga Salaria kishte ardhur Selam Musa Salaria me një pjesë të çetës së tij; nga Vranishti historik ishte kapedan Sali Vranishti, që ka hyrë në histori me këngën “Kapedan Sali Vranishti sa rrojte të punojë gishti...”, etj. Prijës e kapedanë të tjerë shkuan në kuvendimin e Shtëpëzimit, ku ishin mbledhur përfaqësitë e gjithë fshatrave të Kurveleshit të sipërm dhe të Kardhiqit si dhe nga luftëtarë të Lunxhërisë si dhe fshatrave të tjera përreth.

Pesë holandezë në Shtëpëz në Kuvendin e Labërisë kundër andartëve

Kuvendi i Shtëpëzimit ishte vlerësuar dhe nga ekipi holandez që kishte ardhur në Shqipëri për ngritjen e xhandarmërisë ushtarake shqiptare dhe me bekimin e Fuqive të Mëdha të kohës. Ishte koha kur Fuqitë Europiane ishin “bindur” se edhe Shqipëria



Shtëpëzi është një copëz e historisë kombëtare shqiptare. 110 vjet më parë, më 10 prill 1914, malet e Labërisë kishin hequr qeleshen e bardhë të dëborës. Në këmbët e tyre jeta rridhte “e qetë”, por e shqetësuar që në zhargonin popullor është quajtur “drithërimat e katërmbëdhjetës”. Gjithë fshatrave të jugut dhe mbarë Labërisë i kanosej një prej gjëmave më të tmerrshme të shekujve. Qeveria e Ismail Qemal Vlorës ia kishte besuar kontrollin e vendit Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit (KNK).

duhej të krijonte Shtetin e vet sipas modelit Perëndimor. Gjithsesi kufijtë territorialë shtetërorë do të ishin ata, që u përcaktuan nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër në vitin 1913. Është fakt i njohur historik se gjatë Luftërave Ballkanike 1912 - 1914, e sidomos pas largimit të pashmangshëm të Princit Vilhelm fon Viddi, më 3 shtator 1914, por edhe gjatë shtjellimit të ngjarjeve të Luftës së Parë Botërore, Shteti Shqiptar u zhduk: territori i tij u shndërrua në fushëbetejë për fqinjët dhe objekt këmbimi për Fuqitë e Mëdha. Antanta e përdori këtë territor si karrem për të tërhequr në kampin e saj Greqinë, duke i dhënë “licencën” të pushtojë Korçën e Gjirokastrën, sikurse i premtoi Italisë se, do të lejohej të vendosej në portin e Vlorës dhe në ishullin e Sazanit. Në takim ishin edhe kapiteni holandez De Val (De Waal), lejtanti Juljus Sonne si dhe ekipi mjekësor i përbërë nga ushtarakët Tido Reddinguis, Van Vliet dhe civili De Groot. Takimi i Shtëpëzimit u iniciua nga holandezët mbështetur nga një batalion i xhandarmërisë shqiptare. Qëllimi ishte që të vëzhgohej nga afër tërheqja e ushtrisë greke dhe rivendosja e autoritetit të shtetit shqiptar nën drejtimin e Vilhelm Viddit. Në fakt ishte direktiva e Fuqive të mëdha. Ushtria e grekut po tërhiqej nga Picari, Fushëbardha e Kardhiqi. Urdhri i fuqive të Mëdha ishte që ata të dilnin jashtë kufirit të njohur të “Shqipërisë londineze” të miratuar nga Konferenca e Ambasadorëve. Takimi i Shtëpëzimit ishte përzgjedhur në kohën e vendin e duhur. Shtëpëzi ngjante si një vendkomandë lufte në faqe të malit, që priste e përcillte kapedanë, ku lidhej besa si gjerdan i gatshëm për beteja.

Kuvendi i Shtëpëzimit - “Besë për lirinë, besë për Shqipërinë” Labëri, djemtë t’i bën guri,/Përuken, veç tek flamuri!

Burrat e bashkuar në idealin e lirisë lidhën besë që do të zinin pikësëpari të pesë shtigjet e Labërisë, por shtegu i parë ishte qafa e Skërficës. Ata u bashkuan kundër synimeve të qeverisë

autonomiste të Vorioepirit me seli në Gjirokastër. Oshtiu zëri i kapedanit e kryeplak i Fushëbardhës Halil Huto Sullo, i cili kërkoi nga holandezët vetëm armë dhe municion se gjithë burrat e fshatit ishin të gatshëm për luftë. Kishin vetëm pak mauzer, maliher e disa nagantë. Një pjesë e tyre të fshehur në Qafë Dardhë, që të mos i gjenin ushtarët andartë të kapitenit grek Xhavarres (komandant i postës greke në 1913-1914). Këto anë nuk kishin pasur ndonjëherë ndihmë shteti deri në këtë periudhë. Për herë të parë shikonin dhe mjekë holandezë në Labëri. Personel mjekësor tradicional kanë qenë nënat labe dhe ilaçet popullore si melhem për plagët si dhe shehlerët, hoxhallarët e ca “doktorë” pleq e plaka që mjekonin me mjete rrethore. Foli Sulo Beqiri, Kapedan Çerçizi, Xhaferi nga Gusmari, Latifi nga Progonati.. “Fermani i kuvendit të Shtëpëzit” ishte i qartë: “..të mbyllet me çdo kusht e me çdo sakrificë Skërfica, kjo portë e moçme e Labërisë nga kapedan Halil Sullo dhe burrat e Fushëbardhës, Zhulati e Rrëzomës, por edhe luftëtarë të tjerë. Kapedan Sulo Beqiri me çetat e tij u vendos nga Manastiri i Cepos, Qafa e Shtufit, Gryka e Kaparielit dhe Rehovës, Jomenin dhe me radhë..., gjithë shtigjet e Kurveleshit dhe të Labërisë”. Duke u bazuar në ngjarjet e luftës së vullnetarëve labë kundër ushtrisë greke, në pranverën e vitit 1914, të shkruara bukur edhe në librin e intelektualit Manxhar Taka “Drithërimat e Katërbëdhjetës”, ndalimi i mësymjes së andartëve u mundësua më 22 prill 1914, nga forcat e vendosura të rreth 700 luftëtarëve të Labërisë dhe jo vetëm. Edhe një herë vërtetohej ajo që thoshte is-kryeministri i fqinjëve grekë Eleftherios Kyriakou Venizelos (1864-1936): “Le të ketë një çik Shqipëri, po të mos ketë Labëri”. Historia e luftërave për liri nuk do të reshtë dhe as do të dorëzohet përballë civilizimit, përbashkimit në institucionet ndërkombëtare dhe as përballë globalizmit. Paska qenë e shkruar që thënia proverbiale të jetë plotësisht e vërtetë: “Labëri, djemtë t’i bën guri./Përuken, veç tek flamuri!”.

Dyfeku - zanat i Labit

Krismat për lirinë përcjellin historinë në një krahinë e trevë luftarake të panështruar ndaj çdo pushtuesi. Ishin këta prijës dhe çetat e tyre që përbaltën akademikët ushtarakë fqinjë, që hodhën në koshin e plehrave të historisë strategjitë e tyre, përfshi edhe ata ushtarakë grekë që kishin studiuar në akademitë gjermane. Kishin kaluar gjithë jetën me armë në dorë. Në Shtëpëz nuk munguan edhe romuzet, kur oficerët holandezë kërkonin t’u mësonin labëve artin e luftës si dhe armët. Ata nuk e dinin se shqiptarët kishin lindur me armë. Labët ishin mjeshtër kur merrnin nishan në zemër dhe dinin t’i dërgonin plumbat në lule të ballit.

Djalëria e Labërisë këpuste edhe fijen e gjalmit me plumb. Dyfekun e kishin zanat. “Mësimi” i armëve në Shtëpëz nga lejtanti Juljus Sonne i njohu me arsenalin e armëve të andartëve grekë që pothuaj ishin që të gjitha të markave bavareze gjermane me pushkë gjysmë automatike, mitraloza e armë artilerie, topa të kalibrave të lehtë e të mesëm, por dhe thikat që mbanin në brez. Depërtimi në gojëdhënën popullore, në arkivën e përjetshme të shqiptarit, por dhe në fondet

dokumentare gjejmë ende krismën e betejave popullore të 120 burrave në Fushëbardhë, 60 burrave në Zhulat, 170 luftëtarëve të Golemit, 100 luftëtarëve të Lekëdushit, 80 luftëtarë të Gusmarit, 46 burra të Rexhinit, 110 burra të Nivicës dhe çdo fshati të Labërisë.

Në roje të tokës shqiptare

Kuvendi i Shtëpëzit ishte një odë burrash në ballkonin e luginës së Drinos. Atje lidhej besa që çdo pëllëmbë të tokës shqiptare të kthehej në xhephane lufte, për t’u shenjtëruar: “ruajtja e tokës shqiptare”. Shtegu i Fushëbardhës në Labëri përpara se të futej në bankëprovën e historisë kishte marrë bekimin e Kuvendit të Shtëpëzit. Po ashtu edhe xhephania e Cepos. Lufta në Skërficë dhe në Cepo janë prova më e mirë e besës së Shtëpëzit, e këtij kuvendi historik, që i shërbeu denjësisht çështjes kombëtare shqiptare. Kështu Lufta e përgjakshme nga 20 deri më 26 qershor 1914 në Skërficë, ku Çeta e Fushëbardhës që kishte dhe djem luftëtarë nga Zhulati, Golemi, Picari, Libohova, Gjirokastra, Delvina, Rrëzoma që në total shkonin mbi 120 luftëtarë e që komandoheshin nga Halil Sullo, në shtegun e parë të Labërisë shkruan epope lavdie. Luanët flisnin me grykën e maliherit ndaj pesëqind andartësh. “Kali i Trojës”, nuk mundi të mposhtë “Patkoin strategjik” të Skërficës deri në largimin e gjithë banorëve drejt Vlorës. Fushëbardha e Skërfica ngelën të lidhura pazgjidhshmërisht nëpër shekuj sikurse edhe në betejën me andartët. “Patkoin strategjik” të Skërficës e “zbuluan” për herë të parë dhe u ndeshën legjionet romake, Pirro i Epirit tregoi muskujt në emër të forcës dhe krenarisë kaone, duke bërë që të lartësohej lavdia e forca e madhësisht ilire. Në Skërficë me marrëveshje me Papa Zhulin kaloi Boemundi, por u bë shteg i pakalueshëm për gjithë hasmët e të pabesët e Shqipërisë. Skërfica dhe Fushëbardha si binjake historike në mbretërinë e Zotave. Shkalla e Bregu i Erëzës bashkë me qafën e pesë priftërinjve janë mbushur me legjenda e mite që i pështjell Lëmëthi me mistere historike. Ato janë dëshmitare nga kaluan romakë, bizantinë, venecianë, osmanë, grekë etj. Vendasit u ndeshën me perandoritë në Gjashtë, Lëkurës, Sarandë, Delvinë, Rrëzomë në të gjithë Kaoninë. Liria, dinjiteti, krenaria kanë shoqëruar në shekuj luftëtarët fushëbardhas, zhulatas..., në barrikadën e shekujve. Ndaj u bënë barrikadë për andartët e 1914-ës, dhe ngelën në përjetësi në memorialin “Fushëbardha 2014” më i madhi në Labëri, që u kushtohet nëntë dëshmorëve që ranë në Skërficë. Nuk harrohet “përqaqimi” bajonetë më bajonetë e thikë më thikë me pushtuesit në Skërficë. Kaonia, Labëria, Fushëbardha ecin... në rrugën e prosperitetit. Dëshmorët e djeshmja dhe e sotmja bashkë. Rruga aty këtu ndriçon nga gurët e shndritshëm fosforikë, që Fushëbardha i ka me bollëk, ngjan si bulevard pedonaleje e ndriçuar me drita të “mbira” nga dheu. Ato rrezatojnë vetëm lart. Dëshmorët e 14-ës, luftëtarët e tjerë në Skërficës nuk bënë pakt me dredhinë, sepse nuk u zihej besë të pabesëve. Dëshmorët u trupëzuan me kalanë natyrore të Skërficës, portën e parë të Labërisë. Ata ngelën në panteonin e kombit e memorien popullore të Kardhiqit, Rrëzomës, Labërisë, mbarë kombit shqiptar.

Kapedan Kajo Babjeni

Nën drejtimin e Kajo Babjenit, 800 burra lidhën besën e çlijuan Gorën e Pogradecin

Më 28 korrik të vitit 1912, në vendin e quajtur Guri i Kamjes, çetat e Gorës dhe Mokrës, me Flamurin e Shqipërisë, u bashkuan për të luftuar Xhonturqit dhe për të çliuar Pogradecin... Xhonturqit, me shtypjen e kryengritjes së vitit 1905, e me radhë më 1906-1909-1910-1911-1912, nuk arritën të shuanin qëndresën e popullit Shqiptar. Përvoja kishte treguar se fitorja e Lëvizjes Kombëtare mund të sigurohej vetëm duke bashkuar forcat popullore në një kryengritje të vërtetë.

Kërkesat ishin: Për amnistrinë e përgjithshme, për lirinë e plotë të Arsimit Kombëtar mbi bazën e alfabetit latin, krijimin e një administrate me nëpunës shqiptar dhe përdorimin e të ardhurave për zhvillimin ekonomik dhe kulturor të popullit shqiptar.

Përveç pushtimit osman, Krahinat e Gorës, Mokrës dhe Oparit, kërcënoheshin nga orvatjet e shteteve fqinjë, për aneksimin e trojeve. Gora dhe krahinat e tjera, mundën t'i bënin ballë burgosjeve, internimeve e plaçkitjes nga qeveritarët turq. Synimet e pushtuesve ishin, copëtimi i Shqipërisë, duke u mbështetur, me nënshkrimin e Traktatit të Shën Stefanit, më 1878, ku mjaft troje Shqiptare, do t'u aneksoheshin shteteve fqinjë, si Maqedonisë, Jugosllavisë, Greqisë etj... Këto copëtime përfshinin Pogradecin dhe krahinën e Gorës deri në Voskopojë.

Vala e protestave kundër kësaj padrejtësie ishte e fuqishme. Populli i Gorës u organizua dhe u ngrit me armë në dorë. Këtu ishte dhe ndikimi i Degës së Lidhjes të Prizrenit, që sapo ishte formuar në Pogradec... Në këtë situatë, shumë djem gorarë dezertuan nga ushtria osmane, e qëndronin maleve. Po kështu, shumë fshatarë, sa mësonin që në fshat vinin taksambledhësit e zyrtarët e administratës turke, linin shtëpitë e deri dhe qetë e mbrehur në arë dhe dilnin me armë në mal... Në krahinat e Gorës, Mokrës e Oparit, situata po evoluonte çdo ditë e më shumë. Tani po e zinte vendin protesta me armë, nga individë të quajtur grupe kaçakësh.

Kapedani Kajo Babjeni

Lëvizja e kaçakëve, pas Lidhjes së Prizrenit, u bë një rezistencë e rëndësishme në Gorë, që me veprimet e tyre luftarake, zunë vend në histori dhe do të kujtohen brez pas brezi. Ata kundërshtonin regjimin për mospagimin e taksave, mos zbatimin e urdhrave të qeveritarëve turq, godisnin me armë koshadhet e turkut. Këto veprime kryheshin nëpërmjet çetave me Kapedan Kajo Babjenin në krye, Shahin Matrakun nga Popçishti i Oparit dhe Ismahil Dërdusha.

Tre kapedanët bashkëpunonin ngushtë me njeri-tjetrin. Synimi ishte çlirimi i Gorës e mbrojtja e saj nga synimet e pushtuesve të huaj... Çeta e Kapedan Kajo Babjenit, e kishte shtrirë veprimtarinë luftarake në Gorë, Opar, Mokër, Korçë e Pogradec. Ai kishte treguar vendosmëri e trimëri, pjekuri të madhe, cilësi këto që i shërbyen shumë në kohën që drejtonte çetën, e cila mori dhe emrin e tij.



Prandaj, fshatrat e Gorës, Mokrës dhe Oparit, rrëmbyen armët dhe u bashkuan me çetën e Kajo Babjenit, për të mbrojtur tokën amtare. Kapedan Kajua, ishte mjeshtër i dyfekut, luftëtar e komandat i mirë e i zoti, por kishte edhe vështrim e horizont politik. Njihej për karakter të fortë burrëror, për urtësi, besnikëri ndaj popullit e Atdheut. "Për një qëllim të shenjtë kemi rrëmbyer armët". Kur Kajo kishte hyrë në Lëvizjen e Rilindjes Kombëtare, më 1905, bënte pjesë në Komitetin për Çlirimin Kombëtar të Korçës... Qëndresa e çetave të Gorës ndaj administratës osmane e synimeve të shovinistëve maqedonas, po merrte përmasa të mëdha. Përveç çetave, armatosej dhe mbarë popullsia. Në Gorë po vinin patriotë nga Korça, Kolonja, Pogradeci. Gora konsiderohej si bazë e sigurt e lëvizjes atdhetare, si strehë për luftëtarët e çetave patriotike të Rilindësve. Kjo e detyroi administratën osmane që në Gorë, të mos shkelte këmba e osmanlinjve. Lindi nevoja e vetëqeverisjes, nga njerëz patriotë e të devotshëm.

Komiteti i Gorës

Në pranverën e vitit 1906, në fshatin Dërdush të Gorës, u bë një mbledhje e gjerë me përfaqësues nga e gjithë krahina. Aty u propozua dhe u zgjodh një Komitet i Fshehtë Krahinor me 12 anëtarë. Kryetar u zgjodh Kapedan Kajo Babjeni.

Detyra e këtij komiteti ishte për popullarizimin e lëvizjes kombëtare, bashkëpunimin midis çetave, si çeta e Çerçiz Topullit, etj. Luftëtarët e këtyre çetave nuk mbanin vetëm pushkë e fishekë por në çantat e tyre mbanin dhe Abetaren Shqipe. Në vjeshtën 1907, në fshatin Zbogj, u organizua një mbledhje e zgjeruar, me çetat



patriotike të Çerciz Topullit, Spiro Ballkamenit, Qemal Panariti, Kajo Babjenit e Ismail Dërdushës. Qëllimi ishte “shtimi i çetave, bashkëpunimi midis tyre e krahinave”. Ky u quajt Kuvendi i Zbogjit. Kjo e shqetësoi shumë administratën turke dhe e detyroi të tërhiqte 35 xhandarë nga Gora e i çoi në Pogradec. Kjo shënoi dhe çlirimin Gorës nga osmanlinjtë. Menjëherë xhonturqit filluan arrestimet e burgosjet.

Në verën e vitit 1909, në fshatin Babijen, rrethuan Kajo Babjenjin me çetën e tij dhe i bënë thirrje të dorëzohej. Por Kapedani u përgjigj me pushkë. I gjithë fshati luftonte. Se trimat, nuk i dorëzohen të gjallë armikut. Kapedani del nga shtëpia duke shkelur mbi kufomat e turqve që kishin ngelur nën strehët e shtëpisë, çan rrethimin e del pa asnjë dëmtim. Populli i këndon “Ky Babjenji në një breg/ Ndizet zjarr, kërcet dyfek/, O Kajo trim i mirë/ Ç’e nderove Shqipërinë”. Autoritetet xhonturke kishin filluar të merrnin masa të rrepta kundër Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Ata arrestuan në Korçë një numër të madh patriotësh. Çetat e Spiro Ballkamenit dhe Qamil Panaritit, më 29-30 korrik 1911 çanë rrethimin e turqve në Orman-Çiflig.

Çlirimi i Pogradecit

Çetat në Gorë e Mokër ishin të ngritura. Ato udhëhiqeshin nga Kapedanët Kajo Babjenji, Ismail Dërdusha e Xhelo Selca. U bë koordinimi i veprimtarisë së tyre. Për këtë Komiteti Krahinor, mori masa dhe bëri riorganizimin. Ky takim u zhvillua në fshatin Strelcë, në verën e vitit 1912 dhe iu vu emri Komision Krahinor. Kryetar u zgjodh Xhelo Selca. Kryengritja e përgjithshme kundër turqve kishte filluar në vitin 1912 në të gjithë Shqipërinë.

Në jug Themistokli Gërmenji forcoi lidhjet me kapedanët Kajo

Babjeni, Sali Butkën etj. Komisioni Krahinor, më 26 korrik 1912, me rreth 350 burra të armatosur nga gjithë krahina e Gorës mbledhen tek Guri i Kamjes. Aty u mbledhën edhe shumë atdhetarë nga Mokra, nga Pogradeci, Korça etj., me qëllim çlirimin e Pogradecit. Në këtë takim ishin Kajo Babjeni, Xhelo Selca, Telha Senishti, Feta Goca, Feim Zbogji, Mehmet Velçani, Adem Çezma etj. Të gjithë diskutuan dhe caktuan datën e sulmit për të çliruar Pogradecin.

Çetat e Gorës u bashkuan tek Guri i Kamjes, në lartësinë 1461 m tek “Lisi i Gorarëve” dhe u organizuan për luftë kundër forcave turke që kishin pushtuar Pogradecin. Pas organizimit të çetave të Gorës u bë dhe organizimi i 7 çetave të Mokrës. Më 28 korrik 1912 u bashkuan në fshatin Potgozhan e zgjodhën një komandë prej 12 vetash. Komandant ishte Kajo Babjenin. Pra 28 korriku i vitit 1912 ishte evenimenti ku çetat patriotike të Gorës e Mokrës tek ‘Lisi i Gorarëve’ ngritën flamurin Kombëtar... Organizimi u bë i plotë në të gjithë elementët luftarakë. Çetat e kishin siguruar vetë armatim-municionin. Ishin 800 luftëtarë.

Detyra ishte: “Çlirimi i Pogradecit nga xhonturqit dhe bllokimi i ardhjes së ushtrisë serbe nga Ohri. Drejtimi i sulmit mbi Pogradecin u bë nga Kajo Babjeni... Pas disa luftimeve sporadike në kala dhe në rrethinat, garnizoni turk e lëshoi Pogradecin. Pas çlirimit të qytetit Kajua theksoi: “Lirinë e gëzofshi, por mendjen mos e flini, gjumi mos u zërë. Armiqtë greke e sllavë nuk do na lënë kohë të ruajmë mjekrën”.

Çdo 28 korrik, banorët e Gorës e zonave fqinje, kudo që të jenë, mbledhen tek Guri i Kamjes dhe përkujtojnë ngjarjen e rëndësishme.

Gaqo Tanku, ushtaraku model, studiuesi i ‘meritokracisë si kriter bazë në administratë’

Profesor Gaqo Tanku është një nga nxënësit e shkollës “Skënderbej” që pati karrierë të suksesshme ushtarake dhe akademike. Gaqo Tanku ka lindur në Çiflik të Urës Vajgurore, rrethi Berat, më 15.02.1954. Në shtator të vitit 1969 filloi studimet në shkollën e mesme ushtarake “Skënderbej” dhe i përfundoi në korrik të vitit 1973. Më pas vijoi studimet në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve, në Specialitetin Zbulim. Në vitin 1977 titullohet oficer aktiv dhe emërohet shef zbulimi Brigade, njëkohësisht dhe komandant i Kompanisë së Zbulimit të Brigadës (efektiv rezervist). Pak vite më vonë, kryen detyrën e komandantit të Batalionit të Zbulimit të Korpusit të Fierit. Me ndryshimin e strukturës në FA (krijimin e Divizioneve), emërohet shef i zbulimit të Divizionit të Peqinit. Në vijim, ndjek studimet në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së dhe me përfundimin e studimeve në këtë akademi, emërohet komandant i Shkollës së Instruksionit të Zbulimit në Tiranë. Pas ndryshimit të sistemeve politike, emërohet komandant toge, kompanie dhe shef i Formimit të Brendshëm në Brigadën Komando, në Zall Herr. Në vitin 1994, së bashku me disa ushtarakë të tjerë emërohen në rajone jashtë Tiranës, konkretisht në Bulqizë në detyrën e instruktorit të Përgatitjes Fizike në Batalionin e Gatshëm në Brigadën e Këmbëtorisë në Bulqizë, por që nuk e kreu, pasi u urdhërua të kryente detyra shërbimi si oficer roje në ish-Batalionin e Këmbëtorisë në Çereneçin e Sipërm në rajonin e Bulqizës. Me suprimimin e Brigadës së Këmbëtorisë në Bulqizë, del në Rezervë. Rikthehet në Forcat e Armatosura në shtator të vitit 1997 në detyrën e specialistit në Sektorin e Arsimit në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore. Me pas, në vitet 2002, pas kthimit nga studimet në Universitetin e Manchesterit në Mbretërinë e Bashkuar, emërohet në detyrën e zv. drejtorit të Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore. Me suprimimin e vendeve ushtarake në këtë drejtori (u kthyen në pozicione civile), emërohet shef i Sektorit të Arsimit në Drejtorinë e Personelit të Shtabit të Përgjithshëm dhe në vitin 2004, emërohet oficer shtabi për planifikim-programimin në Zyrën e Bashkëpunimit Ushtarak, si koordinator për Zyrën e Bashkëpunimit Ushtarak për Mbrojtjen me SHBA-në dhe Delegacionin Italian të Ekspertëve (DIE). Në vitin



2007 del në rezervë, por punon për një periudhë dy vjeçare si specialist i parë dhe analist në Drejtorinë e Planifikimit të Mbrojtjes. Në shtator të vitit 2009 pranohet si pedagog me kohë të plotë në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës. Në fushën e arsimit, përveç arsimit në shkollat ushtarake në vendin tonë, ka kryer edhe një sërë studimesh e kualifikimesh jashtë vendit. Kështu, në vitin 2000-2001, ndoqi studimet për “Master of Science in Human Resource



Profesor Gaqo Tanku: Nëse kemi mundur të jemi këta që jemi, më lejoni të përmend teorinë e modelit, të cilën çdo student i menaxhimit në mbarë

botën e studion se si duhet zbatuar në praktikë.

Ne kemi pasur fatin të kishim modelet e gjalla.

Development”, Universiteti i Mançesterit, Angli. Në 2006 mbron doktoraturën me temë “Veçori të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Forcat e Armatosura”, ku merr titullin “Doktor i Shkencave Ekonomike”, teme e mbrojtur në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tiranës, ndërsa në mars të vitit 2015 merr titullin e Profesorit të Asociuar. Ka ndjekur shumë trajnime dhe kualifikime, në tetor 1997 ndjek “Reserve Forces and Mobilization Course”, Shkolla e NATO-s, SHAPE, Oberamergau, Gjermani, në Kolegjin e Mbrojtjes në Holandë (kurs 3 mujor), kurs për përgatitjen e ushtarakut për në shtabet ndërkombëtare, Seminari për Menaxhimin e Personelit, Upavon, Angli, kursin “Education and its Major Role in Regeneration, an examination of recent developments and practices in the UK”, seminar një javor i organizuar nga Këshilli Britanik në Durham, Angli, në Universitetin i Granfield, Angli “Diplomacia e Mbrojtjes”, Resource Management Education Programme Course, NATO School, Oberamergau, Gjermani.

Profesor Gaqo ka marrë pjesë në projekte me ekipin Amerikan të KUBIC dhe SAIC në kuadrin e zhvillimit të menaxhimit të burimeve njerëzore në FA etj. Gjatë kohës si pedagog në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, është zgjedhur Kryetar i Këshillit të Administrimit të UAMD-së.

Një rol të rëndësishëm në aktivitetin e Gaqo Tankut, zë aktiviteti shkencor. Nga viti 2009 që ka filluar punë me kohë të plotë në fakultet, është angazhuar në mënyrë të ndjeshme në konferenca me një seri punimesh të cilat janë vlerësuar të rëndësishme. Ai ka marrë pjesë në 11 (njëmbëdhjetë) konferenca ndërkombëtare, ku nëntë, janë botuar në “Proceeding”, të organizuara nga universitete të ndryshme (mbajtur në Shqipëri, Rumania), ku punimet janë pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor. Për sa i përket punimeve shkencore të paraqitura në konferenca, boshti i punimeve të tij ka qenë menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore, kënaqësia në punë, përsosja e metodave të përzgjedhjes së personelit etj. Punime të tilla të paraqitura në konferenca mund të përmendim: “Meritokracia, i vetmi kriter për të patur një administratë publike profesionale, Krijimi i Qendrave të Vlerësimit, ndihmesë për të rekrutuar stafin e duhur dhe zhvillimin e suksesshëm të karrierës bazuar në meritokraci”; “The Implementation of ‘Lessons

Learn’ Concept in Business Administration (Implementimi i konceptit të nxjerrja e mësimëve në fushën e biznesit) etj..

Ka publikuar gjithashtu librin e lëndës së “Sjellje Organizative”, lëndë që zhvillohet në nivelin Master Shkencor dhe Master Profesional etj... Nënkolonel Gaqo Tanku për shkollën që e rriti dhe formoi do të shprehej: Modeli që na dha shkolla jonë e dashur “Skënderbej”... Nëse kemi mundur të jemi këta që jemi, më lejoni të përmend teorinë e modelit, të cilën çdo student i menaxhimit në mbarë botën e

studion se si duhet zbatuar në praktikë. Ne kemi pasur fatin të kishim modelet e gjalla. Ndoshta nuk dinim se ekzistonte në atë kohë kjo teori e krijuar nga shkencëtari Alberto Bandura, sipas së cilës, çdo njeri mëson përmes vëzhgimit të sjelljes së të tjerëve. Dhe ata të tjerët që na mësuam, ishin idealistë të vërtetë si ushtarakët që na drejtonin, me në krye komandantin Meço Starja, partizan trim dhe njeri i ndershëm, që na donte sikur të ishim fëmijët e tij. Ndoshta mund të shkruhen libra të tërë për këta njerëz model. Po kështu, nuk do mund të mos them pak fjalë edhe për mësuesen time kujdestare Gjeraqina Spahiun (Osmanliu), e cila ishte jo thjeshtë mësuese, por ishte dhe motra jonë e madhe. Nuk ishte më shumë se 28 vjeçe e, së bashku me djalin e saj Rezartin e vogël, na mësonte rrugët e Tiranës. Pra edhe një e diel e vetme që ishte pushim, na përkushtohej në atë mënyrë që ndoshta edhe prindërit tanë nuk do ta kishin bërë. Dhe në fund, referuar teorisë së modelit, le të përmend një rast. Personalisht kam qenë zëvendëssekretar i Komitetit të Rinisë të shkollës së mesme ushtarake “Skënderbej”. E, meqë ne ishim vetëm djem, Komiteti i Rinisë i Tiranës, kishte platforma bashkëpunimi me organizatat e rinisë të shkollave të tjera. Rasti e solli që klasa jonë të kishte lidhje me një klasë të shkollës së mesme të gjuhëve të huaja, godina ku është luajtur filmi ‘Lulëkuqet mbi mure’. Për të qenë i sinqertë në rrëfimin tim, duhet të them se ne nuk ishim aq të mirë në vallëzim dhe kur shkuam për herë të parë në mbrëmje me vajzat e klasës së gjuhëve të huaja, një nga shokët tanë, pa dashje, i shkeli këmbët. Vajza u nervozua dhe e shtyu paksa me duar. Shoku jonë u skuq, u ul në stolin më të afërt dhe mbuloi fytyrën me duar. Por ishte ajo, motra jonë e madhe, që përkujdesej me mish e me shpirt, e cila u gjend shpejt aty. Ne nuk dëgjua se çfarë i tha ajo vajzës, por pas këtij momenti, vumë re ndryshimin e sjelljes së saj, e cila jo vetëm që i kërkoi ndjesë shokut tonë, por edhe filloi ta mësojë se si të vallëzonte. Ky ishte modeli që fatmirësisht ne patëm. Për arsye etike nuk po përmend emrin e vajzës, pasi sot ajo është figurë e njohur dhe e martuar me një njeri të mrekullueshëm në fushën e sportit, për të cilin ka respekt e tërë Shqipëria...

E vetmja fjalë që mund të them edhe tani pas kaq e kaq vitesh është: Faleminderit e dashur mësuese Gjeraqina!

Xheladin Çelmeta,

ish-kryeredaktori i gazetës “Ushtria”,
biri që Peza e lindi për pushkë dhe penë

Sikur ta kisha afër do t’i thosha: Din, ke shkruar kaq shumë për të tjerët. Lere penën, sot do të shkruajmë ne për ty. Se vërtet ky portret është punuar nga shumë vetë. Ishin të shumtë shokët e miqtë e Xheladinit që iu përgjigjën idesë sime dhe pa ngurruar më shkruan me fjalë aq të ngrohta e me aq dashuri, respekt e mirënjohje, sa kam frikë se fjalët e mia do të tingëllojnë të varfra e miqtë tanë të përbashkët do të zhgënjehen.

Jemi shokë të vjetër bashkë. Ishim djem 15-vjeçarë atë shtator të largët të vitit 1971, kur të dy veshëm uniformën e bukur të skënderbegasit. Dhe për më se 50 vjet mbetëm shokë e miq. Jemi edhe sot. Në vitet e shkollës së mesme the të lartë kemi qenë në të njëjtën klasë. Provimet, stërviçjet, brezaret në Ksamil, hekurudha në Qukës, stazhi në Fierzë, punimet fortifikuese në Bardhoc të Kukësit dhe Steblevë të Dibrës, marshimet...o sa shumë kujtime! O ç’ nostalgji! Pasi u diplomuam në vitin 1980 në degën e Artilerisë Kundërajrore, sigurisht u ndamë, por kjo nuk na pengoi të takoheshim hera-herës dhe t’i shkruanim njëri-tjetrit kur kishim diçka për të thënë. Por gjithnjë kishim të reja, se jeta e të rinjve është dinamike, prandaj letrat ndiqnin njëra-tjetrën.

E në to, ishte po ai Xheladin që unë dhe të tjerët njohim: i qetë, i thjeshtë, punëtor i palodhur, lexues i etshëm, admirues i së bukurës në jetë, në prozë, poezi dhe arte, shprehës i saj në krijimet e tij, shpeshherë me një nivel të admirueshëm letrar e artistik, por çuditërisht modest, shumë modest! “Kish një të metë thotë”, Thanasi Tane, me të cilin punoi për një kohë të gjatë në gazetën USHTRIA pas vitit 1997, megjithëse njiheshin vite e vite më parë, kur nga bateria ku shërbente në vitet ’80, në Arapaj mbi Durrës, i dërgonte Thanasit artikujt, siç thotë ai, të saktë, të përmbledhur, shkruar në fletë fletoreje të vizuar anash, me një kaligrafi të bukur, si letra dashurie, në redaksinë e Gazetës. (atëherë quhej LUFTËTARI), ulte veten dhe mburrte të tjerët. I thashë një ditë: “Ore Xhelë, pse sillesh si i nënshtruar? A e di që je më i miri?!” Dhe ai mu përgjigj: “Mos ma vër re o shef, ashtu e kam tipin unë”. Dhe thoshte një të vërtetë. Dhe të njëjtat fjalë, të njëjtat përshtypje më shkruan edhe Agustin Gjinaj, nga Belgjika, edhe Muharrem Dardha nga Tirana. Edhe në Shkollën “Skënderbej”, Xheladini shkruante hartimet më të bukura, por kurrë nuk u mburr, madje shprehte admirim për punët e të tjerëve. Mrekullohej edhe për një fjali, një frazë, një paragraf nga hartimet e shokëve. “Shih mër jahu sa bukur e ka thënë!”. Dhe këtë e thoshte me sinqeritetin më të madh! Vazhdon Thanasi: “Xhela i mirë që kish ‘mik të fortë’



modestinë dhe shpirtin e punëtorit të palodhur, mbeti gjithnjë një ndër personazhet më pozitivë, më aktivë të Gazetës. Ai ishte më i palodhuri, më kokuluri, më profesionali, i vetmi që dinte si ta kërkonte dhe si ta shkruante lajmin”. E mua më vjen ndërmend ai episodi që ai e ka përshkruar aq bukur, kur, gjatë Luftës për çlirimin e Kosovës, bashkë me një grup gazetarësh të mediave shqiptare the të huaja u gjend në rrezen e zjarrit të artilerisë serbe, moment që edhe mund t’i kishte kushtuar jetën. Ja pra, kështu e kërkonte lajmin!

Vullnetin për punë dhe talentin i tregoi që në vitet e para të shkollës 8-vjeçare, aty, në Pezën e bukur e të lavdishme. Ai ishte lindur në një familje të njohur për traditat më të mira atdhetare, me



paraardhës punëtorë e luftëtarë, njerëz të thjeshtë e të ndershëm. Pa folur për vitet e hershme, rreth 1900-s, ku Xheladini në biseda dhe shkrime të ndryshme tregon për gjyshin e tij që i trashëgon emrin si një luftëtar aktiv në luftën për pavarësi dhe kur mori formë shteti shqiptar, Çelmetat u lidhën që në krye të herës me luftën që filloi Babë Myslimi kundër fashistëve pushtues të Shqipërisë. E kam treguar në një shkrim për Pezën dhe pezakët atë befasinë që më bëri babai i Xheladinit, Sulejmani, kur vajta për herë të parë te shtëpia e tyre, atje, te kodra e Çelmetajve: “Or çun, aty ku je ul ti, është ul edhe Qemal Stafa, edhe Vasil Shantol!”. Dhe Sula nuk ishte thjesht mikpritëse i partizanëve. Ai vetë ishte një nga partizanët e parë të çetës së Pezës, bashkë me vëllezër, kushërinj e kushërirra. Ja pra, në një familje të tillë u lind the u rrit Xheladin Çelmeta. Kështu që veshja e uniformës së skënderbegasit kishte një themel. Merita e Xheladinit është se ai e mbajti të veshur me nder e dinjitet atë uniformë. Tregon Sherbet Zgura, oficeri pezak: “E kam admiruar që në shkollën fillore. Xhela ishte dy vjet para meje, por poezitë e tij që mësuese Marie Prifti i vinte në tabelën letrare, i kopjoja dhe i mësoja përmendësh kur shkoja të ruaja bagëtitë. E nëse vendosa të shkoj në shkollën “Skënderbej”, ishte shembulli i Xhelës që më shtyu. Lidhjet me Xhelën i kam mbajtur gjithnjë. Ishte dhe është nga ata shokë që nuk të jep arsye të largohesh. Vajtja në Gazetë, librat që shkroi, dhe sidomos libri me kujtimet e Gani Pezës për Babë Myslimin, e ngritën shumë lart figurën e tij, jo vetëm për mua, por për gjithë krahinën e Pezës”, - thotë ai.

Xheladini erdhi në Gazetë në fillim të viteve '90 dhe u bë Kryeredaktor diku aty nga viti 1996, siç e dimë, një periudhë transformimesh të mëdha e vështirësish edhe më të mëdha. Nuk jam i sigurt nëse ai e propozoi emrin që ka sot gazeta “Ushtria”, gjë që besoj se po, por e di që nga ai e kam dëgjuar së pari këtë emër. Por më e rëndësishmja është që ai ia doli, edhe pse mjedisi nuk ishte shumë miqësor e aq më tepër ishte dyshues e gërricës ndaj tij. Iu desh të punonte me një grup eprorësh e vartësish që nuk kishin të ngjashme (me ndonjë përjashtim) as karakterin, as aftësitë profesionale dhe as synimet e idhujve dhe miqve të tij të hershëm në shtypin ushtarak, si Demokrat Anastasi, Filip Rrumbullaku, Ilirjana Sulkuqi, Apostol Duka, Sadik Murra, Mina Qirici etj. Megjithatë ai diti të gjejë gjuhën falë përkushtimit profesional

dhe qetësisë e ndershmërisë në marrëdhëniet me njerëzit. Madje edhe në komentet dhe intervistat me njerëz të politikës, përfshi edhe ministrin e Mbrojtjes z. Safet Zhulali, ai iu shmang politikës e politizimit, duke trajtuar ato probleme që shqetësonin realisht ushtrinë dhe ushtarakët. Një mision i vështirë në ato kohëra, por ai ia doli. Edhe në shkrimet me subjekt ushtarakët e liruar dhe problemet e mbrojtjes që Çelmeta trajtoi e trajton në organet e tjera të shtypit e mediat, asnjëherë nuk bëri e nuk bën politikë. Ai i bie problemit në kokë, nuk i stërhollon idetë dhe fjalitë, nuk e lodh lexuesin me pyetje e dyshime.



Pasi u largua nga “Ushtria”, Xheladini po me atë pasion e përkushtim punoi e punon për një varg gazetash, si “Pavdekësia”, “Kushtrim brezash”, “Sot”, “Telegraf” etj., dhe sidomos për dashurinë e tij të veçantë, gazetën “Peza”. Padyshim një gazetë që spikat në numrin e madh të gazetave shqiptare për cilësinë e shkrimeve dhe paraqitjen estetike. Ka qenë një festë e veçantë për të dhe i gëzohej si fëmijë, kur gjeti mundësinë që gazetën “Peza” ta nxirrte me ngjyra dhe me letër cilësore. E sa për Xheladinit familjar, ç’ mund të themi veç fjalët më të zgjedhura për një bashkëshort, baba e gjysh të përkushtuar e të lumtur. Kur flasim këto vitet e fundit, biseda për Marinin e më pas për mbeskën dhe nipçen të sapoardhur, janë pjesa më e këndshme, më gëzimsjellëse. Sigurisht, kujtojmë peripecitë që ka vluar për strehimin, atë moment emocionesh, ankthi e pritjeje të bashkëshortes, Adiles, gati njëzet vjet më parë, kur ajo ishte me mision në Afganistan, e plot të tjera e të tilla ngjarje që mbushin jetën e njeriut e që bëjnë atë vargan kujtimesh që janë zahireja e shpirtit njerëzor. E sidomos të shpirtit të një njeriu me botë të pasur, me interesa të gjera, me pasion për dijen dhe shprehjen e saj, si ajo e nënkolonel (P) Xheladin Çelmetës, që duket se vërtet Peza që lindi shumë bij për pushkë e punë, atij i dha edhe një mision më tepër: penën. Penën për të shkruar jo vetëm historinë e saj, por edhe të pasqyrore jetën e vendit, posaçërisht të Ushtrisë Shqiptare. Mision që ky pezak fjalëpakë e shkrime shumë, e realizoi me nder e dinjitet.

Veri Talushllari
Nju Jork, prill 2024

Gratë shqiptare që shkruan historinë me germa të arta

Që në lashtësi, e deri më sot, ne kemi qenë dëshmitarë të luftës së vazhdueshme për barazi mes burrave dhe grave. Në çdo fazë historike duket qartë se një nga tiparet kryesore të luftës së grave ishte pabarazia gjinore. Për gratë, u krijua një rregull i pashkruar, karakteristikë e tyre e përbashkët ishte të kishin varësi nga autoriteti mashkullor, sipas tyre gratë ishin qenie riprodhuese, s'gëzonin të drejtën për arsim etj. Në krahasim me gratë greke, gratë ilire ishin më të lira dhe kishin të drejtën e trashëgimisë e të arsimimit.

Historia shqiptare ka njohur gra që shkruan kundër këtyre rrymave e normave sociale dhe vërtetuan se gratë si individ e jo vetëm përfaqësuan makinën riprodhuese, por realiteti tregoi se gratë shqiptare kanë qenë sundimtare, diplomate, politikane të fuqishme, luftëtare trime, si Mbretëresha Teuta e shtetit Ilir, Olimpia e famshme, nëna e Aleksandrit të Madh, Kleopatra unikale mbretëreshën e Egjiptit, me prejardhje nga Epiri.

Donika besnike, që mbeti krah i djalhtë i Gjergj Kastriotit të madh, Mamica trime që luftoi pranë vëllait të saj, Rugina Balsha, Helena Topia etj. Më pas, pushtimi osman që shkaktoi zhvendosjen e popullatës shqiptare drejt brigjeve jugore të Italisë, pranë detit Adriatik dhe detit Jon.

Pjesa e shquar dhe fisnike shqiptare, ku bënin pjesë edhe gratë vazhduan veprimtarinë artistike, shkencore si arbëreshja Elena Lukrecia Peshkëpia, shkencëtarja e parë grua, krijuesja shkrimtarja arbëreshë Maria Antonia Braille, piktorja e parë dhe më e famshme e kohës Eleni Bukura Altamura edhe ajo arvanitase. Gruaja ka treguar se ka pasur aftësi për të bërë poezi, art, kulturë shkencë etj. E gjithë kjo është përcaktuar shumë mirë në zhvillimin e proceseve historike dhe në jep një panoramë të bukur që një grua si individ mund të merrtet në mënyrë të barabartë me të gjitha sfidat e jetës që korrespondojnë me kohën në të cilën ajo jetoi dhe veproi.

Historia botërore njih shumë burra të fortë e të mencur, që kontribuan në ndryshimin e botës, duke krijuar, gjenialitete që sollën ndryshime në shoqërinë njerëzore. Nëse ishin luftëtarë trima ato luftuan për lirinë e atdheut dhe popullit e tyre. Por nuk mund të mos përmend në këtë shkrim edhe gratë trime, pa të cilat njerëzimi nuk do të ishte këtu.

Por ka pasur gra shqiptare, që kapërcyen feminilitetin dhe traditat, që thyen tabu, u hodhën në beteja mizore në emër të një kauze të përbashkët, por që shpesh sakrificat dhe përpjekjet e tyre nuk përmenden, por ato lanë gjurmë në historinë e njerëzimit. Disa prej tyre janë: Teuta, Mbretëresha e Ilirëve. Luftëtarja, Mendimtarja dhe Strategia Mbretëresha Teuta, bëri ndryshime rrënjësore në kohën kur jetoi. Bota e ilirëve ishte ndryshe nga bota antike greke dhe romake. Gruaja ilire gëzonte shumë të drejtë në krahasim me greket. Ajo gëzonte të drejtën për trashëgimi, për arsimim madje kishte të drejtën t'i kthente lirinë skllëvërve. Teuta krijoi një ushtri të organizuar shumë mirë, flotë detare të fuqishme. Teuta vendosi kufi të stabilizuar mes mbretërisë ilire dhe botës së lashtë greke. Ajo udhëhoqi shumë beteja detare me anijet e famshme Liburne që ishin vepër e saj. Por edhe në botën tokësore ajo pati sukses. Ajo ndërmori masa të rëndësishme për mbrojtjen e vijës bregdetare të detit Adriatik. Me gjithë përpjekjet e saj Teuta nuk mundi të bllokonte konfliktin e armatosur të romakëve. Ishte viti 229 p.e.s., kur plasi lufta mbas ndërhyrjes së parë të romakëve në Iliri. Në drejtim të Mbretëreshës u mobilizuan nga Brindizi i Apulisë 20 000 ushtarë romakë, 2 000 kalorës me kuaj dhe 200 anije luftarake.

Mbretëresha nuk mundi t'i përballojë romakët, ajo pësoi humbje të rënda. Teuta me pak forca ushtarake që i kishin mbetur, u mbyll në qytetin e Rizonit (sot Mali i Zi). Ajo hyri në faqet e historisë së

njerëzimit si një personalitet i shquar i botës antike, ajo udhëhoqi shtetin ilir, të cilin e forcoi dhe e fuqizoi si dhe i rezistoi me trimëri dhe vetëmohim fuqive romake, ajo është trajtuar në shumë vepra të zhanreve të ndryshme. Ajo ishte nga gratë e rralla Mbretëreshë.

Elena Lucrezia Peshkopia, gruaja e parë në botë që arriti të marrë doktoraturën në filozofi

Pak e njohur nga shqiptarët, por shumë e njohur kudo në botë, sidomos në Akademitë e mëdha, Elena Lucrezia Peshkopia ishte me origjinë shqiptare. Ajo është gruaja e parë në botë që në vitin 1678 ka arritur të marrë doktoraturën në filozofi.

Gjatë shekullit ku jetoi ajo ishte gruaja më e ditur në Europë.

Statuja e Elenës që u gjet në Universitetin e Padovës, një prej universiteteve më të vjetër dhe ndër më të njohurit në Europë, dëshmon për vlerat e arritjeve të jetës së saj. Portreti i saj është gjithashtu edhe në dritaren e qelqit rreth 7 metra të lartë në bibliotekën "Frederick Ferris Thomson" në kolegjin "Vassar" të Nju Jorkut në SHBA, ku Elena është portretizuar, duke mbrojtur tezën e saj mbi Aristotelin.

Elena Peshkopia lindi në Venecia në vitin 1646, ajo përfundoi shkollën e shqiptarëve "Santa Maria dhe San Gallo" në Venecia (Scuola di Santa Maria e di San Gallo degli Albanesi).

Shkolla ku Elena mësoi është themeluar nga fisnikët e edukuar shqiptarë në 22 tetor 1442 dhe për rreth 200 vite vazhdoi të funksionojë për arsimimin e shqiptarëve deri në fund të shekullit të 18-të. Që prej fillimit, djemtë dhe vajzat e frekuentonin këtë shkollë së bashku, institucioni finançohej nga taksat që paguanin shqiptarët.

Në detyrimet përfshiheshin edhe gratë, por ato edhe do të mund të përfitonin. Godina e shkollës ishte dizajnuar nga shqiptari Viktor Karpaçi, artist i njohur gjatë periudhës së Rilindjes Europiane, ai mbikëqyri ndërtimin e ndërtesës dhe dekorimin e fasadave të shkollës, pikurat e tij janë gjetur në galeritë e Venedikut, Milanos, Parisit (Luvër), Vjenë, Londër.

Prezenca e madhe e shqiptarëve në Republikën e Venecias është lidhur me zhvendosjet e tyre sa më shumë drejt perëndimit si pasojë e pushtimit osman. Elena, e talentuar edhe në muzikë vazhdoi studimet në filozofi dhe astronomi, duke ndjekur edhe programin e doktoraturës në Universitetin e Padovës.

Ajo mbrojti teoritë e saj të doktoraturës, më 25 qershor 1678, para profesorëve të filozofisë dhe logjikës, mjekësisë dhe teologjisë. Ajo u bë një lektore në matematikë në Universitetin e Padovës, ku qëndroi deri në fund të jetës së saj së shkurtër. Elena Peshkopia ndërroi jetë nga tuberkulozi, më 26 korrik të vitit 1684, në moshë shumë të re, vetëm 38 vjeç. Ajo prehet në kishën e Shën Lukës në Padova të Italisë.

Laskarina Boubulina - Admirajla e parë grua në histori (1771- 1825)

Arvanitasja trime, komandantja e parë e flotës detare greke, heroina luftëtare trime e betejave të përgjakshme greko-turke, për pavarësinë e Greqisë admirajla e parë grua në botë. Laskarina lindi në burgun e Konstandinopojës. Ajo lindi ditën kur e ëma vizitoi të atin në atë burg të tmerrshëm mbas hekurave, i ati, kapiteni nga ishulli i Hidrës, uante



dënimin për shkak të pjesëmarrjes së tij në luftën e Peloponezitet. Ai vdiq pasi lindi Laskarina.

Edhe vetë Laskarina pati fat të njëjtë me nënën e saj. Martesa e dytë ishte me pronarin e anijes, kapitenin Dimitrios Boubulis, i cili u vra në vitin 1811 nga disa piratë algjerian, Boubulina ishte 40 vjeçe. Ajo trashëgoi biznesin e të shoqit por ndërtoi edhe katër anije të tjera. Pesë vjet më vonë osmanët bënë provë t'i sekuestronin pasurinë dhe sipas tyre ajo ishte pasuria e bashkëshortit të saj që kishte luftuar kundër turqve prandaj ata duhet ta sekuestronin.

Mbas shumë përpjekjesh në Krime, Laskarina ia doli t'i mbante anijet dhe gjithë pasurinë dhe u kthye në Specia. Atje ajo u bë anëtare e "Filiki Eterija", që ishte organizatë e fshehtë, që përgatiste revolucionin kundër perandorisë osmane. Ajo i furnizoi luftëtarët me armë dhe municione sipas historianëve, më 13 mars të vitit 1821. Ajo e udhëhoqi ushtrinë si kapitene e anijes së saj "Agamemnon".

Ajo lundroi me tetë anijet e saj për Nafpilion dhe organizoi një bllokadë detare. Gjatë luftës humbi të birin. Më pas Laskarinën e arrestuan dy herë dhe e kthyen në Specia, ku qëndroi atje deri në fund të jetës. Trimëresha Laskarina mbeti e vvarë në vitin 1825, si shkak i një zënke familjare. Pas vdekjes perandori rus Aleksandri I, i dha Laskarinës, titullin e lartë të 'Admirales'.

Eleni Bukura Altamura - Gruaja e parë piktore (1821-1900)

Eleni Bukura piktore, arvanitase. U lind në ishullin e Specias në Greqi. Me një mbiemër tipik shqiptar. Ajo ishte gruaja e parë piktore në Greqi, e para grua piktore me prejardhje shqiptare. Pati fat tragjik, duke qenë grua iu deshën kohë që të njihej nga intelektualët dhe artistët e kohës.



Eleni Bukura ka vlera të mëdha, nuk ishte vetëm gruaja e parë piktore në Ballkan, por ka hyrë në historinë botërore si gruaja e parë që studioi në Akademinë e famshme Artistike të Romës si dhe Napolit, ku shkolloheshin vetëm djem. Ishte shumë e talentuar dhe gëzonte simpatinë e profesorëve.

Mbetet nga gratë e rralla artiste të shekullit XIX, dhe ka lënë disa vepra grafike, studime plastike, që janë ekspozuar në muzeun e Specias. Ajo mbetet pararendëse e emancipimit kulturor-artistik i femrës, që ishte koncept i njohur pak për Greqinë dhe rajonin e asaj kohe. Ishte vajzë e bukur dhe inteligjente. Rridhte nga familje me tradita patriotike, e kulturuar dhe e pasur. Babai i saj arvanitasi Jani Bukura, ishte jo vetëm një luftëtar trim por dhe i kulturuar, me iniciativën e tij mbas revolucionit grek të vitit 1821, u ndërta teatri i parë grek. Teatri në Athinë ishte i veçantë me mure guri dhe hyri në histori si "Teatri Bukura". Sot kjo ndërtesë nuk ekziston.

Eleni u rrit me ndjenjën e të bukurës dhe dashurinë për artin. Është interesant fakti që Specia është e famshme jo vetëm për arvanitasen Laskarina Boubulina por edhe për Eleni Bukura Altamura. Duke vëzhguar edhe portretin e saj duket qartë që ajo kishte pamjen e një djali bukurosh me flokë të shkurtra dhe me pantallona. Pra ajo paraqitej si djalë jo si vajzë. Është e kuptueshme se nuk ishte e lehtë për një vajzë të vazhdonte studimet e larta në atë kohë. Arti i pikturës në atë kohë konsiderohej si një e drejtë vetëm për burrat. Atje ajo u dashurua me profesorin, piktorin arbëresh Saverio Altamura.

Patën tre fëmijë, Jani ishte djali i madh, pastaj Sofia dhe Aleksandri. Pas ndarjes me Saverion ajo u kthye në Greqi me fëmijët, i mbeti besnik burrit të saj deri në fund të jetës. Por tragjeditë e ndoqën këmba këmbës, Jani, djali i madh trashëgoi talentin dhe dashurinë për pikturën, pikturonte tema detare, por fatkeqësisht jetoi vetëm 25 vjet. Më pas vdiq djali tjetër, e bija. Pra u larguan nga kjo jetë të tre fëmijët. Pësoi kriza të rënda nervore dhe pas dhimbjes së thellë dhe vetmisë së plotë i dogji veprat e saj. U izolua nga bota e gjallë u mbyll në shtëpinë e saj në Specia si një personazh tragjik i antikitetit grek. U përpoq disa herë të vriste veten por përsëri u dënua nga fati të jetonte

gjatë. Vdiq në 1900 në ishullin e Specias, duke lënë veprën e saj.

Maria Antonia Braile (1894-1917) - Poetja e parë shqiptare që krijoi vargje për dashurinë

Maria lindi në fshatin e De Radës së madh, në Shën Dhimitër Korone në Kalabri, më 13 korrik 1894. U largua shumë e re nga kjo jetë. Ajo ishte një nga zërat e parë femëror, ku tingëlloi pena e gruas. Ajo theu shumë tabu për shkak të kohës dhe vendit ku jetoi dhe krijoi.



Jeta kulturore për gruan në atë kohë ishte fare e errët. Talenti dhe aftësitë e Marias ishin destinuar të fshiheshin e të qëndronin në hije. Ajo mbetet pjesë e botës shqiptare. Poezia e saj ishte shumë e ndjerë, e ëmbël, e thjeshtë dhe melankolike. Ajo ka hyrë në histori si poetja e parë dhe shumë shpirtërore. Nëpërmjet vargjeve që ajo thuri shpalli hapur identitetin e saj si grua dhe feminilitetin e saj plot dritë.

Poetesa jonë e shquar Prof. Dr. Klara Kodra, ndërsa shkruan për Maria Antonian nënvizon faktin se mbi të gjitha vlerat e krijimtarisë së saj qëndron të qenit grua. Duke u bazuar në krijimtarinë e saj vajzërore zbuluam një mesazh shumë të bukur, si vetë vajzat e reja plot freski shpirtërore plot pranverë. Ajo pati një letërkëmbim interesant me De Radën, është e para që botoi letërsi në gjuhën shqipe.

Nga kërkimet e bëra prej qarqeve të Diasporës, u gjend një përmbledhje e thjeshtë me vjersha e titulluar "Canti" (Këngët). Por ky libër nuk pati jehonë as në atdheun e të parëve, por as në mjediset arbërore. Shkrimet e saj u botuan nga i vëllai, i cili ishte poet. Quhej Salvatore Braile, me një individualitet të veçantë krijues. Libri ka mbetur një dokument me vlerë të madhe, si historik dhe letrar. Vëllimi përbëhet nga gjashtë pjesë.

Poezia është e ndier dhe ëndërrimtare. Pjesa më e madhe e poezive përbëhet nga lirika intime. Maria Antonia trajton poezi me temë patriotike, filozofike, erotike etj. Aty ka lirikë intime, guxim dhe shumë sinqeritet në shprehjen e ndjenjave.

Elena Gjika - Dora d'Istria - Intelektualja e Rrallë, Krenaria jonë (1828-1888)

Dora d'Istria, pseudonimi i Elena Gjikkës, ka qenë një figurë e rëndësishme e kulturës shqiptare dhe evropiane e mesit të shekullit XIX. Kjo shkrimtare rumune me prejardhje shqiptare pati lindur në Bukuresht në familjen aristokrate Gjika. Që në moshë të re Dora d'Istria udhëtoi me prindërit dhe vizitoi oborret e Vjenës, Drezdenit dhe Berlinit, dhe kudo u adhuroi për talentin dhe bukurinë.



Më 1849 martesa me princin Aleksandër Masalski e shpuri në Rusi, ku kaloi gati gjashtë vjet. Në 1855, u shpërngul në Zvicër, ishte e para grua që ngjiti Malin Jungfrau, kurse më 1860 bëri një udhëtim në Greqi. Pjesën tjetër të jetës e kaloi kryesisht në Itali. Përkushtimi i pareshtur i Dora d'Istrias ndaj aspiratave të pakicave kombëtare dhe të kombeve të vegjël, ndaj barazisë së gruas e ndaj integritit dhe arsimimit të saj. Ajo zgjodhi si pseudonim artistik emrin "Dora d'Istria", sepse përmbledhte gjithçka që përbënte themelin e punës së saj: lidhjen e fortë me vendin, rrënjët e saj dhe në të njëjtën kohë një konceptim kozmopolit, tolerant, të hapur ndaj botës dhe kulturës.

Në ndryshim me bashkëkohëset ajo pati një pseudonim femëror ndërsa intelektuale të tjera si Georga Sand pati pseudonimi mashkullor. Në një epokë që përtërinte magjepsjen e miteve të lashta të lumenjve, pseudonimin artistik nuk e zgjodhi në mënyrë të rastësishme: Dora d'Istria ishte efektivi Dora e Istros dhe Istro është Danubi, lumi i gjatë që kalon nëpër Rumani, pasi ka përshkuar tokat e tjera evropiane, nga malet gjermane në Detin e Zi, që bashkonte popujt për sa i përket historisë, politikës, fesë dhe gjuhës kurrë nuk e harroi origjinën e saj shqiptare.



Një ditë do të zgjohemi dhe do të jemi në gjendje t'i tregojmë historinë dikujt pa qarë dhe do ta dimë pa dyshim se jemi shëruar

Rrugët tona janë sigurisht të ndryshme, po ashtu sakrificat, idetë, ndjenjat për të cilat luftojmë, ëndrrat që mbyllim në zemër, për t'u përpjekur ndërkohë, të realizojmë ëndrra të njerëzve që i vëmë para vetes. Ja pse tingëllon kaq fuqishëm fjala grua, e cila brishtësinë e saj, e kthen në magji!

Grua...!

Tingëllon aq fuqishëm. Madje jam pothuajse e sigurt që tingëllon po aq bukur në çdo gjuhë të botës. Do ta quaja fatkeqësi për një popull nëse nuk do të kuptonte plotësisht se çfarë do të thotë grua dhe se sa e vakët do të ishte çdo sekondë pa prezencën e saj. Është madje ironike që në shumë kultura, figura e saj ulet, dhe pse?!

Mendimi im është ndoshta mendimi i një femre kryengritëse, e cila do cenonte krenarinë e gjinisë tjetër. Gjithmonë kam menduar se disa burra të vegjël, kanë frikë nga potenciali i saj. Madje, madje, gjithçka e përditshmërisë së saj shihet me një nënçmim, dhe është e qartë përse..., sepse kurrë nuk ka

munguar ajo përditshmëri, e nëse do të mungonte, do të ishte aq shumë e çmueshme...

E nëse do të uleshim të flisnim për gruan?!

Nëse do të analizonim çdo detaj të jetës së saj? I vjen ndokujt në mend fjala sakrificë kur flet për gruan? Mua po, madje fjala sakrificë më ulërit me të madhe kur them fjalën grua. Që fëmijë, shumë e vogël, një vajzë sakrifikon çokolatën e saj për vëllain. Po, unë e kam bërë, e madje jam e sigurt që çdonjëra nga ne e ka bërë... duket se prej atij momenti, jeta e saj, shënon një sakrificë të vazhdueshme, disa të nevojshme, e disa jo, disa të merituar nga pala tjetër, e disa jo....

Sigurisht bazohem më tepër tek femra shqiptare, duke qenë një femër e tillë vetë. E pavarësisht kësaj, duhet të nënvizojmë se të gjitha jemi rritur në familje të ndryshme, e sigurisht bazuar në këtë, kemi marrë formimin, kemi krijuar ëndrrat, zakonet, planet tona për jetën... që gjithsesi na duhet shpeshherë t'i ndryshojmë gjatë rrugës, sepse ne jemi femra!

E në gjithë këtë mes, më lejoni të them se duhet ta duartrokasim njëra-tjetrën, veçanërisht për faktin se sa shpejt adaptohemi në çdo situatë, në çdo vend, në rrethana që kurrë nuk i kishim menduar...!

Unë jam krenare për veten. Po, e them këtë me bindje.

A shkoi jeta ime ashtu siç e kisha planifikuar? Jo!

A u realizuan ëndrrat e mija? Jo të gjitha, deri më sot.

Por unë si njeri ndihem mjaftueshëm e realizuar, se gjithçka që kam përballuar, më kanë bërë atë që unë jam sot.

Si lufton një femër?

Është më e lehtë të falsifikosh një buzëqeshje sesa të shpjegosh pse je e trishtuar, sepse të gjithë janë ende duke u shëruar nga të gjitha gjërat për të cilat nuk flasin.

Disa gra kanë përjetuar aq shumë dhimbje në përditshmëri, saqë e kanë pranuar shprehjen “jam mësuar me të”.

Disa të tjera janë ende duke luftuar betejet e tyre të heshtura, dhe të dashurit e tyre nuk janë plotësisht të vetëdijshëm për këtë.

Por kjo është jeta, dhimbja është e pashmangshme. Çdo histori suksesi shënohet nga linjat e luftës dhe mavijosjet.

Një ditë do të zgjoheni dhe do të jeni në gjendje t'i tregoni historinë tuaj dikujt pa qarë dhe do ta dini pa dyshim se jeni shëruar.

Ndonjëherë do të humbisni interesin për gjërat që keni shijuar, jo sepse nuk i dëshironi më ato, por sepse shpirti juaj ka nevojë për



heshtje dhe paqe të brendshme.

Ndonjëherë është më mirë të shtrihen në shtrat dhe të dëgjoni muzikën tuaj të preferuar ose të shikoni filmin tuaj të preferuar vetëm, larg telefonit dhe të gjitha njoftimeve që ju shqetësojnë herë pas here.

Ndonjëherë është më mirë të kaloni kohë vetëm dhe të mendoni se çfarë doni të bëni, pse vazhdoni të toleroni rutinat e ndenjura dhe pse vazhdoni të qëndroni në vende ku nuk iu përkisni.

Ndonjëherë duhet t'i kushtoni vëmendje trupit dhe mendjes tuaj kur ju thotë të bëni një pushim nga bota e jashtme, të kujdeseni për veten dhe të pushoni derisa të ndiheni përsëri si vetvetja.

Bota nuk rrotullohet rreth buzëqeshjes suaj, dashurisë për dikë ose entuziazmit tuaj, përkundrazi, procesi përfshin heshtjen, trishtimin dhe vetminë. Këto janë pjesë e jetës dhe është më mirë të qani, të nxirri “dufin” tuaj sesa të buzëqeshi falco.

Merrni frymë thellë dhe mbani mend se mund t'i kuptoni të gjitha këto pa u shqetësuar se çfarë do të mendojnë të tjerët, sepse kjo është jeta juaj dhe nuk ka asnjë justifikim për të vënë veten në radhë të parë.

Asnjëherë mos vazhdoni një marrëdhënie të sforcuar...

Ndonjëherë është më mirë të ecësh përpara sesa të mbaresh pas dikujt që nuk e kupton se kush je në të vërtetë.

Fatkeqësisht, do të ketë raste kur mungesa juaj do t'ju mësojë atë që prania juaj nuk mund t'ju mësojë.

Ju duhet të ndaloni së thyeri zemrën tuaj, duke u përpjekur të bëni një marrëdhënie të funksionojë që qartësisht nuk është menduar të funksionojë. Ju nuk mund të detyroni dikë të interesohet sinqerisht për ju.

Ju nuk mund të detyroni dikë që të jetë besnik ndaj jush. Ju nuk mund ta detyroni dikë të jetë personi që ju keni nevojë për të.

E vërteta është, ndonjëherë personi që dëshironi më shumë është personi pa të cilin do të bënit më mirë.

Duhet të kuptosh që disa gjëra kanë për qëllim të hyjnë në jetën tënde, por jo për të qëndruar aty.

Çfarëdo që të bëni për të treguar dashurinë tuaj, duhet të jeni të kujdesshme që të mos humbisni veten tuaj, duke u përpjekur të rregulloni diçka që nuk duhet të kishte ekzistuar kurrë.

Ju nuk mund ta merrni marrëdhënien që ju nevojitet nga dikush që nuk është gati t'ju kthejë dashurinë që i jepni.

E di që është e vështirë kur takon dikë të cilin zemra jote ndjen sikur është personi me të cilin mund të kalosh gjithë jetën dhe të duhet të pranosh se nuk është personi që mendonit se ishte, që duhej të ishte.

Dhe pa marrë parasysh sa herë ju ka zënë gjumi duke qarë, përfundimisht do të shërohemi nga marrëdhënia juaj e vjetër dhe do të gjeni atë që keni dashur gjithmonë. E ardhmja juaj do t'ju lejojë të kuptoni pse gjërat nuk funksionuan në marrëdhëniet tuaja të mëparshme.

Nëse ata ju shohin si një opsion, ata nuk e meritojnë të jenë një prioritet në jetën tuaj.

Nëse e do këshillën time : Mos ndiq kurrë dikë që nuk të ndjek.

Një grua..., ata thanë, ...nuk është aq e fortë, sa është një burrë.

Një grua..., ata thanë, ...nuk mund të bëjë, atë që mund ta bëjë një burrë.

Një grua..., ata thanë, ...nuk është aq e mençur nga ç' mund të jetë një burrë.

Një grua..., ata thanë, ...nuk ka vlerë sa ç' ka një burrë.

Një grua..., ata thanë, ...me lindjen e saj, i bën të qajnë e të pikëllohen të gjithë.

Një grua..., ata thanë, ...është e derës së huaj.

Një grua..., ata thanë, ...rol të vetëm në jetë ka shërbimin ndaj burrit.

Por... ata që thanë e thonë kështu... me siguri nuk e dinë, që po ta dinte një grua, që ata do rriteshin e do flisnin ashtu... ajo grua do zgjidhte të mos bëhej kurrë nënë, se sa të jetë një nënë e një 'njeriu bosh'.

Mos provokoni që nëna juaj të pendohet që ju solli në jetë... sepse ky është dënimi më i madh që mund të marrësh nga jeta.



Nga Dhërmiu në Gjirin e Gramës, riviera shqiptare, oazë e preferuar për europeanët



Me 300 ditët e saj me diell në vit, ujërat bruz të detit Jon dhe ishujt e saj shkëmborë, Riviera Shqiptare është shtëpia e disa prej plazheve më të bukura në Evropë.

Një plejadë limanesh dhe ishujsh shkëmborë me ujëra bruz, duket si një pikturë e Van Gogh-ut. Greqia, Italia? Jo, një vend mesdhetar në zemër të Evropës: Shqipëria.

Vija bregdetare e saj është për t'u pasur zili nga vendet e tjera të Mesdheut. Vendi i shqiponjave ndodhet në veri të Greqisë përballë Italisë. Në perëndim kufizohet nga detet Adriatik dhe Jon.

Moti? 300 ditë me diell në vit. Në jug të vendit ndodhet një bregdet i mrekullueshëm me ujëra të kristalta, shkëmbinj dhe kodra të gjelbëruara, kjo është Riviera Shqiptare.

Vija bregdetare është e përbërë nga kështjella antike, kanione, limane dhe plazhe të izoluar.

Plazhet më të njohura apo trendi, shkëmbore apo të fshehura, ja cilat janë më të bukurat: Plazhi i Porto Palermos dhe ishulli i thesarit.

I parë nga lart, duket si një ishull thesari, i rumbullakët dhe i rrethuar me ujëra të pastra kristal, me shkëmbinj, kodra mes blusë dhe smeraldit të detit Jon.



Plazhi i Porto Palermos

Plazhi i Porto Palermos, është i fshehur në një nga gjiret në jug të vendit. Duket si një përrallë: ishulli është shtëpia e një kështjelle të lashtë në formë trekëndore dhe tre kullave gëlqerore.

Kështjella u ndërtua në vitin 1804 nga Ali Pasha, ish-guvernatori i Perandorisë Osmane. Ju mund të notoni në rripin e ngushtë me rërë që lidh ishullin me tokën, në plazhin e Palermos.



Plazhi i Ksamilit, apo Maldivet e Shqipërisë

Përballë Plazhit të Ksamilit ngrihen si tym malet. Është Korfuzi, ishulli grek, më pak se pesë kilometra larg, në anën tjetër të detit. Plazhi i Ksamilit ofron një atmosferë helene: kudo ka ishuj me ujëra blu në të gjitha nuancat e tyre.

Bukuritë e rivierës shqiptare gjithnjë e më tepër po bëjnë dallimin për veçantitë e tyre. Plazhi i Ksamilit renditet ndër më të bukurit në Shqipëri. Uji i pastër kristal dhe gurët që qëndrojnë anash detit e bëjnë të duket këtë vend si parajsë.

Ndër plazhet që mund të vizitohen janë, Stela, Bora Bora, por mund të merrni, gjithashtu, me qira një makinë dhe të zbuloni më shumë plazhe aty pranë, si Plazhin e Pulëbardhës, Plazhin e Krorëzës dhe Shpellën e Pëllumbave.

Perëndimi i mrekullueshëm mund të vështrohet nga këtu.



Plazhi i Gjipesë, 'margaritari i fshehur' i bregdetit shqiptar

Me të mbërritur këtu, do të keni ndjesinë sikur jeni në fund të botës. Plazhi i Gjipesë është i izoluar, i fshehur pas një kanioni 800

metra të gjatë.

Ky vend është një nga plazhet më magjepsëse në Rivierën Shqiptare, me një sipërfaqe prej 400 metrash me guralecë dhe limane të vegjël të rrethuar nga shkëmbinj të lartë 50 metra.



Himara

Kur deti përshkon murin shkëmbor dhe shpellat mbushen me shumë kristallore, përpara të shfaqet një spektakël. Këto shpella mund të eksplorohehen falë motit të ngrohtë dhe të favorshëm.

Parkoni në manastirin e Shën Theodorit midis qytetit të Iljasit dhe Dhërmiut, më pas ecni 2,5 kilometra deri në plazh, ose merrni me qira një kajak në plazhin e Jalës aty pranë, dhe do të kuptoni që jeni para vegimit të një parajse.



Gjiri i Gramës

Më shumë se 2000 vjet më parë, në kohët e lashta, lundruesit që udhëtonin përgjatë bregdetit ndaluan këtu, në Gjirin e Gramës. Këtu mund të zbuloni mijëra gdhendje në greqishten e vjetër dhe latinisht në muret shkëmbore të këtij lokaliteti arkeologjik: Gjiri i Gramës, në Gadishullin e Karaburunit. Shpellat janë një mister i këtij vendi idilik me ujërat bruz, guralecë të bardhë dhe bimësi të dendur.

Me pak fjalë, të jep idenë e një Parajse: një restorant i vetëm, pa rrjet telefonik dhe akses i rezervuar për më të motivuarit.

Për të arritur në Gjirin e Gramës duhet të ecni 13 kilometra në një shteg bregdetar nga Palasa, ose, merrni një varkë nga Dhërmiu dhe udhëtoni 40 minuta. Shumë shpella mund të eksplorohehen me varkë.

Plazhi i Lllamanit

I vendosur mes dy gjermadhavë shkëmbore, Plazhi i Lllamanit ka një sipërfaqe prej 200 metrash me guralecë të imët.

I vogël në përmasa, plazhi i Lllamanit nuk është më pak i

popullarizuar. Shumë vizitorë marrin me qira çadra dhe shezlongë, shijojnë mbrëmjet dhe muzikën elektronike në verë.

I vendosur pak kilometra larg Himarës, plazhi i Lllamanit është gjithashtu një vend i famshëm për zhytje. Plazhi ka një hapësirë



prej disa mijëra metrash katrorë. Zallishtja e imët, uji i kthjellët dhe i pastër si kristali, perceptohen lehtësisht nga njerëzit që vijnë këtu për herë të parë. Gjithçka të bën për vete. Nëse vendos të vish një herë, nuk mund të mos kthehesh sërish. Ky kënd i fshehur në bregdetin e Himarës, është ndjellës. Mbart mbi vete kërkshërinë që e nxit njeriun ta eksplorojë. Në këtë pikë, vizitori gjendet mes detit, malit dhe qiellit, që duket se tentojnë të bashkohen në një pikë të vetme,



Plazhi i Dhërmiut

Dhërmiu, fshat i krahinës së Himarës, vendosur buzë detit Jon dhe në shpatet e maleve Vetëtimë Pritëse, Akrokerauneve, (që poeti romak Horaci i cilëson si “infames scopulos Acroceraunia”), midis gjelbërimit të ullinjve dhe agrumeve të shumta, fshati ka një bukuri madhështorë, dhe sipas udhëtarit anglez Lir është më i madhërishtëm në vendosjen e tij, se çdo vend tjetër që kam parë në Akrokeraunet dhe që i ngjan jo pak Atranit apo Amalfit.

Dhërmiu shtrihet në fund të një plazhi më tepër se pesë kilometra të gjatë, plazh i cili përfundon më një kodër, mbi të cilën ngrihet manastiri i Shën Theodorit. Fshati përbëhet nga tre lagje: Kondraqa, apo Kallami që është lagja e parë për ata që vijnë nga Llogoraja, vijuar nga Gjileku dhe Dhërmiu - lagja e tretë dhe më e madhja që i ka dhënë edhe emrin fshatit. Fshati ka rreth 600 shtëpi, ku rreth 300 janë në Dhërmi, 150 në Gjilek dhe 150 në Kondraq. Fshati i Dhërmiut ndodhet 52 km në Jug të Vlorës, 72 km në veri të Sarandës dhe rreth 210 km nga kryeqyteti i Tiranës. Nga ana administrative Dhërmiu bën pjesë në Bashkinë e Himarës, krahinën e Himarës, rrethi i Vlorës. Dhërmiu është një vend ku gërshetohet tërheqja nga deti i kaltër dhe i pastër i Jonit më atë të ajrit të pastër dhe të shëndetshëm të maleve. I mbrojtur nga veriu nga gadishulli i Karaburunit, fshati është tepër tërheqës edhe në periudhën e dimrit, pa vënë në dyshim atë të verës që tërheq edhe më shumë turistët. I cilësuar si një nga perlat e Rivierës shqiptare është pa dyshim nga vendet më tërheqëse të Shqipërisë, siç njihet edhe shumë guida turistike të vendit dhe të huaja.

REVISTA MBROJTJA



*[http://www.mbrojtja.gov.al/
index.php/publikime/
revista-mbrojtja](http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja)*